



# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**(Mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)**

**“BASHKIA FINIQ”**

**Tiranë, Prill 2020**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë  
Finiq.

<b>Nr.</b>	<b>PËRMBAJTJE</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMbledhje Ekzekutive.....</b>	<b>4-4</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA.....</b>	<b>4-9</b>
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>9-11</b>
<b>IV</b>	<b>DREJTIMET E AUDITIMIT.....</b>	<b>11-154</b>
	A/1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.....	11-13
	A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.....	13-17
	B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....	17-24
	B/1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.....	24-46
	C. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018 dhe 2019.....	46-68
	C/1. Ekzekutimi i testeve thelbësore të veprimeve të kryera me bankë	68-80
	D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për prokurimet publike.....	80-140
	D/1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.....	140-153
	E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.....	153-157
<b>V</b>	<b>OPINIONI AUDITIMIT.....</b>	<b>157-159</b>
<b>VI</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMIT.....</b>	<b>159-189</b>
<b>VII</b>	<b>ANEKSE.....</b>	<b>186-219</b>



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operator Ekonomik.



### I/a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi kanë rezultuar këto gjetje:

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (balance) të viteve 2017 - 2018, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një opinion të **kundërt**, pasi nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancën financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.
- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një opinion të **kundërt**, pasi janë konstatuar parregullsi në lidhje me mos përgatitjen e unifikimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e vijim AK), të reflektuara me mospërdorimin e fondeve buxhetore me efektivitet me efekt negativ në vlerën **41,773 mijë lekë**.  
*Gjithashtu,*
- Në zbatimin e kontratave të punëve publike dhe shërbimeve janë konstatuar parregullsi për vlerën e dëmit ekonomik **20,654 mijë lekë**, nga e cila vlera 18,010 mijë lekë mos përfundim në afat të punimeve dhe vlera 2,644 mijë lekë mos kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit të punimeve.
- Në administrimin e shpenzimeve operative në buxhet (llog. 602), janë konstatuar veprime financiare me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Finiq me vlerë **3,019 mijë lekë**, nga e cila shpenzime për fatkeqësi natyrore (djegie të shëgëve) për vlerën 1,176 mijë lekë, shpenzime telefonike në vlerën 551 mijë lekë dhe mos argumentim me dokumentacion i përdorimit të karburantit me vlerë 1,292 mijë lekë.
- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime dhe Vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak, për arkëtimin e vlerës **186,939 mijë lekë**, nga e cila dem ekonomik në vlerën 10.800 mijë lekë, mungesë të ardhurash në shumën 36,041 mijë lekë dhe borxh tatimor në vlerën 150,898 mijë lekë.
- Në administrimin e shpenzimeve operative në buxhet (llog. 602), nuk është arritur efienca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit me vlera të vogla, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, veprime financiare me dëm ekonomik në vlerën **143 mijë lekë, etj.**
- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e kaluara, duke vlerësuar se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre, kryesisht për vlerën e shpërblymit të dëmit prej **55,331 mijë lekë**.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, aktrakordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari te lidhura me to; 467-Kreditore te ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime, si dhe 47 procedura prokurimi me vlerë kontrate 403,322 mijë lekë ose 94% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 – 31.12.2019.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1048/1prot, datë 24.12.2019 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 26.12.2019 deri në datën 28.02.2020, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2019 “Auditimi Financiar dhe Përputhshmërisë” nga Grupi i Audituesve Shtetërore:

1. K. Gj, *Përgjegjës Grupi*
2. R. Xh, *Auditues*
3. J. L, *Auditues*
4. A. Z, *Kryeauditues*
5. S. M, *Auditues*

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), auditoi pasqyrat financiare të viteve 2017 dhe 2018, mbi bazën e materialitetit dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditi i Brendshëm. Zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura, procedurat e dhënies së lejeve të zhvillimit/ndërtimit dhe të përdorimit, si dhe veprimtaria e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq.

Auditimi i pasqyrave të vitit 2019 nuk u krye, pasi deri në datën e përfundimit të punës në terren këto pasqyra nuk ishin mbyllur nga ana e subjektit Bashkia Finiq, ku afati për mbylljen e tyre është data 31.3.2020, në zbatim të udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes dhe paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare”.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 18 akte, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 27.02.2020.

Me shkresën nr. 1048/2, datë 10.03.2020, nga KLSH ju dërgua subjekti të audituar Bashkia Finiq Projektraport Auditimi për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive mbi problematikat e trajtuara nga grupi i auditimit të KLSH. Nga ana e subjektit Bashkia Finiq, me shkresën nr. 1209, datë 15.04.2020 u paraqitën vërejtjet e Projektraport Auditimit, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga grupi i auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato që kishin mbështetje ligjore, ndërsa për problematikat e tjera të cilat nuk argumentoheshin me dokumentacion mbështetës, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

- a) **Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërisë.
- b) **Marrësi:** Projektraport Auditimi i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Finiq.
- c) **Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Përcaktimi nëse pasqyrat financiare të subjektit që auditohet janë paraqitur saktë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit financiar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord të procedurave të prokurimit, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime<sup>1</sup>.

<sup>1</sup>-Rregullorja e procedurave të auditimit në KLSH, faqe 28



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### **Objektivat e auditimit synojnë:**

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

#### **d) Identifikimi i çështjes.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Finiq, si dhe përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaje komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

#### **e) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Kryetari i Bashkisë Finiq (*Nëpunësi autorizues*) K. K. dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) L. M. janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6 e nenit 34, neneve 65- *Administrata e njësisë administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e nenit 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore” .

#### **f) Përgjegjësitë e Audituesve:**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.
- b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)
- e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Finiq, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

#### g) Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, etj.
- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...”, i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- ✓ Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurën e përgatitjes dhe paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare”.

#### h) Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

*Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:*

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë" që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

#### i) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, të Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe shqyrtimit me objektivitet dhe profesionalizim të u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimit.

#### j) Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), operative (602) dhe investime (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për





vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **k) Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

#### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

#### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshime.

#### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### 7. Intervistimi

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### 8. Raporte dhe Informacione

### 9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

## III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

### 1. Informacioni i përgjithshëm:

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Aludimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Finiq është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Finiq etj. akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Finiq.

#### 1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Finiq bën pjesë në Qarkun e Vlorës.

#### Të dhëna të përgjithshme:

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Finiq kufizohet në veri me bashkinë Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiq.



**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km<sup>2</sup>. Në bazë të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë/ km<sup>2</sup> ndërsa në bazë të regjistrat civil densiteti është 88.51 banorë/km<sup>2</sup>.

Njësitë administrative përbërëse janë: Finiq, Aliko, Mesopotam, Dhiver dhe Livadhja.

Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e rrethit Sarandë, qarku Vlorë. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censurit 2011	Popullsia sipas Regjistrat Civil	Sipërfaqja km <sup>2</sup>
Vlorë	Fshati Derndsh	Livadhja	Fshatrat: Livadhja, Kufëriç, Liriat, Kalrat, Koster, Leher Fari, Gravy, Qisarat, Surrat, Kanoq, Grazhdan, Zimzac.	11,862	39055	441.2
		Dhivër	Fshatrat: Dhivër, Rumanos, Memeraj, Naxeris, Qermish, Lehnice, Gpërma, Lehnice e Poshtme, Beniot, Ukupat, Carkevas, Shëndra, Makran			
		Aliko	Fshatrat: Aliko, Çorçit, Rreçis, Tromul, Ratuë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Hato, Drita			
		Finiq	Fshatrat: Finiq, Suronq, Çimri, Urion, Karahashë, Bregat			
		Mesopotam	Fshatrat: Mesopotam, Dheogjan, Krongj, Histris, Vlahanit, Lirinë, Bojlat, Grakat, Koster, Fitozë, Kravë, Ardashosë			

### Profili i bashkisë

Bashkia Finiq është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrëzomës së Vurgut. Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo zonë ka



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi.

Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit.

Infrastruktura e komunës është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkuftare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.

#### 2. Të dhëna mbi gjetjet nga auditimet e mëparshme:

Kjo Bashki është audituar nga KLSH-ja për një periudhë nga 01.01.2013 – 31.7.2015 sipas programit të auditimit nr. 494/1, datë 16.5.2016, ku në përfundim të të gjitha hallkave të procesit të auditimit ka dalë vendimi i Kryetarit të KLSH nr. 155, datë 9.11.2017 me rekomandime përkatëse për përmisimin e gjendjes në këtë bashkia.

Kështu sipas këtij vendimi janë rekomanduar 17 masa organizative, 18 masa shpërblim dëmi me vlerë 52,025 mijë lekë; një masë për mos përdorim me efektivitet të fondeve të prokuruar me vlerë 840 mijë lekë; masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për 14 punonjës; 13 masa administrative për APP mbi shkeljet e konstatuara në fushën e prokurimeve, ku nga verifikimi i zbatimit të tyre është konstatuar se nuk janë zbatuar, gjë për të cilën trajtohet gjerësisht në kapitullin IV/E të këtij materiali.

#### **2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:**

*a. Objekti i këtij auditimi*, është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana Bashkisë Finiq përgjatë periudhës 01.01.2017 deri më 31.12.2019.

*b. Qëllimi i auditimit*, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

*c. Fushëveprimi*: Auditimi ka përfshirë fushën e prokurimeve publike, veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, administrimi i Aseteve, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, dhënien e lejeve zhvillimore/ndërtimit dhe përdorimit, veprimtaria e IMT, hartim e zbatimi i buxhetit si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

*d. Misioni*, për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

*e. Objektivat*, burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

<sup>3</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.*

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.*

*Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.*

*Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë*

*Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre. Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.*

**f. Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku.

## IV. DREJTIMET E AUDITIMIT

### IV/A. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.

*A/3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.*

**1. Titulli i gjetjes:** *Mungesa e një kuadër të plote rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit në hartimin e regjistrit të risqeve si dhe mos marrja e masave për ngritjen e strukturave përkatëse siç është koordinatori i risku dhe ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).*

#### **Situata:**

**1-Mjedisi i kontrollit.** Në Bashkinë Finiq, nuk është miratuar kodi i etikës profesionale në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

*Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në papajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2.*

*Në këtë Njësi Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.*

#### **Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:**

*Sipas strukturës organizative të Bashkisë Finiq, janë miratuar 52 vende pune në pozicionin e shërbimit civil, nga të cilët aktualisht; 16 vende pune janë punonjës të cilët kanë marrë statusin e nëpunësit civil, 32 punonjës janë punësuar duke u trajtuar me kontratë pune ose 61% e pozicioneve me statusin civil nuk trajtohen si të tillë, 2 punonjës janë në periudhe prove dhe 2 vende pune janë ende bosh pa emëruar punonjës.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Numri total i punonjësve referuar muajit Shtator 2019, sipas strukturës organizative të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë (VKB) është 200 punonjës, paguar në fakt 196 punonjës.

Numri i punonjësve të niveleve të ndryshëm të cilët janë larguar nga puna nga Titullari i Bashkisë ose të vetë larguar është sipas viteve si vijon:

-Në vitin 2017, janë larguar 7 punonjës,

-Në vitin 2018 janë larguar 13 punonjës dhe

-Në vitin 2019, janë larguar gjithsej 68 punonjës.

**2- Menaxhimi i riskut.** Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, në Bashkinë Finiq, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore pasi nuk është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Për rrjedhojë nuk është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk dhe për rrjedhojë nuk janë marrë masa për menaxhimin e riskut.

**3-Veprimtaritë e kontrollit.** Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga ana e Titullarit të Bashkisë Finiq, nuk janë nxjerrë urdhër me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit.

Nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që:

-ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, Kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave;

-sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë;

Nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 27. Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, nuk janë miratuar nga GMS-ja në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 "Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm", Kap. V.

**4-Informacioni dhe komunikimi** (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

**5-Monitorimi** (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Në monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, u konstatuan se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore, konkretisht janë konstatuar shumë raste ku marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Raste të këtyre shkeljeve, janë trajtuar gjatë auditimit të transaksioneve me bankën në opinionin mbi pasqyrat financiare.

#### **Kriteri:**

Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4 pika 19, nenet 21, 22, 23, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32, UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 "Procedura përgatitjes të Buxhetit afatmesëm", Kap. V dhe UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" pika 40;





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### Impakti:

Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos miratimi i gjurmëve të auditimit, mos organizimi dhe funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), trajnimi për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit.

#### Shkaku:

Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### Rëndësia: *I mesëm.*

#### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së, të nxirren përgjegjësitë më qëllim që GMS-ja të kryejë funksionet e veta ligjore.

Të hartohet regjistri i riskut e në mënyrë periodike të analizohen dhe merren masa për risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave. Të hartohet rregullore për kodin e etikës dhe zbatimin e ligjit për arkivat. Për proceset kryesore të punës të hartohet gjurma e auditimit.

***(Gjerësisht trajtuar faqen 12-17 të Projektraport Auditimit)***

#### **A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.**

##### *-Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditimit të brendshëm;*

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Finiq (këtu e vijim AB), është siguruar si shërbim auditimi me akt marrëveshjen të lidhur midis titullarëve të njësisë Bashkia Dropull dhe Finiq, me nr 1333prot, të ofertuesit dhe nr. 2465prot, të përfituesit, datë 4.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13478/1prot, datë 31.10.2016, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe neni 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, e cila jep shërbim dhe në Bashkinë Finiq në mbështetje të Akt marrëveshjes, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm (këtu e vijim NJAB)”, e cila, për vitin 2016 funksiononte në nivel sektori (*sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 1 datë 23.02.2016*), ndërsa për vitin 2017 e në vazhdim, kjo njësi funksionon në nivel drejtorie (*sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 69 datë 28.12.2016, për vitin 2018 me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 57 datë 21.12.2017, si dhe për vitin 2019 me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 71 datë 23.11.2018, vendime të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë*).

##### *- Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm.*

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion, NJAB gjatë vitit 2017, kishte në përbërjen e saj 4 punonjës, *përkatesisht 1 drejtues dhe 3 specialiste auditimi*, me profili arsimor diplomuar në fushën e ekonomisë, ku dy prej tyre ishin të çertifikuar (*drejtuesi dhe një auditues*), 1 (një) auditues ishte në proces çertifikimi dhe 1 (një) auditues i pa çertifikuar, strukturë e cila ka vijuar dhe gjatë vitit 2018.

Për vitin 2019, kjo njësi kishte në përbërjen e saj 5 punonjës, *përkatesisht 1 drejtues dhe 4 specialiste auditimi*, me profili arsimor të diplomuar në fushën e ekonomisë, ku tre prej tyre ishin



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

te çertifikuar ( drejtuesi dhe dy auditues), 1 (një) auditues ne proces çertifikimi dhe 1 (një) auditues i pa çertifikuar. Audituesi i pa çertifikuar ne muajin Shtator 2019 është larguar me kërkesën e vet.

Struktura e kësaj njësie auditimi, ne forme tabelore për periudhën e audituar 2017 - 2019, paraqitet si me poshtë:

Nr	Nga data e krijimit deri me 30.06.2019	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi auditim/vite	Çertifikimi	Trajtime te vijueshme
<b>Për vitin 2017</b>							
1.	S. K	Drejtori i njësisë	Ekonomist	34	26	Ne vitin 2005	Po
2.	M. M	Përgjegjës sektori	Ekonomiste	30	23	Ne vitin 2005	Po
3.	J. M	Audituese	Financierë	5	2	Ne vitin 2018	Po
4.	K. K	Auditues	Ekonomiste	18	1	Pa çertifikuar	Jo
<b>Për vitin 2018</b>							
1.	S. K	Drejtori i njësisë	Ekonomist	34	26	Ne vitin 2005	Po
2.	M. M	Përgjegjës sektori	Ekonomiste	30	23	Ne vitin 2005	Po
3.	J. M	Audituese	Financierë	5	2	Ne vitin 2018	Po
4.	L. K	Audituese	Ekonomiste	18	1	Pa çertifikuar	Jo
5.	A. P	Auditues	Financier	10	1	Ne proces	Jo
<b>Për vitin 2019</b>							
1.	S. K	Drejtori i njësisë	Ekonomist	34	26	Ne vitin 2005	Po
2.	M. M	Përgjegjës sektori	Ekonomiste	30	23	Ne vitin 2005	Po
3.	J. M	Audituese	Financierë	5	2	Ne vitin 2018	Po
4.	L. K	Audituese	Ekonomiste	18	1	Pa çertifikuar	Jo
5.	A. P	Auditues	Financier	10	1	Ne vitin 2019	Po

*-Numri i subjekteve që i nënshtrohen auditimit. Kapaciteti auditues i njësisë së auditimit të brendshëm të institucionit, në raport me detyrimet për auditim.*

**Për vitin 2017,** janë realizuar:

- **Angazhime auditimi për shërbime këshillimi,** kërkuar nga Titullari i Bashkisë Finiq, me arsyetimin mbi problematikat e hasura gjate zbatimit te reformës Administrativo territoriale, Strategjisë se Decentralizimit e miratuar ne Korrik 2015, si dhe te ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- **Angazhim përputhshmërie dhe financiare,** ne zbatim te programit vjetor me nr. 527 prot datë 02.03.2017, me program angazhimi pranë Bashkisë Finiq me nr. 720 datë 27.03.2017, për zhvillimin e një angazhimi qe nga dita e krijimit te kësaj Bashkie deri ne fund te vitit 2016, ku janë planifikuar për tu audituar pjesa e katër Njësive Administrative si dhe e gjithë veprimtaria e Bashkisë.

**Për vitin 2018,** janë realizuar:

- **Me auditim përputhshmërie,** ne Njësitë Administrative Mesopotam, Livadhja, Dhiver dhe Aliko. Auditimi është realizuar ne zbatim te planifikimit vjetor 2018, miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me nr. 2989 datë 18.10.2017, sipas programeve te angazhimit me nr. 934/2, 935/2, 936/2 dhe nr. 937/2 datë 05.04.2018, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2017 deri me datë 31.03.2018, auditim i cili është realizuar brenda 3 mujorit te dyte te vitit 2018.

Auditimet e realizuara ne 4 Njësitë Administrative te Bashkisë Finiq, kane pasur si objekti kryesor vlerësimin e funksionimit te sistemit mbi krijimin dhe funksionimin e këtyre njësive administrative.

- **Është realizuar auditim i kombinuar,** për veprimtarinë e Njësisë vendore Bashkia Finiq, kjo sipas programit te angazhimit me nr.1520 prot, datë 06.06.2018, për periudhë veprimtarie 01.01.2017 deri me 31.05.2018. Ky auditim ka përfunduar dhe është dorëzuar projekt Raporti i





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

auditimit ne Bashki me shkresën nr. 3226 prot, datë 26.11.2018, por nuk është bere evadimi përfundimtar brenda vitit 2018.

**Për vitin 2019**, janë realizuar:

- Raportimi i auditimit te kombinuar te realizuar gjate vitit 2018 dhe raportuar ne fillim te vitit 2019, ku u është kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve qe lidhen me vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar te Bashkisë, prokurimet me fonde publike, administrimit te asetëve, taksat dhe tarifat vendore, dhënien me qira te pyjeve e kullotave, etj.

Nga grupi i auditimit janë konstatuar shkelje te procedurave, te meta e mangësi ne zbatimin e legjislacionit dhe akteve ligjore e administrative qe rregullojnë funksionimin e Institucionit si ne drejtim te fushës financiare, pagesave te pa ligjshme, administrimit material e monetar, te prokurimeve publike, te cilat kane sjelle për pasoje shkelje te disiplinës financiare me dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë ne vlerën **241,629,096 lekë**.

*- Përcaktimi i objektivave dhe i fushave prioritare, plotësimi i pyetësorëve për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit të brendshëm dhe efektivitetit të sistemeve, vlerësimin e koeficientit të riskut sipas sistemeve.*

Fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar janë ne një nivel të lartë risku, ku përfshijnë: *sistemi i prokurimeve, fushat me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, të cilat shfaqen me mangësi në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik, fusha ku ka nivel të ulët të njohurive dhe zbatimit të procedurave të zhvillimit të prokurimeve publike, dhe kryesisht në drejtim të vendosjes së kriterëve të veçanta në përputhje me përcaktimet ligjore të legjislacionit për prokurimet publike, plotësimi dhe arshivimi i dosjes së procedurës së zhvilluar etj.*

Nga ana e NjAB janë lënë rekomandimet përkatëse për sistemet e audituara duke synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve. Theksojmë se rekomandimet, ndonëse janë pranuar, nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve është ende për të dëshiruar.

Për këtë nga ana e NjAB, ne zbatim te kërkesave te pikës 4.1.13.3 te Manualit te Auditimit te Brendshëm “Përgjegjësia e njësive për te zbatuar rekomandimet e Auditimit te Brendshëm”, me shkresën nr. 3109 prot, datë 22.10.2019, i është kërkuar Bashkisë Finiq “Dhënie informacioni mbi ecurinë e zbatimit te rekomandimeve te lëna..” por deri tani nuk ka një njoftim zyrtar për këtë.

*- Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.*

Planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit te AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi”, ku nga ana e grupit te auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake te subjektit qe do te auditohet me subjektin. Gjate kryerjes se angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve te auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos se veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

*- Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga NjAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj,

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II te MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, veprime të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.

*- Realizimi i planit periodik dhe vjetor, analiza sipas llojit të auditimeve, respektimi i frekuencës së auditimit të subjekteve sipas shkallës së riskut.*

Nga të dhënat e pasqyrave bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, konstatohet se:

*Për vitin 2017, nga NJAB janë realizuar 3 misione auditimi kundrejt 3 misioneve të programuara.*

*Për vitin 2018, janë realizuar **4 misione** auditimi kundrejt **5 misioneve** të programuara, ku njëri është në proces mbyllje.*

*Në përfundim të misioneve të auditimit, janë rekomanduar 33 masa organizative dhe 6 masa shpërblim dëmi me vlerë 32 mijë lekë, kjo në fushën e taksave.*

*Për vitin 2019, janë realizuar **3 misione** auditimi kundrejt **3 misioneve** të programuara.*

*Në përfundim të misioneve të auditimit, janë rekomanduar 59 masa organizative dhe 35 masa shpërblim dëmi me vlerë 139,035 mijë lekë, nga e cila në fushën e prokurimeve për vlerën 116,702 mijë lekë, në sistemin e pagave në vlerën 949 mijë lekë, në zbatimin e kontratave të qirasë në vlerën 21,117 mijë lekë dhe të tjera 20 mijë lekë (në mënyrë analitike janë paraqitur në pasqyrën aneks A/4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Situata:**

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Finiq, nuk është bërë i mundur realizimi i kontroleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera.

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike”, të Bashkisë Finiq.

#### **Impakti:**

Mos thellimi në problematikat e trajtuara sipas fushave në auditimet e kryera si dhe mos nxjerrja e përgjegjësiave e mos marrja e masave për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke mos realizuar kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.

**Rëndësia:** I mesëm



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në subjekt, gjetjet nga auditimi të raportohen si parim i rëndësishëm në raportin përmbledhës, i cili duhet të ketë një shkresë përcjellëse, dhe t'i kërkoher menaxherit të njësisë së audituar të reagojë në lidhjet me rekomandimet.

Të kryhet Monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 17-21 të Projektraport Auditimit)*

**IV/B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017" dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", me ndryshime.**

**1. Titulli i gjetjes:** *Shkelje të procedurave të programimit të buxheteve afat mesëm 2017-2019, 2018-2020 dhe 2019-2021.*

#### Situata:

##### **Programimi i PBA 2017-2019.**

Nga titullari i Bashkisë Finiq, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit (GMS).

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2016, në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33.

-Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 34 .

-Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës) në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 37 .

##### **PBA 2018-2020**

Tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm, është miratuar me VKB nr. 61/1, datë 04.04.2017 mbi "Miratimin e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm të bashkisë Finiq për periudhën 2018-2020" i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me nr. 996 prot., datë 29.05.2017.

Tavanet përfundimtare të programit buxhetor, janë miratuar me VKB nr. 69, datë 21.08.2017 mbi "Miratimin e tavanëve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të Bashkisë Finiq për periudhën 2018-2020".

Buxheti afatmesëm 2018-2020, është miratuar me VKB nr. 71, datë 05.10.2017 mbi "Miratimin e PBA-së me tavanet buxhetor afatmesëm të Bashkisë Finiq për periudhën 2018-2020" i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me nr. 2174 prot., datë 26.10.2017.

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2017, në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Fiq.

*-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë , Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të ardhurave dhe shpenzimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.*

#### **PBA 2019-2021**

Miratimi i taveve buxhetore është bërë në mbledhjen e Këshilli të Bashkisë me nr. 94, datë 15.03.2018, i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me nr. 477 prot., datë 10.04.2018.

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2018, në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33.

*-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë , Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të ardhurave dhe shpenzimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.*

-Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës) në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

#### **PBA 2020-2022**

Miratimi i taveve përgatitore të programit buxhetor 2020-2022 është bërë me VKB nr. 8, datë 08.05.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. 1485/1 prot., datë 20.10.2019.

-Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës) në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37 (Me pretendimin se nuk ka funksionuar Këshilli Bashkiak)

#### **Kriteri:**

Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34 dhe 37.

**Impakti:** Në programimin e tregueseve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet

**Shkaku:** Mos njohja e legjislacionit në fuqi si dhe mos organizimi i dhe ndarja e detyrave sipas grupeve të punës. Mos funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

**Rëndësia:** E mesme

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Fiq, të marrë masa për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore në programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesëm, duke ngritur në kohën e duhur, grupet e punës sipas projekteve të financimit. Të monitorohet zbatimi i kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.

**2. Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2017, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

#### **Situata:**

*-Buxheti faktik për vitin 2017, është miratuar me VKB nr. 92 datë 15.03.2018, i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë, me nr. 477 prot., datë 10.04.2018, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 51, i ndryshuar me Vendimin Nr. 62 datë 04.04.2017 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2017 të Bashkisë Fiq”*

*-Detyrimet kreditore për fund vitin 2016, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritet 401-408 për vlerën 39,566,427 lekë.*



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Shlyerja e këtyre detyrimeve, nuk është programuar si zë më vehte i tregueseve të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101.

-Në vitin 2017, është prokuruar me tender objekti: “Ndërtim rruga Shën Varvarë” me fondin limit 8,262.214 lekë me burim financimi nga të ardhurat e bashkisë, pa miratuar si objekt në këshillin e bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” neni 40 dhe kërkesat e pika 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

Zbatimi i buxhetit viti 2017. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.

### **Pasqyra nr. 1.** Shpenzimet buxhetore sipas zërave dhe burimeve për vitin 2017

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Burimet e fondeve 000/lekë	Viti 2017.		
			Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat		114,924	106,907	93
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore		20,267	17,350	86
3	602 Shpenzime operative		77,564	62,010	80
4	604+609 Ndhimat ekonomike		6,189	1,000	16
5	606 Shpërblim lindje+ emergjence civile		101,123	101,123	100
6	230 +231 Studime projektive		190,987	179,679	95
7	466 Mjete në ruajtje				
	Të trashëguara nga viti kaluar	216,040			
	Transferta të pa kushtëzuara	119,025			
	Transferta specifike	47,191			
	Të ardhurat vendore të vitit	60,369			
	FONDE nga FZHR	68,429			
	Donatorë	0			
	Transferta e Kushtëzuar	0			
	Etj.	0			
	<b>TOTALI</b>	<b>511,054</b>	<b>511,054</b>	<b>468,069</b>	<b>92</b>

**Burimi:** Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 511,054 mijë lekë, realizuar 468,069 mijë lekë ose në masën 92%.

Pagat janë realizuar në masën 93 %, shpenzimet operative janë realizuar 80% dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 95%.

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

-216,040 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,

-60,369 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor,

-68,429 mijë lekë fonde nga FZHR dhe të tjerat transferta të pa kushtëzuara dhe specifike.

-Nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim

-Nuk janë paraqitur në Këshillin e Bashkisë jo më pak se 4 raporte vjetore mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor.

### **Kriteri:**





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, nenet 40 dhe 46; kërkesat e pika 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

### **Impakti:**

Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Finiq dhe performancën në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor.

**Rëndësia:** I lartë

**3. Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitet 2018, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

### **Situata:**

-Për vitin 2018, buxheti i Bashkisë Finiq, është miratuar Vendimin e Këshilli Bashkiak nr. 79, datë 29.12.2017 dhe i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. 168 datë 18.01.2018.

Totali i këtij buxheti është miratuar për shumën 285,331 mijë lekë.

Gjatë vitit, buxhetit të miratuar në fillim të vitit, i janë bërë ndryshime të miratuara me vendime të Këshillit të Bashkisë, të cilat janë si vijon:

-Vendimi i Këshillit nr. 100 datë .04.05.2018 “Për ndryshime në buxhetin e vitit 2018 duke arritur shumën 441.054 mije lekë.

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës për vitin 2018 është programuar për shumën 2.000.000 lekë fond rezervë dhe për shumën 1.000.000 lekë fondi i kontigjencës, sipas kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40/6.

-Realizimi i buxhetit faktik për vitin 2018, është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr. 1, datë 13.03.2019 mbi; “Miratimin e mbylljes së Buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2018”

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit janë në total 57,634,322 lekë përkatësisht sipas llogarive; llogaritë 401-408 për vlerën 47,554,814 lekë dhe 467 për vlerën **10,079,508 lekë**.

Shlyerja e këtyre detyrimeve, nuk është programuar si zë më vehte i tregueseve të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101.

-Në vitin 2018, është prokuruar me tender objekti: “Rikonstruksion i rrugës Karoq” me fondi limit 12,469,313 lekë me burim financimi nga të ardhurat e bashkisë, pa miratuar si objekt në këshillin e bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” neni 40 dhe kërkesat e pika 5, Kap. i të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

Zbatimi i buxhetit viti 2018. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e	Burimet e	Viti 2018
----	----------------------------------	-----------	-----------



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

	fondeve	fondeve 000/lekë	Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat		129,095	121,053	94
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore		22,199	20,098	91
3	602 Shpenzime operative		95,832	84,748	88
4	604+609 Ndihmat ekonomike		1,007	1,004	99
5	606 Shpërblim lindje+ emergjence civile		104,190	103,491	99
6	230 +231 Studime projektive		269,687	231,513	86
7	231 Investime objekte				
8	466 Mjete në ruajtje				
9	Etj.				
	Të trashëguara nga viti kaluar	213,132			
	Transferta të pa kushtëzuara	120,442			
	Transferta specifike	40,434			
	Të ardhurat vendore të vitit	63,223			
	FONDE nga FZHR	80,589			
	Donatorë				
	Transferta e Kushtëzuar	104,190			
	Etj.				
	<b>TOTALI</b>	<b>622,010</b>	<b>622,010</b>	<b>561,907</b>	<b>90</b>

*Burimi: Drejtorie Ekonomike, te dhënat të cilat janë përpunuar nga grupi i KLSH*

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 622,010 mijë lekë, realizuar 561,907 mijë lekë ose në masën 90%.

Pagat janë realizuar në masën 94 %, shpenzimet operative janë realizuar 88% dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 86%.

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

-213,132 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e papërdorur të ardhura të veta dhe grande,

-63,223 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor,

-80,589 mijë lekë fonde nga FZHR dhe të tjerat transferta të pa kushtëzuara dhe specifike.

**-Nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46.**

### **Kriteri:**

Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, nenet 40 dhe 46; kërkesat e pika 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

### **Impakti:**

Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Finiq dhe performancën në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor.

**Rëndësia:** I lartë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**4. Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve. Në zbatimin e buxhetit, në dy raste u konstatuan shkelje ligjore me dëm ekonomik për vlerën totale 1,727,531 lekë.

#### Situata:

-Për vitin 2019, buxheti i Bashkisë Finiq, është miratuar Vendimin e Këshilli Bashkiak nr. 123, datë 17.12.2018 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019, ku të ardhurat dhe shpenzimet gjithsej janë miratuar në shumën 347,878 mijë lekë, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. 11/1 datë .09.01.2018.

Gjatë vitit, buxhetit të miratuar në fillim të vitit, i janë bërë ndryshime të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 2, datë 13.03.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Buxhetin e Bashkisë Finiq për vitin 2019”

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës për vitin 2019 është programuar për shumën 1.000.000 lekë fond rezervë dhe për shumën 1.000.000 lekë fondi i kontigjencës, sipas kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40/6.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit janë në total 60.238.456 lekë përkatësisht sipas llogarive; llogaritë 401-408 për vlerën 60.238.456 lekë dhe 467 për vlerën 0 lekë.

Shlyerja e këtyre detyrimeve, nuk është programuar si zë më vete i tregueseve të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101.

Zbatimi i buxhetit viti 2019. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse është si në pasqyrën që vijon:

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Burimet e fondeve 000/lekë	Viti 2019		
			Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat		139,708	127,869	92
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore		25,324	22,040	87
3	602 Shpenzime operative		75,841	71,019	95
4	604+609 Ndihmat ekonomike		283	283	100
5	606 Shpërbllim lindje+ emergjencë civile		93,810	93,810	100
6	230 +231 Studime projektme		112,149	87,525	78
7	231 Investime objekte				
8	466 Mjete në ruajtje				
9	Etj.				
	Të trashëguara nga viti kaluar	109,560			
	Transferta të pa kushtëzuara	116,070			
	Transferta specifike	41,926			
	Të ardhurat vendore të vitit.	60,451			
	FONDE nga FZHR	25,133			
	Donatorë	0			
	Transferta e Kushtëzuar	99,203			
	Etj.				
	<b>TOTALI</b>	<b>447,116</b>	<b>447,116</b>	<b>402,546</b>	<b>90</b>

**Në këtë shumë të shpenzimeve janë përfshirë edhe Delegim fondesh për U. Kanalizim sha shuma 10,002 mijë lekë për financimin e pagave dhe sigurime shoqërore.**

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 447,116 mijë lekë, realizuar 402,546 mijë lekë ose në masën 90%.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Pagat janë realizuar në masën 92 %, shpenzimet operative janë realizuar 95% dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 78%.

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

-109,560 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,

-55,224 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor,

-25,133 mijë lekë fonde nga FZHR dhe të tjerat transferta të pa kushtëzuara dhe specifike.

***-Nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46.***

***-Në zbatimin e buxhetit për vitin 2019, u konstatuan disa raste të shkeljes së disiplinës financiare, konkretisht:***

***Në një rast për vlerën 1,176,000 lekë, shkelje e disiplinës financiare:***

-Me urdhër shpenzimi nr. 99, datë 05.03.2019, është paguar K. E shpërblim dëmi në shumën 1,176,000 lekë, procedurë e pa mbështetur në ligj me efekt me dëm ekonomik.

Pagesa është bërë bazuar në dokumentacionin bashkëngjitur si vijon:

-Më datën 28.09.2019, i protokolluar në Bashkinë Finiq me Nr. 2594 prot, K. E, ka bërë kërkesë drejtuar Bashkisë Finiq për mbështetje financiare për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri që ka rënë datë 25-26 ora 00 në fshatin Mesopotami, ku i janë djegur kulturat e mbjella me shegë dhe ullinj.

Këto kultura janë mbjellë në kadastrën e qerasë lidhur me Bashkinë Finiq më datën 05.08.2013, sipërfaqe prej 10,998 m<sup>2</sup>, afati 99 vjet.

-Sipas urdhrit të Titullarit të Bashkisë, datë 28.09.2018, është përgatitur akt ekspertiza nga specialistët e Drejtorisë së AMT-së: K. D, K. S dhe A. M. Sipas Akt Ekspertizë dëmi i shkaktuar nga zjarri, është vlerësuar në shumën 1,176,000 lekë.

-Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr. 120, datë 29.10.2018 mbi: “Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri në fshatin Mesopotam, Njësia Administrative Mesopotam”, është miratuar “dhënie ndihmës financiare për shtetasin K. E për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zjarr i rënë me datën 25-26 Shtator në fshatin Mesopotam”.

Në këtë vendim, nuk është përcaktuar vlera e ndihmës financiare të miratuar.

-Sekretari i Këshillit të Bashkisë, me shkresën nr. 2974 prot., datë 02.11.2018 mbi: “Për shprehje të ligjshmërisë së Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Finiq”, i ka kërkuar Prefektin të Qarkut Vlorë, shprehje ligjshmërie.

-VKB i referohet ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 (I cili përcakton kompetencat e KB për miratimin e buxhetit) si dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

**Në këtë procedura dëmshpërblimi, janë këto shkelje ligjore:**

1- VKB nuk është shprehur për vlerën që duhet të dëmshpërblejë Bashkia Finiq, ai është një vendim vetëm në parim si i tillë nga ana financiare, nuk është i plotë dhe i zbatueshëm..

2- VKB nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarku Vlorë,

3- Në VKM nr. 329, datë 16.05.2012, nuk janë parashikuar procedura të vlerësimit të dëmeve në biznese, në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës.

***Në shpenzimet për telefon celular.***



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Me urdhër të kryetarit të bashkisë L. H me nr. 34, datë 27.02.2018 prot., 617, është miratuar financimi i shpenzimeve për telefon celulari për 27 punonjës në shumat nga 600 lekë në muaj deri 11,200 lekë në muaj për Kryetarin e Bashkisë.

Shumat e pagesave që Bashkia Finiq ka paguar për telefonat celularë për 27 funksionet, për vitet 2018 dhe 2018, është në shumën totale **551,531 lekë të vlerësuara me dëm ekonomik**, sipas viteve është për vitin 2018 në shumën 256,015 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 295,516 lekë.

### **Kriteri:**

Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, *Kap. III- Procedurat në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile, pika 1- Procedurat e vlerësimit të dëmit, shkronja (ë) dhe (f) dhe VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pasjen me numër telefon celular të personave juridikë dhe publikë”*, pika 9, 11.

### **Impakti:**

Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Finiq dhe performancën në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor.

**Rëndësia:** *I lartë*

### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore, si dhe të kërkohet arkëtimi i vlerës së dëmit nga personat përfitues.

***(Gjerësisht trajtuar në faqen 21-28 të Projektraport Auditimit)***

## **IV/B.4. Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.**

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në Bashkinë Finiq, bëhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore (*këtu e vijim DAV*), ku për vitin 2017 me urdhër nr. 107, datë 01.11.2017 nga Kryetari i Bashkisë është miratuar struktura me 5 punonjës, nga të cilët 1 (një) përgjegjës dhe 4 specialist. *Për vitin 2018* me urdhër nr. 27/7, datë 01.10.2018 është miratuar struktura me 9 punonjës, nga të cilët 1 (një) drejtor, 2 specialist vlerësimi dhe 6 inspektor terreni dhe *për vitin 2019* me urdhër nr. 14/7, datë 23.8.2019 është miratuar struktura me 10 punonjës, nga të cilat; 1 (një) drejtor, 2 përgjegjës sektori (*sektori i planifikimit dhe sektori i inspektimit në terren*) dhe 7 specialist, më hollësisht pasqyra:

<i>Nr.</i>	<i>Emri Mbiemri</i>	<i>Funksioni Sipas Strukturës</i>	<i>Lloji i shkollës</i>	<i>Larte ose i mesëm</i>	<i>Urdhri i emërimit</i>
------------	---------------------	---------------------------------------	-----------------------------	------------------------------	------------------------------



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

a	b	1	2	3	Nr, datë
1	I. N	Drejtor	Eko. Finance	I larte	11/10/2019
2	TH. Z	Përgjegjës i te Ardhurave	Ekonomist	I larte	1990
3	R. B	Përgjegjës i inspektimit ne teren	Ekonomist	I Larte	01/11/2011
4	V. B	Sp.i vlerësimit ,planifikimit	Ekonomist	I Larte	16/10/1992
5	Z. D	Sp.i vlerësimit ,planifikimit	Ekonomist	I Larte	2011
6	G. A	Sp.i vlerësimit ,planifikimit	Ekonomist	I Larte	24/01/2019
7	Z. K	Inspektor Taksash	Ekonomist	I Larte	12/09/2014
8	K. L	Inspektor Taksash	Ekonomist	I larte	01/09/2009
9	V. SH	Inspektor Taksash	Agronom	I Larte	11/09/2019
10	E. SH	Inspektor Taksash	Ekonomist	I larte	12/08/2019

• *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

*Për vitin 2017*, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr. 41, datë 20.01.2017 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2017”, *për vitin 2018*, miratuar me VKB-në nr. 78, datë 29.12.2017, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2018” dhe *për vitin 2019* miratuar me VKB-në nr. 122, datë 17.12.2018 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019”.

Në **Tabelën B/1** paraqitet i detajuar parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, përkatësisht për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

**Tabela B/1.** Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

(në mijë lekë)

Nr	Lloji I Taksës	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>	<b>1,000</b>	<b>78</b>	<b>8</b>	<b>800</b>	<b>400</b>	<b>50</b>	<b>500</b>	<b>416</b>	<b>83</b>
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	1,000	78	8	800	400	50	500	416	83
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>	<b>40,120</b>	<b>25,345</b>	<b>63</b>	<b>34,680</b>	<b>24,764</b>	<b>71</b>	<b>59,630</b>	<b>31,253</b>	<b>52</b>
1	Taksa mbi B. Vogël			0			0			0
2	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	7,450	4,679	63	6,000	6,440	107	16,960	6,839	40
3	Taksa mbi token Bujqësore	28,500	17,565	62	22,000	16,045	73	37,000	14,935	40
4	DRTSH			0			0	1,500	2,866	191
5	Takse mbi regj e Automjete	1,500	344	23	1,500		0		47	0
6	Taksa e ndik Infrasturk	50	555	1,110	1,000	1,516	152	1,200	3,278	273
7	Kalim te pronësie	1,000		0	1,000	165	17	50	31	62
8	Takse Tabele	500	1,306	261	1,300	416	32	320	452	141
9	Takse Parkimi	100	71	71	80	59	74	100	88	88
10	Taksa Trualli	520	345	66	1,800	123	7	2,500	2,717	109
11	Takse reklame	500	480	96			0			0
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga Tarifat</b>	<b>12,920</b>	<b>6,907</b>	<b>53</b>	<b>11,620</b>	<b>9,655</b>	<b>83</b>	<b>18,120</b>	<b>12,197</b>	<b>67</b>
1	Tarife Pastrimi	4,000	3,671	92	5,000	4,945	99	11,000	8,520	77
2	Tarife leje transport.	120	183	152	120	369	308	120	94	78
3	Vaditje			0	1,900	149	8	2,200	1,366	62
4	Tarifa për gjuetarin	5,000		0			0			0
5	Tarife ndriçimi rrugor			0	4,600	38	1	4,800	2,217	46
6	Tarifë për ndric ambiente pub.biz	3,800	3,053	80		4,154	0			0
<b>IV</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>22,170</b>	<b>28,040</b>	<b>126</b>	<b>30,220</b>	<b>25,549</b>	<b>85</b>	<b>17,560</b>	<b>16,546</b>	<b>94</b>
1	Shërbim Administrativ	140	723	517	150	1,779	1,186	1,500	1,307	87
2	Te ardhura nga nder/ pronësia	6,210	1,340	22			0			0
3	Qira kullote	6,050	10,143	167	12,820	13,991	109	12,300	11,105	90
4	Tarifë uji i pijshëm	5,000	3,592	72	5,100	32	1			0
5	Qira toke për mbjellje me drufrutore	1,700	1,267	75	1,750	2,499	143	1,800	1,871	104
6	Gjoha te Policisë Bashkiake	200	55	27	200	0	0	150	10	7
7	Legalizime	400		0	6,200	0	0			0
8	Te ardhura te tjera	2,370	10,770	454	3,600	3,990	111	1,000	1,863	186



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nr	Lloji I Taksës	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9
9	Sekuestrim dhe Zhdëmtim			0			0	60		0
10	Gjoha nga Inspektorati			0			0	150		0
11	Leje Ndertimi	100		0	200	0	0	100	164	164
12	Leje veprimtarie			0	200	0	0			0
13	Grand			0		2,492	0			0
14	Kamatvonesa		149	0		766	0	500	226	45
	<b>GJITHSEJ (I+II+III+ IV)</b>	<b>76,210</b>	<b>60,369</b>	<b>79</b>	<b>77,320</b>	<b>60,368</b>	<b>78</b>	<b>95,810</b>	<b>60,412</b>	<b>63</b>

*Burimi: Drejtoria e të Ardhurave, përpunuar nga grupi i KLSH*

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2017, të ardhurat paraqiten me një mosrealizim në masë 15,841 mijë lekë ose 79%, ku nga 76,210 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 60,369 mijë lekë. Për vitin 2018, me mosrealizim në masë 16,952 mijë lekë ose 78%, ku nga 77,320 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 60,368 mijë lekë dhe për vitin 2019, me mosrealizim në masën 35,398 mijë lekë ose 63%, ku nga vlera e planifikuar prej 95,810 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 60,412 mijë lekë.

### 1. Titulli gjetjes. Analiza e disa zërave kryesore të detyrimeve fiskale (taksa/ tarifa vendore):

#### Taksës së tokës.

Nga auditimi i procedura e në lidhje me arkëtimin e taksës së tokës, konstatohet se planifikimi i kësaj takse bëhet sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë Bashkia Finiq, konkretisht pasqyra si vijon:

Nr.	Njësia AD	VITI 2017		VITI 2018		VITI 2019	
		Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Vlera	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Vlera	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Vlera
1.	Finjq	1304.09	3,324,411	1304.3	3,324,888	1302.926	3,325,624
2.	Dhiver	1227.281	2,430,465	1213.49	2,403,920	1196.1	2,365,764
3.	Livadhja	2271.55	5,217,732	2359.753	5,403,010	2358.663	5,399,960
4.	Aliko	1631.486	4,821,442	1939.148	5,723,259	1939.148	5,723,209
5.	Mesopotam	1606.005	3,633,091	1606.155	3,633,443	1607.087	3,635,627
	<b>TOTALI....</b>	<b>8040.412</b>	<b>19,427,141</b>	<b>8422.846</b>	<b>20,488,520</b>	<b>8403.924</b>	<b>20,450,184</b>

Nga sa shikohet dhe nga të dhënat e pasqyrës B/1 si mëposhtëm, niveli arkëtimeve të taksës së tokës nga një periudhë në tjetrën paraqitet në rritje, konkretisht: për vitin 2017 janë debitor **4472** familje për vlerën **52,120,652 lekë**, për vitin 2018 paraqiten **4712** familje me vlerë **56,798,915 lekë** ose shtuar për **240** familje me vlerë **4,678,263 lekë**. Ndërsa për vitin 2019 janë **4421** familje me vlerë **62,291,161 lekë**, rritur për vlerën **5,492,246 lekë** nga viti 2018, të dhëna këto të cilat tregojnë mos menaxhim të mirë të kësaj takse.

Deri me 31.12.2019 gjendja e debitorëve të abonentëve familjar që nuk kanë paguar detyrimet për taksat e tarifën vendore (taksën e tokës/ ndërtesës/ ndriçim/ pastrim/ vaditje), paraqitet në nivele të lartë për **16079** familje me vlerë **91,155,843 lekë**, ku sipas deklaratimit verbal të Drejtorit të Taksave z. I. N vjen si rezultat i largimit të familjeve jashtë vendit dhe mos shfrytëzimi i tyre, *të dhëna sipas pasqyrës Aneks B/1.*

NJ.A.	Taksa Dhe Tarifa	Debitor 31.12.2017		Debitor 31.12.2018		Debitor 30.12.2019	
		Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke
FINIQ	Toke Bujqësore	538	5,270,759	719	6,159,945	725	7,169,272
	Takse Ndërtese	598	845,478	874	1,624,381	884	2,522,602
	Tarife Ndriçimi/PAS	618	1,419,500	845	2,127,150	938	3,177,149
	Tarife vaditje			747	249,189	712	420,870
	<b>Shuma</b>	<b>1754</b>	<b>7,535,737</b>	<b>3185</b>	<b>10,160,665</b>	<b>3259</b>	<b>13,289,893</b>





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

NJ.A.	Taksa Dhe Tarifa	Debitor 31.12.2017		Debitor 31.12.2018		Debitor 30.12.2019	
		Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke
LIVADHJA	Toke Bujqësore	1281	23,415,856	1340	24,887,731	1350	26,634,515
	Takse Ndërtësë	1306	674,700	1329	2,015,026	1337	3,557,781
	Tarife Ndrëçimi/PAS.	1306	1,884,000	1329	3,127,160	1337	4,661,200
	Tarife vaditje				285,766	536	317,631
<b>Shuma</b>		<b>3893</b>	<b>25,974,556</b>	<b>3998</b>	<b>30,315,683</b>	<b>4560</b>	<b>35,171,127</b>
ALIKO	Toke Bujqësore	1140	11,454,616	1170	13,285,069	693	14,945,804
	Takse Ndërtësë	1105	401,200	1150	1,251,585	825	2,142,080
	Tarife Ndrëçimi/PAS	1105	1,339,021	1150	2,129,909	842	2,970,089
	Tarife vaditje		0		777,447	520	901,716
<b>Shuma</b>		<b>3350</b>	<b>13,194,837</b>	<b>3470</b>	<b>17,444,010</b>	<b>2880</b>	<b>20,959,689</b>
DHIVER	Toke Bujqësore	992	5,624,449	956	5,751,425	1025	6,438,691
	Takse Ndërtësë	830	247,075	774	685,149	875	1,256,052
	Tarife Ndrëçimi/PAS	830	1,300,975	774	1,955,118	875	3,028,946
	Tarife vaditje					0	
<b>Shuma</b>		<b>2652</b>	<b>7,172,499</b>	<b>2504</b>	<b>8,391,692</b>	<b>2775</b>	<b>10,723,689</b>
MESOPOTAM	Toke Bujqësore	521	6,354,972	527	6,714,745	628	7,102,879
	Takse Ndërtësë	534	259,500	543	750,280	618	1,357,960
	Tarife Ndrëçimi/PAS.	484	876,300	543	1,213,900	619	1,772,600
	Nga KLSH T.BUJQ				470,072	282	307,845
	Tarife vaditje			444	362,920	458	470,161
<b>Shuma</b>		<b>1539</b>	<b>7,490,772</b>	<b>2057</b>	<b>9,511,917</b>	<b>2605</b>	<b>11,011,445</b>
TOTALI BASHKIA FINIQ	Toke Bujqësore	4472	52,120,652	4712	56,798,915	4421	62,291,161
	Takse Ndërtësë	4373	2,427,953	4670	6,326,421	4539	10,836,475
	Tarife Ndrëçimi/PAS	4343	6,819,796	4641	10,553,237	4611	15,609,984
	Nga KLSH T.BUJQ	0	0	0	470,072	282	307,845
	Tarife vaditje	0	0	1191	1,675,322	2226	2,110,378
<b>TOTALI</b>		<b>13188</b>	<b>61,368,401</b>	<b>15214</b>	<b>75,823,967</b>	<b>16079</b>	<b>91,155,843</b>

Burimi: Të dhënë janë marrë nga DAV dhe DMMT, përpunuar nga grupi i auditimit.

Këto të dhëna tregojnë se puna e kësaj administrate në menaxhimin e taksave/ tarifave nga abonentët familjarë nuk është në nivelet e duhura, ku nuk i kushtohet vëmendje e duhur vjeljes së detyrimeve, të dhëna këto të cilat tregohen dhe nga niveli lartë i debitorëve prej **91 milionë lekë, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkia Finiq.**

Grafikisht paraqitet kjo situatë:



### **-Taksa vendore mbi biznesin e vogël/ Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.**

Sipas të dhënave të pasqyrës, kjo taksë për vitin 2017 është realizuar në masën 8%, ose nga 1,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 78 mijë lekë, më pak për vlerën 922 mijë lekë. Për vitin 2018, është realizuar në masën 50%, ku nga 800 mijë lekë është arkëtuar vlera 400 mijë lekë. Për vitin 2019 realizimi paraqitet në nivelin 83%, ku nga 500 mijë lekë është arkëtuar vlera 416 mijë lekë.

Mbledhja e kësaj takse behet me agent tatimor (Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë), e cila është përgjegjëse për menaxhimin e kësaj takse, referuar të dhënave që subjektet deklarojnë në fund të periudhave në administratën fiskale për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### -Tatimi mbi ndërtesat.

Sipas të dhënave të pasqyrës, kjo taksë *për vitin 2017* është realizuar në masën 63%, ose nga 7,450 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 4,679 mijë lekë. *Për vitin 2018*, është realizuar në masën 107%, ku nga 6,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 6,440 mijë lekë. *Për vitin 2019* realizimi paraqitet në nivelin 40%, ku nga 16,960 mijë lekë është arkëtuar vlera 6,839 mijë lekë.

#### Situata:

Konstatohet se dokumentacioni mbështetës mbi llogaritjen e kësaj takse nuk është i saktë, kjo pasi është bërë mbi bazën e vetë deklarimeve të subjekteve, duke mos marrë informacion nga ish- ZVRP Sarandë (sot ASHK)/ dhe ose kryerjen e verifikimeve në terren me grup pune, në lidhje me sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo të mundësuar taksimin e saktë të kësaj takse dhe afër realitetit,

#### Kriteri:

Neni 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime dhe pika 2.1 e VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

**Impakti:** Mos aplikimin e saktë të taksës së ndërtesës.

**Shkaku:** Mungesa e azhurnimit të plotë të legjislacionit në fuqi.

**Rëndësia:** I mesëm

#### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, Bashkia Finiq për rastet e mungesës së të dhënave nga ASHK Sarandë mbi sipërfaqen e objekteve, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës dhe të verifikojë në vend sipërfaqet e objekteve për të bërë të mundur saktësinë e vetëdeklarimit të subjekteve për sipërfaqen e ndërtimit dhe për rastet e diferencave të aplikohen taksa e ndërtesës për gjithë periudhën e pataksuar.

**-Tarifa e pastrimit/ ndriçimi.** Sipas të dhënave të pasqyrës, *për vitin 2017* është realizuar në masën 86%, ose nga 7,800 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 6,724 mijë lekë. *Për vitin 2018*, është realizuar në masën 95%, ku nga 9,600 mijë lekë është arkëtuar vlera 9,137 mijë lekë. *Për vitin 2019* realizimi paraqitet në nivelin 68%, ku nga 15,800 mijë lekë është arkëtuar vlera 10,737 mijë lekë.

Kjo taksë është parashikuar nisur nga numri i bizneseve sipas llojit të aktiviteteve dhe familjarëve të cilët duhet të shlyejnë detyrimet në territorin e Bashkisë Finiq. Sipas të dhënave arkëtimet më të mëdha janë nga subjektet, pasi niveli i arkëtimeve nga abonentët familjarë është shumë i vogël.

#### Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se referuar Vendimeve të KB te viteve 2017 dhe 2018, nga Bashkia Finiq është planifikuar **tarifë gjelbërimi**, ku për subjektet fizike është 2,000 lekë, subjektet juridike 3,000 lekë dhe abonentë familjarë në vlerën 1,000 lekë,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Referuar njoftim detyrimi që DAV ju nis subjekteve fizik/ juridik dhe abonentëve familjarë, konstatohet se Sektori i Vlerësim Planifikimit nuk ka bërë të mundur aplikimin e kësaj tarifë, pavarësisht faktit që në VKB është planifikuar, veprime të cilat kanë çuar në mos planifikim të ardhurash dhe mungesë në të ardhurat e Bashkisë Finiq për vlerën **14,396,000 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi: TH. Z. me detyrë Përgjegjës i të Ardhurave, V. B. Z. D. me detyrë Përgjegjës Sektori Vlerësim Planifikim të Ardhurash**, pasqyra.

SUBJEKTET	Nr.	Tarifa	Vlera	Vitet 2017+2018	Total detyrim
FIZIKE	157	2,000	314,000	2	628,000
JURIDIK	77	3,000	231,000	2	462,000
Abonentët familjare	6653	1,000	6,653,000	2	13,306,000
<b>TOTALI</b>	<b>6887</b>	<b>6,000</b>	<b>7,198,000</b>	<b>6</b>	<b>14,396,000</b>

#### Kriteri:

Për vitin 2017, paketa e taksave/ tarifave vendore në territorin e Bashkisë Finiq është miratuar me VKB-në nr. 41, datë 20.01.2017 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2017”, për vitin 2018, miratuar me VKB-në nr. 78, datë 29.12.2017, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2018”.

#### Impakti:

Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Finiq për vlerën 14,396,000 lekë të periudhës 2017 -2018.

**Shkaku:** Mungesa e azhurnimit të plotë të Vendimeve të KB.

**Rëndësia:** I lartë

#### Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për planifikimin e tarifës së gjelbërimit ndaj subjekteve fizik/ juridik dhe abonentëve familjare për vitet 2017 dhe 2018, si një tarifë e miratuar në vendimet respektive të KB, por të paaplikuar nga kjo drejtorinë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për të mundësuar arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën **14,396,000 lekë**.

#### -Të ardhura nga qiratë e ndryshme.

Sipas të dhënave të pasqyrës, për vitin 2017 është realizuar në masën 185%, ose nga 7,750 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 11,410 mijë lekë. Për vitin 2018, është realizuar në masën 113%, ku nga 14,570 mijë lekë është arkëtuar vlera 16,490 mijë lekë. Për vitin 2019 realizimi paraqitet në nivelin 92%, ku nga 14,100 mijë lekë është arkëtuar vlera 12,976 mijë lekë.

#### Situata:

Bashkia Finiq, nuk ka ndjekur si duhet menaxhimin e asetëve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre pasi shumica e asetëve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël.

#### Kriteri:

Kapitullin e III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimin i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 e Urdhrit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kërkesat e VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

**Impakti:** Mos menaxhim i aseteve, bën që Bashkia Finiq të kenë mungesë të ardhura

**Shkaku:** Neglizhencë e strukturave drejtues.

**Rëndësia:** *i mesë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në eficensë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre.

#### **Situata:**

Nga Bashkia Finiq janë lidhur 2 (dy) kontrata për dhënien me qira të objekteve në pronësi të bashkisë (Kontrata nr. 2052, datë 24.07.2019, “Për dhënien me qira të objektit në fshatin Krane, NJA Mesopotam”, me palë qiramarrëse S. Ç dhe Kontrata nr. ska, datë 04.01.2017, “Për dhënien me qira të objektit ish-Vatra e Kulturës, NJA Aliko”, me palë qiramarrëse V. C).

Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës, si dhe nuk rezultoi të jetë hartuar procesverbal dorëzimi, genplani i objektit, pamje fotografike, gjendja fizike dhe vlera kontabël; nuk janë dërguar periodikisht pranë degës së Shoqërive Publike Vlorë evidenca e objekteve të dhënë me qira si dhe në fillim të çdo viti ushtrimor, për vitin paraardhës evidencat e plota të qirave; si dhe në kontratën e vënë në dispozicion nuk rezultoi bashkëlidhur genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë.

#### **Kriteri:**

VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, *Kreu II* plotësisht kërkesat të pikave (b; c; ç; d; e).

**Impakti:** Mos menaxhim kontratash nga personat përgjegjës.

**Shkaku:** Mungesë të ardhurash në Bashkinë Finiq.

**Rëndësia:** *I ulët*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa që në të ardhmen jo vetëm të lidhë kontratat bazuar në referencat ligjore, por edhe duke i ndjekur ato, në drejtim të administrimit të dokumentacionit, monitorimit të zbatimit të tyre por edhe të mbajtjes të evidencave dhe bërjes me dije të tyre organeve përkatëse, përfshirë këtu edhe këshillin bashkiak.

#### **Situata:**

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se Bashkia Finiq përveçse shkresës nr. 1235, datë 05.04.2017, drejtuar Ministrisë së Mjedisit, me lëndë: “Dërgim azhurnimi i të dhënave kadastrale Pyje-Kullota, gjendje 31.03.2017 si dhe problematikën e tyre”, sipas të cilës është bërë azhurnimi i të dhënave deri më datë 31.03.2017, mbështetur në inventarizimin e vitit 1985, nga ku evidentohen diferencat fakt-dokument, më tej nuk është bërë apo ndërmarrë as edhe një veprim dhe konkretisht, strukturat përgjegjëse duhet të kishin kryer/mbajtur:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- inventarizimin Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), në referim të nenit 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15/2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005.
- mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.
- mbajtjen, evidentimin, administrimin balancimit të fondit kullosor.
  - pasqyrimin në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.
  - aplikimin e regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Sarandë, sot ASHK Drejtoria Sarandë, e cila citon se këto procedura për tokën pyjore e kullosore kryhen nga njësitë vendore pa tarifa aplikimi.
- mbarështimin për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.
- të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, si dhe nuk ekziston asnjë plan mbarështimi menaxhimi të pyjeve dhe kullotave, duke mos u krijuar të ardhura të cilat do të mund të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.
- kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtitish, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullosore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.

#### **Kriteri:**

Nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, neni 5, pika 2/b “Pronësia”, neni 7 “Inventarizimi”, neni 8 “Regjistrimi”, neni 9 “Regjistri i fondi kullosor”, neni 14 “Planet e mbarështimit” dhe neni 15 “Bimët mjekësore”, neni 29 “Organet e kontrollit”, 30 “Dokumentimi”, dhe 33 “Vlerësimi i dëmit” dhe 34 “Kundërvajtjet Administrative”; VKM nr. 799, datë 29.9.2010, “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”; VKM nr.22, datë 09.01.2008, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, si dhe VKM nr. 632, datë 11.6.2009.

**Impakti:** Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq të marrë masa për inventarizimi Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullosor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”; aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Sarandë; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kriterëve për dhënien me qira të tyre.

Në 1 (një) rast nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Delvinë, është lidhur kontrata datë 28.09.2001, me subjektin P. Z, përfaqësuar nga S. Z, për një periudhë kohore prej 49 vjet, për sipërfaqen prej 0.15 ha, dhe vlerë prej 100,000/ha ose total 15,000 lekë, kontratë e ndryshuar më vonë me kontratën datë 29.09.2005, për vlerën prej 162,700 lekë/vit, kontratën nr. 5/7, datë 07.02.2012 dhe më tej me kontratën nr. 5/13, date 30.09.2013, lidhur me subjektin "F.....E", S. Z, për ndërtimi e një bar restorant prej 300m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe pushimi 1200m<sup>2</sup> e vlerë qiraje vjetore prej 225,750 lekë.

Për këtë objekt rezulton se është miratuar edhe leja e ndërtimit nr. 4/17, datë 21.12.2002 dhe vendimi i KRRT Këshilli i Qarkut Vlorë, nr. 4, datë 21.12.2002, pika 17 "Të miratojë lejen e ndërtimit për objektin "Pikë turistike dhe argëtimi", në fshatin Karahaxhë".

Për këtë kontratë ka rezultuar se subjekti është **debitorë për vlerën prej 201,960 lekë**, por nga shqyrtimi i hollësishëm i dosjes të subjektit rezulton e administruar shkresa e protokolluar nga Bashkia Finiq me nr. 3134, datë 16.11.2018 e S. Z, shkresë me të cilën bën me dije bashkinë se është pajisur me leje legalizimi nr. 1011910, datë 18.05.2018, lëshuar në emër të S. Z, për pasurinë nr. 183/1, me sipërfaqe parcele prej 2025m<sup>2</sup> nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 675m<sup>2</sup>, sipërfaqe banimi 226m<sup>2</sup> dhe për aktivitet 675m<sup>2</sup>. Bazuar në sa sipër qytetari ka kërkuar që të zbritet nga kontrata e qirasë sipërfaqja prej 675m<sup>2</sup> dhe të përlllogaritet mbi bazën e sipërfaqes prej 825m<sup>2</sup>. Leja e legalizimit rezulton se regjistruar në ZVRPP Sarandë për pasurinë 183/ND, në volum 4 faqe 15, me sipërfaqe prej 675 m<sup>2</sup> me shënimin "Kjo pasuri vendoset në hipotekë ligjore në favor të ALUIZNI deri në miratimin e parcelës ndërtimore".

ALUIZNI nuk ka qenë në kushtet e lëshimit të lejes së legalizimit për shkak se parcela në fjalë është në pronësi të Bashkisë Finiq dhe se subjekti ndërtues ka pasur kontratë qiraje me bashkinë për një periudhë kohore për 50 vjet, po ashtu Bashkia Finiq nuk ka qenë në kushtet e plotësimit të formularit për pagesën e taksës në infrastrukturë për sipërfaqen prej 901m<sup>2</sup> dhe vlerë 147,507 lekë, kur ky subjekt është kontraktor i bashkisë, dhe veçanërisht nëse do i referohemi nenit 8 të kontratës "Detyrime të përbashkëta të palëve", sipas të cilës "në fund të periudhës të kësaj kontrate ose në përfundim të saj Qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë, dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal".

#### Situata:

Bashkia Finiq ka trashëguar nga ish-Komunat Finiq dhe Mesopotam, 224 kontrata për dhënien me qira për një periudhë 10, 35 dhe 99 vjeçare të tokës bujqësore të pandarë, nga të cilat 16 nga Njësia Administrative Finiq dhe 208 nga Njësia Administrative Mesopotam.

-Për Njësinë Administrative Finiq, deri më datë 31.12.2019 nuk kanë shlyer detyrimet 6 subjekte për vlerën prej 176,568 lekë dhe kanë shlyer plotësisht ato 10 subjekte për vlerën prej 45,134 lekë. Kamatë vonesat e përlllogaritura për periudhën e auditimit rezultojnë në vlerën prej 1,442,156 lekë për 14 subjekte.

-Për Njësinë Administrative Mesopotam, deri më datë 31.12.2019 nuk kanë shlyer detyrimet 27 subjekte për vlerën prej 1,194,819 lekë dhe kanë shlyer plotësisht ato 181 subjekte për vlerën prej 1,828,096 lekë dhe paguar kamatëvonesa 67,863 lekë. Kamatë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

vonesat e përlogaritura për periudhën e auditimit rezultojnë në vlerën prej 11,627,986 lekë për 14 subjekte.

Këto kontrata kanë qenë objekt auditimi nga KLSH gjatë auditimit të kryer edhe më parë në Bashkinë Finiq nga ku është konstatuar dhe lënë detyrë për *llogaritjen e kamatëvonesa sipas kontratës në vlerën 4,305,770 lekë dhe 1,586,653 lekë detyrimi i pa paguar në afat, ose në total 5,892,423 lekë.*

#### **Kriteri:**

UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”; VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

**Impakti:** Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën 11,627,986 lekë.

**Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike dhe Njësitë Administrative Finiq dhe Mesopotam, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos kryerja e pagesës në afatin e caktuar në kontratë për tokat e marra me qira dhe mos llogaritja e kamatëvonesa sipas kontratës **në vlerën e detyrimit prej 1,194,819 lekë dhe kamatëvonesa në vlerë 11,627,986 lekë.**

Për kontrata të cilat ende nuk rezultojnë të zbatuara apo kanë rezultuar në pronësi private dhe jo të bashkisë, të veprohet me prishjen e njëanshme të tyre.

#### **Situata:**

Bashkia Finiq, ka në territorin e saj 16 kontrata afatgjata për përdorimin e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullor (nga të cilat 1 kontratë është lidhur nga bashkia dhe 15 kontrata janë të trashëguara nga ministria, Drejtoria e Shërbimit Pyjor apo ish-komunat), sipas tabelës bashkëlidhur materialit.

Për periudhën objekt auditimit janë debitorë 8 subjekte me vlerë detyrimi prej **1,727,260 lekë dhe kamatëvonesa për vlerën prej 102,060 lekë**, vlera të cilat përbëjnë të ardhura të munguar për bashkinë dhe duhet të paguhen nga subjektet e sipërcituara.

#### **Kriteri:**

Nenit 38 dhe 40, të ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.208 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

**Impakti:** Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën 1,727,260 lekë dhe kamatëvonesa për vlerën prej 102,060 lekë.

**Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bashkia Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos kryerja e pagesës në afatin e caktuar në kontratë për sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në përdorim, sipas kontratave respektive, nga të **në vlerën prej 1,727,260 lekë**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

nga mos pagimi i detyrimit që rrjedh nga kontrata dhe **në vlerën prej 102,060 lekë** si të ardhura të munguar të krijuara nga mos llogaritja e kamatëvonesa sipas kontratës.

#### Situata:

Bashkia Finiq ka lidhur kontratë qiraje me subjektin “G.....O”, me administrator e pronar të vetëm **L. A.** për dhënien me qira për 30 vjet të sipërfaqes prej 50 ha të fondit pyjor e kullësor, për vlerën e kontratës prej 12,100 lekë ha/vit, me destinacion përdorimi “Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e tarifave për qiranë, konstatohen veprime dhe mosveprime me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 11,850,000 leke (minimalisht) për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës po ti referohemi pikës 3 të shtojcës apo nëse do ti referohemi pikës 2.2-3 të shtojcës të ardhura të munguar me dëm ekonomik në vlerën prej **8,850,000 lekë**.

Gjithashtu në këtë kontratë konstatohet dhe këto mangësi:

- a- *Kontratë është bërë pa miratuar më parë në Këshillin Bashkiak (KB) të parcelës të ofruar për tu dhënë me qira, qëllimit të përdorimit dhe vlerës minimale të ofertës, pasi me vendimin nr. 72, datë 05.10.2017 të KB është bërë vetëm miratimin në parim të listës së inventarit pyjeve dhe kullotave, për dhënien me qira, dhe nuk ka autorizuar kryetarin për fillimin e ndonjë procedure konkrete;*
- b- *Kontrata është bërë në kushtet kur eksperti i fushës (anëtar i komisionit vlerësues) S. H nuk ka nënshkruar procedurën e vlerësimit të ofertës;*
- c- *Kontrata është bërë për një person jo vetëm i cili rezulton si person fizik dhe në moshë pensioni (80 vjeç), por është bërë edhe pa disponuar garanci bankare;*
- d- *Kontrata është bërë në kushtet kur subjekti nuk ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara nga bashkia dhe të bërë publike në buletin e APP.*
- e- *Lidhja e kontratës rezulton e “paracaktuar”, pasi subjekti fitues rezulton se ka regjistruar objektin e aktivitetit dhe vendin e ushtrimit të tij në QKL, disa ditë më parë se bashkia të kishte bërë shpalljen në buletin të njoftimit dhe për më tepër në një pronë në pronësi të pronësisë, kur nuk ka asnjë akt apo dokument ku të rezultoi se sipërfaqja do të jepej me qira, pra edhe regjistrimi i aktivitetit nga subjekti rezulton së është bërë në marrëveshje me drejtuesit përse për këtë procedurë rezultojnë të kenë pasur dijeni pas shpalljes së saj vetëm titullari i bashkisë dhe juristi, dhe është përjashtuar nga procedura Drejtoria e Shërbimit Pyjor Bashkia Finiq.*
- f- *Lidhja e kontratës është bërë në kushtet kur bashkia nuk ka pasur të regjistruar në ASHK (ish ZVRPP Sarandë) pronën objekt kontrate, si dhe përpilimi dhe nënshkrimi i saj është bërë jashtë zyrës së protokoll arkivit të bashkisë.*

#### Kriteri:

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, pasi referenca e përdorur është ajo sipas shtojcës nr. 2.2 “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, pikat 4” me afat 6-10 vjet kohëzgjatje kontrate dhe vlerë 12,000 lekë/ha/vit, kur së pari toka e dhënë me qira nuk është kategorizuar në zërin “tokë me bimësi pyjore djerr” dhe kur qëllimi i përdorimit sipas dokumentacionit të sipërcituar është për mbarështimin e faunës dhe florës dhe ku referenca që duhej të ishte përdorur është sipas shtojcës nr. 3. “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut, pikat 2-4” me afat 6-10 vjet kohëzgjatje kontrate dhe vlerë 20,000lekë/ha/vit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Impakti:** Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën **8,850,000 lekë**.

**Rëndësia:** *E lartë*

**Për këtë rekomandojmë:**

- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Shërbimit Pyjor në Bashkinë Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos llogaritja e saktë e vlerës së kontratës me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën **prej 11,850,000 lekë** (minimalisht) për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës po ti referohemi pikës 3 të shtojcës apo nëse do ti referohemi pikës 2.2-3 të shtojcës të ardhura të munguar në vlerën **prej 8,850,000 lekë**.
- Kryetari i Bashkisë të analizojë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, vlefshmërinë e kontratës në referencë të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, duke e shtrirë afatin e vlefshmërisë së saj deri në 10 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**Situata:**

Kontrata nr. 5176 kol dhe 1882 rep, datë 13.10.2009, “Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile”, me palë qiradhënëse Komuna Livadhja, përfaqësuar nga ish-Kryetari dhe me palë qiramarrëse shoqëria “V.....A” **sha.**, për sipërfaqen prej 300 m<sup>2</sup> me çmim prej 153,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 08.08.2015.

Kjo kontratë qiraje ka qenë edhe më parë objekt auditimi nga KLSH, ku është konstatuar se kontrata është llogaritur për vlerën 1,071,000 lekë, por duhej të ishte llogaritur në vlerën 2,520,000 lekë, ku duke zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 1,071,000 lekë, detyrimi i paarkëtuara si mungesë të ardhurash në Bashkinë Finiq, paraqitet në shumën **1,449,000 lekë**.

**Kriteri:**

VKM nr. 391, datë 21.06.2006 është rregulluar dhe referenca ligjore VKM nr. 529, datë 08.6.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014; nenit 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

**Impakti:** Mos njohje e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën **1,449,000 lekë**.

**Rëndësia:** *E lartë*

**Situata:**

Kontrata nr. 5108 rep. dhe 2588 kol. datë 08.11.2007, “Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile”, me palë qiradhënëse Komuna Livadhja, përfaqësuar nga kryetari dhe me palë qiramarrëse shoqëria “T.....A” **sha.**, për sipërfaqen prej 300 m<sup>2</sup> me çmim prej 330,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 17.09.2016, zgjatur afati me kontratën nr. ska, datë 25.11.2016, për vlerën prej 330,000 lekë/vit (pika 5.1) për sipërfaqen prej 300m<sup>2</sup> (pika 3.1) dhe afat përfundimi deri më 17.09.2025 (pika 4.1), kontratë e nënshkruar nga ish-Kryetari i Bashkisë L. H dhe R. E, Drejtor Teknik & IT në shoqërinë “T.....A” sha.

Kontrata është llogaritur për vlerën 2,970,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 3,240,000 lekë, ku duke zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 2,970,000 lekë, mbetet për arkëtim vlera **270,000 lekë, të ardhura të munguara me dëm ekonomik për ish-Komunën Livadhja.**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Kontrata e lidhur rishtazi është lidhur me po të njëjtat kushte si dhe kontrata e mëparshme, pra me tarifë fikse prej 330,000 lekë në vit, ose 27,500 lekë/muaj kur në fakt duhej lidhur  $300m^2 \times 100/lekë/m^2 \times 12 \text{ muaj} = 360,000$ , pra më shumë për vlerën prej 30,000 lekë, ose duhej më shumë në vlerën prej 2500 lekë/muaj.

Moszbatimi i rekomandimeve të KLSH për rregullimin e vlerës mujore të qirasë në rilidhjen e kontratës, me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 337,500 lekë nga të cilat 270,000 nga kontrata e mëparshme dhe 67,500 lekë nga kontrata aktuale + (27 muaj sipas kontratës (deri 1.12.2019)  $\times 2500 \text{ lekë}/m^2 = 67,000 \text{ lekë}$ ).

#### Kriteri:

Ligjit nenit 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

#### Impakti:

Ka sjellë jo vetëm moszbatim të ligjit nenit 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", por edhe mos zbatim të ligjit organik, dhe konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën **270,000 lekë**.

**Rëndësia:** E lartë

#### Situata:

Kontrata datë 01.08.2010, "Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile", me palë qiradhënëse Komuna Livadhja, përfaqësuar nga ish- Kryetari dhe me palë qiramarrëse shoqëria "P.....N" sha., për sipërfaqen prej 400 m<sup>2</sup> me çmim prej 350,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 31.07.2019.

Kontrata është llogaritur për vlerën 3,150,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 4,320,000 lekë, ku duke zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 3,150,000 lekë, detyrimi i munguar paraqitet në shumën **1,170,000 lekë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për ish-Komunën Livadhja**.

Lidhur me detyrimet e rrjedhura nga kjo kontratë rezulton se Bashkia Finiq, me aktmarrëveshjen nr. Ska, datë 08.06.2017, lidhur me kompaninë "P.....N" sha dhe "P.....K" SHPK, ka ndryshuar palën qiramarrëse duke kaluar shoqërinë "P.....K" SHPK, si palë. Kontrata është lidhur me kushtin që të gjitha të drejtat dhe detyrimet janë marrë përsipër nga shoqëria e re, duke filluar nga data 01.02.2017. Sipas aktmarrëveshjes sipërfaqja e marrë me qira është 400m<sup>2</sup> (kreu I) dhe vlera mujore e saj është 29,166 lekë (kreu II pika 6.1)

#### Kriteri:

Ligjit nenit 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", por edhe mos zbatim të ligjit organik, dhe konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.

#### Impakti:

Moszbatimi i rekomandimeve të KLSH për rregullimin e vlerës mujore të qirasë në rilidhjen e kontratës/aktmarrëveshjes për ndryshimin e qiramarrësit, me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Shkaku:** Mungesë në realizimin e të ardhurave në shumën **1,170,000 lekë**.

**Rëndësia:** *E lartë*

**Për këtë rekomandojmë:**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat fillimisht për kontabilizimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë si dhe më tej duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos llogaritja e saktë e vlerës së kontratës, konkretisht:

- **Vlera 1,449,000 lekë**, në ngarkim të subjektit juridik privat “**V.....A**” SHA.
- **Vlera 270,000 lekë**, në ngarkim të subjektit juridik privat “**T.....A**” SHA.
- **Vlera 1,170,000 lekë**, në ngarkim të subjektit juridik privat “**P.....K**” SHPK.

***-Taksa mbi ndikimin në infrastrukturë.***

Sipas të dhënave të pasqyrës, *për vitin 2017* është realizuar në masën 110%, ose nga 50 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 555 mijë lekë. *Për vitin 2018*, është realizuar në masën 152%, ku nga 1,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,516 mijë lekë. *Për vitin 2019* realizimi paraqitet në nivelin 273%, ku nga 1,200 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,278 mijë lekë.

*Nga të dhënat konstatohet se bashkëpunimi midis dy drejtorive nuk ka qenë efektiv, pasi pavarësisht fakti të realizimit, planifikimi është më i ulët. Kjo çon në faktin se nga DPZHT nuk njihen kërkesat për leje zhvillimi/ ndërtimi nga qytetaret apo subjektet.*

**Situata:**

Ndikim në këtë taksë ka dhe taksa infrastrukturës nga ndërtimet e reja (ALUIZNI-t). Kështu për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2019), janë legalizuar gjithsej 339 objekte për sipërfaqe ndërtimi 100 442 m<sup>2</sup>, me detyrim në shumën 14,991,799 lekë, nga e cila janë paguar deri me datë 31.12.2019 për 139 subjekte me vlerë 3,636,433 lekë dhe mbetet për arkëtim **200** subjekte me vlerë **11,355,366 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetit e Bashkisë Finiq.

*Nga Bashkia Finiq, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ZVRPP (sot ASHK), për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet është marrë ose jo certifikatë pronësie, si dhe të bllokohet procesi i dhënies deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Kriteri:** Neni 22 i ligjit nr. 9632, datë “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime.

**Impakti:** Veprime të cilat çojnë në mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Finiq për vlerën 11,35,366 lekë.

**Shkaku:** Bashkëpunimi midis drejtorive dhe institucioneve përgjegjës për këtë taksë.

**Rëndësia:** *I lartë*

**Për këtë rekomandojmë:**

- Drejtoria e të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit të marrë masa për një planifikim sa më të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, kjo referuar zhvillimit të zonës sipas planit urbanistik që është në përfundim.
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 200 personat në **vlerën 11,355,366 lekë**, si një e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Gjithashtu të njoftohet ASHK Sarandë, për bllokimin e pasurive të gjithë personave të cilat paraqiten për tu pajisur me çertifikatën e pronësisë, pa mundësuar pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

### **Komentet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e konstatuara në projektraport auditimi, subjekti i auditimit me shkresën nr. 202prot, datë 15.04.2020 ka paraqitur kundërshtitë në lidhje me tarifën e gjelbërimit, duke cituar:

Nga ana e Drejtorisë së të Ardhura është aplikuar tarifa e gjelbërimit, duke i përmbledhur në një tarifë me vetë.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Referuar shpjegimeve që jepen nga ana juaj, nuk qëndrojnë, pasi referuar VKB të viteve 2017 dhe 2018, është përcaktuar saktë ku thuhet tarifë ndriçimi 3,000 lekë. Viti dhe tarifë gjelbërimi 1,000 lekë/viti. Gjithashtu në njoftim detyrimet nuk është shënuar tarifë gjelbërimi, dokument i cili nuk është bashkëlidhur

**Tarifë parkimi.** Sipas të dhënave të pasqyrës, për vitin 2017 është realizuar në masën 71%, ku nga 100 mijë lekë të planifikuar është realizuar 71 mijë lekë. Për vitin 2018, është realizuar në masën 74%, ku nga 80 mijë lekë është arkëtuar vlera 59 mijë lekë. Për vitin 2019 realizimi paraqitet në nivelin 88%, ku nga 100mijë lekë është arkëtuar vlera 88 mijë lekë.

## **2. Titulli gjetjes.** Përdorimi i të ardhurave.

Referuar të dhënave nga Drejtoria e Financës/ Buxhetit, të ardhurat totale të Bashkisë Finiq, ku përfshihen edhe të ardhurat e trashëguara nga vitet e kaluara (*transferta e pakushtëzuar dhe specifike*), janë paraqitur në **Tabelë B/2**, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Delvinë;

Tabela B/2:

EMERTIMI	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Të ardhurave të trashëguara viti 2016	52,657,991	45,665,594	17,861,560
Transferta e pakushtëzuar trashëguara	12,340,588	15,452,278	26,782,714
Transferta Specifike të trashëguara	97,762,916	94,623,018	46,427,629
FZHR të trashëguara	49,750,000	47,117,501	521
Të ardhurat e veta të vitit	60,369,102	63,223,332	60,451,170
Grande të pakushtëzuara	165,459,351	160,876,040	158,182,000
<b>Grandë të kushtëzuara, nga të cilat:</b>	<b>139,521,092</b>	<b>226,740,201</b>	<b>156,070,240</b>
- Nga FZHR		118,955,201	24,623,240
- Nga KZHR			
- Nga ministrinë e linjë	17,095,345	0	32,244,000
- Invalid etj	122,425,747	107,785,000	99,203,000
<b>TOTALI</b>	<b>577,861,040</b>	<b>653,697,964</b>	<b>465,775,834</b>

## **Pasqyra e shpërndarjes së të ardhurave sipas natyrës shpenzimit**

Emërtimi	Fakt 2017				Gjithsej
	Gjithsej	Tr.Pakushtezuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar	
230-Projekte	941,620	941,620			941,620
231-Investime	178,737,131	47,340,365	6,338,520	125,058,246	178,737,131
600-Paga	106,906,948	68,710,688	33,035,477	5,160,783	106,906,948
601-Sigurime Shoqërore	17,349,456	12,211,911	4,652,057	485,488	17,349,456



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

602-Shpenzime Operative	62,010,190	37,039,730	22,334,680	2,635,780	62,010,190
604-Transferta Institucioneve	1,385,780		1,000,780	385,000	1,385,780
606-Transferta Busch.Fam.Ind	100,737,632			100,737,632	100,737,632
<b>SHUMA.....</b>	<b>468,068,757</b>	<b>166,244,314</b>	<b>67,361,514</b>	<b>234,462,929</b>	<b>468,068,757</b>
<b>Emërtimi</b>	<b>Fakt 2018</b>				<b>Gjithsej</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>Tr.Pakushtez uar dhe Specifike</b>	<b>Te ardhurat e Veta</b>	<b>Transferta e Kushhtëzuar</b>	
230-Projekte	9,269,500		9,269,500		9,269,500
231-Investime	222,243,415	41,655,361	13,182,650	167,405,404	222,243,415
600-Paga	121,052,546	89,380,630	28,610,543	3,061,373	121,052,546
601-Sigurime Shoqërore	20,097,879	12,523,738	7,060,998	513,143	20,097,879
602-Shpenzime Operative	84,747,606	54,846,936	29,900,670		84,747,606
604-Transferta Institucioneve	1,004,000		1,004,000		1,004,000
606-Transferta Busch.Fam.Ind	103,427,312			103,427,312	103,427,312
Tjera	65,000			65,000	65,000
<b>SHUMA.....</b>	<b>561,907,258</b>	<b>198,406,665</b>	<b>79,758,861</b>	<b>274,472,232</b>	<b>561,907,258.0</b>
<b>Emërtimi</b>	<b>Fakt 2019</b>				<b>Gjithsej</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>Tr.Pakushtez uar dhe Specifike</b>	<b>Te ardhurat e Veta</b>	<b>Transferta e Kushhtëzuar</b>	
230-Projekte	10,619,300	10,619,300			10,619,300
231-Investime	76,905,851	26,954,901	14,707,350	35,243,600	76,905,851
600-Paga	118,868,825	86,509,700	28,230,320	4,128,805	118,868,825
601-Sigurime Shoqërore	21,037,635	15,548,035	4,735,410	754,190	21,037,635
602-Shpenzime Operative	71,019,040	47,001,881	23,894,159	123,000	71,019,040
604-Transferta Institucioneve U.....N S/A	10,002,000	10,002,000			10,002,000
606-Transferta Busch.Fam.Ind	94,092,895		282,890	93,810,005	94,092,895
Tjera	0				0
<b>SHUMA.....</b>	<b>402,545,546</b>	<b>196,635,817</b>	<b>71,850,129</b>	<b>134,059,600</b>	<b>402,545,546.0</b>

**Burimi:** Drejtoria e Financës përpunuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se në totalin e shpenzimeve, Bashkia Finiq me të ardhurat e veta mbulon 14.1% të shpenzimeve për vitet 2017 – 2018 dhe 17.7% të shpenzimeve për vitin 20109.

### 3. Titulli gjetjes: Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore.

#### Situata:

Në DAV Bashkia Finiq, nuk ka zyrë/ ose person përgjegjës për menaxhimin e borxhit. Sipas intervistimit të Drejtorit të DAV Bashkia Finiq, u konstatua se jo për të gjithë subjektet janë nxjerr njoftim vlerësimet tatimore dhe ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Në bazë të informacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Finiq, u konstatua se në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e debitorëve për subjektet fizik/ juridik dhe abonentët familjare paraqitet ne pasqyrën si vijon:

Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	152	4,802,928	144	5,237,326	146	5,262,520
Nga subjektet juridik	67	8,471,415	62	8,735,654	58	9,228,608
Nga taksa infrast (ALUIZNI)	-	-	208	9,545,476	200	11,355,366
Taksa tokës bujqësore	4472	51,735,234	4712	56,798,915	4421	62,291,161
Taksë ndërtese	4373	2,427,953	4670	6,326,421	4539	10,836,475
Tarifë ndric/pastrim etj	4343	6,819,796	4641	10,553,237	4611	15,609,984
Tarifë vaditje			1191	1,675,322	2226	2,110,378



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Gjopa te ndryshme					5	25,000
Nga kamat vonesa nëse ka	39	261,595	67	466,375	61	534,190
<b>TOTALI.....</b>		<b>74,518,921</b>		<b>99,338,726</b>		<b>117,253,682</b>

Burimi: Të dhënat nga DAV Bashkia Finiq, ku është bërë përpunimi i tyre në progresiv

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se niveli i debitorëve nga njëra periudhë në tjetër vjen në rritje, gjë e cila tregon se puna në vjeljen e detyrimeve si të subjekteve fizik/ juridik dhe abonentëve familjarë nuk është në nivele të dëshiruara.

### Pamja grafike



Nga të dhënat e grafikut, konstatohet se niveli i borxhit nga një periudhë në tjetër paraqitet në rritje, ku për vitin 2018 ka një rritje prej 75% dhe për vitin 2019 në masën 84%.

Në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizik/ juridik dhe abonentë familjarë paraqitet si vijon:

- a- Debitor fizik/juridik për 204 subjekte me vlerë 14,742,473 lekë
- b- Abonentët familjarë për 4539 familje me vlerë 91,155,843 lekë.
- c- Subjekte nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (ALUIZNI-t) për 200 persona me vlerë 11,355,366 lekë.

**Gjithsej për gjithë Bashkinë Finiq detyrimi nga mos arkëtimi i debitorëve paraqitet në shumën 117,253,682 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq.**

Nga të dhënat konstatohet se vlerën më të lartë të debitorëve e zënë abonentët familja me vlerë 91,155 mijë lekë ose 77.5% e totalit të detyrimeve.

Në fund të periudhave ushtrimore, lista e debitorëve të subjekteve fizik/ juridik por jo abonentë familjarë, me shpresë përcjellëse i është dërguar Analitikisht në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare të viteve respektive, kjo për të mundësuar evidentimin e saktë dhe shmangur abuzimet të eliminimit të tyre gjatë viteve, si dhe ndjekjen e procedurave administrative/ ligjore për arkëtimin e plotë, për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave në favor të Bashkisë Finiq (Në mënyrë analitike pasqyra e subjekteve fizik/ juridik paraqitet bashkëlidhur materialit, kurse pasqyra e debitorëve për abonentët familjarë është sipas të dhënave që disponon ADV Bashkia Finiq, pasi janë voluminoze).

### Kriteri:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Neni 23 - e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2<sup>4</sup> dhe Kreut XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime dhe nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”..

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën **117,253,682 lekë**.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të plotë të kuadrit ligjorë për arkëtimin e detyrimeve.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **117,253,682 lekë**, si më poshtë vijon:

**a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare**, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

**b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

**c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat**, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare** dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, **të bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

**e- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me 4 Njësitë Administrative, respektivisht: Livadhja, Dhiver, Aliko dhe Mesopotam**, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98<sup>5</sup>, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe ndërtesave.

#### **5. Titulli gjetjes: Masat e marra për arkëtimin e debitorëve:**

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV mbi masat e marra në lidhje me punën e kësaj drejtorie në arkëtimin e debitorëve, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime dhe udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, konstatohet se është mundësuar vetëm zbatimi i nenit 90 pika 1, konkretisht:

Niveli i arkëtimeve të debitorëve nga njëra periudhë në tjetër paraqitet si vijon:

Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
----------	-----------	-----------	-----------

<sup>4</sup> “ Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomandë”

<sup>5</sup>Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (familjarë dhe biznese në territorin përkatës)



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

	Vlerë/Lekë	Vlerë/Lekë	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	1,252,875	905,722	929,671
Nga subjektet juridik	2,667,530	1,929,083	1,882,935
Nga taksa infrast (ALUIZNI)			1,166,307
Taksa tokës bujqësore	9,257,979	7,827,888	7,906,694
Taksë ndërtese	295,017	471,034	1,282,073
Tarifë ndric/pastrim etj	795,440	1,281,020	1,840,740
Tarifë vaditje			713,501
Nga kamat vonesa nëse ka		103,516	59,319
<b>TOTALI.....</b>	<b>14,268,841</b>	<b>12,518,263</b>	<b>15,781,240</b>

Pasqyra e detyrimeve dhe arkëtimeve sipas periudhave

Periudha	Detyrimi	Arkëtim	% arkëtim
Viti 2017	74,518,921	14,268,841	19
Viti 2018	99,338,726	12,518,263	13
Viti 2019	117,253,682	15,781,240	13
<b>Total 2017+2018+2019</b>	<b>291,111,329</b>	<b>42,568,344</b>	<b>15</b>

Në lidhje me zbatimin e masave për arkëtimin e detyrimeve (debitorë), në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 9920 me ndryshime, konstatohet se:

Drejtuar	Shkresa nr/datë	Masa Bllokuar		Zbatuar	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Banka nivel dytë	1686/5.6.2017	1	76,260	1	426,492
	1688/5.6.2017	1	86,475	1	156,900
	1690/5.6.2017	1	37,375	1	89,360
	1692/5.6.2017	1	97,240	1	272,449
	1694/5.6.2017	1	321,816	1	155,650
	1985/4.7.2018	65	5,747,494	1	170,928
	252/25.01.2018	31	2,990,180		227,660
	3160/20.11.2018	38	5,471,982		
	3772/16.12.2019	105	11,569,508		
ASHK					
DSHTRR					
Sekuestro					
Bllokim aktiviteti					
Njoftim bllokimi					
<b>SHUMA</b>		<b>244</b>	<b>26,398,330</b>	<b>6</b>	<b>1,499,439</b>

Sipas kësaj pasqyre, konstatohet se nga ADV Bashkia Finiq nuk është kryer asnjë veprim në lidhje arkëtimin e debitorëve më ASHK, DSHTRR, sekuestro ose bllokim aktiviteti.

**Konkluzion:** Referuar sa mësipërm nga strukturat e DTTV Bashkia Finiq, nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikon dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, kjo sipas për të gjithë subjektet, por dhe për ato që është zbatuar procedurat nuk janë të plotë, konkretisht

- Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;
- Nenet 90-Urdhër bllokimet dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit;
- Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

*-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej **kallëzim penal**, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.*

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: I. N me detyrë Drejt. AV dhe specialistët: TH. Z. me detyrë Përgjegjës i të Ardhurave, V. B me detyrë, Z. D me detyrë Specialist Vlerësimi dhe G. A me detyrë Spec Vlerësimi .**

**6. Titulli i Gjetjes:** *Diferenca të konstatuara nga akt-rakordimet për vjeljen e të ardhurave nëpërmjet agjentëve tatimorë. Mangësi në evidentimin dhe regjistrimin e numrit dhe llojit të bizneseve.*

Për asnjë nga periudhat objekt auditimi, konstatohet se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj. Kështu të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Finiq brenda datës 5 të çdo muaji.

Rakordimet në lidhje me TFTH nuk janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë.

Nga DAV Bashkia Finiq, nuk është bërë asnjë raportim me Drejtorinë Rajonale të Taksave Sarandë në lidhje me detyrimet që subjekte të ndryshme të Bashkisë Finiq kanë për rentën minerale.

DRSHTRR Sarandë e cila është agjent tatimor i mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura e mbledh ketë taksë për llogari të Bashkisë Finiq.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Finiq janë paraqitur në **Tabelën**.

**Tabela . Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Finiq**

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2017	2018	2019
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	78	400	416
D.R.SHT Rrugor	Taksa e mjeteve të përdorura	0	0	2,866
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taksa e kalimit të pronësisë	0	165	31
DPT & DPD	Renta Minerare	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>78</b>	<b>565</b>	<b>3,313</b>

Burimi: Bashkia Finiq

#### **Situata:**

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Finiq nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet. Bashkia Finiq nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Finiq, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjorbitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117<sup>6</sup> të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat

<sup>6</sup> “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifave të mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjiellës-Kanalizime, i cili vjel taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Kryesisht, sipas zyrës së taksave dhe tarifave të Bashkisë Finiq, mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve, për të cilat nga Bashkia Finiq është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Finiq duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK.

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar;

Ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”;

UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF Nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

#### **Impakti:**

Bashkia Finiq nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për gjendjen e saj financiare, për pritshmërinë nga të ardhurat që duhet të sigurohen nga agjentët tatimorë dhe rrjedhimisht nuk mund të bëjë në mënyrën e duhur dhe të plotë parashikimet buxhetore.

#### **Shkaku:**

Mos krijimi i bazave të të dhënave, mosfunksionimi i strukturave të bashkisë dhe paqartësia e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash. Veprimet abuzive të personelit përgjegjës të Bashkisë Finiq.

#### **Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Finiq, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”.
- Të marrë masa për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**7. Titulli gjetjes:** Mos evidentim i subjekteve me veprimtari tregtare speciale, mos aplikim në formën dhe në vlerën e duhur i tarifave për këto kategori subjektësh (subjekte që tregtojnë karburante).

### Situata:

Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrjnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrjnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Kështu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se si nga ish-komunat dhe ish-bashkitë ashtu edhe pas konsolidimit, NUK është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njërive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifavat vendore janë paraqitur në **Tabelën 1**.

Detyrimet për pajisjen me licencë tregtimi nuk janë paguar në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, sipas të cilës këto subjekte duhet të paguajnë 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante.

**Tabela 1 . Diferencat e pagesave për autorizimet e tregtimit të hidrokarbureve.**

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	NIPT	AUTORIZIMI		Mandat pagesa nr/datë	Vl. Paguar
				NR	DATE		
1	T.....N	VRION	K.....E	1	17/04/2015		0
2	G.....G	SMT	K.....T	2	3/9/2019	2664/3.9.2019	100,000
3	K.....A SHPK	LIVADHJA	J.....L	1	6/6/2019	15/6.6.2019	100,000
4	B.....L	VRION	K.....K	2	17/09/2015		0
5	B.....L	DERMISH	K.....K	1	17/09/2015		0
<b>Paguar</b>							<b>200,000</b>

Burimi: Të dhënat janë nxjerre nga grupi auditimit

Nga të dhënat konstatohet se nga Bashkia Finiq nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 2,000,000 lekë dhe detyrimi i munguar nga mos aplikimi i saktë dhe në 3 raste mos aplikim i taksës për rinovim të lejes paraqitet në shumën **10,800,000 lekë**, sipas pasqyrës **Tabela 2**, si vijon:

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	Pagesa sipas VKM nr. 970, dt. 2.12.2015		Paguar ne fakt		Diferenca për pagesë
			Pikë shitje	Stac Shitje	Pikë shitje	Stac Shitje	
1	T.....N	VRION	200,000	2,000,000			2,200,000
2	G.....G	SMT	200,000	2,000,000	100,000		2,100,000
3	K.....A SHPK	LIVADHJA	200,000	2,000,000	100,000		2,100,000
4	B.....L	VRION	200,000	2,000,000			2,200,000
5	B.....L	DERMISH	200,000	2,000,000			2,200,000
			<b>1,000,000</b>	<b>10,000,000</b>	<b>200,000</b>		<b>10,800,000</b>

Nga tabela, shihet se tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve është llogaritur gabim, veprim ky i cili ka çuar në të ardhura të munguar në buxhetin e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Bashkisë Finiq, në vlerën **10,800,000 lekë**, *veprime të cilat ngarkojnë TH. Z. me detyrë Përgjegjës i të ardhurave.*

#### **Kriteri:**

Pika 9 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

#### **Impakti:**

Mos aplikim i saktë i tarifës për paisje me autorizim, ka çuar në mungesë të ardhurash në shumën 10,800,000 lekë.

#### **Shkaku:**

Neglizhenca për vjeljen e të ardhurave vendore. Veprimet abuzive të personelit përgjegjës të Bashkisë Finiq.

#### **Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **10,800,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, *respektivisht sipas pasqyrës **Tabela 2** mësipërm:*

#### **Situata:**

-Në paketën fiskale të vitit 2019, u konstatua se në planifikimin e të ardhurave për taksat e tarifave vendore është planifikuar zëri detyrime të tjera për 9 persona në vlerën 1,398 mijë lekë, pa specifikuar se çfarë lloje takse/ tarife përfaqësojnë, gjë e cila nuk është e pranueshme, pasi nuk identifikojnë lloje e taksës/ tarifës që planifikohet.

-Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nuk janë plotësuar për abonentët familjarë njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare, që kanë detyrimin ligjor për të paguar për të gjitha llojet e taksave/ tarifave vendore dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues.

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 23, -Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2 ku citohet : “*Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomandë*”.

**Impakti:** Ndikon në miradministrimin e të ardhurave.

**Shkaku:** Neglizhencë e strukturave drejtues.

**Rëndësia:** I ulët

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, në hartimin dhe miratimin e paketës fiskale të planifikojë të ardhurat me zëra të caktuar dhe jo pa emërtim. Gjithashtu të marrë masa për njoftimin e të gjithë abonentëve familjarë mbi detyrimet vendore që ato duhet të paguajnë dhe gjetjen e rrugëve për eliminimin e borxhit me vlerë 91 milionë lekë.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 28-51 të Projektraport Auditimit)*



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë  
Finiq.

**IV/C. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitet 2017-2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.**

**1. Titulli i gjetjes:** Nxjerrja e pasqyrave financiare, shkeljet të parimeve kontabël për evidentimin e detyrimeve kreditore dhe mos rakordimi I llogarive të pasqyrave financiare me rezultatet e gjendjes fizike nga mos kryerja e inventarëve fizikë për vitin 2017.

## Situata:

### Për vitin 2017.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2017

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, është në pasqyrat financiare për **vlerën debitorë 213,132,893 lekë**. Kjo vlerë është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, e analizuar si vijon:

*I. Të trashëguara nga viti 2016.*

Sipas akt rakordimit për vlerën 216,040,439 lekë.

Këto të ardhura të trashëguara, janë të analizuar me burime si vijon:

Grande të trashëg. të pa kushtëzuara dhe specifike 110.103.504 lekë,

Të ardhura të trashëguara (Sipas akt rakordimit) 52.657.991 lekë,

Te tjera të trashëguara (FZHR) 49.750.000 lekë,

Mjete në ruajtje (llog. 466) 3.528.944 lekë.

*II. Të hyra (shitesat debitorë) gjatë vitit 2017*

Granit i vitit i pa kushtëzuar 119.024.860 lekë

Të ardhurat e vitit 60.369.102 lekë

Të hyra nga mjete ne ruajtje 6.745.691 lekë

Granit specifik 47.191.247 lekë

F.SH.Zh 42.019.247 lekë

Shuma e hyrjeve gjatë vitit ushtrimor 275,350,147 lekë.

**Totali i te ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2017 (I+II)= 216,040,439 + 275,350,147 = 491,390,586 lekë.**

*III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:*

Paga, sig. Shoq. 177,984,543 lekë

Investime etj. 99.272.251 lekë

Derdhur në Qark 1,000,780 lekë

**Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore) 278,257,574 lekë.**

Gjendja debitorë (Saldo debitor) në fund të vitit 2017, është (491,390,586-278,257,574)= **213,133,012 lekë**.

Në këtë rast, u konstatua se në pasqyrat financiare është gjendja debitorë më tepër për diferencën (213,132,893-213,133,012)= 119 lekë.

-Po kështu llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 10,274,635 lekë dhe është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, e cila është shtuar gjatë vitit ushtrimor për diferencën (10,274,635- 3,528,944 ngurtësime në fund të vitit 2016)= 6,745,691 lekë. Këto ngurtësime të kryera gjatë viti ushtrimorë përfaqësojnë 5% të vlerës nga situacione e punimeve dhe shërbimeve të paraqitura nga sipërmarrësit sipas kontratave të lidhura pas procedurës me tender. Është



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

e analizuar sipas objekteve dhe vlerës së ngurtësuar (*Bashkëngjitur Aktivi dhe Pasivi i bilancit Pasqyra Nr. 4*)

### -Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik:

**Për vitin 2017**, nuk është kryer inventarizimi mbi gjendjen fizike të Aktiveve Afat Gjatë dhe Aktiveve afatshkurtër.

Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Nxjerrja e pasqyrave financiare pa i rakorduar vlerat kontabël të llogarive financiare me gjendjen fizike.

### -Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2017.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese të vlerësuar me koston historike dhe u konstatua si vijon:

-Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën kontabël historike 16,374,287 lekë, shtuar gjatë vitit për vlerën (16,374,287-15,432,664)= 941,623 lekë.

Kjo llogari nuk është e analizuar në mënyrë kontabël për të gjithë vlerën e saj.

Shtesa për vitin 2017, përfaqëson vlerën e financiar për Projektin e rrugës Dermish-Cerkovicë për vlerën 941,623 lekë.

-Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” për vlerën historike 300,000 lekë gjatë vitit ushtrimor nuk ka pasur shtesa dhe pakësime. Kjo llogari nuk është e analizuar në mënyrë kontabële.

-Llogaria 212 “*Ndërtime konstruksione*” për vlerën historike 239,028,808 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (239,028,808- 233,782,269)= 5,246,539 lekë.

Shtesa gjatë vitit, është e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI Lekë
Ditari veprime	1	Çelja e tepricës dt. 31.12.2016	233,782,269
Bilanci	2	Zyra e informacionit Finiq	5,055,093
D veprimeve	3	Repartit Ushtrarak Kranë	191,446
		Shuma e tepricës dt. 31/12/2015	239.028.808

-Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për vlerën historike 1,002,619,941 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (1,002,619,941- 866,512,310)= 136,107,631 lekë.

Kjo llogari, për shtesën debitorë të saj, është e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D. veprimeve	1	çelja e llogarive dt. 01/01/2015	866,512,310
'	2	Rruga Dermish Cerkovicë	92,912,232
'	3	Rruga Pllake Kulluricë	32,146,014
'	4	Rruga e dy monastireve Serone dhe kostar	1,815,476
'	5	Kanali kk5	8,040,149
	6	Blerje material ndërtimi	1,193,760
		Shuma	1,002,619,841

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” për vlerën kontabël 43,923,890 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (43,923,890 - 12,490,538)= 31,433,352 lekë.

Kjo llogari, për shtesën debitorë të saj, është e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës dt 01/01/2016	12,490,538
'	2	Vassa linja elektrike	16.773.912
	3	Blerje kondicioner (Kjo shume është më tepër)	614280
	4	K.....I	4427520
	5	Pajisje per amfiteatrin	10231920
'		Shtesa e vitit	32.047.632
		Shuma e tepricës dt 31/12/2017	44.538.170

-Llogaria 215 “Mjete transporti” për vlerën historike 49,420,644 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (49,420,644- 28,606,864)= 20,813,780 lekë.

Kjo llogari, për shtesën debitorë të saj, është e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës dt 31.12.2016	28,606,864
	2	Blerje makine vetëshkarkuese	936,000
	3	Blejë makine gërmimi	4,872,000
	4	Blerje makine gërmimi	3,022,584
'	5	Blerje Eskavator	9,055,196
'	6	Automjet Foristrad AA834SJ	2,928,000
		Shuma Blerjet v. 2017	20,813,780
		Shuma e tepricës dt. 31/12/2017	49.420.644

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën historike 21,506,133 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (21,506,133 – 19,004,027)= 2,502,106 lekë.

Kjo llogari, për shtesën debitorë të saj, është e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës 01/01/2017	19.004.027
'	2	Kompjuter	150.000
'	3	Kompjuter	150.000
'	4	Printer	70000
bilanci 6M	5	Printer	70000
	6	PCD Destop M795 FMT	351558
	7	Printer LeX mark N5312	73632
	8	UPS	37902
'	9	Lenovo thinks	135692
	10	Poëer UPS 1290 V	7446
	11	Info POINT	399840
	12	Fotokopje	135692
	13	Printer kyocera P3045 DN	28020
	14	Poëer UPS 65	3983
	15	Lenovo PC Cent M 79 FP	70615
	16	USB per TOKEN	31200
	17	Lenovo thinks	135692
	18	Për UPS 1290 V	7446
	19	Printer kyocera P3045 DN	49,388
	20	Rafte Metalike	594000
		Shuma e tepricës dt. 31/12/2015	20,891,853

-Llogaria 31 “Materiale” për vlerën kontabël 1,741,317 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (2,128,550- 1,741,317)= 387,233 lekë.

-Llogaria 32 “Inventar i imët” për vlerën kontabël 13,313,262 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (13,783,260- 13,313,262)= 469,998 lekë.



### **Analiza e llogarive debitorë v. 2017**

Në pasqyrat financiare të vitit 2017, gjendja e llogarisë debitorë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet me vlerë kontabël 84,985,816 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (84,956,816-27,528,539)= 19,031,723 lekë.

Në këtë llogari, janë evidentuar edhe subjekte debitorë për tatim taksat lokale. Më hollësisht për debitorët të subjekteve tatim taksave vendore, janë analizuar në pikën përkatëse sipas programit të auditimit.

Në këtë llogari debitorë të tjerë, sipas të dhënave që na u paraqitën, janë dy subjekte për shumën 89,000 lekë debitorë të trashëguara nga ish komunat sot njësi administrative e Bashkisë Finiq të lidhura nga rekomandimet nga auditimet e KLSH-së në vitet e kaluara. (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 5 )

### **Analiza e llogarive kreditore v. 2017**

Gjendja e llogarive kreditore, sipas pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:

Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 47,554,814 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (47,554,814- 39,566,427)= 7,988,387 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën 10,079,508 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (10,079,508- 0)= 0 lekë.

Llogaria 401-408, është e analizuar për 15 subjekte detyrime të gjitha të krijuara gjatë vitit 2017 më hollësisht në mënyrë analitike sipas të dhënave të pasqyrës nr. 6 (Bashkëngjitur Pasqyra Nr.6)

Nga auditimi i konstatua se nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 në llogaritë 401-408 edhe detyrimet për 6 fatura të tjera të pranuar gjatë viti që u përkasin dy subjekteve në shumën totale 52,965,810 lekë (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 8 )

Llogaria 467, është krijuar gjatë vitit 2017 dhe është e analizuar për detyrime ndaj 11 subjekteve në shumën 10,079,508 lekë më hollësisht sipas pasqyrës bashkëngjitur (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 7)

**-Përveç kësaj**, nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2017, **nuk janë kontabilizuar si detyrime në llogarinë 467, faturat e pa paguara për energjinë elektrike që i përkasin viteve paraardhëse, viteve 2011-2015, për shumën 1,801,755 lekë.**

Gjatë vitit 2017, këto detyrime janë paguar me urdhër shpenzimet si vijon:

-Me urdhër shpenzimi nr. 59, datë 27.03.2017, është paguar energji elektrike të prapambetura detyrime ndaj O.....E me NIPT K.....H në total në shumën 1,363,907 lekë, nga të cilat kammat vonesat 190,701 lekë.

Faturat e pa paguara janë të viteve 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

-Me urdhër shpenzimi nr. 13, datë 19.01.2017 paguar energji elektrike në shumën 1,295,961 lekë nga të cilat të prapambetura nga viti 2013 për shumën 400,913 lekë

-Me urdhër shpenzimi nr. 35, datë 21.02.2017 paguar energji elektrike në shumën 888,248 lekë nga të cilat të prapambetura nga viti 2013 për shumën 36,935 lekë.

**Po kështu**, nuk janë kontabilizuar si detyrime në llogarinë 467 edhe shpenzime **për telefona** që i përkasin faturimeve të vitit 2016, në vlerën 144,444 lekë të paguara gjatë vitit 2017 si më poshtë:

-Me urdhër shpenzimi nr. 7, datë 10.01.2017 janë paguar shpenzime për telefona të lëvizshëm në shumën totale 144.444 lekë nga të cilat për muajin Nëntor 2016 për shumën 74,842 lekë dhe për muajin dhjetor 2016 për shumën 69,602 lekë.





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga auditimi i konstatua gjithashtu se nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 edhe shuma kreditore llogaria 467 për 8 subjekte në vlerën totale të detyrimit 4,832,408 lekë të cilat përfaqësojnë vendime gjyqësore të formës së prerë të fituara nga ish punonjës në vitin 2017 për ndërprerje të marrëdhënieve të punës (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr.9*)

Kjo praktikë e mos pasqyrimin të detyrimeve nga të tretët sipas faturave të pranuar dhe vendimeve gjyqësore për vlerën 59,744,417 52,965,810 lekë.

### **Kriteri:**

UMF nr. 14 datë 28.12.2006 i ndryshuar me nr. 26, datë 27.12.2007 Kap. II, pika 3;

UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kap. III, pikat 28, 30, 34;

VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyra financiare” i ndryshuar, Kreu II, neni 7; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pikat, Kap. IV, pika 74.

Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyra financiare” i ndryshuar, Kreu II, neni 7

**Impakti:** Në përpilimin e opinionit mbi pasqyrat financiare, në performancën e Institucionit Bashkia Finiq dhe treguesit ekonomikë dhe financiarë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** *E lartë*

### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq, të marrë masat për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël. Drejtoria e Financës, të marrë masat për regjistrimin kontabël të detyrimeve të angazhimit sipas kontratave të lidhura me subjekte sipërmarrëse përfshi kontratat për dhënien me qira të asetëve.

Për të pasqyruar saktë treguesit financiarë të burimeve dhe detyrimeve financiarë, në fund të periudhave ushtrimore, të rakordohet me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatikë të Thesarit.

**2. Titulli i gjetjes:** *Nxjerrja e pasqyrave financiare, shkeljet të parimeve kontabël për evidentimin e detyrimeve kreditore, mos rakordimi I llogarive të pasqyrave financiare me rezultatet e gjendjes fizike nga mos kryerja e inventarëve fizikë për vitin 2018, mos kontabilizimi i asetëve të dhuruara nga donatorë të ndryshëm si dhe grandet në natyrë të Qeverisë.*

### **Situata:**

*Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V. 2018*

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, është në pasqyrat financiare për vlerën debitorë 109,560,256 lekë. Kjo vlerë është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, dhe e analizuar si vijon:



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

<b>I. Të trashëguara nga viti 2017.</b>	
Sipas akt rakordimit për vlerën .....	213,132,893 lekë.
Grand i trashëguar.....	16,209,041 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	45,665,594 lekë
Mjete ne ruajtje të trashëguara.....	10,274,635 lekë
Specifike.....	93,866,122 lekë
FZHR.....	47,117,501 lekë
<b>II. Të hyra (shitesat debitorë) gjatë vitit 2018</b>	
Granit i vitit.....	120,442,040 lekë
Të ardhurat e vitit .....	63,223,332 lekë
Të hyra nga mjete ne ruajtje.....	8,536,007 lekë
Granit specifik.....	40,434,000 lekë
F.SH.Zh.....	118,955,201 lekë
Shuma e hyrjeve gjatë vitit ushtrimor.....	351,590,580 lekë.
<b>Totali i te ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2018 (I+II)= 213,132,893 + 351,590,580 = 564,723,473 lekë.</b>	
<b>III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:</b>	
Mjete në ruajtje.....	322,787 lekë
Paga, sig. Shoq.....	222,323,515 lekë
Subvencione uji.....	1,004,000 lekë
Investime.....	231,512,915 lekë
<b>Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore).....</b>	<b>455,163,217 lekë</b>

Gjendja debitorë (Saldo debitor) në fund të vitit 2018, është (564,723,473 - 455,163,217 = 109,560,265 lekë.

-Po kështu llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 18,487,832 lekë dhe është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, shtuar gjatë vitit ushtrimor për (18,487,832- 10,274,635 që është ngurtësimi në fund të vitit 2017)= 8,231,197 lekë (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 10 )

-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik v. 2018:

**Për vitin 2018**, nuk është kryer inventarizimi mbi gjendjen fizike të Aktiveve Afat Gjatë dhe Aktiveve afatshkurtër.

Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre.

Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të gjithë asetëve, është shkelje e kërkesave të **UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Kreu III, pika 30.**

-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32 viti 2018.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën kontabël historike 25,643,787 lekë, shtuar gjatë vitit për vlerën (25,643,787 – .16,374,237) = 9,269,499 lekë për 4 projekte të analizuar si më poshtë vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D, Veprimeve	1	Çelja e tepricës dt 31/12/2017	16,374,237
'	2	Hartim Projekti Ujësjellësi Fshati Vagalat	3,260,783
'	3	Hartim Projekti Rehabilitim I kanalit Thoma Filipeu	2,427,401
Bilanci	4	Hartim projekti Ndertim I ministadiumit I qendrës Finiq	1,527,210
	5	Hartim Projekti Rehabilitim I Rrg. Muzine - Dhrovjan	2,054,105
Bilanci		Shtuar gjatë vitit	9,269,499
		Shuma e tepricës date 31,12,2015	25,643,787

-Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” për vlerën historike 300,000 lekë gjatë vitit ushtrimor nuk ka pasur shtesa dhe pakësime.

-Llogaria 212 “*Ndërtime konstruksione*” për vlerën historike 281,048,055 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (281,048,055-239,028,808)= 42,019,247 lekë sipas pasqyrës që vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	Çelja e tepricës dt 31.12.2017	239.028.808
Bilanci	2	Qendra Kulturore Livadhja	42,019,247
		Shuma e tepricës dt 31/12/2018	281,048,055

-Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për vlerën historike 1,139,618,390 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (1,139,618,390-1,002,619,941)= 136,998,446 lekë me analizë sipas të dhënave kontabël si vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e llogarive dt 01/01/2017	1002.619.941
'	2	Rruga Dermish Cerkovice	4,588,429
'	3	Rruga Pllake -Kullurice	72,347,000
'	4	Rruga Fitore –Aliko	34,956,288
'	5	Rikonstruksion I Kanalit kk1-kk2	3,364,476
'	6	Rehabilitim I KK1 Kk2	10,129,964
	7	Ndertimi I rrugës Shen Varvara	5,355,000
	8	Rikonstruksion I varrezave	2,161,689
	9	Blerje barriera metalike	1,927,080
	10	Blerje materiale ndertimi per rikonstruktim. rrugëve	2,168,520
		Shtuar gjatë vitit	136,998,446
		Shuma e tepricës dt 31/12/2018	136,998,446

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” për vlerën kontabël 64,631,731lekë, shitur gjatë vitit ushtrimor për vlerën (64,631,731-43,923,890)=20,707,840 lekë.

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës dt 01/01/2018	43.923.890
	1	Blerje makineri gërmimi	3,392,336
	2	Blerje pajisje audiovizuale	956,880
	3	Blerje Poma e ujit Dhrovjan	780,000
	4	Blerje Mjete per saldaturen	864,000
	5	Prerese Bari	190,000
	6	Blerje ndricues	14,524,624
'		Shtesat e vitit	20.707.840
		Shuma e tepricës dt 31/12/2018	64.631.731



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

*Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2018, Bashkia Finiq, është furnizuar me paisje elektronike nga Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) për vlerën kontabël historike 1,968,750 lekë me procedurën si më poshtë:*

-Kontrata nr. 748 prot., datë 25.10.2016 e lidhur midis Pronarit që është Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. SH dhe përdoruesit Bashkisë Finiq përfaqësuar nga L. H. Afati I kontratës është 18 muaj nga dita e dorëzimit.

Objekti I kontratës është që Pronari merr përsipër të sigurojë në bashkëpunim me shoqëritë kontraktuese për Përdoruesin pajisje Hardëare, Softuerë, zhvillim, instalim, testim dhe mirembajtje të aplikacionit për 1 (një) vit në përputhje me sasinë, cilësinë dhe karakteristikat e tjera të mallit. Furnizime është bërë sipas tabelës së mëposhtme.

Sipas kontratës, do të furnizohet me këto paisje:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Njësia	Sasia
1	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASK alfa 2200	Copë	2
2	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera FS -6525 MFP	Copë	8
3	Kompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	Copë	10
4	Sëтч, Netgear Prosafe FS205- 100 PES	Copë	5
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	Copë	15
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	Copë	10

Shpërndarja do të jetë sipas kushteve të kontratës është si vijon:

### Bashkia Finiq.

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
1	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASK alfa 2200	-	0
2	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera 1FS -6525 MFP	V1C6233893 V1C6C434744	2
3	Kompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	GXL18D2 1HKR792 HTË88C2 FGKR792	2
4	Sëтч, Netgear Prosafe FS205- 100 PES		1
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	-	3
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	Ë1603210639 Ë1603210678	2

### Njësia Administrative Livadhja

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
1	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASK alfa 2200	-	0
2	Paisje multifunkionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera 1FS -6525 MFP	V1C6434669 V1C6434999	2
3	Kompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	HV2FWC2 HPKR792 HV270D2 FDKR792	2
4	Sëтч, Netgear Prosafe FS205- 100 PES	3YJ163DMA0737	1
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	-	3



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	W1603210408 W1603210389	2

### Njësia Administrative Dhiver

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
1	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASK alfa 2200	-	0
2	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera 1FS -6525 MFP	V1C6435180 V1C6435087	2
3	K3ompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	HV10N62 JDKR792 HV1JL82 JPKR792	2
4	Sëtc, Netgear Prosafe FS205- 100 PES	3YJ163DSA0385	1
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	-	3
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	W1603210638 W1603210677	2

### Njësia Administrative Aliko

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
1	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASKalfa 2200	-	0
2	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera 1FS -6525 MFP	V1C6435179 V1C6434743	2
3	K3ompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	HTËKF62 HGKR792 GYZL8D2 CGKR792	2
4	Sëtc, Netgear Prosafe FS205- 100 PES	3YJ163DKA0371	1
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	-	3
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	W1603210405 W1603210390	2

### Njësia Administrative Mesopotam

Nr	Përshkrimi I mallrave	Numër serie	Sasia
1	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera TASKalfa 2200	LBF6305587 LBF6305584	2
2	Paisje multifunksionale për Protokollin dhe Arkivin (A3, printer pa ngjyra, skaner, fotokopjues) për zyrat me kapacitet të vogël, Kyocera 1FS -6525 MFP	--	0
3	K3ompjuter për instalimin e aplikacionit për përdorim nga protokollin dhe arkivi, Dell Optiplex 3020 MT	GYJJ8D2 CPKR792 HTËS992 5TMR792	2
4	Sëtc, Netgear Prosafe FS205- 100 PES	3YJ163DUA0379	1
5	Kabull FTP CAT5 (me koka R145) për lidhje e dy kompjuterëve dhe një MFP në rrjet.(Copë nga 5 metra linear secila)	-	3
6	Paisje UPS, SPS PLI 650I	W1603210406 W1603210155	2

Emërtim dhe vlera kontabël historike e pajisjeve të furnizuara sipas kontratës, është sipas të dhënave që vijon:





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nr	Viti i blerjes	Emërtimi	Sasia/C opë	Çmimi	Vlera Lekë
1	Korrik 2016	Kompjuter Dell Optilex 3020 MT	10	101,520	1,015,200
2	Korrik 2016	Fotokopje Multifunksion Kyocer FS -625 MFP	8	96,600	772,800
3	Korrik 2016	Fotokopje Multifunksion Kyocer Taskalfa 220	2	54,000	108,000
4	Korrik 2016	Paisje UPS SPS PLI 6501	10	5,400	54,000
5	Korrik 2016	Sëitch Netgear Prosafe FS 205- 100 PES	5	1,590	7,950
6	Korrik 2016	Kabull FTP CAT5	15	720	10,800
	<b>Shuma</b>				<b>1,968,750</b>

Marrja në dorëzim është sipas Fletë daljes të furnitorit nr. 166, datë 19.11.2018 për vlerën 1,968,750 lekë, pa komision, fletë dalja është firmosur nga Drejtore e financës L. M.

Janë bërë hyrje në Bashkinë Finiq me fletë hyrjen nr. 47, datë 22.11.2018.

Me kartelë personale, furnizimet u janë bërë dalje Njësive Administrative të firmosura nga Administratorët e këtyre njësive furnizuar sipas kushteve të kontratës.

Aktualisht, sipas deklarimeve të Drejtores së Financës, nga këto furnizime mungon Fotokopja e Njesisë Livadhja pasi është tërhequr nga furnitori për riparim, por nuk është nënshkruar dokumenti që do të ishte akti i dorëzimi dhe fotokopja, nuk është kthyer ende në këtë Njësi, kurse një fotokopje tjetër në njësinë administrative Dhiver, aktualisht nuk është në gjendje pune, është me defekt.

Nga deklaratimet e punonjësit të IT të kësaj bashkia dhe punonjësve që i përdorin ato, pajisjet janë në gjendje pune dhe është implementuar programi për të cilën ato janë instaluar.

Për këtë punonjësit që i përdorin këto paisje, janë trajnuar.

***Bashkëngjitur, janë foto të skanuara të këtyre pasjeve sipas Njësive ku ato janë instaluar.***

Këto inventarë, për vlerën 1,968,750 lekë, përfaqësojnë **grande** të Qeverisë, u konstatua se **nuk janë kontabilizuar në llogaritë financiare të vitit 2018 e na vazhdim në kundërshtim me kërkesat e të kërkesave të UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III, pika 28, 30.**

***Po kështu, gjatë vitit 2018, sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion, u konstatua se Bashkia Finiq, është furnizuar me paisje kaldaja dhe instalime të tjera për shkollën 9 vjeçare të Mesopotami në vlerën totale për 5,141,442 lekë të cilat nuk janë kontabilizuar në llogaritë financiare të vitit 2018 e na vazhdim në kundërshtim me kërkesat e të kërkesave të UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III, pika 28, 30.***

Pajisjet nuk janë marë në dorëzim me komision, fituarat tatimore janë të firmosura nga Drejtore e Financës, L. M.

Furnizimet janë bërë pa pagesë dhuratë nga Shoqata “S.....I” referuar faturave tatimore si vijon:

Fatura tatimore Nr. 3, datë 14.10.2018 për vlerën 2,285,261 lekë.

Fatura tatimore Nr. 4, datë 20.10.2018 për vlerën 297,721 lekë.

Fatura tatimore Nr. 5, datë 22.10.2018 për vlerën 788,310 lekë.

Fatura tatimore Nr. 6, datë 31.10.2018 për vlerën 454,080 lekë.

Fatura tatimore Nr. 8, datë 26.11.2018 për vlerën 1,308,828 lekë.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” për vlerën historike 70.687.643 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (70.687.643-49.420.644)= 21,266,999 lekë

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës dt 31.12.2016	49.420.644
	2	Blerje makine vetëshkarkuese	3,648,000
	3	Blerje makina me karroceri	5,950,000
	4	Blerje mjet transporti	2,998,800
	5	Blerje Zjarrfikese	4,000,000
	6	Blerje Autobus	4,670,199
		Shtesat e vitit	21.266.999
		Shuma e tepricës dt 31/12/2018	70.687.643

Nga auditimi u konstatua se në këtë llogari, nuk janë kontabilizuar edhe mjetet transporti të dhuruara nga të tretët si vijon:

### Donatorë në natyrë.

**Nuk janë pasqyruar në kontabilitet** mjete transporti që Bashkia Finiq ka marrë në formë dhuratë, nga të tretët. Këto mjete **nuk janë vlerësuar me çmim me komision dhe nuk janë kontabilizuar si aktive të kësaj Bashkie, në kundërshtim me kërkesat** e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik” pika 30, 35, 42, 55, 56.

Konkretisht:

1-Në vitin 2018 mjet Benz targa AA....SR, dhuratë nga Ambasada Greke, e pa vlerësuar me çmim. Nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

Është policë sigurie tek A.....A me nr. 124, datë 24.07.2018 me pronësi Bashkia Finiq.

2-Zjarrfikëse dhuruar për B. Finiq nga Komanda e Trupës Zjarrfikese, Rajoni i Epirit, Janinë me datën 16.07.2018. Certifikatë pronësie datë 01.08.2018. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

3-Fugon Mercedesedes. Akti i dhurimit datë 14.03.2018, dhuruar nga Shoqata “F.....V” në Gjermani. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

4-Ambulancë, copë 2. Dhuruar nga Ambasada Greke në Tiranë dy mjete tip Wolsvagen. Certifikatë e pronësisë më 29.05.2019. Akti i dhurimit më 24.04.2019. Targat O.....P dhe O.....P. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën historike 22.757.013 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (22.757.013 – 21.506.133)= 1.250.880 lekë.

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës 01/01/2015	21.506.133
	2	Blerje Kompjuter	957,000
	3	Blerje tavolina karrike per kopshte	173,880
	4	Blerje mobileje MZSH ja	120,000
		Shtuar gjatë vitit	1.250.880
		shuma e tepricës dt 31/12/2018	22.757.013

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Finiq, është furnizuar me inventarë nga donatori “E.....R” shpk **tavolina e karrike etj. Të vlerësuar në vlerën 288,436 lekë.**

Këto inventarë ekonomike, i janë dhuruar shkollës Finiq sipas faturës nr. 8, datë 27.01.2017. Nuk janë kontabilizuar në llogaritë e aktivitet të bashkisë Finiq në kundërshtim me kërkesat ligjore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Llogaria 31 “*Materiale*” për vlerën kontabël lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (2,269.673- 1,741,317)= 528,356 lekë.

-Llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën kontabël lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (16.996.026- 13,313,262)= 3,682,764 lekë.

#### **Analiza e llogarive debitorë v. 2018**

Në pasqyrat financiare të vitit 2018, gjendja e llogarisë debitorë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 117,876,251 lekë. Nga të dhënat që na u paraqitën, në këtë llogari janë evidentuar debitorët për tatim taksat lokale të cilat më hollësisht janë trajtuar me akt konstatimi më vehte si dhe 29 debitorë të tjerë për vlerën 1,036,197 lekë sipas pasqyrës bashkëngjitur (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 13 bashkëngjitur*)

#### **Analiza e llogarive kreditore v. 2018**

Gjendja e llogarive kreditore, sipas pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:

Llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për vlerën 60,238,456 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për 0 lekë.

Llogaria 401-408, është e analizuar për 12 fatura në vlerën 60,238,456 lekë sipas të dhënave të pasqyrës bashkëngjitur (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 14 bashkëngjitur*)

Në llogarinë 467, nuk janë kontabilizuar detyrime sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë për 6 raste në shumën 3,238,193 lekë (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 15 bashkëngjitur*)

Në këtë llogari 467, nuk janë pasqyruar edhe detyrimet e pa paguara diferencë e pa paguar sipas kontabilizimeve të vitit të kaluar 2017 **për vlerën 2,442,506 lekë**.

Më hollësisht në mënyrë analitike, jepet në pasqyrën nr. 7, llogaria 467 për vitin 2017.

#### **Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” Kreu III, pika 28, 30, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 30, 35, 42, 55, 56 dhe ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”, neni 15.

#### **Impakti:**

Në përpilimin e opinionit mbi pasqyrat financiare, në performancën e Institucionit Bashkia Finiq dhe treguesit ekonomikë dhe financiarë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** *E lartë.*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq, të marrë masat për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël.

Për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Drejtoria e Financës, të marrë masat për regjistrimin kontabël të aseteve të dhuruara nga donatorë të ndryshëm si dhe grande të Qeverisë Shqiptarë të dhëna në natyrë.

**3. Titulli i gjetjes:** *Llogaritë financiare të fund vitit 2019, janë të pa rakorduara me inventarizimet fizike ndërkohë që nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të vitit.*

#### **Situata:**

**Për vitin 2019.**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2019

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520** “Disponilitete në Thesar”, është në llogaritë financiare për vlerën debitorë 26,498,067 lekë. Kjo vlerë është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, dhe e analizuar si vijon:

<b>I. Të trashëguara nga viti 2018.</b>	
<b>Sipas akt rakordimit për vlerën .....</b>	<b>109,560,256 lekë.</b>
Grand i trashëguar.....	73,210,343 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	17,861,560 lekë
Mjete ne ruajtje të trashëguara .....	18,487,832 lekë
FZHR .....	521 lekë

<b>II. Të hyra (shitesat debitorë) gjatë vitit 2019</b>	
Grandi i vitit.....	116,070,000 lekë
Të ardhurat e vitit.....	60.451.170 lekë
Të hyra nga mjete ne ruajtje.....	2.855.000 lekë
Sistemi pa kontabilizuar në llog. 466 diferencë.....	210,096 lekë
Granit specifik.....	42.112.000 lekë
F.SH.Zh.....	24.623.240 lekë
<b>Shuma e hyrjeve gjatë vitit ushtrimor.....</b>	<b>246,111,410 lekë</b>
<b>Totali i te ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2019 (I+II)= 109,560,256+246,321,506 = 355,881,762 lekë.</b>	

<b>III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:</b>	
Mjete në ruajtje.....	1,075,697 lekë
Paga, sig. Shoq.....	205.919.513 lekë
Subvencione uji.....	10.002.000 lekë
Ndihma ekon. + paaftësi.....	283,166 lekë
Investime.....	87.525.151 lekë
Derdhur ne buxhet.....	24,623,240 lekë
<b>Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore).....</b>	<b>329,428,767 lekë.</b>
<b>Gjendja debitorë (Saldo debitor) në fund të vitit 2019, është (355.881,762- 329,428,767) = 26,452,995 lekë.</b>	

**Analiza mbi lëvizjen debitorë të kësaj llogarie në shumën totale 26.498.067 lekë, është si vijon:**

<b>I. Të trashëguara.</b> Gjendja ne fund te vitit 2019 paraqitet si me poshtë vijon:	
Grand i trashëguar.....	2.512.239 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	3.462.996 lekë
Mjete ne ruajtje të trashëguara.....	20.522.832 lekë

-Po kështu **llogaria 466** “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 20,477,706 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve dhe sipas aktit



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

të rakordimit me Degën e Thesarit (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 16 bashkëngjitur*)

Nga analiza e gjendjes të fondeve të ngurtësuara si garanci për punimet e kryera nga të tretët, me afat garancie të punimeve, 1 vit nga akti i dorëzimit, u konstatua se në këtë llogari, gjenden të ngurtësuara fonde për **të cilat prej disa vitesh është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë cbllokimi i tyre.**

Shumica e tyre, e kanë burimin e krijimit nga ish komunat sot Njësi Administrative të bashkisë Finiq, pra me burim krijimi para vitit 2015.

Bashkia Finiq, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për cbllokimi e këtyre fondeve dhe përdorimin në buxhetin e vet. Shuma totale e këtyre fondeve në llog. 466, është **për 3,032,612 lekë** e analizuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

Nr	Nga ish Komunat	Objekti i shpenzimit	Vlera Lekë	Shënime
1	Dhiver	Shkolla 8 vjeçare DH.....Ishpk	74,552	
2		Të trashëguara pa analizë	232,104	Nuk ka analiza
3	Aliko	Rikonstru. ujësjellësi F.....N	100,000	
4		Rikonstruksion zyra Aliok K.....I shpk	72,970	
5		Rikonstruksion rrugës Ura e Belit-Caushi K.....I	111,650	
6		Furnizim me ujë fshati Berdenesh F.....S.	168,000	
7		Rikonstruksion ambulanca Jermen F.....S shpk	50,000	
8	Livadhja	Rruga Geaves K.....I shpk	75,000	
9		Rruga e fshatit Sopik K.....I shpk	195,000	
10		Blerje Autoveturë Q.....B	95,000	
11		Rruga Komunës Livadhja J.....Y	47,000	
12		Rruga e mesme lagja Livadhja K.....I shpk	38,000	
13		Nga ish Komuna Finiq	1,773,336	Nuk ka analiza
		<b>Shuma</b>	<b>3,032,612</b>	

*-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik v. 2019:*

**Për vitin 2019**, nuk është kryer inventarizimi mbi gjendjen fizike të Aktiveve Afat Gjatë dhe Aktiveve afatshkurtër.

Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre.

Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Kreu III, pika 30 dhe të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 15.

*-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2019.*

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

-Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën kontabël historike 36,263,087 lekë, shtuar gjatë vitit për vlerën (36,262,087 -25,643,787 ) = 10,618,300 lekë.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2019	25,643,787
	2	Projekt linja e jashtëm Ujësjellësit Finiq	10,619,300
	8		





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
		Shuma teprica datë 31.12.2019	36,263,087

-Llogaria 210 “*Toka, troje, terene*” për vlerën kontabële historike 300,000 lekë. Gjatë vitit nuk ka pasur shtesa dhe pakësime.

-Llogaria 2012 “*Ndërtime konstruksione*” për vitin 2019 nuk ka pasur shtesa dhe pakësime, vlera historike 281,048,055 lekë.

-Llogaria 2013 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për vlerën historike 1,200,622,131 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (1,200,622,131- 1,139,618,390)= 61,003,741 lekë.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2019	1,139,618,390
	2	Rikonstruksion varrezash	6,884,538
	3	Rruga Fitore Aliko	32,244,000
	4	Rruga Karroq	2,999,602
	5	Rehabilitim i rrugëve të brendshme	12,426,691
	6	Tabela sintreguese turistike	1,899,960
	7	Mirembajtje e rrjeteve ujore	2,548,950
	8	Materiale elektrike	--
	9	Blerje shërbim portalit	2,000,000
		<b>Shuma teprica datë 31.12.2019</b>	<b>1,200,622,131</b>

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*” për vlerën kontabële 78,208,562 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (78,208,562- 64,631,730) = 13,576,832 lekë.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2019	64,631,730
	2	Blerje pompë uji	738,000
	3	Kompresor ajri	99,000
	4	Depozite shkumë	95,000
	5	Lavazh makina	99,000
	6	Paisje elektrike	6,743,712
	7	Blerje mjet gjermimi	1,692,120,
	8		4,110,000
		<b>Shuma teprica datë 31.12.2019</b>	<b>78,208,562</b>

-Llogaria 215 “*Mjete transporti*” për vlerën historike 72,909,423 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (72,909,423- 70,687,673)= 2,221,780 lekë.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2019	70,687,643
	2	Blerje autobus (në v. 2018)	245,780
	3	Blerje zjarrfikese	1,976,000
		<b>Shuma teprica datë 31.12.2019</b>	<b>72,909,423</b>

Llogaria 2018 “*Inventar ekonomik*” për vlerën historike 22,860,513 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (22,860,513- 22,757,013) = 103,500 lekë.

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2019	22,757,013
	2	Blerje biblioteke	55,000
	3	Blerje fotokopjues	48,500
		<b>Shuma teprica datë 31.12.2019</b>	<b>22,860,513</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Llogaria 31 “*Materiale*” për vlerën kontabël 1,741,317 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (2,128,550- 1,741,317)=387.233

-Llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën kontabël 13,313,262 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (13,783,260- 13,313,262)= 469.998

#### **Analiza e llogarive debitorë v. 2019**

Në llogaritë financiare të vitit 2019, gjendja e llogarisë debitorë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 863,871 lekë e analizuar për 21 subjekte debitorë të rekomanduara nga auditimet e mëparshme të KLSH-së (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 17 bashkëngjitur*)

#### **Analiza e llogarive kreditore v. 2019**

Gjendja e llogarive kreditore, është si më poshtë vijon:

Llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për vlerën 121,563,700 lekë e analizuar për 42 subjekte dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën 12,898,529 lekë, e analizuar për 10 subjekte (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës Nr. 18 bashkëngjitur*)

#### **Kriteri:**

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Kreu III, pika 30 dhe të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 15.

#### **Shkaku:**

Për verifikimin e llogarive kontabël me gjendjen fizike të tyre me impakt në formimin e opinionit për pasqyrat financiare.

#### **Impakti:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

#### **Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

**4. Titulli i gjetjes:** *Nga testimi i disa llogarive, u konstatuan se B.Finq ka transferuara asetë në U.....N ShA si dhe raste të aseteve të dhuruara nga donatorë të ndryshëm, pa kryer veprime kontabël.*

#### **Situata:**

##### **Për pagat**

Shpenzimet për pagat, janë brenda limiteve të fondeve të miratuara dhe të formalizuar sipas dokumenteve ligjore.

**Për vitin 2017**, janë paguar gjithsej 197 punonjës. Listë pagesat janë të firmosura nga Specialisti I pagave, Drejtori I Financës dhe Kryetari i Bashkisë, L. H.

Lista prezencat janë të firmosura nga P/Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë.

Për punonjësit e Njësive Administrative, listë prezencat janë të firmosura vetëm nga Administratori i Njësive, për Shërbimin MZSH (Zjarrfikëset) janë të firmosura nga



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

K/Inspektori I zjarrfikës, kurse për edukatorët dhe pastrueset e shkollave, janë të firmosura nga Drejtorët e shkollave.

Numri i punonjësve, është miratuar me Vendimi të Këshillit të Bashkisë nr. 57 datë 24.02.2017, miratuar për numrin gjithsej 195 punonjës nga të cilët 14 për punonjës me fonde të deleguara.

Struktura organizative është miratuar me urdhër të Kryetarit të bashkisë, L. H me nr. 107, datë 01.11.2017 dhe nr. 3171 prot. për numrin e punonjësve **195 punonjës**.

**Për vitin 2018**, numri i punonjësve është miratuar me vendimi të Këshillit të Bashkisë nr. 80, datë 29.12.2017 për miratimin e numrit të punonjësve në **total 195 punonjës nga** të cilët 181 për Bashkinë, 14 punonjës të deleguara si edukatorët, zjarrfikësit, dhe për mirëmbajtje të rrugëve.

-Me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 110 datë 29.06.2018, është ndryshuar duke u miratuar numri i punonjësve gjithsej për 200 punonjës.

**Për vitin 2019**, është miratuar shtesë në numrin e punonjësve, ku me vendimin të Këshillit të Bashkisë nr. 5, datë 26.8.2019 ku miratohet shtesë numri i punonjësve me 10 punonjës.

#### **Mbi transferimin e aseteve në U.....N ShA.**

-Me Vendim të Këshillit të Bashkisë (VKB) nr. 4 datë 01.04.2016 me nr. Prot., 1057 datë 14.04.2016 dhe në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, është miratuar krijimi i U.....N ShA me kapital tërësisht publik në vlerën 334.796.075 lekë.

Vlera e aseteve që Bashkia Finiq do të investonte në këtë Shoqëri, është rivlerësuar nga ekspert vlerësues të pasurisë së paluajtshme të licencuar me vendim gjykate nr. 23-2017-631(318) datë 04.04.2017 me nr. NIPT, I.....F.

Është krijuar bordi drejtues i kësaj Shoqërie i përbërë nga:

-L. H ish Kryetar i Asamblesë me detyrë Ish-Kryetari i Bashkisë Finiq.

Këshilli administrativ është i prerë nga:

- 1 A.....I Administrator (Kryetar) ish administrator.
- 2 F. E, (anëtar) specialist e burimeve njerëzore Bashkia Sarandë.
- 3 I. N (anëtar) punonjës në Kadastrën Sarandë.

Nga auditimi dhe të dhënat që na u paraqitën, konstatohet se Bashkia Finiq, **ka transferuar në vitin 2019 asete për U.....N ShA, gjithsej në shumën 350,273,775 lekë** të përbëra si vijon:

-10,002,000 lekë fonde chesh,

-334,796,075 lekë asete të vlerësuara nga ekspertët si tubacione e paisje të tjera teknologjike, -2 mjete transporti në vlerën 3,957,700 lekë,

-2 pompa uji me instalimet përkatëse për vlerën 1,518,000 lekë.

U konstatua se procedurat e ndjekura për këto transferta, janë në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi:

-Për të gjitha këto transferta, me përjashtim të transferta në chesh, nuk janë miratuar me VKB, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 54/e,dh

-Transferta në natyrë, nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 35/a, b, 42, 44.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Për rrjedhojë, nuk janë bërë veprimet kontabël nga ana e Bashkisë Finiq dhe si rrjedhim, pasqyrat financiare të vitit 2019, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e aseteve të Bashkisë Finiq si raportet financiare si aksionere në Ndërmarrjen U.....N ShA, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik” pikat 35/a, b, 42, 44 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme” Kap. II, neni 17.

Më hollësisht, transferimet për periudhën e auditimit për vitet 2017, 2018, 2019, janë si vijon:

**Për vitin 2017:** Nuk ka pasur kalime të aseteve ose vlera monetare për llogari të U.....N ShA.

**Për vitin 2018:** Nuk ka pasur kalime të aseteve ose vlera monetare për llogari të U.....N ShA.

**Për vitin 2019, alokimi i fondeve** për U.....N ShA në shumën 10,002,000 lekë per paga dhe sigurime shoqërore, janë bërë me urdhër shpenzimet:

-U. shpenzimin nr. 20 datë 7.01.2019 kaluar shuma 3,501,000 lekë.

-U. shpenzimi nr. 148 datë 08.04.2019 ka kaluar shuma 3,501.000 lekë si dhe me urdhër shpenzimin nr. 484 datë 13.12.2019 ka kaluar shuma 3.000.000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, **aktivet e vlerësuara** nga grupi I ekspertëve, për të cilat nuk është përpiluar akti i dorëzimit dokumentacioni për U.....N ShA për vlerën 334,796,075 lekë, janë të analizuar si vijon:

Nr	Aktivet . Llogaria	Vlerësuar në Lekë
1	Toka dhe ndërtesa	69,506,095
2	Impiante dhe makineri	236,641,660
3	Të tjera Instalime dhe pajisje	28,348,300
4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	300,020
	<b>Shuma</b>	<b>334,796,075</b>

Që nga periudha e krijimit të U.....N ShA, nga Bashkia Finiq janë kaluar kësaj shoqërie edhe këto **mjete transporti**.

1- Autoveturë 4+1 Mercedes BENZ viti i prodhimit 2000 targa AA....CF vlera kontabël 2,460,200 lekë, amortizimi deri me datën 31.12.2018 është 1.105.466 lekë.

2- Dhe mjete Ranger 2 AB FORD i vitit 2013 I blerë nga Bashkia Finiq në prill të vitit 2018 me vlere fillestare 1,497,500 lekë.

#### **Makineri paisje:**

Për furnizimin me ujë të fshatit Dhrovjan janë financuar dhe montuar nga Bashkia Finiq për llogari të U.....N ShA, dy pompa me vlerën 738,000 dhe 780,000 lekë.

Këto blerje janë bërë nga fondet e bashkisë Finiq. Megjithëse janë investuar për U.....N ShA, nuk është bërë kalimi i kapitalit me akt dorëzimi dhe nuk ka vendim të këshillit të bashkisë për kalim kapitali për U.....N ShA.

#### **Donatorë në natyrë nga të tretët.**

Nuk janë pasqyruar në kontabilitet mjete transporti që Bashkia Finiq ka marrë në formë dhuratë, nga të tretët. Këto mjete nuk janë vlerësuar me çmim me komision dhe nuk janë kontabilizuar si aktive të kësaj Bashkie, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik” pika 30, 35, 42, 55, 56 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme”

Konkretisht:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

1-Në vitin 2018 mjet Benx targa AA....SR, dhuratë nga Ambasada Greke, e pa vlerësuar me çmim. Nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

Është policë sigurie tek A.....A me nr. 124, datë 24.07.2018 me pronësi Bashkia Finiq.

2-Zjarfikëse dhuruar për B. Finiq nga Komanda e Trupës Zjarfikëse, Rajoni i Epirit, Janinë me datën 16.07.2018. Certifikatë pronësie datë 01.08.2018. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

3-Fugon Mercedesedes. Akti i dhurimit datë 14.03.2018, dhuruar nga Shoqata "F.....V" në Gjermani. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

4-Ambulancë, copë 2. Dhuruar nga Ambasada Greke në Tiranë dy mjete tip Wolsvagen. Certifikatë e pronësisë më 29.05.2019. Akti i dhurimit më 24.04.2019. Targat O.....P dhe O.....P. E pa vlerësuar me çmim, nuk është bërë hyrje në kontabilitet.

#### **Kriteri:**

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 54/e, dh, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme" Kap. II, neni 17.

**Shkaku:** Për verifikimin e llogarive kontabël me gjendjen fizike të tyre me impakt në formimin e opinionit për pasqyrat financiare si dhe në administrimin e aseteve.

**Impakti:** Mos zbatimi I kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari I Bashkisë Finiq, të marrë masa për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

**5. Titulli i gjetjes:** *Nga testimi i disa llogarive, u konstatuan raste të shkeljeve të disiplinës financiare në zbatimin e kontratave me sipërmarrje dhe raste të shpenzimeve të tjera pa dëm ekonomik.*

#### **Situata:**

##### **Janë bërë hyrje materiale të kontraktuara pa marë në dorëzim me komision.**

U konstatuan në 5 raste, janë bërë hyrje materiale inerte si beton, rërë, gurë etj. të blera sipas kontratave të lidhura me të tretët pas procedurave të prokurimit **për vlerën totale 22,376,644 lekë** nga të cilat për 11,730,240 lekë në vitin 2017, për 1,880,760 lekë në vitin 2018 dhe për 8,765,644 lekë në vitin 2019, pa i marë në dorëzim me komision, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar neni 37, 42, 43. *Konkretisht:*

##### **Viti 2017**

-Me U. shpenzimi nr. 36, datë 24.02.2017, është paguar "A.....I shpk" me NIPT J.....C për vlerën 2,338,560 lekë për blerje betoni.

Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 29, datë 23.02.2017 e firmosur nga blerësi S. P dhe shitësi përfaqësues i firmës.

Fletë hyrja nr. 6, datë 28.02.2017 për beton, gur dhe rërë guri, firmosur vetëm nga magazinieri.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Furnizimi I referohet kontratës bashkëngjitur e lidhur midis palëve, datë nuk ka me afat sipas nenit 3 për datën 31.12.2016, çmimi total I ofertës është 11,730,240 lekë me TVSh.

#### **Viti 2018.**

-Me Urdhër shpenzimi nr. 118 datë 12.03.2018 është paguar “D.....A shpk” për 1,880,760 lekë për blerje betoni.

Fatura nr. 97 datë 1.03.2018 rërë cakull etj. Në shumën 223,680 lekë. Fatura firmosur nga K. TH , Fletë hyrja nr. 6 date 1.03.2018 për këtë vlerë.

Fatura tatimore nr. 77 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J .

Fatura tatimore nr. 78 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J . .

Fatura tatimore nr. 79 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J .

Fatura tatimore nr. 80 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J .

Fatura tatimore nr. 81 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J .

Fatura tatimore nr. 82, 83, 84 datë 23.02.2018 beton I gatshëm, Zgarë hekuri etj. Shuma 63,000 leke firmosur nga S. J .

Fletë hyrja nr. 5 datë 23.02.2018 vlere 504,000 lekë.

#### **Viti 2019**

-Me urdhër shpenzimi nr. 65, datë 12.02.2019 paguar “K.....I” shpk NIPT J.....C materiale ndërtimi për vlerën 3,900,000 lekë.

F. Hyrje nr. 49, datë 17.12.2018 materiale si beton I gatshëm, çimento, tjegulla, tuba beton etj. **në shumën 7,291,104 lekë** firmosur nga magazinieri V. SH . Bashkëngjitur kopje e faturës tatimore nr. 121 datë 3.12.2018 vlere 7,291,104 lekë, firmosur nga Drejtori I Shërbimeve K. TH.

Situacioni nr. 2, datë 3.12.2018, firmosur vetëm nga K. TH. Nuk ka marrje në dorëzim të materialeve me komision.

-Me urdhër shpenzimi nr. 406, datë 21.10.2019 paguar “D.....A” shpk NIPT J.....J materiale ndërtimi për vlerën 404,640 lekë.

F. Hyrje nr. 51, datë 13.12.2019 material beton I gatshëm lekë 51,840 lekë,

F. Hyrje nr. 46, datë 18.06.2019 material beton I gatshëm lekë 60,480 lekë,

F. Hyrje nr. 50, datë 13.12.2019 material beton I gatshëm etj. lekë 292,320 lekë,

Faturat tatimore nr. 1104 datë 22.8.2019 për 51840 lekë,

Faturat tatimore nr. 926 datë 6.06.2019 për 67,200 lekë,

Faturat tatimore nr. 891 datë 29.05.2019 për 51840 lekë,

Faturat tatimore nr. 892 datë 29.05.2019 për 67,200 lekë,

Faturat tatimore nr. 893 datë 29.05.2019 për 67,200 lekë,

Faturat tatimore nr. 894 datë 29.05.2019 për 67,200 lekë,

Faturat tatimore nr. 895 datë 29.05.2019 për 67,200 lekë,

Marrja në dorëzim e mallrave është firmosur nga Kolaudator S. J dhe magazinieri V. SH. Faturat janë firmosur nga S. J , një firmë për transportuesin pa emër dhe shitësi I mallrave.

Nuk ka marrje në dorëzim të materialeve me komision.

-Me urdhër shpenzimi nr. 415, datë 21.10.2019 paguar personi fizik “J.....I” me NIPT K.....V shuma 1,068,900 lekë për mirëmbajtje automjeti.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Fatura e thjeshtë tatimore nr. 2 datë 17.10.2019 firmosur nga marrësi V. T dhe J. K për 444,500 lekë, Fatura e thjeshtë tatimore nr. 30 datë 18.7.2019 firmosur nga marrësi V. T dhe J. K për 624,400 lekë.

Situacioni nr. 2 ka dy firma pa emër. Është pa komision marrje në dorëzim.

Kontrata e shërbimit me nr. 1641/1 prot. Datë 10.06.2019.

#### **Detyrime ndaj të tretëve të pa kontabilizuar.**

##### **Viti 2018**

-Me urdhër shpenzimi nr. 28, datë 25.01.2019, janë paguar energji elektrike për muajin Nëntor dhe dhjetor 2018 në shumën totale 2,713,788 lekë nga të cilat 1,499,306 lekë të muajit Nëntor 2018 të përcjella nga O.....E me shkresën nr. 24 prot., datë 16.01.2019 dhe 1,214,482 lekë të përcjella me shkresën nr. 909 prot., datë 15.12.2018.

Të pa kontabilizuar si detyrim.

***Vlera 2,713,788 lekë detyrime për energji elektrike për vitin 2018, e pa kontabilizuar e tillë në llogarinë 467 për vitin 2018, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap, II, pika 30, 42.***

-Me urdhër shpenzimi nr. 65, datë 12.02.2019 paguar “K.....I” shpk NIPT J.....C materiale ndërtimi për vlerën 3,900,000 lekë.

F. Hyrje nr. 49, datë 17.12.2018 materiale si beton I gatshëm, çimento, tjegulla, tuba beton etj. në shumën 7,291,104 lekë firmosur nga magazinieri V. SH . Bashkëngjitur kopje e faturës tatimore nr. 121 datë 3.12.2018 **vlera 7,291,104 lekë**, firmosur nga Drejtori I Shërbimeve K. TH.

Situacioni nr. 2, datë 3.12.2018, firmosur vetëm nga K. TH. Nuk ka marrje në dorëzim të materialeve.

***Vlera 7,291,104 lekë detyrime për fatura blerje të pa paguara për vitin 2018, e pa kontabilizuar e tillë në llogarinë 401-408 për vitin 2018, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap, II, pika 30, 42.***

-Me urdhër shpenzimi nr. 71, datë 4.03.2019 është paguar “E.....Y” shpk për shërbime në vlerën 1,976,000 lekë, paguar faturat pjesore me nr. 22, datë 30.07.2018 për vlerën totale 2,988,000 lekë dhe nr. 23, datë 30.7.2018 për vlerën totale po për vlerën 2,988,000 lekë. Vlera totale e kontratës së lidhur datë 02.08.2018 për vlerën totale 5,976,000 lekë me TVSh.

***Vlera 5,976,000 lekë detyrime për fatura blerje të pa paguara për vitin 2018, e pa kontabilizuar e tillë në llogarinë 401-408 për vitin 2018, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap, II, pika 30, 42.***

#### **Detyrime të pa paguara në afat me risk për penalitet ndaj Bashkisë Finiq.**

Nga analiza e llogarive kreditorë të vitit 2018, llogaritë 401-408, konstatohet ***se janë pa paguar 4 faturat tatimore për subjektin sipërmarrës “M.....E” shpk për shumën totale 55,222,000 lekë si më poshtë:***

Faturat tatimore; nr.17, datë 30.11.2018 për vlerën 24,000,000 lekë, nr. 19, datë 18.12.2018 për vlerën 2,370,190 lekë, nr. 4, datë 13.02.2017 për vlerën 12,938,400 lekë dhe nr. 17, datë 13.10.2017 për vlerën 15,913,410 lekë.

Referuar situacioneve përkatëse nr. 1, datë 13.02.2017 për vlerën 12,938,400 lekë i miratuar nga ish kryetari i bashkisë L. H, situacioni nr. 2 datë 01.10.2017 për vlerën 15,117,740 lekë i miratuar nga ish Kryetari i bashkisë L. H.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Fiq.

Prokurim i kryer me urdhër prokurimi nr. 47, datë 24.12.2015 për vlerën 51,885,206 lekë pa TVSh për objektin: “Ndërtimi i ujësjellësit Navaricë –Memoraq- Dermish”.

Kontrata e lidhur midis palëve nr. 3272/2, datë 22.12.2016, me afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës, data 22.03.2017. Sipas nenit 27 –*Dëmshpërblim për vonesat* ku citohet: “Sipërmarrësi do ti pagojë Investitorit dëmshpërblimin për vonesat në afatin e përfundimit të punimeve në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total të kontratës.”

Më datën 28.12.2018, M...E shpk i është drejtuar Bashkisë Fiq, konfirmuar në Bashkinë Fiq me nr. 3491 prot., datë 28.12.2018 për përfundimin e objektit dhe marrjen në dorëzim në zbatim të kontratës nr. 3271/1 prot., datë 22.12.2016.

Këto fatura, nuk janë paguar nga ana e Bashkisë Fiq, megjithëse ato janë pranuar dhe në vitin që ato janë paraqitur, ka pasur fondet përkatëse për ti paguar ato.

Faturat tatimorë; nr.17, datë 30.11.2018 për vlerën 24,000,000 lekë, ditë vonesë (deri më datën 29.12.2019) 455 ditë. Penaliteti si mundësi për të kërkuar nga ana e subjektit “M.....E” shpk, llogaritet;  $24,000,000 \times 455 \times 4/1000 = 43,680,000$  lekë.

Nr. 19, datë 18.12.2018 për vlerën 2,370,190 lekë x ditë vonesë  $435 \times 4/1000 = 4,124,130$  lekë.

Nr. 4, datë 13.02.2017 për vlerën 12,938,400 lekë x 1095 ditë vonesë x  $4/1000 = 56,670,192$  lekë.

Nr. 17, datë 13.10.2017 për vlerën 15,913,410 lekë x 855 x  $4/1000 = 54,423,862$  lekë.

***Shuma e penalitetit të llogaritur: 158,898,184 lekë.***

#### **Përdorim i investimeve pa efektivitet dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore.**

U konstatua se në vitin 2018, janë bërë shpenzime karburanti për mjetin e transportit Autobuzi Urban me Targa AA....UY me destinacionin transporti publik Livadhja- Fiq- Sarandë.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Transportit, janë shpenzuar gjithsej 7044 litra karburant ku sipas viteve; në vitin 2018 për 901 litra dhe në vitin 2019 për 6143 litra të vlerësuara në shumën  $7044 \times 175$  lekë/litër= 1,232,700 lekë.

Kryerja e shpenzime për transportin urban të komunitetit, është bërë pa pagesë (pa bileta) dhe pa pasur miratim nga Këshilli i Bashkisë.

Vlera 1,232,700 lekë, është shkelje e disiplinës financiare.

#### **Kriteri:**

Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1.2./c, neni 54/dh dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar neni 30, 37, 42, 43.

#### **Shkaku:**

Mos marrjen e masave organizative për marrjen në dorëzim të furnizimeve dhe shërbimeve nga të tretët sipas kontratave, mos ndjekja e detyrimeve kreditore dhe kontabilizimi i tyre.

**Impakti:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Fiq, të marrë masa për ngritjen e komisioneve përkatëse për marrjen në dorëzim të shërbimeve dhe blerjeve sipas kontratave me të tretët. Drejtoria Ekonomike të organizojë evidencën kontabël sipas kërkesave ligjore.

***(Gjerësisht trajtuar në faqen 51-83 të Projektraport Auditimit)***



### **IV/C .1 - Ekzekutimi i testeve thelbësore të veprimeve të kryera me bankë.**

*- Në lidhje me rregullshmërinë dhe përputhshmërinë ligjore të kryerjes së pagesave nëpërmjet bankës dhe dokumentacionit mbështetës shoqërues si dhe të procedurave të prokurimit me vlera të vogla.*

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), Bashkia Finiq ka zhvilluar procedurat me blerje me vlera të vogla për blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në rrugë elektronike.

Nga të dhënat, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer gjithsej **26** procedura me vlera të vogla për vlerën e fondit limit prej 17,790,831 lekë, nga e cila në vitin 2017 për 11 procedura me fond 10,022,819 lekë, në vitin 2019 8 procedura me fond limit 4,927,666 lekë dhe në vitin 2019 janë 7 procedura me fond limit 2,840,346 lekë.

Në përfundim të procedurave për periudhën e audituar janë lidhur kontrata në vlerën 13,819,652 lekë ose 77.6% e fondit, nga e cila në vitin 2017 për vlerën e kontratës 6,988,356 lekë, për vitin 2018 për vlerën e kontratës 4,454,341 lekë dhe për vitin 2019 për vlerën 2,366,955 lekë.

Nga grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi, duke vlerësuar të dhënat e materialitetit dhe riskut të auditimit ka vlerësuar për auditim **23** procedura me vlerë kontrate **11,925,561** lekë ose 86% e kontratave.

Nga auditimi i realizuar në dokumentacionin e bankës, për pagesat e kryera dhe dokumentacioni ligjor dhe teknik bashkangjitur për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin me vlera të vogla” me ndryshimet, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr. 2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013, me nr. 1, datë 28.02.2014, si dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar, konkretisht:

#### **Situata:**

- a- Nga ana e AK Bashkia Finiq, për periudhën e audituar, nuk është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike.
- b- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, jo në të gjitha rastet ka përcaktuar fondin limit duke bërë më parë hartimin e kërkesave vjetore për mallra apo shërbime të ndryshme, testimin e tregut dhe nuk ka hartuar urdhër prokurimit sipas formatit standarte.
- c- Në blerjet e realizuara, faturat e subjektit nuk janë plotësuar me të gjitha elementet që kërkon fatura, kishte raste që këto fatura nuk janë firmosur nga blerësi, apo të firmosura nga një person tjetër dhe nuk janë firmosur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla por nga ana e ish- titullarit të AK L. H.
- d- Janë konstatuar raste që nuk disponohej dokumentacioni i plotë që kërkohen për procedurën “Blerje me vlera të vogla”.
- e- Nga ana e autoritetit kontraktor, është shmangur procedura normale e prokurimit, duke përdorur procedurën e prokurimit me vlera të vogla, për mallra dhe shërbime, pasi vlera e mallrave apo dhe grup mallrave që janë blerë apo dhe shërbimeve të realizuara kanë tejkaluar vlerën e përlllogaritur gjatë vitit kalendarik, prej 800,000 lekë pa TVSh.
- f- Në dosjet e objektit për “Rikonstruksionet e ndryshme” që janë realizuar mungon dokumentacioni teknik ( libri i masave) si dokumentacion baze për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimit, i hartuar nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### Kriteri:

VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 40 “Procedura e prokurimit me vlera të vogla” pika 7; pika 1 dhe 4 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrisë të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrisë të realizimeve të prokurimit publik”; pika 5 e Udhëzimit të APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 3.2.

**Impakti:** Shmangie nga procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave drejtuese dhe mos njohja e plotë e kuadrit ligjor të procedurave.

**Rëndësia:** I lartë.

### **1. Titulli gjetjes:** Për shërbimin e realizuar për “Mirëmbajtje të automjeteve”.

#### **Situata:**

Për këtë lloj shërbimi janë realizuar me procedure “Kërkesë për propozim” janë kryer dhe shërbime të tjera me procedure “Blerje me vlera të vogla”, duke mos i grupuar dhe realizuar në një procedurë më vetë.

Planifikimi i nevojave në fillim të periudhave nuk është bërë sipas natyrës së shërbimit, sasisë dhe llojit të kontratave, si dhe përcaktimi i kufirit monetar të llogariten grupmallrash apo shërbimesh të ngjashme, si dhe nuk janë bërë hyrje në magazinë mallrat e vjetra rikupero

- Janë konstatuar raste që procedura e ndjekur për “Mirëmbajtje automjeti” është aplikuar me prokurim **nen 100,000 lekë**, mangësi e konstatuar në procedurat si vijon:

**a.** Është likuiduar subjekti “**D.....O**” me objekt “Mirëmbajtje automjeti”, disa here brenda vitit kalendarik duke aplikuar procedurën nën 100,000 lekë pa TVSh.

**b.** Është likuiduar subjekti “**F.....O**” me objekt “Mirëmbajtje automjeti”, disa here brenda vitit kalendarik duke aplikuar procedurën nën 100,000 lekë pa TVSh.

**c.** Janë kryer “blerje goma apo shërbime të ndryshme” me subjektin “**D.....A**”, nuk disponohej bashkangjitur dokumentacioni i duhur për të faktuar parametrat dhe llojin e gomave, apo llojin e shërbimit të realizuar në mënyrë analitike.

#### **Kriteri:**

VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, pika 1<sup>7</sup>; Udhëzimit të MF me nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, tek kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pika 36 dhe 37;

piken 5, të Udhëzimit të APP nr. 1 datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogël”.

**Impakti:** Shmangie nga procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjor në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

<sup>7</sup> ku theksohet se “Autoriteti kontraktor përdor procedurën me vlera të vogël, për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlllogarituar është me e ulët se 800,000 lekë në vit”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

1. Kryetari i Bashkisë Finiq gjatë fazës së hartimit të buxhetit të vitit pasardhës, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për hartimin e fondit limit për mallra/shërbime/ investime mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/ apo Sektorëve të sajë, duke bërë grupimin e tyre sipas grup mallrave dhe përcaktimin e saktë të procedurës që do zhvillohet.
2. Të hartojë dokumentacion mbështetës nga specialistët e fushës për përpilimin e preventivit sipas llojit të mjetit dhe shumës së fondit të nevojshëm për këtë shpenzim. Nga ana e komisionit të vlerave të vogla, komisionit të blerjes apo dhe punonjësit të magazinës të merren masa që për çdo blerje të realizuar të përcaktohen qarte në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallit, të magazinohen në magazinën rikupero pjesët e vjetra, si dhe të përcaktohen qarte të dhënat për shërbimet që do kryhen, kjo për të ndjekur gjurmueshmëri të tyre.

#### Më poshtë po trajtojmë rastet e konstatuara:

**a-** Është likuiduar subjekti “**K.....I**” me objekt “*Mirëmbajtje ujësjellësi*”.

Me **USH nr. 106 datë 26.04.2017**, për vlerën 31,700 lekë, me procedure emergjence, ku trajtohen dy raste për emergjence përkatësisht me datën 30.12.2016 dhe 18.02.2017, ku ne të dyja rastet nuk disponohet dokumentacioni i plote dhe i sakte për veprimet e kryera, pasi nuk ekziston evidentimi i vendit ku është defekti, si me fotografim, hartim preventivi apo dhe situacioni i kryerjes së punimeve. Nuk ka një proces verbal nga një komision për marrjen në dorëzim të punimeve, sipas kushteve teknike që kërkonte objekti.

**b-** Është likuiduar subjekti “**N.....A**”, me objekt “*Blerje materiale për “U.....T”*”.

- Me **USH nr. 238 datë 10.08.2017**, për vlerën **352,303 lekë**, zhvilluar me procedure “*Blerje me vlera të vogla*” në mënyrë elektronike, ku një nga elementet e preventivat është dhe Panel elektrik (pinaka) trefazor 5.5 K<sup>w</sup>. Në dokumentacionin bashkangjitur mungojnë specifikimet teknike se çfarë kushtesh duhet të plotësojnë mallrat që do të blihen, blerje e realizuar me faturën nr 60 datë ---/06/2017, bere hyrje me flete hyrjen nr 29 datë 01.07.2017, fature e cila nuk ishte plotësuar me të gjitha të dhënat për mallin e blere (*panëshkruar nga Bashkia Finiq*).

Nuk ka një proces verbal nga komisioni mbi marrjen në dorëzim të materialeve të blera veçanërisht “Paneli elektrik” 5.5 K<sup>w</sup>, duke trajtuar specifikimet teknike që duhet të plotësonte paneli, si dhe procesverbal mbi arsyen e skualifikimit të subjekti “**E.....I**” me ofertë më të leverdishme se fituesi 346,800 lekë.

Me **USH nr. 238 datë 10.08.2017**, për vlerën **833,304 lekë**, zhvilluar me urdhrin e prokurimit nr. 29 datë 03.07.2017, për procedure “*Blerje me vlera të vogla*”, me fond limit pa TVSh 800,000 lekë. Procedura e përcaktuar me vlera të vogla nuk duhej të ishte realizuar pasi ka kaluar limiti që duhej, ku duhej të realizohej, me procedurën “**kërkese për propozim**”, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- Kryetarin e Bashkisë L. H.**

**c-** Është likuiduar subjekti “**A.....I**”, me objekt “*Blerje materiale për “U.....T”*”.

Me **USH nr. 347 datë 10.11.2017**, për vlerën 357,876 lekë për “*Shpenzime për uniforma*” në vlerën 238,128 lekë dhe “*Materiale për “U.....T”*” në vlerën 119,748 lekë, me faturat nr. 11, datë 28.7.2017 në shumën 238,128 lekë, fatura nr. 19, datë 18.9.2017 në shumën 78,384 lekë, fatura nr. 20, datë 18.9.2017 në shumën 21,660 lekë dhe fatura nr. 21, datë 18.9.2017 në shumën 19,704 lekë.

Nuk disponohet bashkangjitur dokumentacioni mbi procedurën e ndjekur, fondin të planifikuar, preventivi mbi mallrat që do blihen, specifikimet teknike për kushtet që duhet të plotësojnë mallrat që do të bliheshin, etj. Nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me blerjen uniformave. Nuk ka ftesë për ofertë të shoqërive pjesëmarrës, nuk ka urdhër prokurimi, veprime financiare me efekt negativ me dëm në shumën **357,876 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 24.04.2017.

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera në urdhër shpenzimin nr. 347, datë 10.11.2017 me vlerë **357,876 lekë**, si dhe te dalin me vlerësim nëse kemi një perdorim me mos efektivitet dhe eficientë të këtyre shpenzimeve apo nëse i është shkaktuar dem buxhetit të Bashkisë në vlerën **357,876 lekë**, duke ngarkuar për zhdëmtim personat përgjegjës.

#### **Situata:**

- *Ne lidhje me pagesat e kryera për “Blerje uniforme për policinë”, u konstatua se:*

**a.** Për blerjet e kryera është aplikuar me prokurim **nen 100,000 lekë, pasi vlera e përdorur ka tejkaluar këtë limit, duke çuar dhe ne copëzim fondesh.**

**b.** Ne dokumentacionin e paraqitur mungonin specifikimet teknike se çfarë të dhënash duhet të plotësojnë uniformat e blera.

**c.** Ne disa raste mungonte proces verbali i marrjes ne dorëzim i mallrave, nga komisioni i marrjes ne dorëzim.

#### ***Analitikisht paraqiten si me poshtë:***

Me **USH nr. 418 datë 23.12.2017**, është likuiduar subjekti “**B.....I**”, për vlerën **41,000 lekë**. Procedura e aplikuar është **nen 100,000 lekë pa TVSh**, ku blerja është realizuar me faturën e thjeshte tatimore nr. 50 datë 19.12.2017, bere hyrje ne magazine me f.h nr 72 datë 20.12.2017.

Me **USH nr. 217 datë 14.05.2018**, është likuiduar subjekti “**B.....I**”, për vlerën **30,700 lekë**. Procedura e aplikuar është **nen 100,000 lekë pa TVSh**, ku blerja është realizuar me faturën e thjeshte tatimore nr. 51 datë 23.04.2018.

-*Ne lidhje me likuidimet e kryera për “Mirëmbajtjen e ambjentëve të ndryshme”, u konstatua se:*

Me **USH nr. 342 datë 06.11.2017**, është likuiduar subjekti “**P.....I**”, për vlerën **278,464 lekë**, me objekt “*Riparimi i qendrave të votimit të Bashkisë Finiq*”, ku u konstatua se:

Procedura e përdorur ishte me “Emergjence”.

Është mbajtur proces verbali i datës 14.06.2017, ku nga komisioni i ngritur, ka përcaktuar nevojën e riparimit të zyrave të QV për zgjedhjet e 25.06.2017. Preventivi për përcaktimin e elementeve që do riparohen, apo dhe përcaktimi i fondit limit është hartuar nga Ing. F. TH, për një vlerë prej **278,522 lekë pa TVSh**.

Preventivi i subjektit fitues ( Polikseni Thanasi) është ne vlerën **278,464 lekë**.

Fatura e subjektit është e thjeshte tatimore me nr. 13 datë 22.06.2017, për vlerën **278,464 lekë**, si dhe është mbajtur proces verbali i rasteve të emergjencës pa datë ku pasqyrojnë se janë kryer shpenzime për riparimin e qendrave të votimit të Bashkisë Finiq ne vlerën 278,522 lekë pa TVSh, i firmosur nga komisioni i përberë nga S. P, K. TH, I. K, N. P, F. TH dhe V. SH.

#### **Konkluzioni:**

- *Mungojnë planimetritë e objekteve ku u kryen riparimet përkatëse, ku mbi bazën e të cilave u hartuan dhe preventivat.*

- *Ne preventivin fillestar apo dhe ne situacionin përfundimtar nuk është trajtuar ne mënyrë analitike për çdo objekt nevojat përkatëse apo dhe realizimi i tyre, por trajtimi është bere ne total.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Nuk ka asnjë fotografi të gjendjes së mëparshme apo dhe atyre pas kryerjes së riparimit.  
- Ne faturën e subjektit janë pasqyruar blerje dyer dritare, etj mallra të cilat nuk janë bere hyrje ne Bashki, kjo per te rritur dhe vlerën e asetit.

**Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: L. H në cilësinë e ish- Kryetarit të Bashkisë dhe L. M. me detyrë Drejtoreshe Ekonomike.**

#### Kriteri:

VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, pika 1; Udhëzimit të MF me nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, tek kapitulli “*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*”, pika 36 dhe 37;

piken 5, të Udhëzimit të APP nr. 1 datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

**Impakti:** Shmangie nga procedurat e prokurimit dhe përdorim pa efektivitet të fondeve.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjor.

**Rëndësia:** *E lartë*

#### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera në urdhër shpenzimet nr. 418, datë 23.12.2017, likuiduar subjekti “B.....I”, për vlerën **41,000 lekë**, nr. 217 datë 14.05.2018, likuiduar subjekti “B.....I”, për vlerën **30,700 lekë dhe** nr. 347 datë 10.11.2017, likuiduar subjekti “A.....I”, për vlerën **238,128 lekë**, si dhe të dalin me vlerësim nëse kemi përdorim me mos efektivitet dhe efikasitet të këtyre shpenzimeve apo nëse i është shkaktuar dem buxhetit të Bashkisë, duke përlllogaritur vlerën e demit dhe ngarkuar për zhdëmtim personat përgjegjës.

#### Situata:

Për shpenzime “*Aktivitetet social kulturore*”, të realizuara për periudhën e audituar.

**a.** Në shumicën e rasteve nuk disponohet një program mbi objektin e zhvillimit të aktivitetit, nevojën e kryerjes së programit, mbi numrin e personave apo dhe elemente të tjerë të domosdoshëm për zhvillimin e aktivitetit (*preventivi mbi bazën e të cilit është përcaktuar dhe fondi limit*).

**b.** Në koktejin e organizuar nuk disponohet lista e pjesëmarrësve, si elementet baze për lenie gjurme për shpenzimin e kryer.

**c.** Në faturat e subjektit për realizimin e këtij shërbimi, nuk janë plotësuar me të gjitha elementet që kërkon fatura, kishte raste që këto fatura nuk janë firmosur nga komisioni i caktuar për zhvillimin e aktivitetit.

Me *USH nr. 359 datë 20.11.2017*, është likuiduar subjekti “V.....I” për vlerën **336,845 lekë**, me objekt “*Koktej dhe aktivitetet social kulturore*”.

Me këtë urdhër shpenzimi janë likuiduar aktivitetet:

“*Koktej dhe aktivitetet me rastin e ditës së nënës Terezës*” realizuar me datën 24.10.2017, sipas faturës nr. 152 datë 24.10.2017, për vlerën **180,845 lekë me TVSh**.

“*Koktej dhe aktivitetet me nxënësit e shkollave të bashkisë*” realizuar me datën 27.10.2017, sipas faturës nr. 153 datë 27.10.2017, në vlerën **156,000 lekë me TVSh**.

Tek ftesa e ofertës së subjektit për aktivitetin e datës 27.10.2017, është paraqitur vlera prej **83,100 lekë**, ndërsa fatura e subjektit në këtë datë është në vlerën **156,000 lekë**.

Pra ka një vlerë mbi ofertën e paraqitur prej **72,900 lekë**, **veprimet të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: L. H në cilësinë e ish- Kryetarit të Bashkisë dhe L. M. me detyrë Drejtoreshe Ekonomike.**

#### Kriteri:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

VKM nr. 1173 datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, te pavarura”, kapitulli i II “*Procedurat e organizimit*” pikat 2,4,5 dhe 6; VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u behet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr 258 datë 03.06.1999; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 40 “*Procedura e prokurimit me vlera të vogla*” pika 7.

**Impakti:** Shmangie nga procedurat e prokurimit, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 336,845 lekë, në mos lenie gjurme për të faktuar kryerjen e këtij shpenzimi.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

**Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq me grup pune të analizojë shkeljet e konstatuara në urdhër shpenzimit nr. 359, datë 20.11.2017, për pranimin dhe likuidim të faturës 153, datë 27.10.2017 më shumë se oferta e paraqitur për vlerën **72,900 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj personave përgjegjës, *respektivisht:*

- **Vlera 36,450 lekë**, në ngarkim të **L. H** me detyrë ish- Kryetar i Bashkia Fini, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues;
- **Vlera 36,450 lekë**, në ngarkim të **L. M.** me detyrë Drejtoresh Ekonomike, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.

#### **Komentet e subjektit:**

Nga S. Ç. detyrë specialist në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e Kryetarit të KBVV, janë paraqitur kundërshtime shkresën nr. 1209prot, datë 15.04.2020 (përcjellë elektronikisht me datë 15.4.2020), në lidhje me pagesat e kryera me urdhër shpenzimeve nr. 347, datë 10.11.2017; 418, datë 23.12.2017; nr. 217, datë 14.05.2018; nr. 342, datë 06.11.2017 dhe nr. 359, datë 20.11.2017, në të cilën sqarohet se nuk kanë qenë në dijeni të këtyre blerjeve dhe nuk janë nënshkruar prej tyre, gjë për të cilën nuk mund të ngarkohen me përgjegjës.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:**

Përsa sqaroni në këto urdhër shpenzimi, merret në konsideratë fakti se nuk keni qenë pjesë e komisioneve, por që shkeljet në procedura qëndrojnë.

#### **Situata:**

Nga grupi u analizuar urdhër shpenzimi **nr. 319 datë 23.10.2017**, ku është likuiduar subjekti “ **T.....D**” për vlerën **817,333 lekë**, me objekt “*Riparime në shkollat e Bashkisë Finiq*”.

Në këtë procedurë është shpallur fitues subjekti “ **T.....D**”, i cili është renditur i dyti në radhë me vlerën **611,000 lekë pa TVSh**, pas kërkesës për tërheqje nga subjekti i parë “ **A.....A**”.

Konstatohet se fatura e subjektit fitues “ **T.....D**” me nr. 10 datë 14.09.2017, si dhe nr seria 38301027 është në vlerën **681,111 lekë pa TVSh**, pa firmosur nga blerësi është më e lartë se oferta e subjekti prej **70,111 lekë** (oferta e subjekti është 611,000 lekë), veprime financiare me dëm në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu konstatohet se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- Preventivin fillestar nuk është trajtuar në mënyrë analitike për çdo objekt nevojat përkatëse, por trajtimi është bërë në total.
- Mungojnë planimetritë e objekteve ku u kryen riparimet përkatëse, ku mbi bazën e të cilave u hartuan dhe preventivat.
- Nuk ka asnjë fotografi të gjendjes së mëparshme apo dhe atyre pas kryerjes së riparimit.
- Nuk ka asnjë dokument që të faktojë situacionin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të realizuara.

**Impakti:** Veprime me dëm në buxhetin e bashkisë në vlerën **70,111 lekë pa TVSH.**

**Shkaku:** Përgjegjësi e anëtarëve të KBVV.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq me grup pune të analizojë shkeljet e konstatuara dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit në vlerën **70,111 lekë** ndaj subjekti “ T.....D”, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

#### **Komentet e subjektit:**

Nga S. Ç. detyrë specialist në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e Kryetarit të KBVV, janë paraqitur kundërshtime shkresën nr. 1209, datë 15.04.2020 (përcjellë elektronikisht me datë 15.4.2020), në lidhje me pagesat e kryera me urdhër shpenzimeve nr. 231, datë 03.08.2017, për kryerjen e pagesës në vlerën 936,000 lekë dhe se procedura e ndjekur është në zbatim të dispozitave të LPP, kjo vërtetuar dhe me dokumentacionin bashkëlidhur..

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:**

Përsa sqaroni në lidhje me parregullsitë e konstatuara në procedurën me BVV, likuiduar me USH nr. 231, datë 03.08.2017, sqarojmë se argumentet e paraqitura dhe të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm ligjorë janë bindës për grupin e auditimit. **Argumentet merren në konsideratë.**

#### **Situata:**

Nga Bashkia Finiq me *USH nr. 369/1, datë 14.8.2018* është kryer pagesa ndaj subjekti “E.....O” në shumën 912,000 lekë me objekt prokurimit “*Program Për përmirimin e sistemit kompjuterik të tatimeve*”, sipas faturës nr. 44 (seri 89767181), datë 5.7.2018 (hyrje në bashki me FH nr. 31, datë 13.7.2018).

Fatura është nënshkruar nga ish- Kryetari i Bashkisë L. H, sipas kontratës nr. 1679, datë 26.6.2018 për vlerën 760,000 lekë pa TVSH/ ose 912,000 lekë me TVSH.

Nga dokumentacioni që shoqëron USH dhe të dhënat e sistemit, konstatohet se nuk është ndjekur asnjë procedurë qoftë dhe me blerje me vlera të vogla, ku tregon se subjekti “E.....A” të jetë shpallur fitues, por është bazuar vetëm në kontratën nr. 1679, datë 26.6.2018. Gjithashtu nga kontaktet me drejtuesit e Drejtorisë së Taksave, u konstatua se ky sistem nuk ka funksionuar asnjë ditë, veprime financiare me efekt negativ në buxhet për vlerën **760,000 lekë pa TVSH, duke ngarkuar me përgjegjësi L. H në cilësinë e ish- Kryetarit të Bashkisë.**

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 24.04.2017.





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### Impakti:

Shmangie nga procedurat e prokurimit, veprime te cilat kane çuar në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 912,000 lekë, ne mos lenie gjurme për te faktuar kryerjen e këtij shpenzimi.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjore nga personat përgjegjës.

**Rëndësia:** E lartë

### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera në urdhër shpenzimin nr. 369/1, datë 14.8.2018 me vlerë 912,000 lekë, si dhe te dalin me vlerësim nëse kemi një perdorim me mos efektivitet dhe efincë te këtyre shpenzimeve apo nëse i është shkaktuar dem buxhetit te Bashkisë në vlerën **912,000 lekë, duke ngarkuar per zhdëmtim personat përgjegjës.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 75-83 të Projektraport Auditimit)*

- **Mbi përdorimin e karburantit.**

**1. Titulli i gjetjes.** Për konsumin e karburantit (mjetet motorike apo gjeneratorët) që disponon bashkia miratimi në këshillin bashkiak dhe zbatimi i normativave të harxhimit të karburanteve, për secilin tip mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, sipas urdhrave të titullarit.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Transporteve dhe Drejtoria e Financës në lidhje me sasinë e karburantit të përdorur nga Bashkia Finiq për periudhën 2017 – 2019, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit mbi hyrjet e mallit, shpërndarje sipas mjeteve dhe gjendjes në fund të periudhave, konstatohet se:

**a-** Për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, në përfundim të procedurave të prokurimit, për të cilat është mbajtur akt me vetë, Bashkia Finiq për furnizimet e kryera paraqiten sipas Tabelës 1, bashkëlidhur projektraport auditimit.

Nga të dhënat konstatohet se për vitin 2017 është bërë hyrje sasia 78305 litra, për vitin 2018 bërë hyrje sasia prej 114690 litra dhe për vitin 2019 është bërë hyrje sasia prej 121851 litra.

a- Në lidhje me sasinë e përdorur sipas mjeteve dhe agregateve që disponon Bashkia Finiq, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, paraqiten në **Tabelën 2**, bashkëlidhur materialit.

b- Nga përpunimi i të dhënave, mbi sasinë e bërë hyrje, dalje dhe gjendje, konstatohet se për vitet 2017, 2018 dhe 2019, ka sasi karburanti e cila nuk është as gjendje në magazine dhe as argumentuar me daljet sipas mjeteve/ agregateve, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrat si vijon.

### **Për vitin 2017, kemi:**

Përshkrimi veprimit	Sasi litra
Gjendje nga viti 2016	0
Hyrje viti 2017	78,305
Dalje (përdorimi), viti 2017	74,117
<b>Gjendje sipas veprimeve</b>	<b>4,188</b>
Gjendje sipas magazinës B. Finiq	0
<b>Sasia litra paargumentuar viti 2017</b>	<b>4,188</b>

### **Për aktivitetin e vitit 2018, kemi:**

Përshkrimi veprimit	Sasi litra
Gjendje nga viti 2017	0
Hyrje viti 2018	114,690
Dalje (përdorimi), viti 2018	99,952
<b>Gjendje sipas veprimeve</b>	<b>14,738</b>
Gjendje sipas magazinës B. Finiq	12,706



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Sasia litra paargumentuar viti 2018 ..... 2,032

### Për aktivitetin e vitit 2019, kemi:

Përshkrimi veprimit	Sasi litra
Gjendje nga viti 2018	12,706
Hyrje viti 2019	121,851
Dalje (përdorimi), viti 2019	120,989
<b>Gjendje sipas veprimeve</b>	<b>13,568</b>
Gjendje sipas magazinës B. Finiq	12,286
<b>Sasia litra paargumentuar viti 2019</b>	<b>1,282</b>

### Situata:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe përpunimi i të dhënave, konstatohet se:

-Nuk disponohej një plan shpërndarje, për çdo mjet transporti, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 date 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 38 dhe 59.

-Tërheqja e karburantit nga magazina është realizuar me flete daljet përkatëse për çdo tërheqje.

-Nga ana e drejtuesve të mjeteve, janë plotësuar flete udhëtimet për lëvizjet e kryera, por duhet theksuar se:

a- Nuk disponohet autorizimi, i shoqëruar me një program pune të miratuar nga titullari i këtij institucioni, për lëvizjet e punonjësve, kjo sipas kërkesave të ligjit nr. 10160 date 15.10.2009 “Per rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nënpunësit civile” neni 2 pika 5, ku theksohet se: “...mjetet në përdorim të institucionit, përdoren në çdo rast, vetëm me autorizim apo urdhër të titullarit, për shërbime sipas një programi të miratuar prej tij.”

b- Në fletët e udhëtimit nuk ishte bërë ndarja e kilometrazhit të përshkruar në brenda rrethit dhe jashtë rrethit, ku janë respektuar distancat të përcaktuara nga autoriteti rrugor për lëvizjet jashtë rrethit apo dhe ato të përcaktuara nga ndërmarrja e rrugëve për lëvizjet brenda rrethit.

Nga të dhënat e pasqyrave të mësipërme, konstatohet se për vitin 2017, nuk justifikohet sasia prej **4188 litra**, për vitin 2018 nuk argumentohet sasia prej **2032 litra** dhe për vitin 2019 nuk argumentohet sasia prej **1282 litra**. **Këto diferenca nuk paraqiten as gjendje në gjendje në magazinën e Bashkisë Finiq dhe as bërë dalje mjeteve/ agregateve (Tabela 3.1, bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 11, datë 27.2.2020).**

Për sasinë e karburantit të shpenzuar pa dokumentacion mbështetës, janë veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e bashkisë për vlerën **1,291,786 lekë** (pasqyra poshtëshënuar), **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: L. H me funksion ish-Kryetari i Bashki Finiq, K. K. me funksion Kryetar aktual i Bashkisë Finiq, I. K. me detyrë ish-magaziniere (deri qershor 2018) dhe V. SH. me detyrë magazinier qershor 2018 e vijim.**

Vlera e demit të shkaktuar paraqitet në pasqyrën si vijon:

Përshkrimi veprimit	Sasi pa dokument	Çmim mesatar	Vlera dëm
Për aktivitetin viti 2017	4,188	169	707,772
Për aktivitetin viti 2018	2,032	177	359,664
Për aktivitetin viti 2019	1,282	175	224,350
<b>Totali 2017+2018+2019</b>	<b>7,502</b>		<b>1,291,786</b>

### Kriteri:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Ligjit 10296, datë 08. 07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35/b,36,,

#### **Impakti:**

Veprime të cilat kanë çuar në mos dokumentimin e sasisë së karburantit të bërë hyrje, me dëm në buxhetin e Bashkisë Finiq për vlerën 1,291,786 lekë.

**Shkaku:** Mos dokumentim i lëvizjes së mallit nga momenti i hyrjes deri në përdorimin e tij.

#### **Rëndësia: I lartë**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

1. Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa që shpërndarja e karburantit të bëhet në bazë drejtorie sipas kërkesave që ato paraqesin, duke argumentuar me sasinë dhe destinacionin e lëvizjes. Në çdo rast fletudhëtimet të shoqërohen me urdhrin e titullarit dhe të plotësohen sipas formatit ligjorë, ku të identifikohet targa e mjetit, personi që do lëvizë, destinacionit dhe km e përshkruar.
2. Drejtoria e Financës të marrë masa për arkëtimin e vlerës së dëmit prej **1,291,786 lekë** të sasisë së karburantit prej **7502 litra**, të bërë hyrje dhe të padokumentuar si dalje nga magazina, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët ndaje personave përgjegjës.

**IV/D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.**

#### **1.1-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Në Bashkinë Finiq, u audituar zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik që kanë lidhje me objektet e prokurimit, sipas çështjeve të trajtuara. Nga ana e Autoriteteve Kontraktore (këtu e vijim AK), nuk janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve nuk janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB, respektivisht për vitin 2017 me VKB nr. 56, datë 24.2.2017, për vitin 2018 me VKB nr. 79, datë 29.12.2017 dhe për vitin 2019 me VKB nr. 123, datë 17.12.2018.

Pasqyrat e prokurimeve të realizuar gjatë periudhës objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), paraqitet në pasqyrën **Aneks D/1, 2 dhe 3** bashkëlidhur materialit.

#### **1.2-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.**

#### **Për aktivitetin e vitit 2017.**

Për aktivitetin e vitit 2017, nga Bashkia Finiq janë kryer gjithsej **16** procedura prokurime me vlera të larta, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/LEKË	Në % ndaj fondit
----------	-------------------	------------------------



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

EMËRTIMI	VLERA 000/LEKË	Në % ndaj fondit
<b>Fondet prokuruar gjithsej</b>	<b>310,108</b>	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	262,999	84.7
-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve	47,108	15.1
<b>Financime nga Bashkia/Grande</b>	<b>87,974</b>	<b>28.3</b>
<b>Financim nga FZHR/ Ministri</b>	<b>0222,134</b>	<b>71.6</b>

### Për aktivitetin e vitit 2018

Për aktivitetin e vitit 2018, nga Bashkia Finiq janë kryer gjithsej **16** procedura prokurime me vlera të larta, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/LEKË	Në % ndaj fondit
<b>Fondet prokuruar gjithsej</b>	<b>98,555</b>	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	28,806	29.2
-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve	69,749	70.7
<b>Financime nga Bashkia/Grande</b>	<b>98,555</b>	
Financim nga FZHR/ Ministri	0	0

### Për periudhën e vitit 2019

Për periudhën nga 01.01.2019 – 31.12.2019 janë kryer gjithsej 14 procedura prokurimi me vlerë të lartë për fondin limit prej 78,209 mijë lekë (*sipas parashikimit vjetore 2019*), duke lidhur kontratë për vlerën 75,148 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 3,061 mijë lekë ose 4% e fondit limit. Sipas ndarjes kemi:

EMËRTIMI	VLERA 000/LEKË	Në % ndaj fondit
<b>Fondet prokuruar gjithsej</b>	<b>78.209</b>	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	10,416	12.7
-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve	67,793	87.2
<b>Financime nga Bashkia/Grande</b>	<b>78.209</b>	
<b>Financim nga FZHR/ Ministri</b>		

**1. Titulli gjetjes:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 deri me datë 31.12.2019), janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të LPP, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon:

### Situata.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të larta, u konstatua se:

- a-** Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme;
- b-** Asnjë nga dosjet e audituara nuk është e inventarizuar dhe e numëruara;
- c-** Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit, arsyet e skualifikimit e tij, si dhe të protokolluara në protokollin e Bashkisë Finiq;



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Gjithashtu, procesverbalet e hartimit të kriterëve, DST, procesverbalet e hapjes dhe vlerësimit të procedurës, raporti përmbledhës, si dhe deklaratat e konfliktit të interesit të depozituara në dosjet e procedurave, në pjesën më të madhe nuk ishin të nënshkruara nga anëtarët e NJHDT dhe KVO, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, neni 52 “Hapja e ofertave” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 16, 61, Kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 64 “Hapja e ofertave”.

Në kontaktet që patëm me anëtarët e NJHDT dhe KVO në lidhje me këtë problematikë, u konstatua se referuar deklaratave individuale/ personale të anëtarëve të NJHDT dhe KVO, është deklaruar se nuk kanë qenë në dijeni dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga procedurat e zhvilluara për vitin 2019, sipas praktikave të përcaktuara në urdhëratë e kryetarit si anëtarë NJHDT dhe KVO, duke mos sqaruar se kush nga NHDT ka bërë hedhjen e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave nga KVO në sistemin e prokurimeve (SEP), pasi nga verifikimi i sistemit konstatohet se secili nga anëtarët është cekuar në SEP, konkretisht pasqyra:

Nr	Objekti prokuruar	Anëtarët e Komisioni NJHDT			Anëtarët e Komisioni KVO		
<b>Procedurat e vitit 2017</b>							
1	Rikualifikimi urban i Sheshit Livadhja	L. K	L. M	V. L	F. P	G. M	S. J
2	Rehabilitim rruga Fitore-Aliko	L. K	S. Ç	V. L	F. TH	S. P	I. M
3	Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice	F. P	S. P	V. L	L. K	F. TH	L. M
4	Blerje automjetet per administratën”	F. P	L. M	M. L	L. K	F. TH	S. Ç
5	” Blerje mbrojtëse rrugore per sistemin rrugor te Bashkisë Finiq”	F. P	S. Ç	D. A	L. K	L. M	A. B
6	Shpenzime per mirembajtje Mjete transporti+ eskalatorë.	L. K	L. M	S. J	F. P	G. M	V. L
7	Blerje materiale per ndriçim rrugor.”	F. P	L. M	F. TH	L. K	S. Ç	M. L
8	Blerje mjet teknologjik per mbeturina urbane	G. K	F. P	M. L	L. K	F. TH	S. Ç
9	Riparime dhe pastrime kanale ujitëse Bashkia Finiq	L. K	L. M	D. A	S. P	G. K	F. TH
10	BLERJE MJET GERMIMI.	G. K	L. M	M. L	S. P	F. TH	TH. Z
11	“Shpenzime Mirembajtje per infst. Rrugore te B. FINIQ“	L. K	L. M	M. L	F. P	I. M	TH. Z
12	Rikonstruksion i rrugëve te 2(dy) manastireve	L. K	G. M	V. L	F. P	G. M	I. M
13	“ Studim projektim i objekteve te Bashkisë Finiq”	F. P	F. TH	A. B	V. L	L. M	G. M
14	“blerje gazoil, benzinë dhe gaz”.	L. K	L. M	F. TH	S. P	M. L	S. J
15	Ndertim rruge Aliko-Shen Varvara	F. P	TH. Z	F. TH	I. E	L. M	V. L
16	Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg - Aliko, kanali K-2 dhe K-K-2/1	I. E	S. Ç	D. A	M. L	F. TH	I. M
17	Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko (FAZA ii)	F. P	S. Ç	D. A	L. K	V. J	L. M
<b>Procedurat e vitit 2018</b>							
1	Blerje materiale per mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike	F. P	L. M	V. L	K. TH	S. Ç	V. L
3	” Rikonstruksion i rrugës Karoq.”	F. P	S. Ç	F. TH	K. TH	S. J	V. L
4	Blerje Autobuz per transport udhëtaresh.	F. P	L. M	V. T	K. TH	M. L	V. K
5	Blerje automjete per sherbime	F. P	F. TH	S. Ç	M. L	K. TH	L. M





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nr	Objekti prokuruar	Anëtarët e Komisioni NJHDT			Anëtarët e Komisioni KVO		
	publike, copë 4						
6	Blerje automjete zjarrfikese për Sektorin e SHMZSH.	F. P	V. L	V. T	L. B	K. TH	V. K
7	Blerje kamion vetëshkarkues	F. P	L. M	V. T	K. TH	M. L	S. Ç
8	Blerje karburant (gazoil, benzine, gaz propan lëngshëm ) viti 2018”	F. P	S. Ç	F. TH	L. K	L. M	K. TH
9	Blerje karburanti	F. P	L. M	F. TH	K. TH	S. Ç	V. K
10	Blerje materiale per ndriçimin rrugor	TH. TH	F. P	A. B	Z. LL	K. TH	L. M
11	Blerje mikrobus (Van) per transport te brendshëm.	F. P	L. M	V. T	K. TH	M. L	V. K
12	Mirembajtje e objekteve ndërtimore.						
13	Riparime , Mirembajtje ne veprat ujtëse dhe kulluese.	F. P	L. M	D. A	K. TH	S. Ç	V. K
16	Zgjerimi i varrezave publike te fshatrave Aliko, Çaushe dhe Tremul	F. P	F. TH	V. L	L. K	K. TH	V. K
<b>Procedurat e VITIT 2019</b>							
1	Blerje shërbimi "Dixhitalizimi aseteve pyjeve dhe kullotave"	F. P	V. J	TH. Z	K. TH	V. L	V. K
2	"Blerje materiale elektrike per ndriçim rrugor"	F. P	L. M	V. L	K. TH	S. P	V. K
3	Blerje materiale ndërtimore	F. P	L. M	S. J	K. TH	F. TH	V. K
4	F.V tabela per sinjalistikës rrugore	F. P	L. M	V. L	K. TH	S. P	V. L
5	Blerje shërbimi" Portali taksapaguesve"	F. P	L. M	A. B	K. TH	S. P	V. K
7	Blerje karburant per nevojat e Bashkisë Finiq ( viti 2019)	F. P	L. M	M. L	K. TH	F. TH	V. K
8	Blerje " Vaji goma bateri"	F. P	L. M	V. T	K. TH	L. B	V. K
9	Riparim i Mjeteve te Bashkisë Finiq	F. P	L. M	M. L	K. TH	L. B	V. K
10	Blerje mjet gërmimi	F. P	L. M	M. L	K. TH	L. B	V. K
11	F.V Barriera Mbrojtëse( siguria rrugore)	F. P	L. M	V. L	K. TH	S. P	V. K
12	Rehabilitim i rrugëve te Bashkisë Finiq	F. P	L. M	V. L	K. TH	S. P	V. K
13	“BLERJE KARBURANT”	A. H	O. P	M. L	K. TH	S. P	V. K

**Shënim:** Personat që janë me ngjyrë nuk kanë nënshkruar dokumentacion në procedurat e zhvilluara, si procesverbalet, raportet përmbledhëse, DST etj.

**d-** Për llogaritjen e fondit limit të investimeve/ shërbimeve dhe blerjeve të mallrave, konstatohet se në të gjitha rastet e audituara, nuk ka asnjë urdhër nga ana e Titullarit të AK të jenë ngritur komisione të veçanta për hartimin e tyre, veprim i cili nuk është kryer dhe nga anëtarët e NJHDT, ku nga auditimi i praktikave të procedurave (dosjeve), nuk disponohen asnjë dokumentacion mbi mënyrën e llogaritjes dhe argumentimin e cimeve të përdorura;

**e-** Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Finiq, për asnjë rast nuk është bërë i mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve, dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës;

**f-** Në të gjitha rastet e audituara, procesverbalet/raporti përmbledhës dhe DST, nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Finiq, veprime në kundërshtim me nenin 18, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”;

**g-** Lëvrimi i mallit nuk është në përputhje me pika 41 deri 52, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pasi nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm; nenit 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 4 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

prokurimit publik” i ndryshuar dhe ligjin nr. 10296, date 08.07.2010 Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

**h-** Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/ preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/ shërbimeve dhe blere të mallrave.

**i-** Në likuidimet e kontratave të lidhura për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2019, konstatohet se megjithëse punimet/ shërbimet dhe blerje malli kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuara në kontrata, likujdim i tyre nuk është bërë sipas periudhave përkatëse, duke lënë pa likuiduar një pjesë të këtyre kontratave të investimeve/ shërbimeve dhe blerje mallra, konkretisht:

- **Për aktivitetin e vitit 2017**, nga vlera e kontratave prej 343,037 mijë lekë me TVSH është likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 47,485 mijë lekë ose 13.8% e vlerës së kontratave, duke lënë pa likuiduar vlerën 295,552 mijë lekë ose 86.15%, vlerë e cila është likuiduar në periudhat e mëvonshme dhe deri me 31.01.2020 kanë mbetur për likujdim vlera 47,129 mijë lekë;

- **Për aktivitetin e vitit 2018**, nga vlera e kontratave prej 108,945 mijë lekë me TVSH është likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 67,031 mijë lekë ose 61.5% e vlerës së kontratave, duke lënë pa likuiduar vlerën 41,914 mijë lekë, vlerë e cila është likuiduar në periudhat e mëvonshme dhe deri me 31.01.2020 kanë mbetur për likujdim vlera 167 mijë lekë;

- **Për aktivitetin e vitit 2019**, nga vlera e kontratave prej 90,178 mijë lekë është likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 49,321 mijë lekë ose 54.6% e vlerës së kontratave, duke lënë pa likuiduar vlerën 38,157 mijë lekë deri me 31.02.2020 (e detajuar paraqitet në pasqyrën aneks 1, bashkëlidhur materialit.

Sipas informacionit të dhëna nga ish- Drejtoresha e Financës, nuk jepet shpjegime në lidhje me mos likuidimin e kontratave sipas afateve, duke ditur që institucioni ka gjendje financiare të shëndoshë për likuidimin, ku për vitin 2017 ne shumën **213 milionë lekë**, për vitin 2018 në shumën **110 milionë lekë** dhe vitin 2019 ne shumën **26 milionë lekë** në fund të periudhave ushtrimore.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme përveç anëtarëve të NJHDT dhe KVO sipas rasteve që do trajtohen në vijim, ngarkohet me përgjegjësi dhe ish- Titullari i AK L. H në cilësinë e ish- Kryetarit të Bashkisë Finiq dhe nëpunës autorizuar, F. P. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Prokurimeve (aktualisht i larguar nga puna) dhe L. M. me detyrë Drejtor Finance, në cilësinë e nepunesit zbatues**

#### **Kriteri:**

Neni 12 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26; nenin 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin i MF nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36 dhe 42<sup>8</sup>- Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara; neni kreun VI “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, neni 39 “Kërkesa per propozime”, pika 4, nenin 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pikat 1 dhe 2, neni 64 “Hapja e ofertave”, nenit 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 4te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”; nenin 52- Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936,

<sup>8</sup> Titullari i njësisë miraton urdhrin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorëzim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore.*

**Impakti:** Veprime të cilat kanë çuar në paligjshmëri të përdorimit të fondeve.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave drejtues dhe mos njohja e kuadrit rregullator ligjor të LPP

**Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

1. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Prokurimeve, nuk duhet të vijojnë me procedurat e prokurimit, pa konfirmuar më parë në Degën e Thesarit regjistrimin dhe urdhrat e prokurimeve, për çdo rast, kjo për të sigurua garancinë e fondeve që do prokurohen dhe mos krijimin e precedentit për faturat e palikuiduara në fund të zbatimit të kontratave.
2. Sektori i Procedurave të Prokurimit të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara në Sektorin e Arkivës Bashkia Finiq.
3. Kryetari i Bashkisë në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Finiq dhe jo me protokoll të veçantë.

#### **D/1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).**

Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 – 31.12.2019, konstatohet se janë kryer gjithsej 47 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej 427,807,504 lekë, duke lidhur kontratë për vlerën 403,322,100 lekë ose me një zbritje nga fondi limit prej 5.7 % e fondit të prokuruar.

Mbi bazën e të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur të fondeve të prokuruar për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019 (Ilog. 602/231), grupi i auditimit nga 47 procedura me vlerë kontrate 403,322,100 lekë, ka vlerësuar për auditim 42 procedura me vlerë kontrate prej 349,986,712 lekë ose 86.7% e totalit të kontratave.

Në procedurat e zhvilluara kanë marrë pjesë 117 OE/BOE dhe janë skualifikuar 40 OE/BOE.

Nga të dhënat e pasqyrës së procedurave të prokurimit për periudhën objekti auditimi, konstatohet se nga 47 procedura prokurimi janë zhvilluar me një operator ekonomik 14 procedura ose 29.7% e procedura me vlerë kontrate 120,578 mijë lekë ose 29.8% e kontratave të lidhura.

Nga auditimin i **42** procedurave me vlerë kontrate **403,322 mijë lekë**, u konstatua shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku;

a- Në **12** procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke e rënduar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b- Nga **42** procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate 403,322,100 lekë pa TVSH, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në **27** procedura me vlerë kontrate 367,709,401 lekë ose 91% e vlerës së kontratave të audituar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

ardhurat e buxhetit të Bashkisë Finiq për vlerën **41,773,524 lekë**, si diferencë midis ofertave të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet të mosplotësimit të kriterëve me operatorët ekonomik me oferta më të ulët të skualifikuar padrejtësisht nga zyrtarët e prokurimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

c- Në **16** procedura, nuk janë zbatuar në afatin e caktuar në kontratë punimet/ shërbimet dhe blerjes së mallrave, veprime financiare me efekt negativ me dëm në vlerën **18,010,631 lekë**.

**2. Titulli gjetjes:** Nga KLSH, u konstatua kritere jo në përputhje me dispozitat ligjor/nënligjore të LPP dhe me objektin e prokuruar.

#### Situata:

Në **12** procedura prokurimi me fond limit 217,044 mijë lekë, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të vlerën dhe natyrën e kontratës, të shërbimeve dhe blerjes së mallrave, si dhe nuk janë argumentuar me procesverbal të veçantë, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, ku në 57.4% e procedura të zhvilluara (47 gjithsej), janë realizuar me pjesëmarrjen nga 1 deri 2 operatorë ekonomik me vlerë kontrate 156,847 mijë lekë ose 38.8%.

#### Kriteri:

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 61, Kreun X “Shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “Ankesat ne autoritetin kontraktor”; Nenet 45, 46 dhe 55 të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, dhe ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6.

**Impakti:** Uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura, veprime në mos eficientë të fondeve të pikturuara.

**Shkaku:** Mungesa e stafit me specialit të fushës dhe mos njohja e kuadrit ligjorë.

**Rëndësia:** E lartë

#### Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Finiq, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me një OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**Konkretisht rastet ku janë konstatuar shkeljet e mësipërme, paraqiten si vijon:**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**1. Në procedurën me objekt** “Rikualifikim urban i sheshit Livadhja” viti 2017, zhvilluar me datë 30.06.2017, për vlerën e fondit limit 51,682,705 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “G.....Y” me vlerë kontrate 48,127,941 lekë.

Nga ana e titullarit të AK nuk është kthyer përgjigje subjekti në lidhje me ankesat e bere. Kriteret për të cilat pretendojnë subjektet janë vlerësuar si jo të rregullta nga grupi i KLSH, konkretisht:

a- “OE te kete te punësuar 3 inxhinier ndertimi te zëvendësohet me 1 inxhinier ndertimi dhe te hiqet kriteri qe OE te kete te punësuar 1 inxhinier hortikulture, pasi asnjë zë i preventivit te fondit limit nuk ka te beje me punime, per te cilat duhet ky inxhinier”.

b- OE të këtë të punësuar specialist elektromekanik, pasi nuk ekziston si emërtim;

c- OE të këtë në pronësi objekt për prodhimin gur gëlqeror dekorativ apo kontratë furnizimi me një subjekt tjetër ti shtohet marrja me qira e objekti të këtij lloj.

Veprime ne kundërshtim me nenet 30 dhe 78 “Ankesat ne autoritetin kontraktor”, pika 6 te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, me ndryshime; nenin 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” me ndryshime.

**Per këto mosveprime, mbajnë përgjegjësi, titullari i AK L. H.**

**2. Në procedurën me objekt** “Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice”, viti 2017, zhvilluar me datë 15.06.2017 me fond limit 111,385,721 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “2....T” për vlerën e kontratës 107,174,487 lekë.

Konstatohet se janë vendosur kriteret jo në përputhje me objektin e prokuruar dhe zërat e preventivit, si vijon:

a- “Kategori licence NP-5/D, ku vlera e zërave të preventivit për këtë lloje kategori punimi nuk përputhen prej 101 – 200 milionë lekë

b-Vendosje e kriterit për 100 punonjës është kriter jo në përputhje me dispozitat e VKM nr. 42 dhe zërat e volumit të punimeve sipas preventivit.

Veprime që në kundërshtim me pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, dhe ngarkon me përgjegjësi: **titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**3. Tenderi me objekt:** “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”, zhvilluar me datë 02.11.2017 me fond limit 8,698,702 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 7,489,046 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me proces verbalin nr. 1, datë 16.10.2017. **Proces verbali është i pafirmosura nga 2 anëtarë te njësisë se prokurimit (F. P. dhe S. Ç).**

Në vendosjen e kriterëve janë konstatuar kriteret në kundërshtim me ligjin, pasi nuk përshtaten me objektin e prokurimit, konkretisht:

a- Pajisen me vërtetim nga Bashkia Finiq se nuk ka detyrime. Ky kriter identifikon OE pjesëmarrës dhe nuk ruan fshehtësinë e tij;

b- Është kërkuar disponimin mjeteve të mëposhtëmve:

Fabrike betoni e pajisur me QKL Kodi III.I.A dhe certifikate ISO 9001(sistem i menaxhimit te cilësisë)ne një distance jo me te madhe se 50 km nga objekti.	copë 1 (një)	Ne pronësi ose me qira
Fabrike inerte e pajisur me QKL kodi II.I.B dhe certifikate ISO 9001 (sistem i menaxhimit te cilësisë)	copë 1 (një)	Ne pronësi ose me qira

Referuar zërave të preventivit dhe volumit të punimeve, vendosja e këtyre kriterëve është e panevojshme dhe frenon pjesëmarrjen, **veprime të cilat ngarrojnë me përgjegjësi: titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**4. Tenderi me objekt:** “Blerje materiale per ndriçim rrugor”, zhvilluar me datë 05.06.2017 me fond limit 15,000,000 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “V.....A”, me vlerë kontrate 14,930,800 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin nr.1, datë 22.05.2017 nga NJHDT të tenderit, **i cili nuk është firmosur nga anëtarët e NJHDT**, për të cilat ka pasur ankesa nga OE si më poshtë:

a- Subjekti “M.....L” ka bere ankese, me shkresën nr.1609 Prot. datë 29.05.2017 me pretendimin se kriteri qe OE te jete i pajisur me çertifikatën ISO 5001 është i panevojshëm pasi kjo çertifikatë është per kursim energjie dhe per operatoret prodhues.

b- Kriteri qe OE te paraqesë autorizim nga prodhuesi i materialeve, ku te shënohen qarte te dhënat e adresës se tij, me qellim verifikimin nga ana e AK është diskriminues;

c- Kriteri qe OE te kete te punësuar 12 punonjës per periudhën Tetor 2016 – Shkurt 2017 ne listëpagesat, si dhe te kete ne stafin e tij një inxhinier elektrik dhe tre specialist elektrik është diskriminuese.

Per kete, nga ana e titullarit te AK nuk ka dale urdhri per caktimin e komisionit te shqyrtimit te ankesave qe do te shqyrtoje çështjen. Nuk i është kthyer përgjigje me shkrim ankimues, Kriteret për të cilat është bërë ankesë, sipas grupit të KLSH janë kritere të rënduara dhe nuk përshatën me procedurën e zhvilluar, **veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: titullari i AK L. H për mos ngritje të Komisionit të Shqyrtimit të ankesave dhe anëtarët e NJHDT për vendosjen e kritereve në kundërshtim me ligjin.**

**5. Tenderi me objekt:** “Blerje automjet per administratën”, zhvilluar me datë 07.08.2017 me fond limit 2,500,000 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “Z.....P”, me vlerë kontrate 2,440,000 lekë.

Për kriteret e vendosura ka pasur ankesa, konkretisht nga OE:

a- **Shoqëria “R.....Y”** me formularin e ankesës Nr.2075 Prot, datë 14.07.2017 dhe Nr.2777, datë 29.09.2017.

Subjekti ka bere ankese për mos pranim te anulimit te procedurës se tenderit i cili është njoftuar 1 muaj pas hapjes se tenderit me datën 10.07.2017, prandaj kërkon:

1. Pezullimin e procedurës se prokurimit.

2. Rivlerësim te procedurës se prokurimit, duke hequr anulimin e procedurës se prokurimit.

3. Rivlerësimin e procedurës se prokurimit, duke dërguar njoftimin per kualifikim/skualifikim.

Për këtë ankese, ne dosje, nuk ka dokumentacion nëse është bere pezullimi i procedurës nga titullari AK, shqyrtimi i ankesës, marrja e vendimit përkatës dhe kthimi i përgjigjes per OE.

OE i është drejtuar KPP i cili, ku me vendimin nr. 632/2017, datë 25.07.2017 dërguar ne Bashkinë Finiq me shkresën Nr.632/1, datë 31.08.2017, ka vendosur;

1. Te pranoje ankesën e subjektit “R.....Y”.

2. Te anulojë vendimin per anulimin e procedurës se prokurimit nga ana e Bashkisë, ku kjo e fundit, te kryeje veprimet e nevojshme per rikthimin ne sistemin elektronik te procedurës se prokurimit, objekt ankimimi.

3. AK Brenda 10 ditëve te veje ne dijëni KPP per zbatimin e vendimit.

4. Zyra e financës te beje kthimin e tarifës financiare te paguar nga OE “R.....Y”.

b- **Subjekti “S.....O”** ka bere ankese per vendosje kriteri diskriminues ne kërkesat per kualifikim, per dorëzimin e mostrave origjinale te pajisjeve qe oferton ne datën e hapjes se tenderit, në një kohe qe mjeti mund te vije nga jashte ne momentin e daljes fitues, ankese, per te cilën është kthyer përgjigje nga Bashkia me shkresën Nr.2310, datë 09.08.2017, ku shprehet se pretendimi nuk pranohet pretendimi.

Per kete ankese, ne dosje, nuk ka dokumentacion nëse është bere pezullimi i procedurës nga titullari, shqyrtimi i ankesës dhe marrja e vendimit përkatës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Kriteret për të cilat pretendojnë ankuesit, sipas grupit të KLSH qëndrojnë dhe janë kritere të rënduara, **veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**6. Tenderi me objekt:** “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor të Bashkisë Finiq”, zhvilluar me datë 8.9.2017 me fond limit 1,666,666 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “D.....N”, me vlerë kontrate 1,605,900 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin nr. S’ka, datë 13.07.2017, të cilat nuk janë firmosur nga njësia e prokurimit dhe për të cilat ka pasur ankesa, konkretisht:

**a-** Subjekti “**R.....M**” ka bërë ankesë me shkresën datë 31.07.2017, e pa protokolluar në Bashki, ku kërkohet:

*-Heqja e kriterit për paraqitjen e certifikatës ISO 39001 – 2013, pasi nuk ka të tilla dhe zëvendësimin e saj me certifikatën ISO 39001 - 2012.*

*-Numri i punonjësve të kërkuar prej 15 persona të punësuar është i lartë në krahasim me vlerën e fondit limit, pasi me pak punëtore bëhen 300 ml/dite prandaj ky numër të behet 5 punëtore.*

*-Heqja e kriterit që OE të këtë liçencë për kategorinë NS – 5 (Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut).*

Për këtë, nga ana e titullarit të AK ka dale Urdhri nr. S’ka, datë 03.08.2017 për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e KSHA të përbërë nga M. Ç, G. M dhe DH. B.

Nga ana e KSHA nuk është mbajtur proces verbal i shqyrtimit, vendimi përkatës, si dhe raporti për titullarin. Me shkresën nr. 2305 Prot., datë 09.08.2017, Bashkia Finiq ka kthyer përgjigje, ku është pranuar vetëm ndryshimi i Certifikatës ISO 39001 – 2013 dhe nuk pranohen dy pretendimet e tjera me argumentimin.

Nga ana e grupit të KLSH është vlerësuar se të dy kriteret për të cilat është bërë ankesë qëndrojnë dhe janë të rënduara, pasi argumentimi i fundit për kriterin e numrit të punësuarve nuk është argumentim justifikues dhe se ky kriter është diskriminues dhe eliminon konkurrencën, pasi kemi të bëjmë me procedurë blerje dhe jo kontratë punimi.

**Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:** Titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT, anëtarët e KSHA të përbërë nga: M. Ç. me detyrë elektrikist në Sektorin e Ndriçimit Rrugor dhe Dekorit, G. M. me detyrë ish- Specialist në DPZHT dhe DH. B. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**7. Tenderi me objekt:** “**Rikonstruksion rruga Karroq, viti 2018**”, zhvilluar me datë 10.12.2018 me fond limit 12,469,313 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “J.....Y”, me vlerë kontrate 12,193,657 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin datë 7.11.2018, por të pafirmosura nga anëtarët e NJHDT, duke përjashtuar kryetarin e tij.

Në kriteret e vendosura, konstatohet si kritere të rënduara:

*a- Kriteri për një numër punonjës prej 30 veta, ndërkohë që pjesa më e madhe e punimeve janë me makineri;*

*b- Kriteri për ing. Elektrik dhe ing. Marksheder, ku referuar zërave të preventivit memec, nuk ka punime për këto inxhinier;*

*c- Nuk argumentohet certifikatat ISO 27001-2013; 18001-2007; 39001-2012;*

**Veprime që ngarkon me përgjegjësi titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**8. Tenderi me objekt:** “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik”, zhvilluar me datë 29.5.2018 me fond limit 14,100,000 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 13,107,000 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin datë 29.3.2018, por te pafirmosura nga anëtarët e NJHDT, duke përjashtuar kryetarin e tij.

Në kriteret e vendosura, konstatohet si kritere të rënduara:

*a- Kriteri për një numër punonjës prej 10 veta, është një kriter i panevojshëm, pasi kemi të bëjmë me procedurë blerje materiale;*

*b- Nuk argumentohet kriteret për disponim e mjete, pasi kemi të bëjmë me procedurë blerje materiale dhe FV , konkretisht:*

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 15 ton	copë 2 (dy)	Ne pronësi ose me qira
Eskavator me zinxhirë dhe kove	copë1 (një)	Ne pronësi ose me qira
Eskavator me goma	copë1 (një)	Ne pronësi ose me qira
Pompe për hedhje betoni	copë1 (një)	Ne pronësi ose me qira
Autobetonjere	copë 2 (dy)	Ne pronësi ose me qira
Asfalto shtrueses	copë 1 (një)	Ne pronësi ose me qira

**Veprimet që ngarkon me përgjegjësi titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

#### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Juristi i Sektorit të Procedurave në Bashkinë Finiq me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedurë (7 dhe 8 mësipërm) për kriteret, të cilat i janë paraqitur grupit të KLSH me datë 19.04.2020 me elektronik. Sipas kundërshtive të paraqitura ish- juristi kundërshton mangësitë e kriterëve me faktin se ato janë të domosdoshme për zbatimin e projekti.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:**

Argumentet e paraqitura nga ish- juristi nuk janë bindës për grupin e KLSH, pasi kriteret nuk janë mbështetur në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, si dhe shpjegimeve të dhëna nga grupi i KLSH kur janë analizuar mangësitë e kriterëve.

**9. Tenderi me objekt:** “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh”, zhvilluar me datë 13.4.2018 me fond limit 4,166,666 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “K.....A”, me vlerë kontrate 4,096,666 lekë. Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin pa nr., datë 30.4.2018. Konstatohet se procesverbali i hartimit të kriterëve është i panënshkruar nga anëtarët e NJDT.

*a- Në vendosjen e kriterëve konstatohet të jenë vendosur kritere të cilat nuk përputhen me procedurën e prokurimit. Kështu objekti i prokurimit është blerje malli (mjet transporti) dhe nuk kuptohet pse kërkohet vendosja e kriterit për një numër punonjësish prej 6 veta. Ky kriter mbi nesh dhe me kriterin tjetër që OE duhet të ketë kontratë bashkëpunimi me servis te specializuar per riparimin e mjetit objekt prokurimi gjate periudhës se garancisë shoqëruar me prospektin e kompanisë dhe foto te ambienteve te tij. Në këto kushte numri i punonjësve është i panevojshëm*

*b- Nuk kuptohen vendosja e kriterit të certifikatave ISO 9001-2015 dhe 39001-2012;*

**Mangësi për të cilën ngarkohet ish- Titullari i AK titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**10. Tenderi me objekt:** “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaushe dhe Tremul”, zhvilluar me datë 07.06.2018 me fond limit 10,000,000 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “SH.....I”, me vlerë kontrate 7,538,901 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin pa nr., datë 30.4.2018. Konstatohet se procesverbali i hartimit të kriterëve është i panënshkruar nga anëtarët e NJDT.

*a- Nuk është i argumentuar numri i punonjës prej 30 veta, pasi nuk lidhet me volumet e punimeve sipas zërave të preventivit;*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- b- Nuk kuptohet kërkesa për 3 manovrator, ku sipas makinerive që kërkohet janë vetëm dy makineri të rënda, si Eskavator dhe fadromë;*
- c- Është i paargumentuar kërkesa për 8 punonjës të pajisur me kartela personale për një objekt prokurimi të tillë “Zgjerim i varrezave publike”. Nuk kuptohet hidrauliku, mekaniku, elektrikist 1 dhe këto me kartela personale;*
- d- Kërkesa për 3 punonjës në lartësi të çertifikuar është pa pakuptimte për objektin e prokurimit;*
- e- Nuk kuptohen vendosja e kriterit kategori licencë NS 14/A, e cila ka si objekt “Impiante të ndershme elektrike, telefonisë, radistacion etj, punime këto të cilat nuk janë kërkuar në preventiv;*

Per argumentimin e fondit limit, nuk është mbajtur proces verbal se ku është mbështetur NHDT në përcaktimin e këtij fondi dhe përcaktimin e çmimit të mjetit, pra nuk është bere argumentimi i plote dhe i sakte, duke vepruar ne kundërshtim me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” me ndryshime, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i proçedurave”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës”, pika 2.

Deklaratat e konfliktit të interesit si të anëtarëve të NJHDT dhe KVO, rezultuan të panënshkruara nga anëtarët përkatës, veprim ne kundërshtim me nenin 16 “Deklaratat e konfliktit te interesit” te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” me ndryshime, **mangësi për të cilën ngarkohet titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**11. Tenderi me objekt:** “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues”, zhvilluar me datë 14.5.2018 me fond limit 4,762,000 lekë, ku fitues është shpallu shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 3,894,401 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin pa nr., datë 29.4.2018. Konstatohet se procesverbali i hartimit të kriterëve **është i panënshkruar nga anëtarët e NJDT.**

*a- Mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punëtorëve, personelit ne zbatim te VKM nr. 312 date 05.05.2010 si me poshtë vijon:*

*Kokore minimumi 20 cope*

*Rripa lidhës sigurimi per punime ne lartësi minimumi 5 cope*

*Fikse zjarri te lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 cope*

*Prozhektore ndriçimi natën minimumi 4 cope;*

*b- Numri i punonjës prej 25 punonjësish, nuk është në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit.*

*c- Shoqëria duhet te kete ne stafin e saj minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës te pajisur me kartelat personale te sigurimit teknik, te lëshuara nga organe kompetente të akredituara ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013 , ku te përfshihen elektriciste, hidraulike , mekanik, saldator). **Janë kritere të cilat nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.***

Per argumentimin e fondit limit, nuk është mbajtur proces verbal se ku është mbështetur NHDT në përcaktimin e këtij fondi dhe përcaktimin e çmimit të mjetit, pra nuk është bere argumentimi i plote dhe i sakte, duke vepruar ne kundërshtim me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” me ndryshime, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i proçedurave”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës”, pika 2.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjëse: titullari i AK L. H dhe anëtarët e NJHDT.**

**12. Tenderi me objekt:** “Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019”, zhvilluar me datë 25.4.2019 me fond limit 2,583,330 lekë, ku fitues është shpallu JV “G.....Y + K.....L”, me vlerë kontrate 2,568,870 lekë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Në vendosjen e kriterëve, konstatohet se janë vendosur disa kriterë të cilat nuk përshtaten me procedurën e prokurimit, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrëse, konkretisht:

*a- Është e pakuptimtë vendosjen e kriterit për certifikata ISO (9001/2008; 18001/2007; 14001/2004; 28000/2007), ku të jetë objekti i prokuruar (blerje gomash)*

**Në lidhje me shkeljet e konstatuara në rastet e mësipërme mbi vendosjen e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore/ nënligjore të LPP, ngarkohen me përgjegjësi si ish- Kryetari i Bashkisë L. H, në cilësinë e ish- Titullarit të AK dhe anëtarët e NJHDT, konkretisht:**

**1. L. M.** me detyrë Drejtoreshë Ekonomike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar kjo në **5 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Rikualifikim urban i sheshit Livadhja” viti 2017; Procedurën me objekt “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh, viti 2018; Procedurën me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik” viti 2018; Procedurën me objekt “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues, viti 2018” dhe Procedurën me objekt: “Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019”.

**2. L. K.** me detyrë me detyrë ish- Përgjegjës në Sektorin Juridik, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT, konstatuar kjo në **2 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Rikualifikim urban i sheshit Livadhja” viti 2017 dhe procedurën me objekt “Blerje mjet gjermimi”.

**3. V. L.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, konstatuar kjo në **4 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Rikualifikim urban i sheshit Livadhja” viti 2017; Procedurën me objekt “Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice”, viti 2017; Procedurën me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik” viti 2018; Procedurën me objekt “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaush dhe Tremul, viti 2018”.

**4. F. P.** me detyrë ish- Përgjegjës në Sektorin juridik për procedurat, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT, konstatuar kjo në **9 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice”, viti 2017; Procedurën me objekt “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”; Procedurën me objekt “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor te Bashkisë Finiq”; Procedurën me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik” viti 2018; Procedurën me objekt: “Rikonstruksion rruga Karroq, viti 2018”; Procedurën me objekt “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh, viti 2018; Procedurën me objekt “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaush dhe Tremul, viti 2018”; Procedurën me objekt “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues, viti 2018” dhe Procedurën me objekt: “Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019”.

**5. S. P.** me detyrë specialist në Sektorin e Transporteve, konstatuar kjo në procedurën me objekt “Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice”, viti 2017.

**6. S. Ç.** me detyrë specialist në Sektorin Juridik për procedurat, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar kjo në **3 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”; Procedurën me objekt “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor te Bashkisë Finiq”; Procedurën me objekt: “Rikonstruksion rruga Karroq, viti 2018”.

**7. D. A.** me detyrë punonjës në Drejtoria Ujitje Kullimit dhe Mbrojtjes se Brigjeve, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar kjo në **3 procedura, respektivisht;** Procedurën me objekt “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”; Procedurën me objekt “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor te Bashkisë Finiq”; Procedurën me objekt “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues, viti 2018”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**8. G. K**, me detyrë ish- Drejtoreshë Kabineti, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT, konstatuar kjo në procedurën me objekt *“Blerje mjet gjermimi”*.

**9. M. L** me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit Juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar kjo në procedurën me objekt *“Blerje mjet gjermimi”*.

**10. F. TH** me detyrë përgjegjës në sektorin e pastrimit të Territorit dhe mirëmbajtjes së objekteve të Bashkisë, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar në **2 procedura**, *respektivisht*: Procedurën me objekt: *“Rikonstrukcion rruga Karroq, viti 2018”* dhe procedura e prokurimit me objekt *“Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaushe dhe Tremul, viti 2018”*.

**11. V. T** me detyrë mirëmbajtës të mjeteve motorikë në Sektorin e Transporteve, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, konstatuar kjo në **2 procedura**, *respektivisht*: Procedurën me objekt *“Blerje Autobuzi për transport udhëtarësh, viti 2018”* dhe procedurën me objekt: *“Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019”*.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 83-100 të Projektraport Auditimit)*

**3. Titulli gjetjes:** Nga KLSH, u konstatua se nga subjektet sipërmarrëse nuk është zbatuar në afatet e caktuara në kontratat respektive punimet për investime/ shërbimet e ndryshme/ dhe ose blerje mallrash.

#### **Situata:**

Në **15 raste**, nga ana e subjekteve sipërmarrës (fitues të procedurave), nuk janë respektuar afate e përcaktuara në kontratë dhe njoftimin e kontratës, për përfundimi e punimeve, blerjes së mallrave/ dhe shërbimeve, veprime të cilat kanë ndikim negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Finiq nga mos llogaritja e kamatëvonesave të përcaktuara në kontratë në masën 4/1000 në ditë, për vlerën **18,010,631 lekë**.

#### **Kriteri:**

Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pjesa “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 42, 43 dhe 52; Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Kushteve të përcaktuara në kontratat e lidhura midis investitorit (Bashkia Finiq) dhe sipërmarrësit të punimeve.

**Impakti:** Ndikim negativ në fondet e Bashkisë Finiq me dëm ekonomik në vlerën 9,701,031 lekë.

**Shkaku:** Mangësi e strukturave drejtues në zbatimin e kontratave dhe mos ngritja e komisioneve për marrjen në dorëzim të zbatimit të kontratave.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të mos respektimit të afatit të kontratës së punimeve/ blerjes së mallrave dhe shërbimeve, si dhe të dalin me vlerësim për dëmin e shkaktuar në buxhetin e Bashkisë në vlerën **18,010,631 lekë**, në ngarkim të subjekteve sipërmarrës, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos ndjekje të kontratës dhe llogaritje të kamatëvonesave, *respektivisht*:

- **Vlera 181,355 lekë**, në ngarkim të subjekti **“V.....A”** në objektin e prokurimit *“Blerje mjete teknologjike për mbeturinat urbane”*, zhvilluar datë 30.5.2017.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- **Vlera 178,640 lekë**, në ngarkim të subjekti “E.....N” në objektin e prokurimit “*Blerje mjet gjermimi*”, zhvilluar datë 18.5.2017.
- **Vlera 3,649,012 lekë**, në ngarkim të subjekti “D.....A” në objektin e prokurimit “*Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)*”, zhvilluar datë 20.6.2017.
- **Vlera 2,819,588 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....I” në objektin e prokurimit “*Ndertim rruge Aliko – Shen Varvara*”, zhvilluar datë 20.11.2017.
- **Vlera 437,089 lekë**, në ngarkim të JV “SH.....I+ J.....Y” në objektin e prokurimit “*Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/I*”, zhvilluar datë 27.3.2017.
- **Vlera 873,598 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....I” në objektin e prokurimit “*Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik*”, zhvilluar datë 29.5.2018.
- **Vlera 1,392,866 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....A” në objektin e prokurimit “*Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh*”, zhvilluar datë 13.4.2018.
- **Vlera 617,520 lekë**, në ngarkim të subjekti “E.....Y” në objektin e prokurimit “*Blerje automjete zjarrfikëse për nevojat e SHMZSH (copë 2)*”, zhvilluar datë 16.7.2018.
- **Vlera 315,187 lekë**, në ngarkim të subjekti “A.....Y” në objektin e prokurimit “*Blerje kamion vetëshkarkues*”, zhvilluar datë 11.5.2018.
- **Vlera 809,676 lekë**, në ngarkim të subjekti “A.....Y” në objektin e prokurimit “*Blerje automjet VAN për nevojat e bashkisë*”, zhvilluar datë 11.5.2018.
- **Vlera 1,250,971 lekë**, në ngarkim të subjekti “SH.....I” në objektin e prokurimit “*Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çausht dhe Tremul*”, zhvilluar datë 07.06.2018.
- **Vlera 3,384,066 lekë**, në ngarkim të subjekti “D.....A” në objektin e prokurimit “*Blerje materiale ndërtimore*”, zhvilluar datë 05.02.2019.
- **Vlera 349,680 lekë**, në ngarkim të subjekti “V.....A” në objektin e prokurimit “*Blerje mjet gjermimi*”, zhvilluar datë 08.03.2019.
- **Vlera 247,676 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....I” në objektin e prokurimit “*Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko*”, zhvilluar datë 08.03.2019.
- **Vlera 1,503,707 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....I” në objektin e prokurimit “*Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues*”, zhvilluar datë 14.5.2018

- **Rastet me shkelje janë trajtuar si më poshtë:**

1. Tenderi me objekt: “*Blerje mjet teknologjik per mbeturinat urbane*”, zhvilluar me datë 30.05.2017 me fond limit 2,658,333 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “V.....A”, me vlerë kontrate 2,518,820 lekë.

Likuidimi per kete objekt është bere me urdhër shpenzimin. nr.230/1, datë 07.08.2017 per vlerën **3,022,584 lekë me TVSh**, po aq sa është vlera e ofertës fituese.

Referuar kushteve të kontratës nr. 2046, datë 12.07.2017, afati për dorëzimin e mallit është 10 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, pra nga data 12.7.2017 deri me datë 22.7.2017.

Nga të dhënat konstatohet se malli është bërë hyrje me datë 07.08.2017 ose me 15 ditë vonesë, për të cilën nga Bashkia nuk janë llogaritur kamatëvonesat për mos dorëzim malli në afat për vlerën **181,355 lekë** (3,022,584 x 4/1000 x 15 ditë), veprim financiar me efekt negativ në buxhet dhe ngarkon me përgjegjësi si shoqërinë “V.....A” për shpërbllim dëmi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

2. Tenderi me objekt: **“Blerje mjet gjurmimi”**, zhvilluar me datë 18.5.2017 me fond limit 4,166,667 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E.....N” , me vlerë kontrate 4,060,000 lekë.

Likuidimi per kete objekt është bere me USH nr.194, datë 11.07.2017 per vlerën 4,872,000 lekë me TVSh, po aq sa është edhe vlera e ofertës fituese, por jo sipas afatit të përcaktuar në kontratë. Kështu sipas kushteve të kontratës malli duhej bërë hyrje brenda 10 ditëve, pranë nga data 20.6.2017 deri me datë 30.6.2017. Në fakt malli është bërë hyrje me datë 11.7.2017, **pra me 11 ditë vonesë** dhe nga Bashkia Finiq nuk janë llogaritur kamatëvonesat për mos dorëzim në afat të mallit, veprime financiare me efekt negativ në buxhet në vlerën **178,640 lekë** ( $4,060,000 \times 4/1000 \times 11$  ditë vonesë), veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi shoqërinë **“E.....N” për shpërblim demi.**

3. Tenderi me objekt: **“Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)”**, zhvilluar me datë 20.06.2017 me fond limit 6,833,334 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “D.....A”, me vlerë kontrate 6,699,700 lekë.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës mbi likuidimet, konstatohet se nuk është zbatuar afati i lëvrimit të mallrave e përcaktuar ne kontrate deri me 31.12.2017. Gjithashtu nga Bashkia Finiq (personat përgjegjës), nuk janë zbatuar sanksionet (kamatvonesa), sipas kushteve të kontratës, ne masën 4/1000 e vlerës se mbetur pa u zbatuar te kontratës ose jo me pak se 25 % e vlerës totale te kontratës, e cila kap vlerën prej **3,425,332 lekë** ( $5,671,080$  lekë vl. mbetur  $\times 4/1000 \times 151$  dite =  $3.425.332$  lekë), veprime financiar me efekt negativ me dëm në buxhetin e bashkisë dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë **“D.....A”** për shpërblim të vlerës së dëmit.

#### Komente të subjekti:

Nga shoqëria “D.....A” me shkresën nr. 885/1, datë 09.03.2020, prot KLSH nr. 1048/7, datë 16.04.2020 është kundërshtuar fakti se vlera e kamatës prej 3,425,332 nuk qëndron, kjo pasi është mangësi e Bashkisë që nuk ka tërhequr mallrat sipas kontratës.

#### Qëndrim i grupit të KLSH-së

Argumentet që paraqisni nuk janë bindës për grupin e auditimit, pasi mallrat sipas kontratës duhet të ishin bërë hyrje deri me datë 31.12.2019, pavarësisht kërkesave të bashkisë. **Argument nuk qëndron.**

4. Tenderi me objekt: **“Ndertim rruge Aliko – Shen Varvara”**, zhvilluar me datë 20.06.2017 me fond limit 8,263,214 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 6,587,823 lekë.

Nga të dhënat e financës, punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratën nr. 3492, datë 6.12.2017 (30 ditë kalendarike), nga momenti i lidhjes, për të cilën nuk janë llogaritur dhe penalitetet. Sipas faturës nr. 17, datë 23.4.2018 në shumën 3,148,707 lekë me TVSh, pra jashtë afatit të kontratës për **107 ditë vonesë.**

Kamatvonesa e pallogaritur paraqitet në shumën **2,819,588 lekë** ( $6,587,823$  lekë  $\times 4/1000 \times 107$ ), veprim financiar me efekt negativ në buxhetin e bashkisë, **dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve K. K, për Bashkinë Finiq K. TH dhe shoqërinë “K.....I” për shpërblim demi.**

5. Tenderi me objekt: **“Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/I”**, zhvilluar me datë 27.3.2017 me fond limit 12,157,222 lekë, ku fitues është shpallur JV “SH.....I & J.....Y”, me vlerë kontrate 9,139,613 lekë.

-Akti i kolaudimit është mbajtur me 19.11.2017, ne një kohe qe, proces verbali i përfundimit te punimeve te mbajtur midis sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit te punimeve, mban datën 21.11.2017;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Situacionit e depozituara ne dosje nr. 1 për shumën 1,993,410 lekë me TVSh, likuiduar me USH nr. 223, datë 19.7.2017 në shumën 1,993,410 lekë; situacion nr. 2 per shumën 8,040,150 lekë me TVSh, likuiduar me USH nr. 281, datë 19.9.2017 në shumën 6,046,739 lekë, më pak se vlera e situacionit. Me USH nr. 77, datë 12.2.2018 është likuiduar shuma 3,364,476 lekë.

Gjithsej janë situacionuar vlera 10,033,560 lekë dhe likuiduar vlera prej 11,404,625 lekë, ose likuiduar më shumë se kontrata për vlerën **437,089 lekë** (11,404,625 – 10,967,533), veprime financiar me dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë, **dhe ngarkohet me përgjegjësi, mbikëqyrësi i punimeve z. Spartak Shehu dhe JV “SH.....I+ J.....Y” për shpërblim dëmi.**

**6. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik”,** zhvilluar me datë 29.5.2018 me fond limit 14,100,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 13,107,000 lekë.

Referuar kushteve të kontratës nr. 1644, datë 21.6.2018 të lidhur midis shoqërisë “K.....I” dhe Bashkisë Finiq, konstatohet se afati për përfundimin e punimeve është deri në fund datë 31.12.2018.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, konstatohet se nga shoqëria “K.....I” deri në datën e hartimit të këtij akt, nuk është mundësuar dorëzimi i mallrave sipas kontratës për vlerën e mbetur prej 4,367,988 lekë me TVSH ose në vlerën 3,639,990 lekë pa TVSH, dhe nga Bashkia Finiq nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesave për shumën **873,598 lekë** {3,639,990 lekë x 4/1000 x 60 ditë novele (29.2.2020)}, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë dhe **ngarkon me përgjegjësi: shoqërinë “K.....I” për shpërblim dëmi dhe K. TH si personi i ngarkuar për marrjen në dorëzim të materialeve.**

**7. Tenderi me objekt: “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh”,** zhvilluar me datë 13.4.2018 me fond limit 4,166,666 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.....A”, me vlerë kontrate 4,096,666 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 1678, datë 26.6.2018, afati i lëvrimit të mallit është 10 ditë kalendarike (nga data 26.6.2018 deri me datë 6.7.2018). Shoqëria ka bërë hyrje mallin me datë 01.10.2018 ose me **85 ditë vonesë** dhe nga Bashkia Finiq, nuk është mundësuar llogaritje e kamatëvonesave në zbatim të nenit 24/a të kontratës së mësipërme në shumën **1,392,866 lekë** (4,096,666 lekë pa TVSH x 4/1000 x 85 ditë kalendarike), veprime me efekt financiar negativ në dëm të buxhetit të bashkisë.

**Veprime dhe mos veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: shoqërinë “K.....A” për shpërblim dëmi.**

**8. Tenderi me objekt: “Blerje automjete zjarrfikëse për nevojat e SHMZSH (copë 2)”,** zhvilluar me datë 16.7.2018 me fond limit 5,000,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E.....Y”, me vlerë kontrate 4,980,000 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 2050, datë 2.8.2018, afati i lëvrimit të mallit është 10 ditë kalendarike (nga data 2.8.2018 deri me datë 12.8.2018). Shoqëria ka bërë hyrje mallin me datë 13.9.2018 ose me **31 ditë vonesë** dhe nga Bashkia Finiq, nuk është mundësuar llogaritje e kamatëvonesave në zbatim të nenit 24/a të kontratës së mësipërme në shumën **617,520 lekë** (4,980,000 lekë pa TVSH x 4/1000 x 31 ditë kalendarike), veprime me efekt financiar negativ në dëm të buxhetit të bashkisë.

**Veprime dhe mos veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: shoqërinë “E.....Y”, për shpërblim dëmi.**





**9.** Tenderi me objekt: **“Blerje kamion vetëshkarkues”**, zhvilluar me datë 11.5.2018 me fond limit 3,333,333 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A.....N”, me vlerë kontrate 3,200,000 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 1671, datë 26.6.2018, afati i lëvrimin të mallit është 10 ditë kalendarike (nga data 26.6.2018 deri me datë 12.7.2018). Shoqëria ka bërë hyrje mallin me datë 01.8.2018 ose me **18 ditë vonesë** dhe nga Bashkia Finiq (Komisioni i marrjes së mallit në dorëzim sipas urdhrit nr. 102/1, datë 13.7.2018, i përbërë nga F. P. , L. M dhe K. TH ), nuk është mundësuar llogaritje e kamatëvonesave në zbatim të nenit 24/a të kontratës së mësipërme në shumën **315,187 lekë** (4,377,600 lekë pa TVSH x 4/1000 x 18 ditë kalendarike), veprime me efekt financiar negativ në dëm të buxhetit të bashkisë.

**Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: Komisionin e marrjes në dorëzim të mjetit i përbërë nga F. P. , L. M dhe K. TH dhe shoqërinë “A.....Y” për shpërblim dëmi.**

**10.** Tenderi me objekt: **“Blerje automjet VAN për nevojat e bashkisë”**, zhvilluar me datë 06.08.2018 me fond limit 2,500,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A.....N”, me vlerë kontrate 2,499,000 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 2467, datë 18.9.2018, afati i lëvrimin të mallit është 10 ditë kalendarike (nga data 18.9.2018 deri me datë 28.9.2018). Shoqëria ka bërë hyrje mallin me datë 19.12.2018 ose me **81 ditë vonesë** dhe nga Bashkia Finiq, nuk është mundësuar llogaritje e kamatëvonesave në zbatim të nenit 24/a të kontratës së mësipërme në shumën **809,676 lekë** (2,499,000 lekë pa TVSH x 4/1000 x 81 ditë kalendarike), veprime me efekt financiar negativ në dëm të buxhetit të bashkisë.

**Veprime dhe mos veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: shoqërinë “A.....Y” për shpërblim dëmi.**

**11.** Tenderi me objekt: **“Riparim mirëmbajtje në vepra ujtëse dhe kullues”**, zhvilluar me datë 14.5.2018 me fond limit 4,762,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 3,894,401 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 1759, datë 7.6.2018, afati i lëvrimin të mallit është 25 ditë kalendarike, pra nga data 7.6.2018 deri me datë 3.7.2018.

Referuar të dhënave të financës, shoqëria “K.....I” nuk ka përfunduar në afat punimet, konkretisht:

a- *Situacioni nr. 1 për vlerën 2,489,390 lekë me TVSH është paraqitur për likuidim me faturën nr. 68, datë 8.9.2018 ose me **35 ditë vonesë** dhe nga bashkia (mbikëqyrësi i punimeve), nuk janë llogaritur penalitetet për mos mbyllje në afat të punimeve në masën 4/1000, konkretisht në vlerën **290,428 lekë** (2,074,491 lekë pa TVSh x 4/1000 x 35 ditë vonesë);*

b- *Situacioni nr. 2 për vlerën 2,179,542 lekë me TVSH është paraqitur për likuidim me faturën nr. 125, datë 20.12.2018 ose me **167 ditë vonesë** dhe nga bashkia (mbikëqyrësi i punimeve), nuk janë llogaritur penalitetet për mos mbyllje në afat të punimeve në masën 4/1000, konkretisht në vlerën **1,213,279 lekë** (1,816,285 lekë pa TVSh x 4/1000 x 167 ditë vonesë);*

Gjithsej detyrimi për kamatëvonesën e pallogaritur paraqitet në shumën **1,503,707 lekë, dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Finiq dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve K. K, ish- Titullarin e AK L. H dhe shoqërinë “K.....I” për shpërblim dëmi.**

**12.** Tenderi me objekt: **“Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaush dhe Tremul”**, zhvilluar me datë 07.6.2018 me fond limit 10,000,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “SH.....I”, me vlerë kontrate 7,538,901 lekë.

Referuar nenit 3 të kontratës nr. 2049, datë 2.8.2018, afati i lëvrimin të mallit është 60 ditë kalendarike (nga data 2.8.2018 deri me datë 2.10.2018).

Me faturë nr. 21, datë 5.11.2018 për shumën 5,299,500 lekë, faturë e cila është jashtë afatit për 33 ditë vonesë (nga data 2.10.2018 deri datë 5.11.2018), për të cilën nuk janë llogaritur





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

kamatëvonesat në shumën **699,534 lekë** ( $5,299,500 \times 4/1000 \times 33$  ditë), veprim me efekt financiar me dëm.

Me faturë nr. 77, datë 3.01.2019 për shumën 1,584,588 lekë, faturë e cila është jashtë afatit për 87 ditë vonesë (nga data 2.10.2018 deri datë 3.01.2019), për të cilën nuk janë llogaritur kamatëvonesat në shumën **551,437 lekë** ( $1,584,588 \times 4/1000 \times 87$  ditë), veprim me efekt financiar me dëm.

Gjithsej detyrimi për kamatëvonesat e pallogaritur për mos përfundim në afat të punimeve, paraqitet në shumën **1,250,971 lekë, veprime financiar me dëm në buxhet dhe ngarkon me përgjegjësi: Mbikëqyrësin e punimeve V. L me detyrë Drejtor i DPZHT Bashkia Finiq dhe shoqërinë “SH.....I” për shpërblim dëmi.**

**13.** Tenderi me objekt: **“Blerje materiale ndërtimore”**, zhvilluar me datë 05.2.2019 me fond limit 16,666,666 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “D.....A”, me vlerë kontrate 16,498,640 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacioni në Sektorin e Financës, konstatohet se kontrata nuk është zbatuar e plotë për vlerën 19,798,368 lekë me TVSH, deri me datë 31.12.2019.

Kështu sipas të dhënave të zyrës së financës dhe Drejtorisë së Shërbimeve, konstatohet se deri me datë 31.12.2019 janë prerë gjithsej fatura me vlerë 2,591,250 lekë me TVSH.

Nga Bashkia Finiq është likuiduar vlera 404,640 lekë nga sipas USH nr. 406, datë 22.10.2019, duke mbetur pa likuidim vlera 2,184,640 lekë.

Nga sa trajtuam më sipër shoqëria “D.....A” nuk ka zbatuar vlerën e kontratës deri me 31.12.2019 për vlerën 14,339,265 lekë pa TVSH (*16,498,640 lekë të kontratës pa TVSH–2,159,375 lekë të faturave të prera pa TVSH*), për të cilën nga ana e Bashkia Finiq nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesës për mos zbatim të kontratës deri me 31.12.2019, me vonesë prej **59** ditë vonesë deri datë 28.01.2020, datë në të cilën është mbajtur akt-konstatimi.

Vlera e kamatës në referencë të nenit 24 shkronja (a), në masën 4/1000 ditë vonesë, penalitet i cili përllogaritet në shumën **3,384,066 lekë** ( $14,339,265 \times 4/1000 \times 59$  ditë), veprime me efekt financiar negativ me dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë.

**Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: subjektin “D.....A” për shpërblim dëmi për mos lëvrim të mallit në afat.**

**14.** Tenderi me objekt: **“Blerje mjet gërmimi”**, zhvilluar me datë 08.3.2019 me fond limit 1,416,666 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “V.....A”, me vlerë kontrate 1,410,000 lekë.

Likuidimi për këtë objekt është bërë me USH. nr. 261/1, datë 18.6.2019 për vlerën **1,692,120 leke me TVSh**, po aq sa është edhe vlera e ofertës fituese.

Siç shihet, nuk është zbatuar afati i lëvrimin të mallrave e përcaktuar në kontrate që është nga data e lidhjes së kontratës (datë 21.3.2019) deri me 26.3.2019, për mosrespektimin e së cilit duhej të zbatoheshin sanksionet e përcaktuara në kushte të kontratës, të aplikoheshin kamatvonesa, gjë e cila nuk është zbatuar në masën 4/1000 e vlerës së mbetur pa u zbatuar të kontratës ose jo me pak se 25 % e vlerës totale të kontratës që kap vlerën prej **(1,410,000 leke x 4/1000 x 62 ditë) = 349,680 leke, vlerë kjo, e kërkuar për zhdëmtim në ngarkim të shoqërisë “V.....A”.**

**15.** Tenderi me objekt: **“Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”**, zhvilluar me datë 02.11.2017 me fond limit 8,698,702 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.....I”, me vlerë kontrate 7,489,046 lekë.

-Njoftimi për përfundimin e punimeve nga sipërmarrësi, procesi verbal i përfundimit të punimeve dhe relacioni për përfundimin e punimeve mbajnë datën 06.12.2017, ndërsa akti kolaudimi mban datën 05.12.2017, ndërsa ditari i objektit pasqyron punimet nga data 18.11.2017 deri me 05.12.2018, gjë që tregon se punimet kanë përfunduar 2 muaj me vonesë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Fiq.

Nuk është llogaritur kamata për kryerje të punimeve me vonese, sipas dokumentacionit të mësipërm në masën mbi 25 % të vlerës totale të kontratës, që duke e llogaritur me 26 % të saj kap vlerën **247,676 lekë pa TVSh ( 952,599 lekë pa TVSh x 26 %)**, veprime me efekt financiar negativ me dëm në buxhet dhe ngarkon me përgjegjësi sipërmarrësit “K.....I” për arkëtimin e vlerës prej 247,676 lekë dhe mbikëqyrësin e punimeve ing. K. K.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme me pasoja në buxhetin e Bashkisë Fiq, nga mos zbatimi i penaliteteve të mos mbylljes së kontratave në afat, ngarkohen me përgjegjësi përveç subjekte dhe mbikëqyrësit edhe L. H me detyrë ish- Kryetar i Bashkisë Fiq, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues dhe L. M. me detyrë Drejtoresh Finance, në cilësinë e Nënpunësit zbatues*

#### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Jurist i Sektorit të procedurave me datë 10.04.2020 është kundërshtuar fakti se kamatvonesa e konstatuar nga grupi i KLSH për shumën 715,249 lekë, nuk qëndron, paraqitur kjo grupit të KLSH me formë elektronike, për faktin se:

Grupi i KLSH në llogaritjen e kamatës është bazuar vetëm tek urdhër shpenzimi dhe jo në faturat e subjekti. Kështu subjekti lëvrimin e mallit e ka paraqitur me faturat nr 40,41 dhe 42, datë 06.11.2019, pra brenda aftit ligjorë të zbatimit të kontratës dhe nuk ka vonesa, pavarësisht faktit të likuidimit në një periudhë tjetër.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Argumentet e paraqitura nga subjekti janë bindës për grupin e auditimit dhe merren në konsideratë.

#### **Komentet e subjektit:**

Nga shoqëria “V.....A” me e-mail, janë paraqitur kundërshtitë me datë 09.03.2020, në lidhje me kamatëvonesën e aplikuar nga grupi i KLSH për vlerën **2,646,604 lekë** në procedurën me objekt: “Blerje materiale elektrike për ndriçim rrugor”, zhvilluar me datë 28.02.2019.

Sipas shoqërisë afati i lëvrimin të malli është shtyre deri me datë 20.06.2019, kjo referuar akt-mavreshjes së lidhur midis ish- Kryetarit të Bashkisë L. H dhe shoqërisë “V.....A”.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa argumentoni në kundërshtitë tuaja, në lidhje me kamatëvonesën e aplikuar nga KLSH për vlerën 2,646,604 lekë, sqarojmë se pretendimet tuaja qëndrojnë dhe se nga Bashkia gjatë fazës së auditimit në terren nuk u mundësua paraqitja e kësaj akt-marrëveshje për shtyre të afatit të kontratës. **Argumenti juaj qëndron.**

**4. Titulli gjetjes:** Nga KLSH, u konstatua se në **14** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 2017 – 2019, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet për vlerën **136,713,771 lekë**.

#### **Situata:**

Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga 42 procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate 403,322,100 lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore/nënligjore të LPP në 14 procedura me vlerë kontrate 136,713,771 lekë ose



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

38.9% e vlerës së kontratave të audituar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet për vlerën **136,713,771 lekë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- Kryetarin e Bashkisë L. H dhe anëtarët e NJHD dhe KVO.**

### Kriteri:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### Impakti:

Nga vlerësimi jo i drejtë i operatorëve në garë, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet për vlerën **136,713,771 lekë.**

### Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kriterëve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të LPP.

### Rëndësia: E lartë

### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet ( 3E) për vlerën **136,713,771 lekë pa TVSH.**

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

## Trajtimi i rasteve me shkelje në mënyrë të hollësishme sipas praktikave, paraqiten si vijon:

### Për aktivitetin e vitit 2017.

### **I. Procedura e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban i sheshit Livadhja” viti 2017.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rikualifikim urban i sheshit Livadhja”, viti 2017</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 21, datë 7.6.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 21, datë 7.6.2017 L. K L. M V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 21/1, datë 7.6.2017 F. P - kryetar G. M - anëtar S. J - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Tender i Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 51,682,705 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “G.....Y” me ofertë 48,127,941 lekë pa TVSH dhe kontratë nr. 2039, dt. 11.7.2017, me afat 90 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 3,555 mijë lekë ose 6.8 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 30.6.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. ---; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ---, dt. ---



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Në këtë procedura ka marrë pjesë vetëm shoqëria “G.....Y” me ofertë 48,127,941 lekë pa TVSH, e cila është shpallur shoqëri fituese pasi plotëson kriteret e DST sipas KVO.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është botuar në buletin e APP Nr 52, datë 29.12.2017, **pra, 5 muaj me vonese**, duke vepruar në kundërshtim me kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 71 “Publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar”, ku përcaktohet afati 5 ditor nga data e lidhjes së kontratës.

#### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë së vetme pjesëmarrës dhe shpallur fitues në dosjen dhe sistemin SEP, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, *konkretisht:*

*a-OE te paraqesë leje shfrytëzimi miniere guri dekorativ lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes. Per kete, nga QE është paraqitur leja e shfrytëzimit nr.1359, datë 08.06.2009 per vendburimin Karkanjoz – Berat, te shoqëruar me hartën përkatëse në emër te “P.....A& S.....T” me përfaqësues A. SH dhe adrese Tirane, **pra, nuk është plotësuar ky kriter**, pasi leja e shfrytëzimit nuk është në emër te shoqërisë “Guri-Berat” apo shoqërisë qe ia ka dhënë me qira “L.....I”.*

*-OE te paraqesë leje dhe autorizim mjedisor te tipit III.I.A per pike grumbullimi, përpunimi dhe tregtimi te pllakave dhe blloqeve te gurit, lëshuar nga agjencitë rajonale te mjedisit. Per kete OE ka paraqitur leje mjedisore , kodi III.I.A ne emër te shoqërisë “G.....T” si dhe leje mjedisore nr.150, datë 30.04.2009 ne emër te “P.....A& S.....T” .*

*c-Per kriterin qe OE te kete ne stafin teknik te shoqërisë një inxhinier mjedisi, i pasqyruar ne Liçensën e Shoqërisë, OE ka paraqitur dokumentacion per **D. D** e diplomuar per kimi dhe e liçensuar per hartimin e raporteve te vlerësimit ne mjedis, **por qe nuk është e përfshirë ne stafin teknik te pasqyruar ne licencën e shoqërisë.***

*e-Per kriterin, një inxhinier ndertimi profili strukture dhe një inxhinier agrar profili hortikulture, OE ka paraqitur kontrate pune te datës 13.04.2007 per te parin dhe kontratë pune te datës 03.04.2017 **per te dytin, jo qe nga muaji Janar 2017.***

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “G.....Y”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, korrigjimin e kriterëve të cilat nuk janë në përputhje me zërat e preventivit dhe kushtet e objektet të prokuruar, kjo për të mundësuar rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, e cila është një EO dhe për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën 51,682,705 lekë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: **Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e NJHDT dhe KVO.**

#### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- juristi i sektorit të procedurave Bashkia Finiq, me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedura, të cilat i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit me postë elektroni me datë 19.04.2020, në të cilën sqarohen se asnjë nga mangësitë e konstatuar nga grupi i KLSH nuk qëndron pasi janë paraqitur nga subjekti.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Përsa sqaron ish- juristi në lidhje me mangësitë e konstatuara në këtë procedurë, sqarojmë se një pjesë e tyre mangësitë, pasi verifikimit të sistemit qëndron dhe nuk janë mangësi për subjektin fitues, ndërsa për mangësitë e tjera nuk jepen argumente ose argumentet e paraqitura nuk sqarojnë me dokumentacion mangësitë e konstatuara, pasi nga riverifikimi në sitëm ato nuk janë paraqitur nga subjekti.





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Konkretisht janë marrë në konsideratë këto mangësi:

**a-**Nuk ka paraqitur akt kolaudimi dhe police sigurimi për mjetin me targë AA.....IB.

**b-**Per kriterin qe OE te kete ne pronësi karrierë prodhimi dhe përpunimi per gurë dekorativ;

-Aktin e pronësisë se furnizuesit ose kontrate qiraje te sipërfaqes ku nxirret guri dekorativ. Per kete, OE ka paraqitur kontrate furnizimi noteriale me nr.937 Rep. datë 27.06.2017 me shoqërinë "G.....T" per realizimin e objektit qe tenderohet, kontrate qiraje te kësaj shoqërie me qiradhënësin shoqërinë "L.....I" me 4 përfaqësues, datë 26.10.2010, per sipërfaqen e shfrytëzimit prej 4.000 m2 me afat 10 vjet ne Vodice – Berat si dhe dokumentacion per makineritë e shoqërisë "G.....T" per kete prodhim.

-OE te paraqesë certifikatën ISO 8001:2008 lëshuar per prodhim dhe përpunim gurë dekorativ sipas preventivit dhe specifikimeve teknike. Per kete, është paraqitur kjo certifikate ne emër te shoqërisë "G.....T" .

-OE te paraqesë flete analizën e gurit dekorativ ranor qe përdorët per përcaktimin e rezistencës se konsumit te gurit sipas metodës U.....5. Per kete, nga OE është paraqitur raporti i provës U.....5 datë 06.06.2011 lëshuar nga Universiteti i Bilonjës, ne te cilën nuk vërtetohet klienti qe e ka porositur, si dhe është lëshuar 6 vjet me pare se data e tenderit, pra nuk është plotësuar ky kriter.

**d-**Nuk plotësin kriterin për 2 inxhinier te certifikuar per punime ne lartësi, **pasi nga OE është paraqitur dokumentacion vetëm per një inxhinier.**

**f-**OE nuk ka paraqitur dokumentacion per makinerinë per shkulle pemësh, aparat GPS per punimet gjeodezike, pompe suvatimi dhe fshese per pastrim dhe larje rrugësh.

**g-**OE nuk ka paraqitur deklarate noteriale qe shpreh dakortesine me financimin 3 – vjeçar te objektit i përcaktuar nga AK.

**l-**OE nuk ka paraqitur deklarate noteriale qe ekzekutimi i kontratës do te behet brenda afatit kohor te përcaktuar nga AK.

Ndërsa pjesa tjetër e cila është paraqitur mësipërm nuk merret në konsideratë, por duhet theksuar se në zbatim të depozitave të LLP, nëse ekziston edhe një mangësi subjekti duhet skualifikuar, përjashto devijime të vogla (me argument) qe nuk çenojnë procesi, dhe nuk është bindës fakti se investimi është investim publik dhe i domosdoshëm për komunitet, pasi është një investim i planifikuar i nevojshëm por jo për shkeljen e akteve ligjore. **Argumento qëndron pjesërisht, por procedura e parregullt.**

## II. Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtjeje per mjete transporti dhe Eskavator”, rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shpenzime mirëmbajtjeje per mjete transporti dhe Eskavator”, viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 35, datë 26.07.2017.	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 35, datë 26.07.2017. L. K L. M M. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 35/1, datë 26.07.2017 F. P - kryetar TH. Z - anëtar I. M - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1.666.666 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “D.....O” me ofertë 1.666.000 lekë pa TVSh dhe 1,999,200 lekë me TVSh, me kontratë nr. 2426 Prot. datë 24.08.2017 dhe afat nga data e lidhjes deri datë 31.12.2017.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 0 mijë lekë ose 0 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>	<b>9. Burimi Financimit</b>	<b>10. Operatoret Ekonomike</b>





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Datë 15.08.2017	Bashkia Finiq	a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -- ; KPP --- APP-s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### Shqyrtimi i procedurës:

Proçes verbali i hapjes se ofertave date 15.08.2017, proçes verbali i shqyrtimit dhe klasifikimit të ofertave date 15.08.2017, rezultojnë të panënshkruar nga anëtarët e KVO (i paprotokolluar dhe firmosur nga anëtarët TH. Z, I. M). Gjithashtu dhe raporti përfundimtar date 15.08.2017, është i pafirmosura nga K/KVO dhe K/AK, ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, kreu V “Zhvillimi i proçedurave”, neni 52 dhe 53 dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i proçedurave”, neni 64 , 66 dhe 68.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm shoqëria “DH.....O” me ofertë ekonomike 1,666,000 lekë pa TVSH, ku pas verifikimit të dokumentacionit, sipas KVO plotëson kriteret për kualifikim dhe shpallje fitues.

Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “DH.....O”, rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- OE ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të E. Elektrikë me Nr. Ekstra, date 26.07.2017 të O.....E njësisë Sarande, i firmosur në emër të drejtorit të njësisë F. B, i pa identifikueshëm se nga kush është firmosur, nuk është formular tip i miratuar nga O.....E “Vërtetim debie për OE për pjesëmarrje në proçedurat e prokurimit publik....” për tu paraqitur në tender, të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të O.....E Gjirokastrë, por një vërtetim pa numër protokoll si dhe vula e vendosur është e dyshimte;
- b- OE nuk ka paraqitur deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.
- c- OE nuk ka paraqitur leje të lëshuar nga QKL Tipi C, për riparim mjetesh motorike si dhe Çertifikatë të lëshuar nga një subjekt privat ose nga Shërbimi Kombëtar i Punësimi;
- d- Nuk paraqet punime të ngjashme në vlerën jo më të vogël se 40 %;
- e- OE nuk ka paraqitur dëshmi për numrin mesatar i punonjësve të siguruar të jete jo më i vogël se 2 (dy) punonjës për periudhën Janar – Maj 2017, të vërtetuar me listëpagesat e periudhës përkatëse.

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “DH.....O”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kriterëve, kriteret të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën 1,666,666 lekë.

Theksojmë se mungesa e konkurrencës ka bere qe vlera e preventivit fitues te jete pothuajse e barabarte me vlerën e fondit limit me një diference prej 666 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

**III. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor të Bashkisë Finiq”, rezultoi si më poshtë:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje mbrojtëse rrugore për sistemin rrugor të Bashkisë Finiq”,viti 2017		
1. Urdhër Prokurimi nr. 32, datë 13.07.2017.	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 32, datë 13.07.2017.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 32/1, datë 13.07.2017
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”	F. P D. A S. Ç	L. K - kryetar L. M - anëtar A. B - anëtar



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1.666.666 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “D.....N” me ofertë 1.605.900 lekë pa TVSh dhe 1.927.080 lekë me TVSh, me kontratë 2811 Prot. datë 04.10.2017 dhe afat. 10 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 61 mijë lekë ose 3.6 %</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 08.09.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -- ; KPP --- APP-s'ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### Shqyrtimi i procedurës:

Ne buletin e APP Nr.30 date 31.07.2017 i njoftimit të kontratës me date tenderi 07.08.2017, ora 12:00, **pra 14 dite me vone** se data e anuluar, veprime në kundërshtim me nenin 42 “Sqarimet dhe ndryshimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2 dhe 2/1 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk është hartuar shtojca për ndryshimet dhe është tejkaluar zgjatja e afatit kohor prej 5 ditësh të përcaktuar në kete nen.

Proçes verbali i hapjes së ofertave date 08.09.2017, proçes verbali i shqyrtimit dhe klasifikimit të ofertave date 08.09.2017, **te pafirmosura prej 2 anëtareve të saj (L. M dhe A. B)**. Raporti përmbledhës date 08.09.2017 i **pafirmosura nga K/KVO, gjë, që tregon për veprime fiktive të kryera nga ana e KVO.**

Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “D.....N” , rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- *Mungon preventivi me zërat dhe çmimet përkatëse në përputhje me zërat e preventivit të argumentimit të fondit limit.*
- b- *OE për gjendjen financiare ka paraqitur vërtetim nga B.....S me Nr.507 Prot. por pa date dhe pa përcaktuar shumen përkatëse të vlerës monetare.*
- c- *Sipas Ekstraktit të QKB ( për të gjitha NIPDET), ky OE duhet të paraqiste vërtetim nga Bashkitë, Tirane, Vore, Burxull, Shkoder, Çorovode, Bajram Curri, Pogradec dhe Korçë. Në fakt, në dosje u gjeten vetëm vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Tirane për vitet 2015-2016, Bashkia Vore për vitet 2015-2016-2017 dhe nga Bashkia Buxull për vitin 2015 dhe nuk ka paraqitur vërtetim nga bashkitë e tjera të sipërpërmendura;*
- d- *Nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme në masën jo më të vogël se 40 % e fondit limit.*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “D.....N” , nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kriterëve, kriteret të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën 1,666,666 lekë, **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **IV. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje mjet gjermimi”, rezultoi si më poshtë:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje mjet gjermimi viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 9, datë 05.05.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 9, datë 05.05.2017	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 9/1, datë 05.05.2017
<b>2. Lloji i Procedurës</b>	G. K	S. P - kryetar



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

“Kërkesë me propozim”	L. M M. L	F. TH - anëtar TH. Z - anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,166,667 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “E.....N” me ofertë 4,060,000 lekë pa TVSH dhe kontratë xxxx prot., datë 20.6.2017, me afat 10 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 106 mijë lekë ose 2.5 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 18.05.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO ; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Proçes verbali i hapjes se ofertave datë 18.5.2017, është i pafirmosura nga anëtarët e KVO.

Në këtë procedura kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht shoqëria “E.....N” dhe subjekti fizik “S.....O”, ky i fundit është edhe për mosparaqitje dokumentacioni për furnizime të ngjashme. Raportit përmbledhës të datës 18.05.2017, konstatohet se janë kualifikuar të dy OE, raport, i pafirmosura nga Kryetari i KVO.

Kemi mospërputhje datash, pasi raporti përmbledhës është përgatitur me pare se proçes verbali i klasifikimit si dhe përmbajtja e tyre nuk përputhet, pasi në proçes verbal subjekti “S.....O” është s’kualifikuar ndërsa në Raport është i kualifikuar, gjë, që tregon për veprime fiktive të kryera nga ana e KVO.

**Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “E.....N”, rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- *Nuk ka paraqitur vërtetim të shlyerjes së taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Sarandë, sipas të dhënave të ekstraktit mbi historikun e subjektit.*
- b- *Nuk ka paraqitur dëshmi të origjinalitetit të mjetit, përshkrimi dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike.*
- c- *Nuk ka paraqitur dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mjetit me specifikimet teknike.*
- d- *Nuk ka paraqitur specifikimet teknike të mjetit, për të verifikuar nëse ato përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.*

**Konkluzioni:** KVO nuk duhej të kualifikonte shoqërinë “E.....N”, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, analizonte shkaqet e dështimit dhe rishikimin e kriterëve të cilat mund të kenë ndikuar në uljen e numrit të pjesëmarrës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO .**

**V. Procedura e prokurimit publik me objekt “Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2017”, rezultoi si më poshtë:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 5, datë 11.04.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 5, datë 11.04.2017	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 5/1, datë 11.04.2017
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Hapur”	L. K L. M F. TH	S. P - kryetar M. L - anëtar S. J – anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 9.200.000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “B.....L” me ofertë 9.200.000 lekë me TVSh, marzhë fitimi 10 % për gazoil	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 0 mijë lekë ose 0 %



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

	dhe benzine dhe 15 % per gazin, me kontratë 2012 prot., datë 07.07.2017 dhe afat. 6 muaj nga data e lidhjes se kontratës.	
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 28.06.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO ; KPP --- APP-s'ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----</b>

### Hartimi fondit limit:

Vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogenerator, kaldata, etj*) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Finiq, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit. Përsa i përket vlerës së përlllogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përlllogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar, veprime në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronjat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni përcaktimit specifikimeve teknike e përlllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës dhe NJP që ka miratuar këto përlllogaritje me DST dhe ish- titullari AK.

### Shqyrtimi i dokumentacionit:

Sipas proces verbalit te shqyrtimit te ofertave te datës 22.5.2017, i vetmi OE qe ka paraqitur oferte është JV “A.....T & S.....A”, i cili është s’kualifikuar per mosparaqitje te vërtetimeve te likuidimit te taksave vendore per te gjitha adresat ku kane pika karburanti, **proces verbal ky i pa firmosur nga anëtarët e KVO.**

Proces verbali i hapjes se tenderit, proces verbali i shqyrtimit te ofertave dhe raporti përmbledhës datë 28.06.2017, ku ne kete te fundit është **vendosur si anëtar KVO, L. K** , kur ky është anëtar i njësisë se prokurimit, konstatohet se këto dokumente nuk janë firmosur nga anëtarët e KVO. Po kështu, edhe vendimi i titullarit per miratim procedurën nuk është firmosur prej tij.

**Nga anëtarët e KVO (S. P me funksion specialist në Sektori i Transportit, M. L me funksion Përgjegjës Sektori Transporti dhe S. J me funksion Përgjegjës në Sektori I mirëmbajtjes së rrugëve rurale dhe urbane), janë kryer veprime fiktive ne kryerjen e procedurës se prokurimit, ç’ka i ngarkon me përgjegjësi.**

Nga auditimi i ofertës fituese të shoqërisë “B.....L”, rezultoi se operatori ekonomik nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e veçanta te kualifikimit te dokumenteve standarte, si me poshtë:

- a- Nuk ka paraqitur vërtetim nga Administrata Tatimore per xhiron mesatare vjetore te vitit 2014 ( tre vitet e fundit);
- b- Nuk ka paraqitur çertifikatë te gjendjes financiare nga një ose me shume banka per gjendje likuiditetesh me vlere jo me te vogël se 10% e vlerës se objektit, e lëshuar jo me pare se 5 dite nga data e hapjes se tenderit;
- c- Nuk ka paraqitur kopje te çertifikuar te bilancit te vitit 2016.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- d- OE ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të E. Elektrikë;
- e- OE nuk ka paraqitur dokument për llogaritjen e analizës së kostos .

**Konkluzioni:** KVO nuk duhet të kualifikonte shoqërinë “B.....L”, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, analizonte shkaqet e dështimit dhe rishikimin e kriterëve të cilat mund të kenë ndikuar në uljen e numrit të pjesëmarrës.

Nga auditimi, konstatohet se nga KVO është anuluar procedura e parë, me faktin se JV “A.....T & S.....A” nuk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së taksave vendore në vendet e biznesit, mangësi e cila mund të klasifikohet dhe si devijim i vogël në zbatim të pikës 4 të nenit 53 të LPP dhe nuk është shkak për mos zbatim kontrate, kjo dhe për faktin se oferta e paraqitur është më e leverdishme se oferta e shoqërisë “B.....L”, konkretisht:

EMËRTIMI	JV “A.....T + S.....A	B.....L	Diferenca
NAFTË	7.8 %	10 %	+ 2.2
BENZIN	7.8 %	10 %	+ 2.2
GAZ	35 %	15 %	- 20

Veprimet e mësipërme kanë çuar në paligjshmëri të përdorimit të fondit të prokuruar prej 9,200,000 lekë, nga mos menaxhimi më i mirë i procedurës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish-titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 99-107 të Projektraport Auditimit)*

- **Për aktivitetin e vitit 2018**

### **I. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik” viti 2018.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik”, viti 2018</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 13, datë 29.3.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 13, datë 29.3.2018 F. P L. M V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 13/1, datë 29.3.2018 K. TH - kryetar S. Ç - anëtar V. K - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Tender i Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 14,100,000 lekë REF-65928-04-28-2018	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “K.....P” me ofertë 13,107,000 lekë pa TVSH dhe kontratë nr. 1644, dt. 21.6.2018, me afat 31.12.2018.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 993 mijë lekë ose 7 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 29.5.2018	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. ---; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

#### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm shoqëria “K.....P” me ofertë 13,107,000 lekë pa TVSH, procesverbal i cili nuk është nënshkruar nga asnjë nga anëtarët e KVO.

Raporti përmbledhës datë 29.5.2019, **raport i cili nuk është sipas përcaktimeve dhe nuk është nënshkruar nga Kryetari i KVO K. TH**, ku sipas deklaratimit verbal nuk është në dijeni të





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

qenies anëtarë KVO, veprime në kundërshtim me nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.3.2014, me ndryshime.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, të OE të vetëm pjesëmarrës, konstatohet se nuk plotëson kriteret e DST, konkretisht:

*a-Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk ka arritur të dëshmojë plotësimin e pikës 2.1/dh te kritereteve te Veçanta per Kualifikim.*

*Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga O.....E nr. 478 prot datë 25.4.2018, ku theksohet se nuk është përfshirë pagesa e muajit mars 2018.*

*Në nenin 9 “Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”, paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjare”, përcaktohet shprehimisht që:*

*“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

*Pra, afati i maturimit për pagesën e muajit Mars 2018 ka qene deri ne 30.04.2018 ndërkohë qe data e tenderit është ne 29.5.2018.*

Në procedura të tjera si “Rehabilitim i rrugës Pllake – Kullurice”, KVO e ka përdorur këtë mangësi si kriter skualifikuar për shoqëri me oferta më të leverdishme, kjo pasuar dhe në vendimmarrjeve te KPP, konkretisht Vendimi i KPP nr. 479/2015 si dhe një sere vendimesh te tjera si KPP nr. 279/2016 ; KPP nr. 668/2016 ; K.P.P. 889/2016, etj.

*b-Çertifikatë ISO 9001-2008 dhe 14001-2004, nuk janë paraqitur nga subjekti, pasi certifikatat e paraqitura janë të vitit 2015, ndërkohë që në procedurë është kërkuar viti 2004 dhe 2008*

*c-Subjekti nuk paraqet leje mjedisore, sipas kritereteve të DST,*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “K.....I”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kritereteve, kriteret të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën **14,100,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

## II. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje kamion vetëshkarkues”, rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje kamion vetëshkarkues, viti 2018</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 12., datë 29.3.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 12., datë 29.3.2018 1. F. P 2. L. M 3. V. T	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 12/1, datë 29.3.2018 1. K. TH 2. M. L 3. S. C
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 3,333,333 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “A.....N” me ofertë 3,200,000 lekë me kontratë nr. 1671, datë 26.6.2018, me afat 10 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 133 mijë lekë ose 3.9%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 11.5.2018 (REF-65929-04-28-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Juristi i Sektorit të Procedurave në Bashkinë Finiq me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedurë për kriteret, të cilat i janë paraqitur grupit të KLSH me datë 19.04.2020 me elektronik. Sipas kundërshtive të paraqitura ish-juristi kundërshton mangësitë në lidhje me mos përputhjen e kriterëve të mjetit me ato të specifikimeve teknik.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:**

Argumentet e paraqitura nga ish- juristi janë bindës për grupin e KLSH, pasi për mangësitë e konstatuara në mos përputhjen e specifikimeve teknike është sqaruar me argumentin se këto specifikime janë ndryshuar dhe mjeti i bërë hyrje është me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara. **Argumenti qëndron**

### **III. Procedura e prokurimit publik me objekt “Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2018”, rezultoi si më poshtë:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2018		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 2, datë 13.3.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 2, datë 13.3.2018 F. P S. Ç F. TH	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 2/1, datë 13.3.2018 L. K - kryetar L. M - anëtar K. TH – anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 9,500,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “B.....L” me ofertë 9,500,000 lekë me TVSh, marzhë fitimi 20 %, me kontratë 1104/1 prot., datë 27.4.2018 dhe afat deri 31.12.2018.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 0 mijë lekë ose 0 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 9.4.2018 REF-55851-03-13-2018	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO ; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### **Hartimi i fondit limit:**

Vlera e karburantit e përlogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogenerator, kaldaja, etj*) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Finiq, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit. Përsa i përket vlerës së përlogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përlogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar. Në këto kushte veprimet në lidhje me përlogaritjen dhe argumentimin e vlerës limit të njoftimit të kontratës lidhen direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronjat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni përcaktimit specifikimeve teknike e përlllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës dhe NJP që ka miratuar këto përlllogaritje me DST dhe ish- titullari AK.

### **-Shqyrtimi i procedurës:**

Në këtë procedura ka marrë pjesë vetëm shoqëria “B.....O” me marzhë fitimi 20 % Raporti përmbledhës është mbajtur datë 24.4.2018, është nënshkruar vetëm nga ana e ish-titullarit të AK L. H dhe jo nga Kryetari i KVO L. K. .

Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë fituese “B.....O”, konstatohet se nuk plotëson kriteret e DST, konkretisht:

a- Nuk paraqet vërtetim nga ISHTI. Nuk paraqet Siguracion ndaje palëve të treta, pika II/c e DST

b- Nuk paraqet raport analizë cilësie së karburantit të lëshuar nga një laborator i certifikuar ne Republikën e Shqipërisë, sipas pikës II/d të DST.

c- Shoqëria ka paraqitur vërtetim nr. 952, datë 6.4.2018 në të cilën theksohet se nuk është debitor për vitin 2017 në Bashkisë Finiq, vërtetim i nënshkruar nga ish- Kryetari L. H. Nga verifikimi në sistemimin e taksave vendore mbi gjendjen e debitorëve, konstatohet se shoqëria “B.....O” është debitorë ndaje Bashkisë Finiq për vlerën **351,600 lekë, deklaram i rremë.**

d- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike, nuk është sipas modelit të kërkuar dhe vula është e paidentifikuar. Gjithashtu në vërtetimin nr. Ekstra (e cila nuk ndodh), datë 5.4.2018 nuk është përcaktuar se deri në çfarë data subjekti ka ose jo detyrime të energjisë elektrike.

**Konkluzioni:** KVO nuk duhej të kualifikonte shoqërinë “B.....L”, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, analizonte shkaqet e dështimit dhe rishikimin e kriterëve të cilat mund të kenë ndikuar në uljen e numrit të pjesëmarrës, siç është kriteri për paisje me autorizim për pikën e karburantit nga Bashkia Finiq, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondit të prokuruar prek 9,500,000 lekë, nga mos menaxhimi më i mirë i procedurës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **III-Tenderi me objekt: “Blerje materiale elektrike per ndriçim rrugor, viti 2018, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje materiale elektrike per ndriçim rrugor, viti 2018		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 3., datë 15.3.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 3., datë 15.3.0018 1. TH. TH 2. F. P 3. A. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 3/1, datë 16.3.2018 1. F. TH 2. K. TH 3. L. M
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 15,000,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “V.....A”. me ofertë 14,930,800 lekë me kontratë nr. 1250, dt. 9.5.2018, me afat 150 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 70 mijë lekë ose 0.46%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 10.4.2018 ndryshuar me datë 23.4.2018, pas ankesave (REF-56657-03-16-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

AK- nr. PO; KPP----- APP-s'ka/ka;	Shkresa nr. -----	AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----
--------------------------------------	-------------------	-----------------------------------

### **-Shqyrtimi i procedurës:**

Në preventivin e hartuar nga A. B, janë të evidentuara vetëm artikujt, por pa argumentuar se ku janë kërkesat dhe në cilat rrugë do bëhen këtë zëvendësime.

Nga ana e KVO është mbajtur proces verbali i hapjes se ofertave date 23.4.2018, i pafirmosura prej anëtarëve të KVO, në të cilën evidentohet se në këtë procedurë ka marrë pjesë 2 OE, konkretisht subjekti “R.....O” pa ofertë ekonomike dhe shoqëria “V.....A”. me ofertë 14,930,800 lekë pa TVSH.

Raporti përmbledhës i datës 2.5.2018 është i pafirmosura nga kryetari i KVO F. TH, por vetëm nga ana e ish-Titullarit të AK. Gjithashtu ky raport përmbledhës nuk është sipas kërkesave të “V.....A”. me ofertë 14,930,800 lekë pa TVSH

Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “V.....A” shpk, rezultuan mangësitë e mëposhtme:

*a-Nga ana e KVO nuk është dokumentuar nëse OE ka paraqitur mostrat përkatëse me skedën teknike të tyre për të vërtetuar përputhshmërinë e materialeve objekt prokurimi me specifikimet teknike të kërkuara.*

*b-Ofertat e paraqitura nga shoqëria nuk përputhet me preventivin e kërkuar nga AK, sipas artikujve, konkretisht subjekti ka paraqitur ofertën për sha Ujësjellës Kanalizime Peqin:*

*c- Subjekti nuk paraqet pagesën e taksave vendore nga Bashkia Finiq për vitet 2016-2017, megjithëse ka pasur kontrata të lidhura për vitet 2016- 2018, për punë të ndryshme’*

*d- Mjet me targë AA.....SJ në pronësi të shoqërisë “V.....A”, nuk paraqet pagesën e taksave vjetore 2018, siguracioni të mjetit dhe kolaudim. Gjithashtu ky mjet nuk është fjugon siç kërkohet në DST, por veturë.*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “V.....A”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kriterëve, kriteret e cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën **15,000,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **Komentet e subjektit:**

-Nga Z. LL me detyrë Sekretar i Përgjithshëm janë paraqitur kundërshtitë me shkresën nr. 1076, datë 31.3.2020, në të cilën sqaron se me urdhër nr.2, datë 23.4.2018 të ish-Kryetarit të Bashkisë Finiq Z. LL në pozicionin e Kryetarit të KVO është zëvendësuar nga F. TH.

-Nga ish- Juristi i Sektorit të Procedurave në Bashkinë Finiq me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedurë në lidhje me kualifikimin e padrejtë, të cilat i janë paraqitur grupit të KLSH me datë 19.04.2020 me elektronik, nuk qëndrojnë pasi ato janë të argumentuara dhe paraqitura nga subjekti i vetëm fitues.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH.**

-Përsa sqaron Z. LL , argumentet e paraqitura të cilat janë të shoqëruar dhe me dokumentacion ligjorë, janë bindës për grupin e auditimit të KLSH.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

-Përsa sqarohet nga ish- juristi, theksojmë se argumentet e paraqitura nuk janë bindës për grupin e auditimit me dokumentacion mbështetës, duke mos argumentuar asnjë nga mangësitë e konstatuara.

Në lidhje me pagesën e taksave vendor, pavarësisht faktit nëse subjekti ka hapur ose jo Nipt sekondar, duhet të paraqesë vërtetim mbi pagesën e taksave kur dihet se ka aktivitet në këtë njësi vendore. Pra, operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia Finiq , nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së , si vende zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende të tjera zhvillimi biznesi , e me tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njërive. Personi i tatuëshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me çertifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT unik”, Mos regjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit Nr. 131/2015” Për qendrën kombëtare të biznesit” si dhe ligjin Nr. 9723 dt.03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.” **Argumenti juaj qëndron.**

#### IV. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjet VAN për nevojat e bashkisë”, rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje automjet VAN për nevojat e bashkisë”, viti 2018</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 17, datë 30.4.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 17, datë 30.4.2018 1. F. P 2. L. M 3. V. T	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 17/1, datë 30.4.2018 1. K. TH 2. M. L 3. V. K
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,500,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “A.....N” me ofertë 2,499,000 lekë me kontratë nr. 2467, dt. 18.9.2018, me afat 10 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1 mijë lekë ose 0.04%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 6.8.2018 (REF-79602-07-17-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. --; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --

#### **-Dokumentet e tenderit:**

Per argumentimin e fondit limit, nuk është mbajtur proces verbal se ku është mbështetur NHDT në përcaktimin e këtij fondi dhe përcaktimin e çmimit të mjetit, pra nuk është bere argumentimi i plote dhe i sakte, duke vepruar ne kundërshtim me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” me ndryshime, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës”, pika 2.

Sipas proces verbalit te klasifikimit te ofertave date 6.8.2018 te mbajtur nga KVO, i pafirmosura prej tij, ka shpallur fitues shoqërisë “A.....N” me ofertë 2,499,000 lekë pa TVSH.

Raporti përmbledhës është mbajtur me datë 28.8.2018, i panëshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH , por vetëm nga ish- titullari AK. Gjithashtu raporti përmbledhës nuk është mbajtur





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

brenda afatit **7 ditor** nga vlerësimi i ofertave, gjë për të cilën nuk ka pasur dhe ankesa, veprime në kundërshtim me nenet 65 dhe 68 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**-Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “A.....N” nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

a- Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave lokale të vetë Bashkisë Finiq, kur kjo shoqëri ka kontratë me Bashkinë Finiq po për blerje mjetesh, sipas pikës 2.2.3 të DST;

b- Sipas DST është kërkuar që mjeti të jetë me transmision manual, por në fakt mjeti është me transmision **automat**.

Ne dosjen e prokurimit mungon Urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mjetit si dhe proces verbali i mbajtur prej tij nëse mjeti përmbush specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu, mungon proces verbali i marrjes në dorëzim të mjetit, veprim, që bie ndesh me nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 4 të VKM të mësipërm dhe Ligjin Nr.10296, date 08.07.2010 Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.30, date 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë të sektorit publik” i ndryshuar, pjesa “Marrja në dorëzim të aktiveve të furnizuara”, pika 42, 43 dhe 52 .

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “A.....N”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kriterëve, kriteret të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën **2,500,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

#### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Juristi i Sektorit të Procedurave në Bashkinë Finiq me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedurë për kriteret, të cilat i janë paraqitur grupit të KLSH me datë 19.04.2020 me elektronik. Sipas kundërshtive të paraqitura ish-juristi kundërshton mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kualifikim të shoqërisë me pretendimin se i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga subjekti është në përputhje me kriteret e DST.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:**

Argumentet e paraqitura nga ish- juristi nuk janë bindës për grupin e KLSH, pasi nga ana e tij janë argumentuar disa prej tyre, konkretisht

kriteret nuk janë mbështetur në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, si dhe shpjegimeve të dhëna nga grupi i KLSH kur janë analizuar mangësitë e kriterëve.

a- Nuk paraqet certifikatën ISO 39001:2012, sipas pikës 1.3/d të DST;

b- Nuk paraqet kontrata për eksperiencë të ngjashme për transportin publik, sipas pikës 1.3 të DST.

Nga ish- juristi nuk është argumentuar dy kriteret e tjera të trajtuara më sipër në material, konkretisht:

Në lidhje me pagesën e taksave vendor, pavarësisht faktit nëse subjekti ka hapur ose jo Nipt sekondar, duhet të paraqesë vërtetim mbi pagesën e taksave kur dihet se ka aktivitet në këtë njësi vendore. Pra, operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

vendndodhje të ndryshme nga selia Finiq , nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së , si vende zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende të tjera zhvillimi biznesi , e me tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njësive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT unik”, Mos regjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit Nr. 131/2015” Për qendrën kombëtare të biznesit” si dhe ligjin Nr. 9723 dt.03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.” **Argumenti juaj qëndron.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 107- 114 të Projektraport Auditimit)*

- **Procedurat periudha 01.01.2019 – 31.12.2019**

**I-Tenderi me objekt: “Blerje shërbimi Dixhitalizimi asetëve pyjeve dhe kullotave, viti 2019, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje shërbimi Dixhitalizimi asetëve pyjeve dhe kullotave, viti 2019</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 6, datë 17.2.2019	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 6, datë 17.2.2019 1. F. P 2. V. J 3. TH. Z	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 6/1, datë 17.2.2019 1. K. TH 2. V. L 3. V. K.
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> shoqëria “E.....A” me ofertë 1,490,000 lekë me kontratë nr. 789, dt. 21.3.2019, me afat 30 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 10 mijë lekë ose 0.67 %
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1,500,000 lekë	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 28.2.2019 (REF-08702-02-17-2019)	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ---, dt. ---
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -----; KPP----- APP-s’ka/ka;		

**-Hartimi i fondit limit:**

Nuk disponohet asnjë dokument se si është llogaritur fondi limit, ku është bazuar bashkia në përcaktimin e këtij fondi, ku të evidentohet llojet e procedurave të njëjta, kapaciteti mbartës i sistemit, sasia e hartave etj, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerësimit te kontratës”, pika 2, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: L. H me funksion ish- Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK dhe anëtarët e NJHDT.**

**- Zhvillimi procedurës.** Nuk është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës dhe vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, por është kaluar direkt në raport përmbledhës datë 12.3.2019, raport i cili nuk është sipas dispozitave ligjore dhe **nuk është nënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH** , por vetëm nga ana e ish- titullarit të AK L. H.

Referuar të dhënave të raportit përmbledhës, në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm subjekti fizik “E.....A” me Nipt L.....M për vlerën e ofertës 1,490,000 lekë.

**-Zbatimi i kontratës:** Referuar të dhënave të zyrës së financës, malli është bërë hyrje sipas faturës nr. 65, datë 21.4.2019 në shumën 1,788,000 lekë me TVSH (Fletë Hyrja nr. 36, datë



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

22.5.2019), pra brenda afatit ligjorë të përcaktuar në kontratë. Por likuidimi nuk është bërë, kjo për mungesë fondesh nga bashkia, për mosrealizim të ardhurash.

Nga subjekti është paraqitur fatura nr. 65 (seri 72341808), datë 21.4.2019 në shumën 1,788,000 lekë me TVSH, brenda afatit të zbatimit të kontratës. Fletë hyrja nr. 36, datë 22.5.2019 është nënshkruar vetëm nga magazinieri dhe nga asnjë person tjetër.

Lëvrimi i mallit nuk është në përputhje me pika 41 deri 45 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pasi nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm, si:

- Nuk ka urdhër të titullarit për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit;
- Malli është bërë hyrje pa komision, gjë e cila ka bërë që të mos identifikohet specifikimet teknike për marrat e bërë hyrje;
- Mungojnë procesverbalet e përdorimit të tij, si dhe urdhrat e kryetarit për daljet nga magazina.
- Sipas deklaramit verbal të Drejtorit të Pyjeve dhe kullotave, deklaroi se nuk është në dijeni të këtij investimi, pasi nga Ministria e Mjedisit ka ardhur programi GIS për pyjet dhe kullotat, gjë e cila tregon mosefektivitetin e fondeve të prokuruar.

Nga sa mësipërm investimi i kryer është i panevojshëm dhe tregon për keqmanaxhim të fondeve, pasi Dixhitalizimi i pyjeve dhe kullotave po realizohet nga vetë Ministria e Mjedisit, veprime të cilat tregojnë mos efektivitetin e fondit të prokuruar për këtë qëllim për vlerën e kontratës prej **1,788,000 lekë me TVSH.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### II. Tenderi me objekt: “Blerje karburanti, viti 2019, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ““ Blerje karburant per nevoja te bashkisë Finiq (2019)” “.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.2, date 31/ 01/ 2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr.2, date 31/ 01/ 2019 F. P L. M M. L	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr.2/1, date 31/ 01/ 2019 K. TH F. TH V. K
2. Lloji i Procedurës – “Procedure e hapur.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh): 14,129,166 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE/BOE “T.....N” me oferte me vlerë marzhë fitimi të ofertuar 16%, me kontratë Nr.665, dt. 13/03/2019, Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për furnizimin e mallit : 31/12/2019	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) marzhë fitimi të ofertuar 16%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 25/02/2019 REF-05904-01-31-2019	9. Burimi Financimit (Nga të ardhurat e Bashkisë.)	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender OE “T.....N” me ofertë me marzhë fitimi 16% b) S’kualifikuar ---- Jo c) Kualifikuar ---- “Toto”
11. Ankimime; Ka ankesë Nuk ka AK- nr. ----- APP-----; KPP-----	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Nuk ka Shkresa nr. ----

-Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk disponohet asnjë dokument mbi mënyrën e llogaritjes së fondit limit prej 14 milionë lekë, si është mundur dalje e këtij fondi, sa është sasia e karburantit që duhet për një vit ushtrimore, sa është sasia e karburantit të harxhuar nga mjetet e bashkisë, veprime këto në kundërshtim me Kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, pika 2 të nenit 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Kryetarin e Bashkisë L. H dhe anëtarët e NJHD.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### **-Zhvillimi procedurës.**

Në këtë procedurë ka marrë pjesët vetëm shoqëria “T.....N” me marxhë fitimi 16%. Raporti përmbledhës, nuk është sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68 “Raporti përmbledhës”, pasi nuk paraqet asnjë detaj sipas përcaktimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria e shpallur fitues në lidhje me shpalljen fitues “T.....N” me marxhë fitimi 16%, **nuk** plotëson të gjitha kriteret e kualifikim, pasi nuk plotëson kriteret:

*a-Ofertuesi pjesëmarrës per piken e karburantit nuk ka paraqitur leje ndertimi/leje legalizimi , certifikatën e pronësisë.*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “T.....N”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën **14,126,166 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- juristi në Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Finiq, me shkresën datë 10.04.2020, paraqitur grupit të KLSH me elektronik me datë 19.04.2020, sqaron se pretendimet në lidhje me mos plotësimin e kriterëve nga subjekti fitues nuk qëndrojnë, pasi nga shoqëria është paraqitur certifikata e pronësisë e cila është marrë si e mirëqenë dhe për lejen.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Argumentet e paraqitura nga subjekti nuk janë bindës për grupin, pasi sipas DST kërkohet leje ndërtimi dhe certifikate pronësisë, dhe se ato janë dy koncepte të ndryshme, pasi është tjetër gjë certifikata pronësi dhe tjetër leje ndërtimi. **Argumenti nuk merrte në konsideratë.**

### **III. Tenderi me objekt: “Blerje mjet gjermimi, viti 2019, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje mjet gjermimi, viti 2019</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 8, datë 25.2.2019	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 8, datë 25.2.2019 1. F. P 2. L. M 3. M. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 8/1, datë 25.2.2019 1. K. TH 2. L. B 3. V. K.
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> shoqëria “V.....A”. me ofertë 1,410,000 lekë me kontratë nr. 786, dt. 21.3.2019, me afat 5 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 6 mijë lekë ose 0.42 %
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1,416,666 lekë	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 8.3.2019 (REF-10526-02-2019)	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -----; KPP----- APP-s’ka/ka;		



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### **-Hartimi i fondit limit:**

Nuk disponohet asnjë dokument se si është llogaritur fondi limit, ku është bazuar bashkia në përcaktimin e këtij fondi, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: L. H me funksion ish- Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK dhe anëtarët e NJHDT.*

### **- Zhvillimi procedurës.**

Me procesverbal datë 4.3.2019 është mundësuar hapja e procedurës, nga ku konstatohet se ka marrë pjesë vetëm shoqëria “V.....A”. me ofertë ekonomike 1,410,100 lekë pa TVSH.

Referuar të dhënave në dosjen e subjektit, por dhe në sistemin SEP, konstatohet se në lidhje me shpalljen fitues të operatorit të vetëm shoqëria “V.....A”. nga auditimi i dokumentacionit teknik e ligjorë, konstatohet se **nuk** plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, fakt të cilin është shprehur dhe në vlerësimin e bërë nga anëtarët e KVO DH. DH, konkretisht:

a- *Nuk plotëson kriterin e specifikimeve teknik, ku kërkohet kilometra jo më shumë 4200 orë/pune, nuk ka fuqi motorike më pak se 60 kuaj fuqi dhe nuk ka akse 4 x 4*

*-Nuk ka paraqitur dëshmi të origjinalitetit të mjetit, përshkrimi dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike.*

*-Nuk ka paraqitur dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mjetit me specifikimet teknike.*

*-Nuk ka paraqitur specifikimet teknike të mjetit, për të verifikuar nëse ato përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.*

*Kritere këto, të kërkuara në piken 2.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

*-Mungojnë mostrat origjinale të pajisjeve që oferton në datën e hapjes së tenderit, kriter i përcaktuar në piken 1.e të kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërinë “V.....A”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka operatorë të tjerë pjesëmarrës, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe verifikuar kriteret e vendosura të cilat kanë çuar në mospjesëmarrje të OE, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar me efekt financiar **1,416,666 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **IV. Tenderi me objekt: “Rehabilitim i rrugëve të Bashkisë Finiq, viti 2019, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rehabilitim i rrugëve të Bashkisë Finiq, viti 2019</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 07, datë 25.2.2019	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 07, datë 25.2.2019 1. F. P 2. L. M 3. V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 7/1, datë 25.2.2019 1. K. TH 2. S. P 3. V. K.
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “A....I” me ofertë 12,218,580 lekë me kontratë nr. 869, dt. 27.3.2019, me afat 120 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1.082 mijë lekë ose 17.4%
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 10,416,666 lekë	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 28.3.2019 (REF-10525-25-2019)	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo
<b>11. Ankimime</b>		





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

AK- nr. ....; KPP-.....  
APP-s'ka/ka;

Shkresa nr. ....

AKKP ; Shkresa nr. ...., dt. ....

### **- Zhvillimi procedurës.**

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nuk është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës dhe vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, por është kaluar direkt në raport përmbledhës datë 10.3.2019, raport i cili nuk është sipas nenet 64, 66 dhe 68 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime dhe nuk është nënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH , por vetëm nga ish- titullari AK L. H.

Në këtë procedura ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht shoqëria “A....I” me ofertë 12,218,580 lekë, i cili është shpallur dhe fitues.

Referuar të dhënave në dosjen e subjektit, por dhe në sistemin SEP, konstatohet se në lidhje me shpalljen fitues të operatorit të vetëm shoqërinë “A...I”, nga auditimi i dokumentacionit teknik e ligjorë, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- *Grafikun e punimeve të firmosur e vulosur nga administratori i ofertuesit ;*

b- *Linja e inerteve nuk është brenda juridiksionit të Bashkisë Finiq, por është në juridiksion të Bashkisë Finiq. Nuk paraqet program vjetor të miratuar, raport vetëmonitorimi mjedisor për vitin 2018, tarifë vjetore tipi (B).*

c- *Linja e betoni nuk është brenda juridiksionit të Bashkisë Finiq, por është në juridiksion të Bashkisë Finiq. Nuk paraqet raport vetëmonitorimi mjedisor për vitin 2018, tarifë vjetore tipi (B).*

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqëria “A...I”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka operator të tjerë në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisuar kriteret e vendosura të cilat kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar me efekt financiar **10,416,666 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 114 - 118 të Projektraport Auditimit)*

**4. Titulli gjetjes:** Nga KLSH, u konstatua se në **14** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 2017 - 2019, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq për vlerën **41,773,524 lekë**.

### **Situata:**

Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga **42** procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate 403,322,100 lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore/nënligjore të LPP në **14** procedura me vlerë kontrate 233,128,100 lekë ose 58% e vlerës së kontratave të audituar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq për vlerën **41,773,524 lekë**, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- Kryetarin e Bashkisë L. H dhe anëtarët e NJHD dhe KVO, sipas praktikave.

### **Kriteri:**

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### Impakti:

Nga vlerësimi jo i drejtë i operatorëve në garë, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Finiq për vlerën **40,709408 lekë**.

### Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të LPP.

### Rëndësia: E lartë

### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kritereve, të konstatuara kjo në 11 procedurat e mëposhtëm, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq me vlerën **41,773,524 lekë pa TVSH**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin në ngarkim të personave përgjegjës të procedurave (në mënyrë të barabartë).

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

*Më poshtë po paraqesim rastet me shkelje të procedurave të periudhës 01.01.2017 - 31.12.2019*

- Procedurat periudha 01.01.2017 - 31.12.2017

### I-Tenderi me objekt: “Rruga Fitore – Aliko”, viti 2017.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rruga Fitore – Aliko”, viti 2017</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 2, datë 09.03.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 2, datë 09.03.2017 L. K S. Ç V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër n. r2/1, datë 06.03.2017 F. TH - kryetar S. P - anëtar I. M - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Tender i Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 59,065,322 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “2...T” me ofertë 57.668.618 lekë me kontratë nr. 2363, dt. 18.8.2017, me afat 120 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1,397 mijë lekë ose 2.3 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 31.3.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE b) Skualifikuar 4 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. po; KPP po APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### -Shqyrtimi procedurës;

Nga ana e KVO nuk është mbajtur proces verbali i hapjes së ofertave dhe proces verbali i shqyrtimit të ofertave, pa përcaktuar datën e hapjes së procedurës dhe klasifikimi i tyre si dhe sa



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

OE kane marre pjese ne tender dhe cilët prej tyre janë s'kualifikuar, por është kaluar direkt në hartim e raportit përmbledhës. Raport nuk është nënshkruar dhe nga ana e Kryetarit të tij F. TH. Sipas raportit përmbledhës në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 OE/BOE. Nga 6 operatorë pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 5 OE/BOE dhe ka kualifikuar si të rregullt shoqërinë "2....T" me ofertë ekonomike 57,668,618 lekë pa TVSH më të lartë se operatorët e tjetër pjesëmarrës.

#### **-Shqyrtimi ankesave:**

Subjektit "M.....S", ka paraqitur ankesë ne Bashki me nr. 1634, datë 01.06.2017 dhe JV "SH.....I & J.....Y" protokolluar ne Bashki me nr. 1648, datë 02.06.2017, ku janë kundërshtuar skualifikimet e padrejta të tyre.

Nga ana e tij, KSHA **nuk ka mbajtur proces verbal te shqyrtimit te ankesave**, nuk ka hartuar vendimin përkatës dhe raportin për titullarin, nga i cili duhej te merrej vendimi për miratimin apo mosmiratimin e tij, veprime ne kundërshtim me kreun X "Shqyrtimi i ankesave", neni 78 "Ankesat ne autoritetin kontraktor", pika 6 te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ndryshime, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KSHA, respektivisht: M. Ç me detyrë ish- Inspektor ITMV, G. M me detyrë ish-specialist në DPZHT dhe DH. B me detyrë specialist në DPZHT**

Për mospranimin e ankesave nga ana e AK, te dy JV "M.....S& B.....S" dhe "SH.....I & J.....Y" kane bere ankimimi ne KPP, i cili, me vendimet përkatëse te depozituara ne dosjen e prokurimit, ka vendosur pezullimin e procedurës se prokurimit dhe shqyrtimin e ankesave, por ne dosje mungon vendimi KPP për pranimin ose jo te ankesave, por është depozituar vetëm vendimi i KPP nr. 497/4/2017 protokolluar ne Bashkinë Finiq me nr. 2362, datë 18.08.2017, ne te cilin është vendosur heqja e pezullimit te procedurës se prokurimit.

Nga ana e KVO është hartuar Raporti përmbledhës për titullarin e AK datë 17.08.2017, pra, para datës se protokollimit te Vendimit KPP ne Bashki (me një ditë avancë), ne te cilin nuk janë vendosur arsyet e s'kualifikimit te OE dhe pasaktësi për OE te kualifikuar.

Nga ana e titullarit te AK është miratuar procedura e prokurimit dhe fituese, subjekti " 2.....T" me vendimin e datës 17.08.2017.

Formulari i njoftimit te kontratës se nënshkruar është botuar ne buletin e APP nr. 1, datë 08.01.2018, pra, **5 muaj me vonese**, duke marre për te dhe datën e sigurimit te kontratës qe mban datën 18.08.2017, veprime ne kundërshtim me kreun VII "Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave", neni 71 "Publikimi i njoftimit te kontratës se nënshkruar" te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ndryshime, **ku përcaktohet afati 5 ditor nga data e lidhjes se kontratës, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: ish- titullari AK L. H**

#### **- Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga dokumentacioni konstatohet se shoqëria "G.....Y" me ofertë 54,072,065 lekë, është skualifikuar për mos paraqitje të vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale ne vende ku shoqëria ka aktivitet (pika 2.1.2 e DST). Për këtë kriter, nisur nga çmimi më i leverdishëm, KVO mund të klasifikonte dhe si devijim i vogël në zbatim të nenit 53, të VKM nr. 914, kjo për të vlerësuar kriterin kryesorë "Çmimi më i leverdishëm".

Megjithatë nga verifikimi në sistem i dokumentacionit për këtë mangësi, konstatohet se kjo mangësi **nuk ekziston**, pasi nga shoqëria "G.....Y" janë paraqitur vërtetimet për pagesën e taksave lokale.

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë "2....T" , **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST dhe se KVO ka skualifikuar padrejtësisht shoqërinë "G.....Y" me ofertë më të leverdishme se shoqëria "2.....T" për vlerën **3,596,552 lekë (57,668,618 lekë shoqëria "2....T" – 54,072,065 lekë shoqëria "G.....Y"**, me pasojë përdorimi të fondit publik me efekt financiar negativ në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Finiq.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Jurist i Sektorit të Procedurave Bashkia Finiq janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me këtë procedura me datë 10.04.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit me datë 19.04.2020 me poste elektronike, në të cilën sqaron se:

Mangësitë e konstatuar nga grupi i KLSH nuk qëndrojnë, pasi në sistem është paraqitur i gjithë dokumentacioni i cili është konstatuar si mangësi.

Ndërsa në lidhje me vërtetimin e taksave vendore të shoqërisë "G...G" shpk, sqaron se nuk është paraqitur.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa argumentoni në kundërshtitë e paraqitura, sqarojë se disa mangës të grupit nuk qëndrojnë dhe pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj dhe në sistem, u konstatua se qëndrojnë dhe nuk ka mangësi.

Në lidhje me mangësitë e konstatuar në shoqërinë "G...G" shpk, ku thuhet se është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit, sqarojmë se argumentet nuk qëndrojnë, pasi:

Nga shoqëria janë paraqitur vërtetimet mbi pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit. Sipas QKB shoqëria ka aktivitet vetëm në Bashkinë e Lushnjës, për të cilën ka paraqitur vërtetimet përkatëse

Skualifikim i shoqërisë "G...G" shpk me ofertë më të leverdishme është në kundërshtim me dispozitat e LPP.

## **II. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice".**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rehabilitim i rrugës Pllake - Kullurice</i> , viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 12, datë 22.05.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 12, datë 22.05.2017 F. P S. P V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 12/1, datë 22.5.2017 L. K - kryetar L. M - anëtar F. TH - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> "Tender i Hapur"		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 111,385,721 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> "2...T" me ofertë 107.174.487 lekë pa TVSH dhe kontratë nr. 2126 Prot., datë 21.07.2017, me afat 120 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 4,211 mijë lekë ose 3.7 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 15.06.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Zhvillimit Urban	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE b) Skualifikuar 4 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. ---; KPP --- APP-s'ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### **Shqyrtimi procedurës:**

Me datë 15.6.2017 është bërë hapja e procedurës, për evidencimin e OE pjesëmarrës, **por që nuk është firmosur nga anëtarët e KVO.** Në këtë procesverbal konstatohet se kanë marrë pjesë 6 OE/BOE. Me datë 27.6.2017 është mbajtur procesverbali i shqyrtimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Konstatohet se në këtë procesverbal janë trajtuar vetëm OE te kualifikuar dhe nuk është bere klasifikimi i OE qe janë skualifikuar, **proçes verbal i cili, nuk është firmosur nga anëtarët e KVO.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Gjithashtu dhe raporti përmbledhës, mbajtur datë 29.11.2017, nuk përshkruan procedurën e plotë të ndjekur, **nuk është firmosur nga K/KVO**, nuk janë vendosur arsyet e s'kualifikimit të OE.

Nga 6 OE/BOE pjesëmarrës, janë skualifikuar 4 prej tyre. Pas njoftimit të bërë nga AK, disa nga OE pjesëmarrës kanë paraqitur ankesa, si vijon:

-Subjekti “C.....L” me shkresën nr. 100, datë 30.6.2017, protokolluar ne Bashki me nr. 1956, datë 31.7.2017. Nga AK me shkresën nr. 1991, datë 5.7.2017, është kthyer përgjigje se ankesa nuk pranohet.

-BOE “K.....N” ka paraqitur ankesë me shkresën nr. 38, datë 28.06.2017, protokolluar ne Bashki me nr.1940, datë 28.06.2017. Nga AK me shkresën nr. 1972, datë 4.7.2017, është kthyer përgjigje se ankesa nuk pranohet.

-BOE “J.....Y & A.....I” ka paraqitur ankesë me shkresën nr. 38, datë 28.6.2017, protokolluar ne Bashki me nr.1976, datë 04.07.2017. Nga AK me shkresën nr. 2005, datë 6.7.2017, është kthyer përgjigje se ankesa nuk pranohet.

Per këto ankesa, nga ana e titullarit të AK nuk ka dale urdhri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe urdhri për caktimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave që do të shqyrtonte çështjen, rrjedhimisht, por nga KSHA **nuk është mbajtur proces verbal i shqyrtimit dhe vendimi përkatës**, si dhe raporti për titullarin, veprime në kundërshtim me Kreun X “Shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK L. H dhe Kryetarin e KVO L. K. me funksion ish- Përgjegjës në Sektorin Juridik.**

#### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se shoqëria “2.....T”, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

**a-** OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Librazhd, ku ka ushtruar aktivitetin për vitin 2016 dhe 2017.

**b-** Operatori duhet të ketë në stafin e tij nga Gushti 2016 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Operator ka kontratë pune me mjekun jo që nga data e kërkuar në DT por shume kohe më vonë, nga data 8.4.2017 me nr. 1626kol/478.2prot, me mjekun M. K, **kriter për të cilën janë skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme.**

**c-** OE ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 cope kamionçine me kapacitet deri 6 ton, kur, në kriteret e kualifikimit kërkohen 3 cope të tilla, **kriter për të cilën janë skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme.**

**d-** Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e energjisë elektrike, siç kërkohet në 2 shkronja (dh) e DST  
**f-** Nuk paraqet listpagesat nga muaj Janar 2016 deri në dhjetor 2016.

**e-** Referuar të dhënave të deklaratës së mjetëve shtojca nr. 9, konstatohet se mjetet e deklaruara janë të angazhuara dhe në kontratën me objekt “Rruga Fitore – Aliko”, ku punimet janë për një afat deri në tre muaj nga data e fillit 22.8.2017, por që sipas aktmëvreshjes afri për zbatim e tij janë shtyrë deri me datë 20.4.2018, ndërkohë që po këto mjete janë deklaruar dhe në këtë kontratë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE të skualifikuar në të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se **JV “K.....N”, është skualifikuar padrejtësisht**, pasi mangësitë e evidentuara **nuk qëndrojnë**, kjo pasi nga njëri prej operatorëve, konkretisht shoqëria “A.....N” është paraqitur mjeku i shoqërisë dhe në kriteret e DST nuk specifikohet se në rast bashkim OE duhet që ky kriter të plotësohet nga të dy. **Sqarojmë se mungesën e mjekut nuk e plotëson dhe OE i shpallur fitues.**

Në lidhje me mangësi se ka detyrime, sqarojmë se shoqëria ka lidhur aktmarrëveshje me Administratën Fiskale sipas ligjit dhe nuk njihet si debitor.





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “2....T” , NUK është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST dhe se KVO ka skualifikuar padrejtësisht JV “K....I+A.....N” me ofertë më të leverdishme se shoqëria “2.....T” për vlerën **34,633,194 lekë** (107,174,487 lekë shoqëria “2....T” – 72,541,293 lekë JV “K....I+A.....N”), me pasojë përdorimi të fondit publik me efekt financiar negativ në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Finiq.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### **Komentet e subjektit:**

Nga ish- Jurist i Sektorit të Procedurave të Prokurimit Bashkia Finiq, me datë 10.04.2020 janë paraqitur kundërshtitë ne lidhje me këtë procedura, të cilat janë bërë prezent grupit të KLSH me datë 19.04.2020 me poste elektronike.

Sipas ish- juristit asnjë nga pretendimet e konstatuara nga grupi i KLSH nuk qëndrojnë, pasi nga shoqëria janë paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Në lidhje kundërshtitë e ish-juristit, sqarojmë se ato nuk janë bindës dhe të shoqëruar me dokumentacion mbështetës. Kështu nuk janë argumentuar një pjesë e mirë e mangësive të konstatuara mësipërm.

Në lidhje me skualifikimin e JV “K.....N”, sqarojmë se mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH qëndrojnë dhe argumentet që paraqet ish- juristi nuk qëndrojnë për mangësitë e konstatuara më sipër gjatë materialit. **Argumenti nuk merret në konsideratë**

### **III. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjet per administratën”.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje automjet per administratën viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 16, datë 23.05.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 16, datë 23.05.2017 F. P L. M M. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 16/1, datë 23.05.2017. L. K - kryetar F. TH - anëtar S. Ç - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2.500.000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “Z.....I” me ofertë 2,440,000 lekë me TVSh dhe 2.928.000 lekë me TVSh, me kontratë 3270, datë 10.11.2017 dhe afat. 10 ditë nga data e lidhjes se kontratës.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 233 mijë lekë ose 3.36 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 07.08.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operoretorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. po ; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

**Zhvillimi i procedurës:** Nga ana e KVO është mbajtur proces verbali i hapjes se ofertave datë 06.06.2017, i pa firmosur nga KVO. Në këtë procedurë kane marre pjese ne tender 4 OE, por ne fakt, tenderi është anuluar dhe është zhvilluar ne datën 07.08.2017, per te cilin nuk është mbajtur proces verbali i hapjes se tenderit dhe proces verbali i shqyrtimit dhe klasifikimit te ofertave si dhe Raporti përmbledhës.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Pas vlerësimit të dokumentacionit, KVO ka skualifikuar e shoqëri pjesëmarrës, duke kualifikuar shoqërinë “Z.....I”.

**Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “Z.....I”, rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- Nuk ka paraqitur dëshmi të originalitetit të mjetit, përshkrimi dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;
- b- Nuk ka paraqitur dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mjetit me specifikimet teknike;
- c- Nuk ka paraqitur specifikimet teknike të mjetit, për të verifikuar nëse ato përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.
- d- Nuk ka dokumentacion nëse janë paraqitur mostrat origjinale të pajisjeve që oferton në datën e hapjes së tenderit, kriter i përcaktuar në pikën 1.e të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Konkluzioni:** KVO ka vepruar me dy standarte në vlerësimin e ofertave, pasi dhe OE “Z.....I” i shpallur fitues nga KVO, nuk plotëson kriteret për kualifikim, duke skualifikuar OE me mangësi të njëjta ose mangësi të cilat mund të klasifikohen si devijime të vogla ose të kërkonte sqarim nga shoqëritë, në referencë të nenit 14 dhe 58, të VKM nr. 914, i ndryshuar.

Në këto kushte procedura duhej të vijonte me OE vjetër të mbetur në garë ose midis operatorëve me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me efekt negativ në vlerën **484,045 lekë pa TVSh**, llogaritur si diferencë nga oferta e kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fituese “Z.....I” minus (-) ofertën me të ulet të “R.....Y”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### IV. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale për ndriçim rrugor”,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “ <i>Blerje materiale për ndriçim rrugor viti 2017</i> ”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 15, datë 22.05.2017	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 15, datë 22.05.2017 F. P L. M F. TH	4. Komisioni i Vlerësimit <b>Ofertave</b> Urdhër nr. 15/1, datë 22.05.2017 L. K - kryetar S. Ç - anëtar M. L - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6.916.667 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “V.....A” me ofertë 6,683,500 lekë pa TVSh dhe 8.020.200 lekë me TVSh, me kontratë 1888 Prot. datë 22.6.2017 dhe afat. 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 233 mijë lekë ose 3.36 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 05.06.2017	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. PO ; KPP --- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -

### Zhvillimi i procedurës:

Nga ana e KVO është mbajtur procesi verbal i hapjes së ofertave datë 07.06.2017, i pafirmosura prej tij, në një kohë që data e tenderit është me 05.06.2017, pra, **2 dite me vonë**.

Nga ana e KVO, procesi verbal i klasifikimit të ofertave mban datën 13.06.2017, pra 8 dite me vonë se data e hapjes së ofertave, në kundërshtim me nenin 39 “kërkesat për propozime”, pika 5



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, *ne te cilën citohet*; “Shqyrtimi dhe klasifikimi i ofertave duhet te behet jo me vone se 5 (pese) dite nga dorëzimi i ofertave”.

Raporti përmbledhës i datës 13.06.2017 **është i pafirmosura nga Kryetari i KVO** dhe jo sipas specifikimeve teknike që kërkohen në nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht shoqëria I.....P me ofertë 5,306,475 lekë dhe shoqëria “V.....A” me ofertë 6,683,500 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit te subjektit fitues “V.....A” , rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- *OE nuk ka paraqitur çertifikatë ISO 14001 dhe ISO 50001 ne emër te tij;*
- b- *OE nuk ka paraqitur dokumentacion se ka ne përbërje te tij një inxhinier elektrik dhe tre specialiste elektrik;*
- c- *Nga ana e KVO nuk është dokumentuar nëse OE ka paraqitur mostrat përkatëse me skedën teknike te tyre per te vërtetuar përputhshmërinë e materialeve objekt prokurimi me specifikimet teknike te kërkuara, mosparaqitja e te cilave ne orën e caktuar te hapjes se tenderit përbën kusht skualifikues nga tenderi.*

Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “I.....P”, nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem SEP, konstatohet se kriteri i mos paraqitjes së detyrimeve për taksat vendore nuk është kërkuar në DST.

Në lidhje me mangësi se nuk ka paraqitur saktë ofertën ekonomike, KVO në zbatim të nenit 14 dhe 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, duhet të kërkonte sqarim në lidhje me ofertën, nisur nga fakti që oferta ekonomike është më e leverdishme.

**Konkluzioni:** KVO ka vepruar me dy standarte ne vlerësimin e ofertave, pasi te dy operatoret ekonomik pjesëmarrës ne gare, “I.....P” me vlere te ofertës 5,306,475 lekë pa TVSh dhe “V.....A” me vlere te ofertës 6,683,500 lekë pa TVSh, kane mangësi ne plotësimin e **“Kritereve te veçanta te kualifikimit”**, per rrjedhoje, tenderi duhej anuluar, ç’ka nuk është bere, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE “V.....A” me vlere me te larte se vlere e OE “I.....P” qe është s’kualifikuar dhe ka vlerën me te ulet, ç’ka ka krijuar paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar prej **1,377,025 lekë pa TVSh**, llogaritur si diference nga oferta e kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fituese minus (-) ofertën me te ulet.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

#### Situata:

Nga të dhënat e sektorit të financës, shoqëria “V.....A” është likuiduar për vlerën 9,213,312 lekë, më shumë se vlere e kontratës për vlerën 1,193,112 lekë. Sipas informacionit të marrë nga L. M. kjo shumë ka lidhje me shtesën e kontratës në masën 20% të kontratës fillestare nr. 2753, datë 27.12.2016 në shumën 4,971,300 lekë.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua procedura e ndjekur në lidhje me këtë shtesë kontrate dhe nuk u paraqit nga subjekti audituar për argumentimin e kësaj shtese kontrate.

Nga ana e ish titullarit të AK L. H **nuk ka dalë urdhër prokurimi, i cili duhet të përmbante objektin e prokurimit, fondin limit, llojin e procedurës dhe arsyet e përdorimit të saj, si dhe emrat e anëtarëve të njesisë së prokurimit.**

*Në dosjen e procedurës së prokurimit, mungon publikimi i kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.*



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

AK është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, siç përcaktohet në nenin 1 të LPP, KU parashikon se, qëllimi është që të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ulë shpenzimet proceduriale, të nxisë pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet OE, si dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kushtet e mësipërme, kur nuk argumentohet dhe dokumentohet shtesës së kontratës, përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është i pambështetur në ligjin e

prokurimit publik, **vlera prej 1,193,112 lekë, është një vlerë e paargumentuar nga AK, si dhe përbën efekt negativ financiar ndaj buxhetit të Bashkisë Finiq dhe Buxhetit të Shtetit, pasi është një shpenzim i paligjshëm, i pa dokumentuar dhe i paargumentuar, referuar procedurës së ndjekur nga AK.**

### Kriteri:

Neni 60, i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; pika 1 e nenit 12 dhe pika 5/a e nenit 33 e LPP.

**Impakti:** Veprime me efekt negativ në fondet e buxhetit për vlerën 1,193,112 lekë.

**Shkaku:** Mangësi e personave përgjegjës në zbatimin e dispozitave të LPP, të cilat ngarkohen me përgjegjësi **ligjore ish- titullari i AK L. H, si dhe ish- Përgjegjësi i Sektorit të procedurave F. P. .**

**Rëndësia:** E lartë

### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara në procedurën me objekt “*Blerje materiale per ndriçim rrugor*”, për shtesën e kontratës me vlerë **1,193,112 lekë**, të bëjë vlerësimin nëse kemi një perdorim me mos efektivitet dhe efencë të këtyre fondeve apo nëse i është shkaktuar dem buxhetit të Bashkisë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit në ngarkim të personave përgjegjës të procedurave (në mënyrë të barabartë).

## V. Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)”,viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 17, datë 24.05.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 17, datë 24.05.2017 L. K L. M S. J	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 33,datë 05.08.2016. F. P - kryetar G. M - anëtar V. L - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6.833.334 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “D.....A” me ofertë 6.699.700 lekë pa TVSh dhe 8.039.640 me TVSh, me kontratë 2014 Prot, datë 07.07.2017 dhe afat. 10 ditë nga data e lidhjes se kontratës.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 134 mijë lekë ose 1.9 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 20.06.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -- ; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### Zhvillimi procedurës:

Nga ana e KVO është mbajtur proces verbali i hapjes se ofertave datë 20.06.2017 i **pafirmosura nga 2 anëtarë të KVO (G. M dhe V. L)**, proces verbali i klasifikimit të ofertave datë 24.06.2017 i pafirmosura nga KVO dhe raporti përmbledhës datë 24.06.2017 i pafirmosura nga Kryetari i KVO, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, kreu V “Zhvillimi i procedurave”, neni 52 dhe 53 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 64, 66 dhe 68, **gjë, që tregon për veprime fiktive të kryera nga ana e KVO.**

Ne tender kanë marrë pjesë 2 OE, “D.....A” i shpallur fitues me vlerë oferte me të lartë për 6,699,700 lekë pa TVSh dhe “K.....I” i **s’kualifikuar vetëm nga anëtarë i KVO F. P , ndërsa nga dy anëtarët e tjerë (G. M dhe V. L) e kanë kualifikuar.**

S’kualifikimi i tij nga F. P është bërë për mosparaqitje të ekstraktit historik, bilancit, vërtetimit bankar mbi gjendjen financiare dhe vërtetim xhiroje, në një kohë që dy anëtarët e tjerë **e kanë kualifikuar për paraqitjen** e gjithë dokumentacionit që kërkohet në kërkesat për kualifikim.

Nga verifikimi në sistem i mangësive të shoqërisë “K.....I”, u konstatua se nuk qëndrojnë dhe është skualifikuar padrejtësisht.

**Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues, “D.....A” , rezultuan mangësitë e mëposhtme:

a- *Për kriterin e OE të kete magazine dhe sillos me kapacitet deri në 2000 ton të shoqëruar me leje ndertimi, ky OE ka paraqitur një leje ndertimi të vitit 2006, një akt marrëveshje të datës 02.07.2014 me shoqërinë “E.....T” për ndërtimin e një sillosi metalik me kapacitet 750 ton çimento rifuxho, një akt marrëveshje po njësoj me shoqërinë “M.....O”, një fature tatimore shitje me shitës “K.....A” dhe blerës “M.....O” për monton sillosi çimento me kapacitet 750 ton, një fature shitje të shoqërisë “M.....I” me blerës “M.....O” Vlore për blerje peshore elektronike. Pra, ky dokumentacion nuk vërteton nëse OE ka në pronësi magazine çimento dhe sillose si dhe dokumentacioni i paraqitur është për sillose me kapacitet 750 ton dhe jo për 2000 ton;*

b- *Nga ana e OE fitues, nuk është paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar – Dhjetor 2015 është i përfshirë edhe një saldator, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit;*

c- *Nuk është paraqitur dokumentacion se ka të punësuar 7 punonjës që nga fillimi i vitit 2017;*

d- *Nuk ka paraqitur dokumentacion se ka në pronësi një cope autoprese betoni;*

e- *Nuk ka paraqitur dokumentacion se ka zbatuar kontratë të ngjashme me vlerë deri 40 % të vlerës së kontratës së prokuruar;*

f- *Nuk ka paraqitur ekstraktin e regjistrit tregtar për të vërtetuar nëse është me status aktiv;*

g- *Nuk është mbajtur dokumentacion ( proces verbal ) nëse në ditën e hapjes së tenderit janë paraqitur mostrat origjinale të materialeve që oferton, kriter i përcaktuar në piken 2.1.e të kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

**Konkluzioni:** KVO ka vepruar me dy standarte në vlerësimin e ofertave, pasi të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në gare, “D.....A” me vlerë të ofertës **6,699,700 lekë pa TVSh**, duke skualifikuar padrejtësisht shoqërinë “K.....I” me vlerë të ofertës **6,082,970 lekë pa TVSh**, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar prej **616,730 pa TVSh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

## VI. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Mesopotam, Kostar, Lefter Talo, manastir i Seronese”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rikonstruksion i rrugëve Mesopotam, Kostar, Lefter Talo, manastir i Seronese”,viti 2017		
1. Urdhër Prokurimi nr. 20, datë 07.06.2017.	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 20, datë 07.06.2017. L. K G. M V. L	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 20/1,datë 07.06.2017.. F. P - kryetar G. M - anëtar I. M - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1.666.667 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S.....L” me ofertë 1.261.063 lekë pa TVSh dhe 1,261,063 me TVSh, me kontratë 2379 Prot, datë 21.8.2017 dhe afat. 20 ditë nga data e lidhjes se kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 405 mijë lekë ose 24 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 07.08.2017	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -- ; KPP --- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### Komentet e subjektit:

Nga subjekti “S.....A” me postë elektronike janë përcjellë kundërshtitë me shkresën nr. 4, datë 11.03.2020, në lidhje me shtesën e kontratës së punimeve me vlerë **302,500 lekë, ku kundërshton se:**

Nuk është dakord me gjetjet e grupit të auditimit të KLSH, pasi në Bashkinë Finiq është dorëzuar i gjithë dokumentacioni me shkresën nr. 2671, datë 21.9.2019, mbi argumentimin e punimeve shtesë në masën 20% të vlerës së kontratës.

### Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa sqaroni në kundërtitë tuaja në lidhje me punimet shtesë, grupi i KLSH arrin në konkluzionin se janë bindës dhe shoqëruar me dokumentacioni, dokumentacion i cili gjatë fazës së auditimit nuk iu paraqit grupit të auditimit. Pra kemi të bëjmë me shtesë kontrate në masën 20% të kontratës fillestare. **Argumenti juaj merret në konsideratë.**

## VII. Procedura e prokurimit publik me objekt “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU - 4, kanali K-K-2 Aliko”, rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko viti 2017		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1/1, datë 16.10.2017	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 1/1, datë 16.10.2017 F. P S. Ç D. A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1/1/1, datë 16.10.2017 L. K - kryetar V. J - anëtar L. M – anëtar
2. Lloji i Procedurës “Hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8.698.702 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “K.....I” me ofertë 7.489.046 lekë pa TVSH dhe kontratë 3337 prot., datë 16.11.2017, me afat 20 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1.209 mijë lekë ose 13.8 %
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit	10. Operatoret Ekonomike



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Datë 02.11.2017	VKM Nr.525, datë 27.09.2017 “Per shpërndarjen dhe detajimi e fondit te investimeve, per funksionimin e ujitjes dhe te kullimit per Bashkitë”	a)Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 4 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO ; KPP --- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

### -Shqyrtimi i dokumentacionit:

Ne proces verbalin e vlerësimit te ofertave dhe ne Raportin përmbledhës, datë 02.11.2017, konstatohet se ne tender kane marre pjese 5 OE, prej te cilëve është s’kualifikuar subjekti “F.....D” i cili ka dhe vlerën me te ulet te ofertës prej **7,168,100 lekë pa TVSh**, por që nuk është shprehur se çfarë kriteresh nuk ka plotësuar, ne kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, Kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i proçedurave”, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 1 dhe 5 si dhe nenin 68 “Raporti përmbledhës”.

Sipas dokumentit te vlerësimit ne sistem te printuar, rezultojnë mangësi ne dokumentacionin e paraqitur nga OE “F.....D”, vlerësimi ky i bërë nga L. K , L. M (anëtar te KVO te miratuar me urdhër te titullarit) dhe **V. L** , i cili nuk është miratuar si anëtar KVO me urdhër të titullarit të AK, pasi vlerësimi duhej bërë nga V. J i miratuar nga titullari ne KVO e këtij objekti.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te subjektit fitues “K.....I” , rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- a- OE nuk ka përcaktuar me ane e një deklarate me shkrim drejtuesin teknik te punimeve;
- b- Në lejen e manovrimit te vlefshme per mjete e renda nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë se saj;
- c- OE nuk ka paraqitur Leje mjedisore te tipit III.I.B per aktivitetin “Impiant prodhim inerte”, por ka paraqitur leje mjedisore te tipit (B) per aktivitetin “Nxjerrje e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim ne qiell te hapur dhe nga guroret”;

**Konkluzioni:** KVO ka vepruar me dy standarte ne vlerësimin e ofertave, pasi operatori ekonomik “F.....D” me ofertë 7,168,100 lekë pa TVSh, është s’kualifikuar per mangësi ne plotësimin e “Kritereve te veçanta te kualifikimit”, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE “K.....I” me mangësi në plotësimin e kritereve. Në këto kushte KVO ose duhet të vijonte me OE e tjerë në garë ose midis OE me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm” për të shmangur paligjshmërinë përdorimit të fondeve publik me efekt financiar në vlerën **320,946 lekë pa TVSh**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### VIII. Procedura e prokurimit me objekt “Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/1”, viti 2017

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/1”, viti 2017		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 1, datë 01.03.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 1, datë 01.03.2017 I. E S. Ç D. A	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 1/1, datë 01.03.2017 M. L - kryetar F. TH - anëtar I. M - anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 12.157.222 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> JV “SH.....I & J.....Y” me ofertë 9.139.613 lekë pa TVSH dhe kontratë nr. 1858 Prot., datë 20.6.2017,	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 3.018 mijë lekë ose 24.8 %



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

	me afat 120 ditë kalendarike.	
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 27.03.2017	<b>9. Burimi Financimit</b> VKM nr.926,datë 21.12.2016 nga buxheti i shtetit + ardhura bashkia (TVSH)	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. PO ; KPP --- APP-s'ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP</b> apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Proçes verbali i zhvillimit të procedurës së tenderit datë 27.03.2017, nuk është firmosur nga anëtarët e KVO. Sipas këtij procesverbali në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 2 EO.

Nga shoqëria "B.....3" është bere ankese sipas formularit nr. 2012.Prot. datë **25.04.2017**, ku kërkon rishqyrtimin e dokumentacionit se në Vërtetimin e likuidimit të taksave vendore është bere lapsus nga bashkia qe e ka lëshuar, pasi bashkangjitur paraqitet vërtetimin e sakte dhe M.A e likuidimit.

Nga ana e KVO është bere kërkesës tek titullari për shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertave datë 10.04.2017 për të pritur sqarimet e OE, kërkesë e miratuar nga titullari me Vendimin nr.1/2 datë 10.04.2017, në të cilin nuk është vendosur afati i vlerësimit.

Nga të dhënat, konstatohet se kërkesa drejtuar titullarit dhe miratimi i saj është bere me përpara se të depozitohet formulari i ankesës nga OE "B.....3", **e cila tregon për veprime fiktive të kryera nga ana e KVO.**

Me shkresën nr.1267/1, datë 27.04.2017 të Bashkisë, i kërkohet OE të paraqesë dokumentin origjinal të pagesës së taksave, shkresë kjo, e pafirmosura nga KVO, për të cilën është kthyer përgjigje nga OE se dokumenti i paraqitur është i sakte, në rast të kundërt do të drejtohet APP.

Për shqyrtimin e ankesës, nga ana e titullarit të AK **nuk ka dale urdhri për pezullimin** e procedurës së prokurimit, caktimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave që do të shqyrtoje çështjen, i cili do të hartonte proces verbalin e shqyrtimit dhe vendimi përkatës dhe do të njoftonte titullarin për miratimin e vendimit në kundërshtim me kreun X "Shqyrtimi i ankesave", neni 78 "Ankesat në autoritetin kontraktor" të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime, si dhe nuk i është kthyer përgjigje OE "B.....3" se çfarë është vendosur.

Sipas raportit përmbledhës të datës 18.05.2017, ky OE është s'kualifikuar, **por nuk është firmosur nga 2 anëtar të KVO (F. TH dhe I. M).**

### Shqyrtimi i dokumentacionit:

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "B.....3", rezultoi se dokumentacioni i paraqitur prej tij është i rregullt dhe plotëson kriteret e vendosura. Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore të kërkuara nga KVO janë të sakta, pasi nga shoqëria është paraqitur vërtetimi.

Sqarojmë se në kriteret e DST, nuk është përcaktuar se për cilin vit duhet të paraqiteshin pagesat e taksave vendore dhe duke qenë se procedura zhvillohej në mars 2017 dhe afatet e pagesave të taksave vendore 2017 janë deri në fund muajt prill 2017 dhe qershor 2017, sipas vendimeve respektive të KB ku shoqëritë ushtrojnë aktivitetet, është normale që shoqëritë duhet të paraqitshin detyrimin mbi pagesën e taksave vendore deri në fund të vitit 2017.

Në këto kushte OE është s'kualifikuar pa të drejte, megjithëse kishte edhe ofertën me të ulet në vlerën **8,885,555 lekë pa TVSh** me një diferencë nga OE fitues prej **254,058 lekë pa TVSh**, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me dëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues, JV “SH.....I & J.....Y”, rezultuan mangësitë e mëposhtme:

a- Vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të OSHE për të dy subjektet e BO, “J.....Y” dhe “SH.....I” mbajnë datat përkatëse 27.02.2017 dhe 16.02.2017, pra pagesën e kryer deri për muajin janar, në një kohë që duhej të paraqitej pagesa deri për muajin Shkurt 2017, nisur nga fakti që procedura zhvillohej me datë 27.3.2017, mangësi të cilën në procedura të tjera është përdorur si element skualifikues.

b- Për punimet e ngjashme nga subjekti “J.....Y” është paraqitur dokumentacioni për objektin “Pastrim i kanaleve të peshkut”, situacioni i të cilit është në vlerën 3,667,700 lekë me TVSh nuk i përmban të gjitha zërat e preventivit fitues (vetëm dy zëra) si dhe për objektet “Rikonstruksion rruge Delvine – Rusan” për vlerën 3,045,444 lekë me TVSh dhe “Ndertim KUZ fshati Velmish” për vlerën 6,421,743 lekë.

c- Nga ana e BO nuk është paraqitur dokumentacion për Inxhinierin hidroteknik, si kusht për efekt të kryerjes së punimeve, si kontrate pune të vlefshme të lidhur para noterit, CV dhe Diplome.

d- Listëpagesat e periudhës Janar 2015 – Dhjetor 2016 të paraqitura nga subjekti “SH.....I”, nuk janë të konfirmuara nga Administrata Tatimore me nënshkrim dhe vule, me përjashtim të muajve Janar – Shkurt 2015.

e- Subjekti “SH.....I” nuk ka paraqitur çertifikatat e cilësisë së punimeve, për të cilat, sipas kriterëve të kualifikimit, në rastin e BO, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e cilësisë.

f- Nga ana e BO nuk është paraqitur deklaratë nga Administratori me anën e të cilës autorizon AK për verifikimin nëse drejtuesi teknik që do të ndjeke punimet është i punësuar ose jo në një subjekt shtetëror apo privat në rolin e drejtuesit teknik, i cili sipas kriterëve të kualifikimit nuk duhet të jete i punësuar në asnjë prej subjekteve të sipërpërmendura.

g- Nga BO, nuk është paraqitur dokumentacion për mjetin furgon për transportin e punëtoreve, për mjetin kamion me vinç dhe për 200 m<sup>2</sup> skele.

h- Nga ana e BO nuk është paraqitur dokumentacion se ka të punësuar 2 automekanik dhe 1 karpentier të çertifikuar nga IQT apo institucion tjetër ekuivalent.

**Konkluzioni:** KVO ka vepruar me dy standarte në vlerësimin e ofertave, pasi JV “SH.....I & J.....Y” i kualifikuar ka mangësi në plotësimin e kriterëve, duke skualifikuar OE pa mangësi në plotësimin e kriterit dhe me oferta me të leverdishme se shoqëria e shpallur fitues, si shoqëria “B.....3” me vlerë të ofertës 8,885,555 lekë pa TVSh, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt negativ në vlerën **254,058 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen problemet janë 119- 134 të Projektraport Auditimit)*

- Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018

### I. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Autobuzi për transport udhëtarësh, viti 2018, rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje Autobuzi për transport udhëtarësh, viti 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 16, datë 30.4.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 16, datë 30.4.2018	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”	1. F. P 2. L. M	Urdhër nr. 16/1, datë 30.4.2018 1. K. TH



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

	3. V. T	2. M. L 3. V. K
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,166,666 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “K.....A” me ofertë 4,096,666 lekë me kontratë nr. 2050, dt. 2.8.2018, me afat 10 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 70 mijë lekë ose 1.68%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 13.4.2018 (REF-66333-04-30-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. --; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -

Sipas procesverbali datë 5.6.2018 të vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, konstatohet se janë skualifikuar 3 OE, duke kualifikuar si të rregullt shoqërinë “K.....A” me ofertë 4,096,666 lekë.

Referuar të dhënave të raportit përmbledhës datë 28.5.2018, konstatohet se nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe i panënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH dhe as nga ish- titullari AK L. H. Gjithashtu raporti përmbledhës nuk është mbajtur brenda afatit **7 ditor** nga vlerësimi i ofertave.

Nga të dhënat shihet se kemi mos përputhje datash, raporti përmbledhës është mbajtur 6 ditë më përpara se të mbahej procesverbali i verifikimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët KVO.**

### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “K.....A” e shpallur fitues, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

**a- Certifikata ISO 9001-2015 të paraqitura nuk kanë objektin e prokurimit, siç kërkohet në pikën 1/c të DST dhe se data e lëshimit të certifikatës (3.5.2018) është më vonë se koha e zhvillimit të procedurës (datë 13.4.2018);**

**b- Gjithashtu dhe certifikata ISO 39901-2012, data e lëshimit (3.5.2018) është më vonë se data e zhvillimit të procedurës (13.4.2018). c- Nuk paraqet vërtetim nga Bashkia Finiq siç kërkohet në DST pika 2.2, paragrafi parafundit.**

**d- Shoqëria nuk plotëson pikën që OE duhet të ketë eksperiencën të mëparshme në monitorimin në kohë reale të transportit publik dhe duhet të ofroje platformën përkatëse për këtë monitorim. Kjo të provohet me fature dhe kontrate, kriter për të cilën është skualifikuar dhe OE “R.....Y” me ofertë më të leverdishme.**

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “K.....A”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur nuk ka OE të tjerë në garë, KVO duhet të anulonte procedurën ose midis OE me mangësi, ku në rastin konkret shoqëria “R.....Y” është skualifikuar se nuk plotëson kriterin e fuqisë punëtore, kriter ky i panevojshëm dhe se nuk paraqet eksperiencën të mëparshme, mangësi të cilën e ka dhe OE i kualifikuar. Pra kemi trajtim me dy standarte, veprime në paligjshmërinë e përdorimit të fondit me efekt negativ në vlerën **796,666 lekë** (4,096,666 lekë – 3,300,000 lekë). **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### II. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjet PIC AP, copë 4, viti 2018”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje automjet PIC AP, copë 4, viti 2018”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 28.2.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 1, datë 28.2.2018 F. P F. TH S. Ç	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1/1, datë 28.2.2018 M. L - kryetar K. TH - anëtar L. M- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A.....Y” me ofertë 4,958,333 lekë pa TVSH dhe kontratë 985 prot., datë 11.4.2018, me afat 30 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 42 mijë lekë ose 0.84 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.3.2018 REF-52975-02-28-2018	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. PO ; KPP --- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

- a- Shoqëria “A.....Y”; me ofertë 4,958,333 lekë;
- b- Shoqëria “A.....P” me ofertë 4,600,000 lekë.

Sipas këtij procesverbali datë 19.3.2018 është bërë vlerësimi i dokumentacionit teknik e ligjorë, ku është skualifikuar shoqëria “A.....P” me ofertë 4,600,000 lekë. Me datë 27.3.2018 është mbajtur raporti përmbledhës, raport i cili nuk është sipas dispozitave ligjore të LPP, **nuk është nënshkruar nga ana e kryetarit të KVO z. M. L .**

#### **Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit fitues “A.....Y”, rezultuan mangësitë se *nuk ka paraqitur vërtetim të shlyerjes së taksave vendore për vitin 2016.*

Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “A.....P” me ofertë 4,600,000 lekë, me ofertë më të leverdishme se OE i shpallur fitues, nga verifikimi në sistemin SEP, konstatohet se plotëson kriteret për të cilat është skualifikuar, konkretisht:

- a- *Nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetim disbrutor “T.....E”, ndërkohë që subjekti ka paraqitur këtë vërtetim;*
- b- *Nga shoqëria nuk është plotësuar kushti i punimeve të ngjashme, por që nga verifikimi në sistemin SEP, shoqëria ka paraqitur faturë shitje në vlerën 17200 euro x 122 = 2,098,400 lekë, është më e madhe se 40 % e vlerës së fondit limit (5,000,000 \* 0.4 = 2,000,000 lekë, pra më shumë prej 98,400 lekë.*
- c- *Pretendohet se nuk është paraqitur katalogu sipas pikës 1.3 të DST, sqarojmë se nga OE është paraqitur katalogu.*

**Në këto kushte skualifikimi i shoqërisë “A.....P” është i padrejtë.**

**Konkluzioni:** Referuar të dhënave të procesit të auditimit, evidentohet se OE “A.....P” është skualifikuar padrejtësisht, veprim i cili ka ndikuar në keq menaxhimin e fondeve të prokuruar me efekt negativ në vlerën **358,333 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

#### **Komentet e subjektit:**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga ish- Specialisti i Transporteve ing. M. L sipas shkresës datë 05.04.2020, janë paraqitur në mënyrë elektronike (datë 14.04.2020), kundërshtitë në lidhje me prezencën e tij si Kryetar KVO në procedurat me shkelje të konstatuara nga grupi i KLSH për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

Sipas kësaj shkrese, ish- punonjësi deklaroi se vetëm në procedurën “Blerje 4 automjete PC AP” ka marrë pjesë si Kryetar/ anëtarë KVO, pasi rastet e tjera ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni të faktit se është pjesë e KVO.

Në lidhje me mangësitë e procedurës ku ka qenë kryetar KVO, sqaron se mangësitë e konstatuar nuk qëndrojnë, por pa argumentuar me dokumentacion ligjorë thënie të tij.

### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa argumenton ing. M. L, merret në konsideratë fakti që në pjesën më të madhe të procedura nuk ka qenë në dijeni të faktit, pro dhe kjo pjesërisht, pasi nga ana e tij nuk është argumentuar fakti i cekimit të sistemit, kur dihet se kodet janë personale.

Ndërsa në lidhje me procedurën “Blerje 4 automjete PC AP”, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi nga punonjësit nuk është kundërshtuar fakti se shoqëria fituese “A.....Y”, nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave lokale. Ndërsa në lidhje me skualifikim e padrejtë të shoqërisë “A.....P”, sqarojmë se nga sistem SEP, shoqëria ka paraqitur dokumentacionin për të cilën pretendohet se nuk është.

**Argumentet nuk qëndrojnë.**

### **III. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjete zjarrfikëse për nevojat e SHMZSH (copë 2).**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje automjete zjarrfikëse për nevojat e SHMZSH (copë 2), viti 2018</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 19, datë 7.6.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 19, datë 7.6.2018 1. F. P 2. V. L 3. V. T	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 19/1, datë 7.6.2018 1. L. B 2. K. TH 3. V. K
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,000,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “E.....Y me ofertë 4,980,000 lekë me kontratë nr. 2050, dt. 2.8.2018, me afat 10 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 20 mijë lekë ose 0.4%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 16.7.2018 (REF-75936-06-21-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 3 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. --; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -

Sipas procesverbali datë 17.7.2018 të vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, konstatohet se janë skualifikuar 3 OE, duke kualifikuar si të rregullt shoqërinë “E.....Y me ofertë 4,980,000 lekë.

Referuar të dhënave të raportit përmbledhës datë 16.7.2018, konstatohet se nuk është nënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO z. L. B, por vetëm nga ish- titullari AK.

### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “E.....Y e shpallur fitues, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

a- Referuar të dhënave të QKB, subjekti nuk ka në objektin e tij të shënuar objektin për të cilën zhvillohet procedura e prokurimit, pra nuk ka si objekt shitje mjeteve motorike.

b- Faturat që subjekti paraqet nuk janë furnizime të ngjashme, pasi në faturat që subjekti paraqet si artikull shitje janë kamion dhe mjete zjarrfikëse të cilat kanë specifikimet të veçanta të tyre.

c- Në dosje dhe sistem nuk ka asnjë procesverbal që tregon se mjete është paraqitur ditën e zhvillimit të procedurës, megjithëse një kriter i tillë nuk ekziston në DST dhe nga KVO është përdorur si kriter skualifikues për OE e tjerë por me oferta më të leverdishme.

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me skualifikimin e 3 OE, konstatohet se kriteri për të cilën janë skualifikuar është një kriter i cili nuk është në DST.

Kështu sipas të dhënave të sistemit, pasi në procesverbal nuk janë deklaruar arsyet e skualifikimit, rezulton se të 3 OE janë skualifikuar pasi në datën e zhvillimit të procedurës mjetet duhet të paraqiteshin, por që në fakt një kriter i tillë nuk ekziston.

Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “S.....2”, ku sipas KVO përveçse nuk ka paraqitur mjetet në ditën e zhvillimit të procedurës, nuk ka paraqitur dhe vërtetimin e O....E, mangësi e cila nuk qëndron, pasi nga verifikimi shoqëria e ka paraqitur vërtetimin e O....E.

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “E.....Y , **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Ndërsa në lidhje me skualifikimin e OE të tjerë, KVO nuk ka vlerësuar drejt kriteret e DST dhe se kriteri për të cilën janë skualifikuar nuk është në kriteret e DST dhe se OE fitues nuk e plotëson këtë kriter,. Pra kemi trajtim me dy standarte, veprime në paligjshmërinë e përdorimit të fondit me efekt negativ në vlerën **280,000 lekë** (4,980,000 lekë shoqërisë “E.....Y – 4,700,000 lekë shoqëria “R.....I”).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

### IV. Procedura e prokurimit me objekt “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <u>Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues, viti 2018</u>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 14, datë 20.4.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 14, datë 20.4.2018 1. F. P 2. L. M 3. D. A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 14/1, datë 20.4.2018 1. K. TH 2. S. Ç 3. V. K
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,762,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “K.....I” me ofertë 3,894,401 lekë me kontratë nr. 1759, dt. 7.6.2018, me afat 25 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 868 mijë lekë ose 18.1%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.5.2018 (REF-6594-04-29-2018)	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 5 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --; KPP----- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Me datë 14.5.2018 është bërë hapja e procedurës, ku shprehet se njësia e prokurimit ne datën 14.5.2018, ora 12:00 beri mbylljen e sistemit dhe KVO filloi procedurën e hapjes se ofertave, ne një kohe qe ne DST. **Konstatohet se procesverbali i hapjes së procedurës është i panënshkruar nga anëtarët e tij**

Sipas procesverbali datë 7.6.2018 të vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, konstatohet se nga 6 OE janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 5 OE.

Procesverbali nuk është sipas përcaktimeve ligjore, pasi nuk shpjegon arsyen e skualifikimit të OE, nuk janë kryer kontrolli i veprimeve aritmetike dhe **mbi të gjitha është i pananshkaur nga anëtarët e KVO.**

Raportit përmbledhës datë 18.6.2018, nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar dhe i panënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH , por vetëm nga ish- titullari AK L. H.

**-Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “K.....I” e shpallur fitues, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

*a- Certifikata ISO 9001-2008 dhe ISO 14001-2004 e paraqitura nuk është sipas certifikatë së kërkuar, pasi shoqëria ka paraqitur certifikatë ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015 dhe jo sipas kërkesave të DST.*

*b- Nga subjekti nuk është paraqitur vërtetimi mbi pagesën e taksave vendore të vitit 2017, siç kërkohet në pikën 2.1 të DST,*

*c- Mjekun që paraqet shoqëria (K.....I), nuk paraqitet licenca e shoqërisë, siç kërkohet në DST<sup>9</sup>;*

*d- Nga shoqëria nuk është plotësuar kriteri që në stafin e saj duhet 15 punonjës të pajisur me kartela të sigurimit teknik të lëshuara nga organet kompetente, sipas ligjit nr. 8734, datë 01.2.2001 dhe ligjit nr. 13/2013, datë 14.2.2013, ku të bëjnë pjesë: elektrikist, hidraulik, Mekanik dhe saldator< konkretisht*

*Nga verifikim i dokumentacionit, konstatohet se shoqëria ka paraqitur 16 punonjës me IST, por vetëm 4 (katër) prej tyre plotësojnë kushtin e DST, pasi janë të profilit hidraulik dhe elektrikist, konkretisht: TH. M, V. P, E. A me profil hidraulik dhe M. A me profil elektrikist. Ndërsa pjesa tjetër janë murator, bojaxhi që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit (4 veta), murator dhe ndërtues. Nuk janë paraqitur me aktivitet mekanik dhe saldator.*

*e- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk ka arritur te dëshmojë plotësimin e pikës 2.1/b te kriterëve te Veçanta per Kualifikim.*

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “K.....I”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur JV “A.....I + K.....A”, mangësitë për të cilat është skualifikuar plotësohen nga operatori tjetër, KVO ose duhet të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi anomalish i ulët”, pasi shoqëria “K.....I” nuk është në kushtet e plotësimit të kërkesave të DST, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit me efekt negativ në vlerën **375,643 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

<sup>9</sup> **ku thuhet se:** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) mjek ndërmarrjeje, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e një Liçensë, Kontratës së Punës së doktorit.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### V. Procedura e prokurimit me objekt “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çausb dhe Tremul, viti 2018.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çausb dhe Tremul, viti 2018</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 10, datë 29.3.2018	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 10, datë 29.3.2018 1. F. P 2. F. TH 3. V. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 10/1, datë 29.3.2018 1. L. K 2. K. TH 3. V. K
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 10,000,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “SH.....I” me ofertë 7,538,901 lekë me kontratë nr. 2050, dt. 2.8.2018, me afat 60 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 2,462 mijë lekë ose 24.6%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 7.6.2018 (REF-66219-04-30-2018)	<b>9. Burimi Financimit</b> Grand pakushtëzuar	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE b) Skualifikuar 4 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. --; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Me procesverbal datë 7.6.2018 të vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, konstatohet se nga 7 OE janë skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 3 OE.

Në OE të kualifikuar, nga KVO është vlerësuar si fitues shoqëria “SH.....I” me ofertë ekonomike 7,538,901 lekë pa TVSH më të favorshme se shoqëria “M.....S”.

Raportit përmbledhës datë 16.7.2018, nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe i panënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO L. K. , por vetëm nga ish- titullari AK L. H.

#### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “SH.....I” e shpallur fitues, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

**a- Certifikata ISO 20001-2012 e paraqitura nuk është sipas certifikatë së kërkuar, pasi shoqëria ka paraqitur certifikatë ISO 50001-2011, pra në një vit të mëvonshëm**

**b-Nuk paraqet vërtetim nga Bashkia Finiq për vitin 2017, megjithëse shoqëria ka pasuar punimeve në këtë njësi vendore, konkretisht “Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg - Aliko, kanali K-2 dhe K-K-2/1”**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SEP, konstatohet se shoqëria “N.....6” me ofertë ekonomike 6,880,598 lekë është skualifikuar padrejtësisht, pasi subjekti paraqet punimeve të ngjashme, konkretisht kontratat me objekt: “Rikonstruksion Rruga Llakatund” Bashkia Vlorë nr. 9777, datë 18.11.2016 me vlere të kontratës 10,505,928 leke. Sipas KVO thuhet se nuk është përcaktuar përqindja e ndarjes, pasi ky kontratë është me dy subjekte shoqërinë “N.....6” dhe “K.....N”. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistem, konstatohet se sipas formularit të vlerësimit shtojca nr. 7, vlere e situacionit prej 10,505,928 lekë me TVSH ndahet 60% të punimeve të kryhen nga shoqëria “N.....6” ose në vlerën 6,303,556 lekë dhe 40% e punimeve do kryen nga shoqëria “Kaliger Konstruksion” ose në vlerën 4,202,371 lekë.

Referuar DST, kërkohet që punimet e ngjashme të jenë në masën 40% të vlerës së fondit limit 12,000,000 lekë ose 4,800,000 lekë , pra më shumë për vlerën 1,503,556 lekë

**Konkluzioni:** Kualifikimi i shoqërisë “SH.....I” SHPK, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Gjithashtu konstatohet se skualifikimi i shoqërisë “N.....6” është i padrejtë, pasi OE plotëson kriteret e





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

DST. Pra kemi trajtim me dy standarte, veprime në paligjshmërinë e përdorimit të fondit me efekt negativ në vlerën **658,303 lekë** – 6,880,598 lekë shoqëria “R.....I”).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Ish- titullarin e AK L. H dhe anëtarët e KVO.**

- Për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019

### I-Tenderi me objekt: “Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje vajra, goma, bateri, viti 2019		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 12, datë 14.4.2019	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 12, datë 14.4.2019 1. F. P 2. L. M 3. V. T	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 12/1, datë 14.4.2019 1. K. TH 2. L. B 3. V. K.
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “Kërkesë me propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,583,330 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> JV “G.....Y + K.....I” me ofertë 2,568,870 lekë me kontratë nr. 1458, dt. 21.5.2019, me afat 60 ditë kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 15 mijë lekë ose 0.58%
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 25.4.2019 (REF-17943-04-14-2019)	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Finiq	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -----; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> ; Shkresa nr. ----, dt. ----

#### - Zhvillimi procedurës.

Me procesverbal datë 23.4.2019 është mundësuar hapja e procedurës. Sipas këtij procesverbali, konstatohet se në këtë procedura kanë marrë pjesë 2 OE si vijon:

Me procesverbal datë 2.5.2019, **i panëshkruar nga anëtarët e KVO**, është bërë klasifikimi përfundimtar i operatorëve pjesëmarrës, ku konstatuan se nga 2 OE pjesëmarrës është skualifikuar shoqëria “S.....Y” me ofertë 2,568,870 lekë për mos plotësim kriteresh paraqitur në pasqyrën sipër.

Konstatohet se ky procesverbal është mbajtur **9 ditë** më përpara se të hartohej raporti përfundimtar (raporti datë 23.4.2019), veprime në kundërshtim me nenin 66-*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Me shkresën datë 23.4.2019, është hartuar raporti përmbledhës dhe dërguar për miratim Titullarit të AK. Raporti përmbledhës nuk është nënshkruar nga ana e Kryetarit të KVO K. TH , por vetëm nga ish- titullari AK L. H.

#### -Shqyrtimi i dokumentacionit:

Referuar të dhënave në dosjen e subjektit, por dhe në sistemin SEP, konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues JV “G.....Y + K.....I”, nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- *Asnjë nga bashkimi i operatorëve nuk paraqet certifikatë ISO 9001:2008 dhe 14001:2004, pika 2.3.2 e DST;*

b- *Malli nuk është i certifikuar me certifikatë ISO 9001:2008 ;*

c- *Shoqëria “K.....L”, certifikatat e paraqitura nuk janë të certifikuara, siç kërkohet në pikën 2.3.2 të DST;*



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Konkluzioni:** Kualifikimi i JV “G.....Y + K.....I”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur asnjë nga shoqëritë pjesëmarrës nuk plotësojnë kriteret për kualifikim, AK duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, ose midis operatorëve me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë “*çmimi më i leverdishëm*”, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar me efekt financiar në vlerën **15,400 lekë**.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: L. H me funksion ish-Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK, si dhe anëtarët e NHDT dhe KVO.**

### II. X-Tenderi me objekt: “Riparim te mjeteve te rënda dhe të rënda viti 2019”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Riparim i mjeteve te lehta viti 2019</i>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 11, datë 18.3.2019	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 11, datë 18.3.2019 1. F. P 2. L. M 3. M. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 11/1, datë 18.3.2019 1. K. TH 2. L. B 3. V. K
<b>2. Lloji i Procedurës</b> “ <i>Kërkesë me propozim</i> ”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 3,750,000 lekë. Ndarë në dy lote. Mjete të lehta për vlerën 1,500,000 lekë dhe mjeteve të rënda 2,250,000 lekë, (REF-21571-05-12-2019)	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “DH.....O” me ofertë 1,771,338lekë me kontratë nr. 1641/1, dt. 10.6.2019, me afat deri me 12 muaj kalendarike.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 479 mijë lekë ose 21.2 %
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 24.5.2019	<b>9. Burimi Financimit</b> Ardhurat e veta + grande	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
<b>11. Ankimime</b> AK- nr. -----; KPP----- APP-s’ka/ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Shkresa nr. -----	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> ; Shkresa nr. ----, dt. ----

#### **-Hartimi i fondit limit:**

Nuk disponohet asnjë dokument se si është llogaritur fondi limit, ku është bazuar bashkia në përcaktimin e këtij fondi, ku është mbështetur në përcaktimin e çmimeve të artikujve (pjesëve të ndërtimit), etj. Konstatohet se preventivi është nënshkruar për ish- Titullari i AK, pa përcaktuar personi se kush e ka nënshkruar atë dhe nga asnjë person tjetër, pavarësisht faktit se në preventiv është dhe emri V. T me detyrë mirëmbajtës i mjeteve motorike në Sektorin e Transportit, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 59 “Përllogaritja e vlerësimit te kontratës”, pika 2, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- titullarin e AK dhe anëtarët e NJP.**

#### **- Zhvillimi procedurës.**

Me procesverbal datë 24.5.2019 është mundësuar hapja e procedurës, ku janë evidentuar dhe OE pjesëmarrës, konkretisht:

a- Shoqëria “DH.....O” me Nipt K.....T me ofertë 1,771,338 lekë pa TVSH

b- Shoqëria “K.....U” me Nipt J.....K me ofertë 1,758,483 lekë pa TVSH.

Me procesverbal datë 27.5.2019 është bërë vlerësimi i dokumentacionit teknik e ligjor, ku konstatohet se është skualifikuar shoqëria “K.....U” me ofertë më të leverdishme se OE i shpallur fitues “DH.....O”.

*Operatori ekonomik “K.....U” është skualifikuar për faktin se nuk ushtron aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Finiq dhe nuk ka ambiente (servis) të pasqyruar me foto.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Raporti përmbledhës është mbajtur me datë 6.6.2019 dhe nuk është sipas kërkesave të nenit 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik.

#### **-Shqyrtimi i dokumentacionit:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në plotësimin e kriteve. Ndërsa në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “K.....U” me ofertë ekonomike më të leverdishme prej 1,758,483 lekë pa TVSH pretendimin se nuk ka pikë shërbimi në juridiksionin e Bashkisë Finiq, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin SEP, konstatohet se kjo shoqëri ka paraqitur kontratë qiraje nr. 760kol dhe 212/1 rep, datë 27.3.2018 me subjektin “A.....I” me Nipt L.....S dhe adresë: Vlorë, Sarandë, gjashtë rruga Skënderbeu, godinë private 2 katesh, nr. 118, e cila plotëson kriterin e pikës së servisit.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, skualifikimi i shoqëria “K.....U” me ofertë më të leverdishme se subjekti fizik “DH.....O”, janë veprime në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar me efekt financiar negativ në vlerën **12,885 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: L. H me funksion ish- Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK dhe anëtarë i NJHDT dhe KVO.**

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 118 - 142 të Projektraport Auditimit)*

**Shënim:** Referuar dokumentacionit në dosjen e procedurave të prokurimit, u konstatua se dokumentacionet mbështetëse, si deklaratat e konfliktit të interesit, procesverbalet e hartimit të kriteve, DST, procesverbalet e hapjes dhe vlerësimit të procedurës, raporti përmbledhës ishin të panënshkruar nga një pjesë e mirë e anëtarëve.

Për këtë grupi i KLSH me shkresat nr. 1048/1.2, datë 16.01.2020 (prot subjekt nr. 107, datë 16.01.2020) dhe shkresën nr. 1048/1.3, datë 17.2.2020 (prot subjekt nr. 499, datë 17.2.2020), ju kërkua anëtarëve të NJHDT dhe KVO të deklaronin në lidhje me mangësinë e konstatuar për mos nënshkrimin e dekalumenëve.

Nga ana e punonjësve të Bashkisë Finiq, u deklaruar me shkrim (sipas protokolleve në bashki), se nuk janë në dijeni të faktit të qenies së tyre anëtarë të NJHDT dhe KVO dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga procedurat ku ato janë anëtarë sipas urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Finiq, për të cilën dhe nuk janë vënë në dijeni.

Konkretisht kanë paraqitur deklaratat e tyre, punonjësit: **L. M.** me funksion Drejt/Ekonomike, **M. L** , me funksion me funksion ish- punonjës, **K. TH** , me funksion Drejt Shërbimesh, **z. F. TH**, me funksion Përgj/ Sek. Pastrimit, **V. K**, me funksion Përgj. Emergjencave Civile, **S. P.** , me funksion specialist në Sektorin e Transporteve, **S. J** , me funksion Përgjegjës i zyrës së shërbimeve, **V. T**, me funksion mirëmbajtës mjetesh në Drejt/ Shërbimeve, **L. B**, me funksion shef i MZSH, **TH. Z.**, me funksion Përgj. Drejt Ardhurave, **V. L.** , me funksion Drejtor i PZHT, **V. J**, me funksion Drejt. Në Drejt. Ujerave dhe Kullotave, **G. M.**, me funksion ish Specialist DPZHT, **I. E** , me detyrë Drejtoresh Burimeve Njerëzore, **Z. LL** , me detyrë ish- Nënkyetar i Bashkisë Finiq, **V. L**, me detyrë shefe finance në Ujësjetllës, **V. K**, me detyrë Përgj. Emergjencave Civile, **TH. TH** , me detyrë ish- nënkryetar i Bashkisë Finiq, **I. M**, me detyrë ish- Nënkyetar Bashkia Delvinë, **G. K** , me detyrë Drejtor kabinetit, **G. M.**, me detyrë ish- specialist DPZHT dhe **A. B**, me detyrë Specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

#### **Komentet e subjektit:**

Nga një pjesë e anëtarëve të KVO si: K. TH , TH. Z, V. L, F. TH, kanë deklaruar nëpërmjet postës elektronike duke rikundërshtuar fakti se nuk kanë qenë pjesë e këtyre komisioneve, gjë për të cilën kanë dhënë dhe deklaratën personale të kërkuar nga grupi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

i auditimit të KLSH gjatë procesit të auditimit. Në këto kushte nuk jenë dakord vënien para përgjegjësive në procedurat për të cilat në gjejmë veten në rastet e shkelje të konstatuara nga KLSH.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së.**

Nisur nga shpjegimet tuaja dhe deklaratat personale që ju keni lëshuar gjatë procesit të auditimit, argumenti juaj se nuk keni qenë pjesë e komisioneve, merret pjesërisht në konsideratë, pasi nga ana juaj nuk është shpjeguar cekimi në sistem i dokumentacionit të procedurës, kur dihet se kodet janë personale dhe sekret.

#### **IV/D.1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.**

Nga verifikimi i regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), konstatohet se janë kryer gjithsej 18 procedura investimi me vlerë të fondit limit prej 394,620,362 lekë dhe kontrata të lidhura për vlerën 372,550,029 lekë.

Pas analizës së riskut dhe në varësi të kohës së auditimit, grupi i auditimit të KLSH nga 18 procedura auditoi **5 procedura** me vlerë kontrate **235,346,853 lekë**, vlerë kjo e barabartë me 63.1 % e vlerës së kontratave të lidhura për këto 18 procedura. Mangësitë e konstatuara nga auditimi i këtyre procedurave paraqitet si vijon:

#### **1. “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, Bashkia Finiq**

##### Projektpreventivin

- Për këtë objekt, nuk rezulton të jetë dhënë nga Bashkia Finiq leja e ndërtimit.

- Në dosje nuk administrohet oponenta teknike e objektit, si detyrim ligjor në zbatim të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6, sipas të cilit “Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve”.

Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Finiq (G. M, Konstruktor V. L ), në vitin 2017.

##### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 22.08.2017 dhe kanë përfunduar me datë 20.05.2018. Pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve, ndërmjet palëve është bërë aktmarrëveshja me nr. 3657, datë 29.12.2017, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 90 ditë (3 muaj), sipas të cilës data e përfundimit të punimeve të jetë 22.03.2018. Përsa sipër, punimet kanë përfunduar jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve me 58 ditë. Deri në afatin kontraktual të përfundimit të punimeve datën 22.03.2018, janë realizuar 104,493,015 lekë (situacioni nr.2), ose 24,116,369 lekë më pak se vlera e kontratës prej 128,609,384 lekë me TVSH. Për këtë arsye, nga ana e AK duhej bërë penalizim i shoqërisë kontraktore, sipas nenit 23 të kontratës “Dëme të likuidueshme për vonesa në mbarimin e punimeve”, sipas të cilit AK penalizon me tarifën ditore 2/1000 (pasi afati kontraktual i përfundimit të punimeve i ka kaluar 6 muaj) të vlerës së mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës. **AK duhet të kishte llogaritur penaltiteti për 58 ditë vonesë x 2/1000 x 24,116,369 (128,609,384 vlera totale – 104,493,015 punime të kryera deri në afatin ligjor të përfundimit të punimeve), gjithsej 2,797,498 lekë.**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Akti i kolaudimit nuk është i rregullt dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim me datë 07.06.2018, është firmosur vetëm nga kryetari i Bashkisë Finiq dhe nuk rezulton të jetë ngritur grup pune.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, Bashkia Finiq		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2126 prot datë 21.07.2017	15.Vlera e kontratës (me TVSh) 128,609,384 lekë OE fitues “2.....T” SHPK	16.Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar dt 04.09.2017 -Vlera me TVSh 128,606,425 lekë -Vlera pa TVSh 107,172,020 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 268 ditë. Fillimi punimeve: 22.08.2017 Përfundimi punimeve : 20.05.2018	19. Zgjatja e kontratës Akt-marrëveshja nr. 3657, datë 29.12.2017. Shtyrje 90 ditë, deri në datën 22.03.2018.
20. Mbikëqyrësi i punimeve Z.....T-06	Licenca Nr: MK 1208/8	Kontrata nr. 2364 prot, datë 18.08.2017
21. Kolaudatori i punimeve P. K	Licenca Nr: MK .....	Pa kontratë
22.Akt Kolaudimi Datë 23.05.2018	23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim dt 07.06.2018	

**Titulli gjetjes 1.** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, Bashkia Finiq, nga zbatuesi i punimeve OE “2.....T” SHPK, për zërin e punimeve I.1, III.4, III.5 dhe V/5.

### Situata:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **635,259 lekë pa TVSH**.

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV Bordurë guri gëlqeror i bardhë 15 x 25 cm (Çmimi)”, “Beton M-200 për fixim bordure” dhe “FV kolona ndriçimi alumini t=4 mm, h= 9m, çmimi”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve

### Kriteri:

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2126 prot datë 21.07.2017.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2364 prot, datë 18.08.2017.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nëse ka patur.

#### **Ndikimi/efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Finiq.

#### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivin, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.

#### **Rëndësia: I Lartë.**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Nga Bashkia Finiq të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **635,259 lekë pa TVSh** nga OE “2.....T” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 224/23 prot datë 24.05.2019 me “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, *Bashkia Finiq*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera. Të kryhen riparimet e sipërfaqes prej 150 m<sup>2</sup>, të dëmtuar për shkak të cilësisë jo të mirë të punimeve.

#### **Komentet e subjektit:**

Lidhur me objektin e mësipërm, me e-mail e datës 17.04.2020, janë dërguar kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Z.....O” SHPK, bashkëlidhur dhe dokumentacionit shoqëruar është edhe dëftesa postare e kësaj shoqërie për Bashkinë Finiq, e datës 06.04.2020, datë në të cilën pretendohet që janë nisur kundërshtitë e kësaj shoqërie, ku argumentohet se:

1. “Zëri 3.104/b - Gërmim seksion i lirë, tokë e zakonshme, makineri” mbetet sipas projektit të rishikuar dhe zvogëlimi i sasisë së gërmimit nuk qëndron. Sasia e gërmimit mbetet 10337.9 m<sup>3</sup>. Gjatë procesit të punës së gërmimit në progresivet 2+700 deri në 2+760 materiali i gërmuar ishte argjilë. Në mënyrë që të krijohet bazament i qëndrueshëm për këtë segment dhe mos të krijohen cedime të rrugës, kontraktori ka gërmuar një shtresë me lartësi 1.4m në të gjithë gjerësinë e rrugës dhe me pas ka bere mbushjen e kësaj shtrese. Pas mbushjes ka filluar ndertimi I paketës së shtresave të rrugës. Projekti sipas faktit fillon llogaritjen e gërmimit aty ku fillon ndertimi i paketës bazë të rrugës dhe nuk e ka marrë në konsideratë shtresën përforcuese as në zërin e gërmimit, as në zërin e mbushjes. Gërmimet reale janë bërë sipas profileve bashkëngjitur.

..... Duke qenë se gërmimin e shtresës me lartësi 1.4 m nuk e kemi marrë në konsideratë në zërin “3.104/b - Gërmim seksion I lire, toke e zakonshme, makineri.”, sasia e tij mbetet sipas projektit të rishikuar dhe zvogëlimi i sasisë së gërmimit nuk qëndron. Sasia e gërmimit mbetet 10337.9 m<sup>3</sup>.

2. “Zëri An - F.V. kolona ndriçimi Alumini t = 4 mm h=9 m”. Vendosja e kolonave të aluminit me lartësi h=6.8m është bërë në marrëveshje me Autoritetin Kontraktor. Bazuar në specifikimet teknike të shtyllave të vendosura, cilësia e tyre është më e mirë se ato të parashikuara në projekt, fakt nga i cili jemi nisur për mos të ndryshuar çmimin e ofertës.

3. - “Zëri 3.243 - Beton M-200 për fiksion bordure”. Sasia e betonit të varfër nuk është ndryshuar pasi në zonat e banuara kemi shumë segmente ku bordura është e shtrirë dhe volumi i betonit për fiksimin e bordurës ka sipërfaqen S=0.06 m<sup>2</sup>.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

1. Përsa i përket zërit 3.104/b - Gërmim seksion i lirë, tokë e zakonshme, makineri”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.
2. Përsa i përket zërit “F.V. kolona ndriçimi Alumini t = 4 mm h=9 m”, në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument që të vërtetojë atë që pretendohet në observacion. Nëse do te ishte bërë kjo marrëveshje, do të shoqërohej me negociim çmimi. Përsa sipër pretendimi nuk merret në konsideratë.
3. Përsa i përket zërit “Beton M-200 per fiksime bordure”, pretendimi i sjellë nuk ka argumente teknike dhe për pasojë nuk merret në konsideratë.
  - Në këtë observacion nuk është kundërshtuar dëmi ekonomik i ardhur nga zëri “FV Bordurë guri gëlqeror i bardhë 15 x 25 cm (Çmimi)”.
  - Bashkëlidhur këtij observacioni është paraqitur edhe një aktmarrëveshje ndërmjet palëve me nr. 5659/1, datë 22.03.2018, sipas të cilës shtyhet afati i përfundimit të punimeve me 90 ditë të tjera, deri në datën 22.06.2018, me argumentin “... për kushte jo të favorshme klimaterike gjatë vjeshtës dhe dimrit...Problemet e pronësisë që janë shfaqur”. Pretendimet e mësipërme nuk shoqërohen me argumente bindës teknike (ditë shiu apo me temperatura të ulëta). Gjithashtu, bazuar në akt dorëzimit të datës 22.08.2017, sheshi ka qenë i lirë. Përsa sipër pretendimi nuk merret në konsideratë.

***Vlera prej 635,259 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Finiq. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

- 1) R. T me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- 2) P. K me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
- 3) L. H në cilësinë e anëtarit të grupi të marrjes së përkohshme në dorëzim;

## **II. “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, Bashkia Finiq**

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, nuk administrohet asnjë kontratë, apo urdhër i titullarit të AK dhe nuk administrohet gjithashtu edhe aktkolaudimi për këtë objekt.

Përsa sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti kontraktor.

### Projektpreventivin

- Për këtë objekt, nuk rezulton të jetë dhënë nga Bashkia Finiq leja e ndërtimit.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se projekti i administruar në dosje, i hartuar nga shoqëria “H.....G” SHPK nuk është i plotë. Në dosje ndodhen vetëm 12 fletë të projektit arkitektonik dhe asnjë detaj konstruktiv.

Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 24.07.2017 dhe kanë përfunduar me datë 22.04.2018. Pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve me nr. 195 prot, datë 10.10.2017, ndërmjet palëve është bërë aktmarrëveshja me nr. 2970 prot, datë 18.10.2017, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 180 ditë (6 muaj), sipas të cilës data e përfundimit të punimeve të jetë 22.04.2018. Shtyrja e afatit me 6 muaj, ose 3 muaj më shumë se afati kontraktual i përfundimit të punimeve, është i palogjikshëm (që nga fillimi i punimeve deri në datën e shtyrjes së punimeve, nuk është



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

punuar vetëm 5 ditë për shkak të kushteve atmosferike dhe është punuar gjithë ditët e tjera) dhe i paligjshëm, pasi mund të ketë çenuar edhe shmangien e pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Nga verifikimi i ditarit të punimeve, për periudhën 24.07.2017 – 21.04.2018, nuk është punuar për shkak të kushteve atmosferike gjithsej 17 ditë dhe afati kontraktual i punimeve me 90 ditë të punuara, plotësohej që në datën 20.11.2017. Për këtë arsye, nga ana e AK nuk ka argumente teknike të besueshme dhe nuk duhej miratuar shtyrja e afatit më shumë se kjo datë dhe duhej bërë penalizim i shoqërisë kontraktore, sipas nenit 23 të kontratës “Dëme të likuidueshme për vonesa në mbarimin e punimeve”, sipas të cilit AK penalizon me tarifën ditore 4/1000 të vlerës së mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës. Nisur nga fakti që kontrata është shtyrë pa argumente teknike 151 ditë më shumë dhe deri në datën 20.11.2017 është kryer 15,352,500 lekë me TVSH (situacioni nr 1, dorëzuar me faturën tatimore nr. 27, datë 06.12.2017), nëse nuk do të bëhej shtyrja e jashtëligjshme e afatit të përfundimit të punimeve, AK do të kishte llogaritur penaliteti për 151 ditë vonesë x 4/1000 x 43,966,679 (59,319,179 vlera totale – 15,352,500 punime të kryera deri në afatin ligjor të përfundimit të punimeve), gjithsej 26,555,874 lekë. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, Bashkia Finiq		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2039 prot, datë 11.07.2017	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 59,319,179 lekë <b>OE fitues “G.....G” SHPK</b>	16. Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSh 59,294,176 lekë -Vlera pa TVSh 49,411,813 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 270 ditë. Fillimi punimeve: 24.07.2017 Përfundimi punimeve : 22.04.2018	19. Zgjatja e kontratës Akt-marrëveshja nr. 2970 prot, datë 18.10.2017. Shtyrje 180 ditë, deri në datën 22.04.2018.
20. Mbikëqyrësi i punimeve Z.....T-06	Licenca Nr: MK .....	Kontrata nr. 2364 prot, datë 18.08.2017
21. Kolaudatori i punimeve Nuk administrohet	Licenca Nr:	
22. Akt Kolaudimi Nuk administrohet	23. Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim dt 18.05.2018	

**Titulli i gjetjes 2.** *Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, Bashkia Finiq, nga zbatuesi i punimeve OE fitues “G.....Y” SHPK, për zërin e punimeve 5.17, 8.2 dhe 4.4.*

### Situata:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **706,106 lekë pa TVSh.**

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve “FV kabull Cu (4x4) mm<sup>2</sup>”, “Rrethim i përkohshëm me kolona b/a + rrjet teli”, “Mur guri i skalitur me fugaturë në lartësi deri në 3 m, Ilaç. M15”, dhe “Mur guri i skalitur me fugaturë në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

lartësi deri në 3 m, llaç. M15, çmimi”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

#### **Kriteri:**

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2039 prot, datë 11.07.2017.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2364 prot, datë 18.08.2017.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nëse është bërë.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Finiq.

#### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivin.

#### **Rëndësia: E lartë:**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **706,106 lekë** pa TVSh nga OE fitues “G.....Y” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3226 prot datë 11.07.2017 me “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, *Bashkia Finiq*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

#### **Komentet e subjektit:**

Lidhur me objektin e mësipërm, me e-mail e datës 17.04.2020, janë dërguar kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Z.....O” SHPK, bashkëlidhur dhe dokumentacionit shoqërues është edhe dëftesa postare e kësaj shoqërie për Bashkinë Finiq, e datës 06.04.2020, datë në të cilën pretendohet që janë nisur kundërshtitë e kësaj shoqërie, ku argumentohet se:

1. Zëri 5.17. FV kabëll Cu ( 4x4 ) mm<sup>2</sup>. Për sa pretendohet nga ana juaj se për tokëzim duhen vetëm 2 ml per shtyllë, nuk qëndron kështu pasi tokëzimi i shtyllave është realizuar me një linjë të veçantë paralele me linjën e furnizimit, në gjatësinë e secilës janë vendosur edhe elektodat e tokëzimit, prandaj diferenca prej 651 ml nuk qëndron dhe për pasojë as dëmi ekonomik.

2. Zëri 8.2. Rrethimi i përkohshëm me kolona b/a + rrjetë teli. Në preventivin e ripunuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 550 m<sup>2</sup>. Edhe në librin e masave ky zë pune figuron në sasinë 550 m<sup>2</sup>. Ky rrethim është realizuar për periudhën gjatë realizimit të punimeve të objektit dhe është i përkohshëm. Ky rrethim ka shërbyer vetëm për periudhën gjatë ndërtimit dhe më pas është hequr. Për sa i përket pretendimit tuaj që ky zë nuk është realizuar po ju tregojmë më poshtë fotot e rrethimit provizor.

3. Zëri 4.4. Mur guri i skalitur me fugaturë në lartësi deri në 3 m, ll.c.M15. Bazuar në preventivin e ripunuar, situacionin përfundimtar dhe librezën e masave volumi i nuraturës së gurit të skalitur është 236.9 m<sup>3</sup>. Gjatë llogaritjes nuk është përfshirë trau (brezi) betonarme e për pasojë nuk ka përse të zbritet. Volumet që janë përfshirë gjatë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Ilogaritjes janë zbritur në librezën e masave. Të shikohet me kujdes kjo në librezën e masave

4. Zëri 4.4. Mur guri i skalitur me fugaturë në lartësi deri në 3 m, ll.c.M15, çmimi.

Në preventivin e ripunuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 236.94 m<sup>3</sup>, me çmimin 12473 lekë/m<sup>3</sup>. Analiza e çmimit, është teknike. Ne realizimin e një zëri pune luajnë rol disa faktorë si punëtoria, materiali, makineria dhe transporti. Kështu që punëtoria nuk është njëllë si te ndërtohet një 1m<sup>3</sup> mur guri të zakonshëm, me 1m<sup>3</sup> mur guri të skalitur me fuga. Në murin e gurit të zakonshëm thjesht behet lidhja e murit ndërsa në murin e skalitur me fugaturë duhet të ruhet vertikalishteti dhe horizontaliteti i fugës duke ruajtur edhe gjerësinë e saj. Kështu që pretendimi juaj që çmimit të këtij zëri i është shtuar 518 lekë/m<sup>3</sup> nuk qëndron dhe është i pa baze e për pasojë as demë ekonomik për të nuk ekziston.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

1. Përsa i përket zërit Zëri 5.17. "FV kabëll Cu ( 4x4 ) mm<sup>2</sup>", pretendimi i sjellë nuk ka argumente teknike, pasi tokëzimi do të mjaftojë me lidhjen nga shtylla deri tek elektroda. Nuk paraqitet asnjë dokument shoqërues, ku të tregohet se tokëzimi është bërë siç pretendohet në observacion, për pasojë ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Përsa i përket zërit "Rrethimi i përkohshëm me kolona b/a + rrjetë teli.", në observacion janë bashkëlidhur fotot, të cilat tregojnë që ky rrethim i përkohshëm është realizuar, por jo sipas emërimit të zërit, pasi në foto shihet që nuk është bërë me kolona b/a dhe në disa vende pa rrjetë teli. Nga verifikimi i analizës së këtij zëri pune (3.837), elementët e kostos "material" të përcaktuar, janë më vlerën 470 lekë/m<sup>2</sup> ((136.4 (betoni)+196.7 (hekuri)) x 1.18) x 1550 (çmimi i ofertuar)/1766 (çmimi i manualit). Për pasojë janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 258,500 lekë (470 lekë/m<sup>2</sup> x 550 m<sup>2</sup>), e cila do të reflektohet në vlerën e demëtit. Përsa sipër pretendimi merret pjesërisht në konsideratë.

3. Përsa i përket zërit "Mur guri i skalitur me fugaturë në lartësi deri në 3 m, ll.c.M15", pretendimi i sjellë nuk ka argumente teknike, pasi volumi i traut b/a të realizuar me gjatësi 114.8 m me përmasa 25 cm x 25 cm brenda murit, nuk është zbritur nga volumi i murit të gurit. Për pasojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

4. Përsa i përket zërit 4.4. "Mur guri i skalitur me fugaturë në lartësi deri në 3 m, ll.c.M15, çmimi.", argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e demëtit ekonomik.

#### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

- 1) R. T me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes
- 2) L. H në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;

***(Gjerësisht trajtuar në faqen 144 - 148, të Projektraport Auditimit)***





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Titulli i gjetjes 3:** *Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik dhe penalitet për punime jashtë afateve të kontratës në objektin “Rehabilitimi i Rrugës Fitore - Aliko” Bashkia Finiq”.*

#### **Situata:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrugës Fitore-Aliko” Bashkia Finiq, me vlerë 69,202,342 lekë me TVSH, fituar nga OE “2.....T” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **436,837** lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2363 prot, datë 18.08.2017, *konkretisht:*

Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Germim toke seksion i detyruar peseta + tombino + ura; F.V tuba b/a 1000 mm dhe Hidroizolim si dhe penalitet për punime jashtë kontrate.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **436,837 lekë pa TVSH**, për punime të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.

#### **Kriteri:**

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me Nr. 2382 Prot, Datë 22.08.2017 dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. Prot. 2363, datë 18.08.2017.

#### **Impakti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Finiq.

#### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej 436,837 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Finiq.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: R. T, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.**

#### **Rëndësia:** *E lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Nga Bashkia Finiq, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **436,867 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “2.....T” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2363 prot, datë 18.08.2017 me objekt “Rehabilitimi i rrugës Fitore-Aliko”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara dhe kryerjes së punimeve të ndërtimit të pamiratuara nga Kryetari i Bashkisë, jashtë afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

***(Gjerësisht trajtuar në faqen 148 - 150, të Projektraport Auditmit)***



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### **Komentet e subjektit:**

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve R. T, përcjellë në mënyrë elektronike mbi Akt-Konstatimin nr. 14, datë 27.02.2020, është trajtuar si vijon: Mbikëqyrësi nuk është dakord me vlerën e dëmit ekonomik si dhe me problematikat e konstatuara. Në observacion ka argumentuar se kryerja e tombino se ndryshuar nuk është realizuar në fakt. Si dhe shtyrje e punime jashtë afatit të kontratës është bërë për arsye objektive dhe është miratuar nga titullari i Bashkisë.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

përsa i përket dëmit ekonomik në vlerën 436,837 lekë, observacioni nuk merret në konsideratë sepse, problematika e trajtuar është mbështetur në fakte reale të kryerjes së punimeve në terren, dhe se argumentet tuaja nuk qëndrojnë.

Lidhur me vlerën e penalitetit, observacioni merret në konsideratë mbështetur në argumentin e paraqitur, pra në: Akt marrëveshjen me nr. Prot. 3658, datë 22.02.2018 ndërmjet Bashkisë Finiq dhe supervisorit "Z.....O" shpk, ku është përcaktuar si datë e përfundimit të punimeve deri me 22.06.2018. akt marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët. Gjithashtu është dërguar fotokopje e protokollit ku duket qartë regjistrimi i kësaj akt marrëveshje për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve.

**Titulli i gjetjes 4:** *Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik dhe realizim i punimeve me cilësi të dobët në objekt "Rikonstruksion i rrugës Karroq" Bashkia Finiq.*

#### **Situata:**

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit të kontratës nr. 2363, datë 18.8.2017 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Karroq" Bashkia Finiq, me vlerë 14,632,388 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik "Y.....Y" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, si dhe kryerja punimesh betoni me cilësi të dobët, në vlerën **446,465 lekë pa TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2363 prot, datë 18.08.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Finiq dhe Operatorit Ekonomik "Y.....Y" SHPK.

Ka patur likuidime për punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: Cilindrim Kasonete; Mure betoni M-200 për kanale anësore dhe shtresë zhavorri për nivelim 20 cm, kanali.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të situacionuara dhe realizim i zërave me cilësi të dobët, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **446,465 lekë pa TVSH**.

#### **Kriteri:**

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Urdhrit të titullarit të AK për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve (Nëpunës i Bashkisë) dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. Prot. 3466, datë 21.12.2018.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### Impakti:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Finiq.

#### Shkaku:

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të punimeve dhe cilësisë së tyre në përputhje me kërkesat teknike të zbatimit. Vlera prej 446,465 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt si dhe atyre me cilësi të dobët, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Finiq. ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: V. L. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit.***

#### Rëndësia: I lartë

#### Për këtë rekomandojmë:

-Bashkia Finiq, t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Operatorit Ekonomik "J.....Y" SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore në të gjitha shkallët, që:

- **Vlera prej 380,160 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda afatit prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kalendarike shtrirë brenda afatit tre vjeçar 2018-2019-2020, ku afati i punimeve do të llogaritet dhe shpërndahet në bazë të lëvrimin të financimit. Realizimi i punimeve për zërin e punimit "Mure betoni M-200 për kanale anësore", duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Finiq dhe Mbikëqyrësi i punimeve brenda afatit të përfundimit të punimeve. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit, KTZ dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

- Arkëtimin e vlerës prej **66,305 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik "Y.....Y" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3466 prot, datë 21.12.2018 me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Karroq*", Bashkia Finiq, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhje e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

#### Komentet e subjektit:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve V. L , përcjellë në mënyrë elektronike mbi Akt-Konstatimin nr. 15, datë 27.02.2020, është trajtuar si vijon: Është pranuar cilindrimi në situacion pasi nga kalimi i mjeteve të rënda në segmentet e gërmuara, kasoneta është ngjeshur, por megjithatë ajo u pranua edhe nga fakti se rruga është në proces dhe nuk ka përfunduar dhe kështu do të realizohet në fazën e dytë.

Betonimi i kanalit është kryer por nga rrënja e shirave kishte dëmtime sipërfaqësore, dhe nisur nga ky fakt shtresa e kanalit do të ribetonohet duke u mbikëqyrur rreptësisht.

Ndryshimi i volumit në shtresën e zhavorrit në kanale është evident dhe i pranuar, dhe do të merret parasysh në situacionin e dytë të vazhdimin të punimeve.

- Në lidhje me konstatimet e KLSH-së, se në lidhje me dokumentacionin teknik të dosjes ka plotësisht të drejtë.

Nuk është vlerësuar kjo kërkesë ligjore si nga sipërmarrësi ashtu edhe nga mbikëqyrësi i punimeve duke menduar se rikonstruksioni i rrugës ishte në proces dhe do të bëheshin në vijim, por pranojmë që është antiligjore dhe mbaj përgjegjësi me ndërgjegje.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Meqenëse rruga është në proces dhe të gjitha këto do të ndreqen në vazhdim, bëj autokritikë të fortë dhe është në dorën e KLSH-së, për ta gjykuar.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

- Nisur nga fakti se punimet e ndërtimit për kontratën me objekt “Rikonstruksion i rrugës Karroq” janë në proces e sipër ndërtimi, personat përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit (sipërmarrës dhe mbikëqyrës të punimeve), të plotësojnë dokumentacioni tekniko-ligjor të zbatimit të punimeve sipas kuadrit rregullator në fushën e ndërtimit, përgjatë fazave të zbatimit të kontratës për punë publike.

- Realizimin e punimeve për zërat e punimeve: “Cilindrim Kasonete 1,700 m<sup>2</sup>, Beton M 200 për kanal anësor dhe shtresë zhavorri për nivelim kanali” brenda afatit të përfundimit të punimeve (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit, KTZ dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 148 – 150, të Projektraport Auditimit)*

**Titulli i gjetjes 5:** *Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik në objektin “Rehabilitimi i rrugëve të Bashkisë Finiq”.*

#### **Situata:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrugëve të Bashkisë Finiq”, me vlerë 14,662,272.60 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomikë “A...I” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune për zërin e punimeve; “Emulsion bitumi + transport” në vlerën **419,448** lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 869 prot, datë 27.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Finiq dhe Operatorit Ekonomik “A...I” SHPK.

Ka patur likuidime për punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punimeve: Spërkatje me emulsion prajmeri.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se ky zë punimi nuk është kryer sipas volumit të situacionuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **419,448 lekë pa TVSH**.

#### **Kriteri:**

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Urdhrit të titullarit të AK për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve (Nëpunës i Bashkisë) dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. Prot. 869, datë 27.03.2019.

#### **Impakti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Finiq.

#### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të punimeve. Vlera prej 419,448 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Finiq. Për veprimet



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: V. L. , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit.

**Rëndësia:** *I lartë*

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Finiq, t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "A...I" SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e vlerës prej **419,448 lekë pa TVSH**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 869 prot, datë 27.03.2019 me objekt "*Rikonstruksion i rrugëve të Bashkisë Finiq*" vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

#### **Komentet e subjektit:**

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve V. L , përcjellë në mënyrë elektronike mbi Akt-Konstatimin Nr. 16, datë 27.02.2020, është trajtuar si vijon:

1. Lidhur me mosrealizimin e disa zëra punimesh nga autoriteti kontraktor nëpërmjet brigadës së punimeve me pasojë efekt negativ në qëndrueshmërinë e rrugëve në vlerën 916.124 leke pa TVSH, mbikëqyrësi sqaron se; Zërat e punimeve që nuk janë realizuar nga brigada e ndërtimit të Bashkisë Finiq, *janë në fazën përmbushësh* dhe do të realizohen komplet sipas projektit.

2. Në lidhje me argumentimin e blerjeve të materialeve me fatura, sqarojmë se bashkia e Finiq gjatë realizimit të mbushjeve të rrugëve ka marrë materialin *Çakëll mali* nga firma "A...I" Sh.p.k rreth 1,025 m<sup>3</sup> me fatura ku transporti është realizuar komplet nga mjetet e bashkisë Finiq.

Ndërsa për shtresat e Çaksëllit (1 x 20) Bashkia Finiq i ka realizuar nga 2(dy) Karrierat (Gurore) të saj , një në fshatin Memoraq dhe një në fshatin Dobër të cilat kanë material shumë të mirë për shtresa rrugore të cilat plotësojnë kushtet teknike. Pra shtresat rrugore janë marrë nga këto dy gurore që I shfrytëzon Bashkia Finiq.

3. Lidhur mbi likuidimin tepër shoqërisë "A...I" SHPK 419,448.75 lekë, sqarojmë se zbatuesi i punimeve ka realizuar spërkatje me prajmeri 8012.5 kg, dhe jo 4415.25 kg dhe se spërkatja është bërë 1 kg për m<sup>2</sup>.

4. Në lidhje me problematikën se nga mbikëqyrësi i punimeve nuk janë zbatuar detyrimet ligjore; ka vend për vërejtje , por nga ana e mbikëqyrësit, janë bërë të gjitha përpjekjet që të gjitha punimet të bëhen me cilësi dhe sasi sipas kushteve teknike. Mangësitë janë shënuar dhe në raportin e Mbikëqyrësit, mund të ketë gabime teknike në procedurën e pasqyrimin të dokumentacionit por kjo dhe nga fakti se ato janë në proces nga ana e bashkisë Finiq

#### **Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH-së:**

1. Me argumentet e paraqitura, fotografi, lidhur me realizimin e disa zëra punimesh nga autoriteti kontraktor nëpërmjet brigadës së punimeve në, grupi i auditimit merr në konsideratë që zërat e punimeve që nuk janë realizuar nga brigada e ndërtimit të Bashkisë Finiq, *janë në fazën përmbushësh* dhe do të realizohen sipas projektit të zbatimit.

2. Në lidhje me argumentimin e blerjeve të materialeve me fatura, grupi i auditimit merr në konsideratë se bashkia e Finiq gjatë realizimit të mbushjeve të rrugëve ka marrë materialin *Çakëll mali* nga firma "A...I" Sh.p.k ku transporti është realizuar





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

komplet nga mjetet e bashkisë Finiq, por në observacion nuk keni paraqitur asnjë faturë blerje(kopje fature) bashkëngjitur këtij observacioni. *Realizimin e blerjes së materialeve me faturë, si dhe prodhimin e materialeve çakëll për shtresa rrugësh në 2(dy) Karrierat (Gurore), përkatësisht në fshatrat Memoraq dhe Dobër, grupi i auditimit do ta verifikojë në vijim të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.*

3. Lidhur me zbatimin e zërit "Emulsion bitumi + transport objekt" nga sipërmarrësi i punimeve "A...I" SHPK, referuar sipërfaqes së shtruar me binder dhe asfaltobetoni për rrugët hyrëse në fshatrat Fitore, Bregas dhe Karahaxhe, rezulton sipërfaqe e spërkatura me prajmeri 8,830.5 m<sup>2</sup> (në rrugën Fitore: 2 x 1676.25 ( dy shtresa asfaltikebinder dhe asfaltobetoni me dy spërkatje me prajmeri); Në rrugë Bregas: një shtresë binder me sipërfaqe 1353 m<sup>2</sup> dhe në rrugën Karahaxh: një shtresë me binder me sipërfaqe 4125 m<sup>2</sup>). Nga llogaritja për 4 (katër Shtresa, përkatësisht një asfaltobetoni dhe 3(tre) binder me sipërfaqe totale 8830.5 m<sup>2</sup> nevojiten 4415.25 kg prajmeri dhe jo 8012.5 kg siç është situacionuar nga shoqëria "A...I" SHPK, sepse po t'i referohemi të zërit 3.222/2 "shtresë binderi me granil gur kave me t=6 cm, me makineri" si dhe çmimit të zërit 3.226 "shtresë asfaltobetoni me granil gur kave me t=4 cm, me makineri" në VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", konstatohet se spërkatja me prajmeri është përfshirë si nën zë punimi ku: për 1 m<sup>2</sup> shtresë binderi dhe shtresë asfaltobetoni do të përdoret 0.5 kg prajmeri dhe jo 1 kg prajmeri. Sa më sipër trajtuar, observacioni nuk merret në konsideratë dhe shuma prej 419,448.75 lekë është përfituar tepër nga zbatuesi i punimeve.

4. Grupi i auditimit rekomandon se: mangësitë e konstatuara dhe rregullimi i të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor i zbatimit të plotësohet nga personat përgjegjës deri me datë 27.07.2020, pra brenda përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve. Gjithashtu, titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për të realizuar kolaudimin e objektit dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, konformë kuadrit ligjor të fushës së ndërtimit të punimeve.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 148 - 151, të Projektraport Auditimit)*

#### IV/E. Auditim mbi zbatimin e Rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

**1- Titulli gjetjes:** *Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërbllim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimit e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimit nuk janë pranuar.*

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

**a . Nga 18 masa organizative për vlerën 118,867,664 lekë,** të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **4 masa,** janë në proces zbatimi **6 masa,** ku nga vlera e rekomanduar prej 118,867,664 lekë është arkëtuar vlera 35,246,904 lekë ose 30% dhe mbetet për arkëtim vlera 83,620,749 lekë ose 70%. Nuk janë zbatuar **7 masa organizative.**

**b. Nga 18 masa shpërbllim dëmi me vlerë 53,616,974 lekë,** janë pranuar 15 masa me vlerë 24,854,495 lekë dhe nuk janë pranuar 3 masa me vlerë 28,727,495 lekë për faktin se çështja është në prokurori.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,872,504 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 476,194 lekë dhe paarkëtuara vlera **1,396,310 lekë**.

Nuk janë zbatuar akoma 9 masa me vlerë 22,981,991 lekë, por që nga Sektori i Financës për këto masa akoma nuk është kryer dhe kontabilizimi i vlerave.

**c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të**, është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën **840,319 lekë**.

**d. Janë rekomanduar 14 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;

-Sipas “Ligjit për Nënpunësin Civil” janë **rekomanduar 3 masa disiplinore** “Vërejtje” e parashikuar në nenin 58, shkronja “a” deri në masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit” e parashikuar në nenin 58, shkronja “c”

Sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë rekomanduar 11 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për të cilën Kryetari i Bashkisë Finiq ka nxjerrë urdhrat për masën disiplinore “Vërejtje” për 12 punonjës, dhe për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për **2 punonjës**.

**e. I janë rekomanduar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 13 persona.** Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr.15 datë 26.02.2018 përcjellë për në Bashkinë Finiq dhe KLSH-në me shkresën nr. 494/26 datë 20.12.2018, e cila është protokolluar në Bashkinë Finiq me shkresën nr. 13881/7 prot. datë 26.02.2018 duke vendosur masa dënim me gjobe për **19 persona në vlerën 1,970,000 lekë** dhe rekomandim për masë disiplinore për **12 persona**. Për të cilët nga Bashkia Finiq janë njoftuar personat janë kontabilizuar veprimet.

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 494/21 datë 09.11.2017, protokolluar në Bashkinë Finiq me shkresën nr. 13881/7prot, datë 26.02.2018, ndërsa nga Bashkia Finiq për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje, **veprime të cilat mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë L. H.**

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Finiq, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 494/21 datë 09.11.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 09.05.2018. Ndërkohë nga Bashkia Finiq nuk është raportuar brenda afatit .

Pra mos raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30- Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë L. H.**

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga verifikimi rezulton se edhe pse bashkia Finiq ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr 494/21prot, datë 09.11.2017, ndërkohë nuk ka raportuar rregullisht në këshillin bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 5e nenit 50-Auditimi i jashtëm, **veprim për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i bashkisë L. H.**

**Konkluzioni:** Gjatë auditimit rezultoi se nuk është bërë asnjë punë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i radhës. Kështu për disa nga masat e mësipërme, jeni mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative“ (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi L. H, me detyrë ish- Kryetar Bashkie; K. K. me detyrë Kryetar i Bashkisë; L. M. me detyrë Drejtoreshë Finance.**

#### Situata:

Pavarësisht nga puna e bërë nga administrata e Bashkisë Finiq, për disa nga masat Bashkia Finiq është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktar nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), sipas vendimit administrativ të dënimit me gjobë.

Në auditimin i dokumentacionit mbi zbatimin e Rekomandimeve, konstatohet se:

#### A. Masa Organizative:

Nga **18 masa** organizative për vlerën 118,867,664 lekë, janë zbatuar plotësisht **4 masa**, janë në proces zbatimi **6 masa**, ku nga vlera e rekomanduar prej 118,867,664 lekë është arkëtuar vlera 35,246,904 lekë ose 30% dhe mbetet për arkëtim vlera 83,620,749 lekë ose 70%. Nuk janë zbatuar **7 masa organizative.**

#### B. Masa për shpërblim dëmi:

Janë rekomanduar **18 masa** me vlerë **53,616,974 lekë**, nga e cila janë pranuar 15 masa me vlerë 24,854,495 lekë dhe nuk janë pranuar 3 masa me vlerë 28,727,495 lekë për faktin se çështja është në prokurori.

Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,872,504 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 476,194 lekë dhe paarkëtuara vlera 1,396,310 lekë.

Nuk janë zbatuar akoma 9 masa me vlerë 22,981,991 lekë. Nga Sektori i Financës për këto masa akoma nuk është kryer dhe kontabilizimi i vlerave.

#### C. Masat disiplinore:

##### C/I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

**I.** Për 3 punonjës me status të Nënpunësit civil **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Finiq**, që ti kërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” deri në masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga verifikimi rezulton se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Finiq është dhënë si mase disiplinore “**Vërejtje**”.

*C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:*

Për 11 punonjës që trajtohen me kod pune, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Finiq**, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhje të kontratës së punës**”,

Nga verifikimi rezulton se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Finiq është dhënë si mase disiplinore “**Vërejtje**”.

*D. Masa administrative:*

*D/I. Mbi gjokat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.*

I. KLSH me shkresën nr 494/26 prot., datë 20.12.2017 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik R. K , të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **19 personat**.

Nga ana APP ka dale Vendimi nr. 15, date 26.03.2018, dërguar me shkresën nr. 13881/7 date 26.02.2018 dhe protokolluar në Bashkinë Finiq me nr. 647, date 01.03.2018, ku është vendosur që për 18 persona dënim me gjobë në masën 2,190,000 lekë dhe për një person (znj. N. K), është rekomanduar Titullarit të AK marrje masë disiplinore:

Nga ana e Bashkisë Finiq, është kryer njoftimi i personave të cilët janë dënuar nga APP me Vendimin e APP nr. 15, date 26.02.2018, por që nuk është bere kontabilizimi, dhe arkëtimi i detyrimit, sipas Vendimit të mësipërm.

Nga personat të cilët janë dënuar me sanksion gjobe nga ana e APP, është bere ankimimi në Gjykatë, përkatësisht: L. K. , L. M. G. K , I. E dhe E. GJ , e cila, deri në momentin e auditimit nuk është shprehur me vendimet përkatëse.

Nga ana e ish- titullarit të AK , nuk është marre mase disiplinore ndaj N. K, si anëtarë e NjP, si person përgjegjës për hartimin e kriterëve të kualifikimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP (sipas parashikimit ligjor në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës).

Nga ana e AK nuk është bere informimi i APP mbi zbatimin e masave të vendosura sipas Vendimit të APP me nr 15 date 26.02.2018, kjo në respektim të neneve 79/5 dhe 81/3 të VKM nr 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

#### **Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 1233/15, datë 30.04.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”.

#### **Impakti:**

Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën **55,295 mijë** lekë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave drejtues.

**Rëndësia:** I lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 494/21, datë 9.11.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, respektivisht:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- a-Për **7 masa** organizative me vlerë 83,620,749 lekë, konkretisht për pikat;
- b-Për **18 masa shpërblim** dëmi në vlerën **53,140,780 lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;
- c- Për **18 masa** administrative me vlerë **2,190,000 lekë**.

#### Situata:

Në rekomandimet e dhënë me shkresën nr. 494/21 datë 09.11.2017, të miratuar nga Kryetari i KLSH, për auditimin e periudhës 01.01.2015 – 3.3.2017, është konstatuar se Bashkia Finiq nuk është marrë në dorëzim nga ish Komuna Finiq, sot Njësi Administrative “**Tre mjete tip Zetora**” me vlerë kontabël **4,170,200 lekë**, të dhuruara gjatë viteve 1994-1995, mjete të cilat nuk gjendet në ambientet e kësaj njësie, madje nuk disponohet as kartelë edhe pse të regjistruar në llogaritë inventariale të Aktiveve të Qëndrueshme.

Nga Bashkia Finiq me komision është vlerësuar gjendjen e mjeteve (zetorave) me një vlere per secilin prej **1,390,066 lekë**, duke evidentuar personat përgjegjës përkatësisht: Q. Z, P. T dhe S. K , por nuk ka marre masa administrative dhe ligjore per kthimin e tyre ose te arkëtojnë vlerën e demit nga personat qe i kane pasur ne ngarkim, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- Kryetarin e Bashkisë L. H në cilësinë e Nënpunësit autorizues, L. M. me detyrë Drejtorit të Financës në cilësinë e Nënpunësit zbatues.**

#### Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7.

#### Impakti:

Veprime financiare me efekt negativ me vlerë **4,170,200 lekë**, nga mos menaxhim i aseteve

**Shkaku:** Neglizhencë e drejtuesve të bashkisë në marrjen e masave për kthimin e vlere.

**Rëndësia:** E lartë

#### Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **4,170,200 lekë**, të “**Tre mjete tip Zetora**” të pakthyer në Bashkinë Finiq nga personat përgjegjës ose përfaqësues të tyre, si dhe në çdo rast në çdo rast të mos kthimit të mallit ose të kundërvleftës të njoftojë organet përkatëse për veprime të mëtejshme procedurale.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 151 - 155, të Projektraport Auditimit)*

## V. OPINIONI AUDITIMIT

### **I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare në Bashkinë Finiq të periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe vitit 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare, duke bërë vlerësimin e parimeve kontabël të aplikuar, vlerësimet e bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave





financiare.

Bazuar sa më lart dhe mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200, shprehim një **Opinion i kundërt**<sup>10</sup> për pasqyrat e financiare të periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018, pasi nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare të llogarive, referuar kuadrin të raportimit financiar në Sektorin Publik, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe aktet të tjera nënligjore mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

### **Baza për opinionin e kundërt:**

Përgjegjësitë tona janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit (Kap IV/C, faqe 46-65).

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë edhe faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të viteve 2017 dhe 2018 dhe/ose në këtë periudhë nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, është përgjegjësi e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive.

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura, i referohen faktit nga auditimi ka rezultuar se disa llogari të detyrimeve kreditore dhe të drejtave mbi debitorët, nuk pasqyrojnë gjendjen reale në vlera materiale.

Ka llogari të Aktiveve të krijuara në vitet paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, si dhe se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për të saktësuar vlerat në pasqyrat financiare.

## **II. Opinion mbi përputhshmërinë.**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e procedurave të prokurimit, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Finiq mbi zbatueshmërinë e rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, të procedurave të prokurimit në periudhat ushtrimore të vitit 2017, 2018 dhe 2019, bazuar në analizën e riskut<sup>11</sup>.

Ne kemi konkluduar në dhënien e një **Opinion i kundërt**, pasi gjatë auditimit të veprimtarisë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin*”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

### **Baza për opinionin e kundërt:**

Auditimi u krye në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), të cilat janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit (Kap IV/D, faqe 75-132).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore në fuqi, veprime të cilat kanë sjellë anomali materiale dhe të

<sup>10</sup> **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

<sup>11</sup> **Sipas ISSAI 1315 (ISA 315)**, objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt në procedurat e prokurimit.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme<sup>12</sup>, për të siguruar bazën për opinion të kundërt, konkretisht:

- Në hartimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese, arrihet në konkluzionin se Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), nuk ka të argumentuar vendosjen e tyre, duke u mjaftuar vetëm me pasqyrimin dhe përshkrimin e termave të përgjithshme;

- Në kualifikimin e Operatorëve Ekonomik (OE), arrihet në konkluzionin se nuk është bërë i saktë, duke kualifikuar OE me mangësi dhe skualifikuar OE padrejtësisht me oferta më të leverdishme, veprime këto në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt negativ në vlerën 41,773 mijë lekë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.**

Stafi drejtues Bashkia Finiq, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe përdorimin e burimeve financiare të fondeve të prokuruar në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>13</sup>. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin të cilat i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

**Shënim:** Për pasqyrat financiare të vitit 2019, janë audituar llogaritë financiare për veprime të mbyllura deri në datën e përfundimit të auditimit në terren (datë 27.02.2020).

Për këto llogari shprehim një opinion të **kundërt**, pasi ato nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare të llogarive, mangësi këto të konstatuara dhe në pasqyrat financiare të viteve 2017 dhe 2018, të shprehura në pikat nr. 1, 2, 5, 6 dhe 7 të “Masave Organizative”.

## VI. GJETJE DHE REKOMANDIME

<sup>12</sup> Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300)

<sup>13</sup> ISSAI 300, Parimet bazë të auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditim duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimtarive të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektin e auditimit.



### A. MASAT ORGANIZATIVE:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq, u konstatua se për vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk është kryer inventari fizik i Aktiveve të Qëndrueshme të patrupëzuara/ të trupëzuara dhe qarkulluese, veprime të cilat bëjnë që llogaritë e pasqyrave financiare, të mos jenë të besueshme pasi nuk janë të verifikuara me gjendjen fizike të tyre.

Për pasojë, përgatitja e pasqyrave financiare është në shkelje të kërkesave të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” i ndryshuar; Kreu III, pika 30, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe pikave: 74, 77, 83, 85/a dhe b, 86, 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C), faqe 46-68, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa të ngrejë komisionet përkatëse për inventarizimin e Aktiveve të veta në zbatim të kërkesave ligjore.

Për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

**Brenda datës 30.06.2020**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesëm për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore:

- Mos miratimi në Këshillin e Bashkisë, të dy procedurave të prokurimit me vlerë totale 20,731,527 lekë nga të cilat; 1 procedurë prokurimi në vitin 2017 për vlerën 8,262,214 lekë dhe 1 procedurë prokurimi në vitin 2018 për vlerën 12,469,313 lekë, në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe kërkesat e pikës 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

- Mos programimi në buxhetet vjetore si zë më vete, shlyerja e detyrimeve të mbartura nga viti paraardhës, në kundërshtim me pikën 101, të UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, konkretisht *për vitin 2017* në vlerën 39,566 mijë lekë, *për vitin 2018* në vlerën 57,634 mijë lekë dhe *për vitin 2019* në vlerën 60,238 mijë lekë.

-Në programimin e buxheteve afatmesëm (PBA) për periudhat 2017-2019, 2018-2020, 2019-2021, 2020-2022, nuk janë zbatuar të gjithë procedurat ligjore dhe nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, veprime në kundërshtim me nenin 33, 34 dhe 37 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

-Për vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor (të vitit pasardhës), në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

-Nuk janë paguar detyrimet kreditorë të krijuara në vitin ushtrimor si dhe ato të trashëguara nga viteve paraardhëse, megjithëse në fund të vitit ushtrimor, kanë rezultuar gjendje financiare të pa përdorura, konkretisht në fund të vitit 2017 në vlerën 213,132 mijë lekë, në fund të vitit 2018 në vlerën 109,560 mijë lekë dhe në fund të vitit 2019 në vlerën 5,975 mijë lekë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 101, të UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B), faqe 17-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Finiq, të marrë masa për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore në programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesëm, për këtë:

-Të ngrejë në kohën e duhur, grupet e punës sipas projekteve të financimit,

-Të monitorohet zbatimi i kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.

-Të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**2.2 Rekomandimi:** Bashkia Finiq, të marrë masat e nevojshme për programimin dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura duke miratuar një kalendar mbi bazën e mundësive financiare dhe riskut nga penalitete të mundshme.

#### **Brenda afateve ligjore të miratimit të buxheteve**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e pasqyrave financiare 2017, 2018 dhe llogaritë e vitit 2019, u konstatua se nuk janë pasqyruar të gjitha detyrimet që Bashkia Finiq ka ndaj të tretëve për rrjedhje; llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të besueshme pasi nuk pasqyrojnë saktë detyrimet kreditore, *konkretisht:*

**Për vitin 2017,** nuk janë kontabilizuar detyrimet ndaj të tretëve në vlerën totale **59,744,417 lekë** e analizuar; Në llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për 6 fatura që u përkasin 2 subjekteve për vlerën 52,965,810 lekë; Në llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” faturat për energjinë elektrike për vlerën 1,801,755 lekë, faturat e pa paguar nga viti 2016 për shpenzime telefonike për vlerën 144,444 lekë, si dhe detyrime për vendimet gjyqësore të formës së prerë për 8 subjekte në vlerën 4,832,408 lekë.

**Për vitin 2018,** nuk janë kontabilizuar detyrimet ndaj të tretëve në vlerën totale **21,661,591 lekë**, e analizuar;

-Në llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” detyrimet sipas faturës nr. 121 datë 3.12.2018 për vlerën 7,291,104 lekë, si dhe detyrime sipas faturave nr. 22, datë 30.07.2018 dhe nr. 23, datë 30.07.2018 për vlerën totale 5,976,000 lekë, detyrime të cilat janë paguara në vitin 2019;

-Në llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, faturat për energjinë elektrike në vlerën 2,713,788 lekë të përcjella nga O.....E me shkresat nr. 24 prot., datë 16.01.2019 dhe nr. 909 prot., datë 15.12.2018, vlera e faturave të pa paguara sipas gjendjes kreditore të kësaj llogarie në vitin paraardhës të cilat nuk janë pasqyruar në vitin 2018 në vlerën 2,442,506 lekë si dhe detyrime të pa paguara për vendimet gjyqësore të formës së prerë për 6 subjekte në vlerën 3,238,193 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të Kreut III, pika 28 dhe 30, të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C), faqe 46-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave ligjore duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit. Të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit testoi disa nga *komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm*, nga të cilat rezultoi;

-*Mjedisi i kontrollit.* Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të miratuar me Vendim nr. 1739, datë 04.07.2016 të Kryetarit të Bashkisë, por nuk është miratuar kodi i etikës profesionale

Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Lëvizjet e punonjësve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, vlerësohen me risk përse i përket shkallës së kualifikimit të tyre, veprime në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22.

-*Menaxhimi i riskut.* Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, në Bashkinë Finiq, nuk është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.

**-Veprimtaritë e kontrollit.** Në këtë Bashki, nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), veprime të cilat kanë çuar në mos miratimin e Planeve të Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010; ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF nr. 8 dt. 29.3.2012 "Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm", Kap. V.

**-Informacioni dhe komunikimi.** Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.4.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

**-Monitorimi.** Në monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatuan se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore, konkretisht janë konstatuar shumë raste ku marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47 (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/A.1), faqe 11-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së e të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të hartohet regjistri i riskut, kodi i etikës si dhe hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Me Vendim të Këshillit të Bashkisë (VKB) nr. 4 datë 01.04.2016 dhe në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", është miratuar krijimi i Ndërmarrjes "U.....T" SHA me kapital tërësisht; Bashkia Finiq.

Vlera e aseteve që Bashkia Finiq do të investojë në shoqërinë "U.....T" SHA, është rivlerësuar nga ekspertë vlerësues të pasurisë së paluajtshme të licencuar.

Bashkia Finiq, në vitin 2019, ka transferuar në "U.....T" SHA asete në vlerën 350,273,775 lekë.

Procedurat e ndjekura për këto transferta, janë në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi të gjitha këto transferta, me përjashtim të transfertave në chesh, nuk janë miratuar me VKB dhe transfertat në natyrë, nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët.

Për rrjedhojë, nuk janë bërë veprimet kontabël nga ana e Bashkisë Finiq për këto transferta dhe si rrjedhim; llogaritë financiare të vitit 2019, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e aseteve të Bashkisë Finiq për vlerën **350,273,775 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 54/e, dh, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. II, neni 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C), faqe 46-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masat, të ngrëjë komisionin me specialistë të fushës për dorëzimin pranë "U.....T" SHA të aseteve që në fakt i kanë kaluar kësaj Ndërmarrje, si dhe të bëhen veprimet kontabël sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**6. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar 2017-2019, Bashkia Finiq, ka marrë Aktive Afatgjatë materiale nga donator të ndryshëm si dhe grante në natyrë nga Qeveria Shqiptarë, për të cilat nuk janë bërë procedurat e nevojshme ligjore, *konkretisht*.

**A-Dhurime nga donatorë të ndryshëm:**

-Në vitin 2018, dhuruar nga “A.....E”, mjet transporti tip Benz me targa AA....SR, pa vlerësuar në vlerë.

-Zjarrfikëse dhuruar me datë 16.07.2018 nga “K.....I”, pa vlerësuar në vlerë.

-Fugon tip Mercedesedes, dhuruar më datë 14.03.2018, nga Shoqata “F.....V” në Gjermani, pa vlerësuar në vlerë.

-Ambulancë tip “Wolswagen”, copë 2 dhuruar datë 24.04.2019 nga “A.....E”, pa vlerësuar në vlerë.

-Dhuruar nga Shoqata “S.....I” paisje “Kaldaja dhe instalime të tjera” për shkollën 9 vjeçare në Mesopotami në vlerën **totale 5,141,442 lekë**.

Pajisjet nuk janë marrë në dorëzim me komision dhe nuk janë kontabilizuar në llogaritë financiare të vitit.

**B- Grante të Qeverisë Shqiptare:**

Në vitin 2018, Bashkia Finiq, është furnizuar me paisje elektronike; kompjuteri, fotokopjues dhe aksesore të tjerë, nga “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” (AZRT) për vlerën kontabël historike **1,968,750 lekë**.

Furnizimi është bërë sipas kontratës nr. 748 prot., datë 25.10.2016 e lidhur midis Pronarit që është “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. SH dhe përdoruesit Bashkisë Finiq (sipas Fletë daljes të furnitorit nr. 166, datë 19.11.2018), pa komision dhe pa bërë veprimet kontabël për këto hyrje.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në shkëlqje të kërkesave të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 30, 35, 42, 55, 56 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 28, 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C), faqe 46-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masat, të ngrrejë komisionin me specialistë të fushës për vlerësimin me çmim të aseteve të dhuruara nga donatorët, si dhe të inventarizohen në ngarkim të personave që i administrojnë ato.

Të kryen veprimet kontabël për hyrjet e aseteve nga donatorët si dhe grandet nga Qeveria Shqiptare.

#### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2019, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është për vlerën kontabël 20,477,706 lekë. Nga analiza konstatohet se në këtë llogari, gjenden të ngurtësuar fonde për të cilat prej disa vitesh është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë cbllokimi i tyre, për vlerën 3,032,613. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve, e kanë burimin e krijimit nga ish komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Finiq, pra me burim krijimi para vitit 2015.

Drejtoria e Financës, Bashkia Finiq, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet, në kundërshtim me kërkesat e pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në pikan (IV/C), faqet 46-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera dhe të përfunduara në kohë, për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, duke proceduar sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.



**Brenda datës 30.6.2020**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës “*Rikonstruksioni i rrugëve të Bashkisë Finiq*”, me vlerë 14,662,272.60 lekë me TVSH, realizuar nga shoqëria “A...I” SHPK, u konstatua se kontrata e lidhur është e tipit të kombinuar (*Blerje mallra dhe F.V. realizim punimesh ndërtimi nga Drejtoria e shërbimeve në Bashkinë Finiq*).

Nga verifikimi i dokumentacionit teknik në dosje rezultoi se, blerja e materialeve të ndërtimit për rrugët, është realizuar nga shoqëria “A...I” shpk, por nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit për rrugët në fshatrat Fitore, Bregas dhe Karahaxh, lidhur me realizimin e volumeve të punës në objekt nga brigada e shërbimeve në Bashkisë Finiq, u konstatuan se:

- Volumet e pasqyruara në situacionin përfundimtar, nuk janë të njëjta me volumet e preventivit ofertues të miratuar nga Titullari i Bashkisë dhe për këto ndryshime volumesh në dosjen teknike të zbatimit nuk rezultojnë të jetë bërë rishikim i preventivit dhe miratim i tij, apo të hartimit të një procesverbali mbi saktësimin e volumeve mbas azhurnimit të projektit të zbatimit.

- Nga sipërmarrësi i punimeve (Bashkia Finiq) dhe mbikëqyrësi i punimeve (nëpunës i Bashkisë), nuk është mbajtur i gjithë dokumentacioni teknik i zbatimit, në referencë të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 8; UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” të ndryshuar, pika 3.2; UKM Nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, pika 3; UKM Nr.1, datë 16.6.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.1.4, faqet 135-144 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**8.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa që për kontratën me objekt “*Rikonstruksion i rrugëve të Bashkisë Finiq*” dhe në vazhdimësi në realizimin e kontratave (*Blerje mallra + kryerje punime ndërtimi*), të bëjë analizë të saktë paraprake mbi, sigurinë e burimit financiar të investimit, mbulimin me makineri dhe pajisje të domosdoshme për rikonstruksionin/rehabilitimin ose ndërtimin e rrugëve të bashkisë, si dhe në cilësinë e zbatuesit të punimeve të ndërtimit, të hartojë dosjen e plotë teknike të zbatimit të kontratës, në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e ndërtimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) Bashkia Finiq, nuk janë kryer kontrole për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezultojnë të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe Menaxheri i Njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”; Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “*Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/A.2), faqen 17-24 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në njësitet e audituara, të kryej kontrollin e zbatimit të rekomandimeve, të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Finiq nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet, veprime të cilat kanë çuar në mos evidentimin e saktë të të ardhurave nga agjentët tatimor, në kundërshtim me nenin 117, të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar, ligjin nr. 68-2017, “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ” dhe UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për taksat kombëtare” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Finiq, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura.

**10.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Finiq, të marrë masa për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

**Brenda datës 31.07.2020**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me vlera të larta, u konstatua se asnjë nga dosjet e audituara, si dosjet e procedurave dhe të zbatimit nuk është e inventarizuar dhe e numëruara, veprime në ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26; nenin 8- “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 77-135 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**11.1 Rekomandimi:** Sektori i Procedurave të Prokurimit të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara në Sektorin e Arkivës Bashkia Finiq.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në **12 procedura** prokurimi me fond limit 217,044 mijë lekë, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që kanë të bëjnë me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura me aftësinë zbatuese dhe llojit të punimeve apo shërbimeve, vlerën dhe natyrën e kontratës dhe të blerjes së mallrave, si dhe nuk janë argumentuar me procesverbal të veçantë, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, pra në kufizimin e tyre.

Kjo pasi ka rezultuar se në 57.4 % e procedura të zhvilluara (47 gjithsej), janë realizuar me pjesëmarrjen nga 1 deri 2 operatorë ekonomik (OE) me vlerë kontrate 156,847 mijë lekë ose 38.8 %.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 45, 46 dhe 55 të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 77-135 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**12.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Finiq për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nga Bashkia Finiq janë lidhur 2 (dy) kontrata për dhënie me qira të objekteve në pronësi të bashkisë (kontrata nr. 2052, datë 24.07.2019, “Për dhënie me qira të objektit në fshatin Krane, NJA Mesopotam”, me palë qiramarrëse S. Ç. dhe kontrata nr. ska, datë 04.01.2017, “Për dhënie me qira të objektit ish-Vatra e Kulturës, NJA Aliko”, me palë qiramarrëse z. V. C).

Nga auditimi rezultoi se nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e VKM nr. 693, datë 05.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu II, pasi nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet ligjore lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës, si dhe nuk rezultoi të jetë hartuar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Fiq.

procesverbal dorëzimi, genplani i objektit, pamje fotografike, gjendja fizike dhe vlera kontabël, nuk janë dërguar periodikisht pranë degës së Shoqërive Publike Vlorë evidenca e objekteve të dhënë me qira në fillim të çdo viti ushtrimor, nuk rezultoi bashkëlidhur genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**13.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fiq të marrë masa që në të ardhmen jo vetëm të lidhë kontratat bazuar në referencat ligjore, por edhe duke i ndjekur ato, në drejtim të administrimit të dokumentacionit, monitorimit të zbatimit të tyre por edhe të mbajtjes të evidencave dhe bërjes me dije të tyre organeve përkatëse, përfshirë këtu edhe këshillin bashkiak.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**14. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi rezultoi se Bashkia Fiq përveçse shkresës nr. 1235, datë 05.04.2017, drejtuar Ministrisë së Mjedisit, me lëndë: “*Dërgim azhurnimi i të dhënave kadastrale Pyje-Kullota, gjendje 31.03.2017 si dhe problematikën e tyre*”, sipas të cilës është bërë azhurnimi i të dhënave deri më datë 31.03.2017, mbështetur në inventarizimin e vitit 1985, nga ku evidentohen diferencat fakt-dokument, më tej nuk është bërë apo ndërmarrë as edhe një veprim nga strukturat përgjegjëse, konkretisht: - Inventarizimin Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); - Mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; - Mbajtjen, evidentimin, administrimin balancimit të fondit kullosor; - Pasqyrimin në kontabilitet, llogaria nr. 211 “*pyjet, kullotat dhe plantacione*”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie; - Aplikimin e regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Sarandë, sot ASHK Drejtoria Sarandë; - Mbarështimin për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; - Akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes; - Të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, si dhe nuk ekziston asnjë plan mbarështimi menaxhimi të pyjeve dhe kullotave, duke mos u krijuar të ardhura të cilat do të mund të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve; - Kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtiesh, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullosore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 5, 6, 15/2 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005; nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “*Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “*Për fondin kullosor*”, neni 5, pika 2/b, neni 7, 8, 9, 14 dhe neni 15; VKM nr. 799, datë 29.9.2010, “*Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”; VKM nr. 22, datë 09.01.2008, pika 3 e vijim, duke mos gjetur zbatim dhe pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fiq të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës.

Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Fiq, të marrë masa për inventarizimi Kadastral pyjor dhe përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullosor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “*pyjet, kullotat dhe plantacione*”; aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Sarandë; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kriterëve për dhënien me qira të tyre.

**Brenda datës 31.07.2020**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste, janë bërë hyrje materiale inerte si beton, rërë, gurë etj. sipas kontratave të lidhura me të tretët pas procedurave të prokurimit për vlerën totale 22,376,644 lekë, nga e cila; për vitin 2017 në vlerën 11,730,240 lekë, për vitin 2018 në vlerën 1,880,760 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 8,765,644 lekë në vitin 2019. Këto blerje, nuk janë marë në dorëzim me komision, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar neni 37, 42, 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D.1.4), faqe 135-144 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** Bashkia Finiq, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave në kundërshtim me kërkesat ligjore në menaxhimin e fondeve publike dhe marrjen në dorëzim të mallrave/ apo shërbimeve, për blerjet nga të tretët sipas kushteve të kontratave të lidhura me ta.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e rekomandimeve për përmisimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Finiq, KLSH ka njoftuar Bashkinë Finiq me shkresën nr. 494/21, datë 09.11.2017, protokolluar në Bashkinë Finiq me nr. 13881/7prot, datë 26.02.2018.

Bashkia Finiq për zbatim e rekomandimeve të KLSH, **nuk** ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu nuk është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në shkëlqje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se:

**A. Nga 18 masa** organizative për vlerën 118,867,664 lekë, janë zbatuar plotësisht **4 masa**, janë në proces zbatimi **6 masa**, ku nga vlera e rekomanduar prej 118,867,664 lekë është arkëtuar vlera 35,246,904 lekë ose 30% dhe mbetet për arkëtim vlera 83,620,749 lekë ose 70% dhe nuk janë zbatuar **7 masa organizative**.

**B. Janë rekomanduar 18 masa** shpërblim dëmi me vlerë **53,616,974 lekë**. Nga masat e rekomanduar janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,872,504 lekë (*arkëtuar vlera 476,194 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 1,396,310 lekë*) dhe nuk janë zbatuar akoma 12 masa me vlerë 51,744,470 lekë, nga e cila në proces gjyqësor 3 masa me vlerë 28,727,495 lekë.

Nga Sektori i Financës për këto masa akoma nuk është kryer dhe kontabilizimi i vlerave.

**C. Nga ana APP ka dale Vendimi nr. 15, datë 26.03.2018 (shkresa nr. 13881/7 datë 26.02.2018 dhe protokolluar në Bashkinë Finiq me nr. 647, datë 01.03.2018),** ku është vendosur që për **18 persona** dënim me gjobë në masën **2,190,000 lekë** dhe për një person (znj. N. K), është rekomanduar Titullarit të AK marrje masë disiplinore:

Nga Bashkia Finiq, është kryer njoftimi i personave, por që nuk është bërë kontabilizimi, dhe arkëtimi i detyrimit, sipas Vendimit të mësipërm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”; Nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve) (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/E), faqe 144-149 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**16.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 494/21, datë 9.11.2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të bëjë kontabilizimin dhe të nxjerrë urdhër-zhdëmtimeve për shumët e pakontabilizuar, respektivisht:

a-Për **7 masa** organizative me vlerë 83,620,749 lekë, konkretisht për pikat;

b-Për **18 masa** shpërblim dëmi në vlerën **53,140,780 lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për **18 masa** administrative me vlerë **2,190,000 lekë**.

**Brenda datës 31.07.2020**

**17. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Finiq është konstatuar se nuk janë marrë në dorëzim nga ish Komuna Finiq (sot Njësi Administrative) “Tre mjete tip Zetora” me vlerë kontabël **4,170,200 lekë**, të dhuruara gjatë viteve 1994-1995, mjete të cilat nuk gjendet në ambientet e kësaj njësie, madje nuk disponohet as kartelë edhe pse të regjistruar në llogaritë inventariale të Aktiveve të Qëndrueshme.

Me komision është vlerësuar gjendjen e mjeteve (zetorave) me një vlere per secilin prej **1,390,066 lekë**, duke evidentuar personat përgjegjës përkatësisht: Q. Z, P. T dhe S. K , por nuk ka marre masa administrative dhe ligjore per kthimin e tyre ose te arkëtojnë vlerën e demit nga personat qe i kane pasur ne ngarkim, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe ligjit nr. 9228 datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/E), faqe 144-149 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **4,170,200 lekë**, të “Tre mjete tip Zetora” të pakthyer në Bashkinë Finiq nga personat përgjegjës ose përfaqësues të tyre, si dhe në çdo rast në çdo rast të mos kthimit të mallit ose të kundërvleftës të njoftojë organet përkatëse për veprime të mëtejshme procedurale.

**Brenda datës 31.07.2020**

**18. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë FINIQ në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë FINIQ për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2017 - 31.12.2019, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

**Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Finiq), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **77,384,848 lekë** për **72 persona**, si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**1. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimi nr. 99, datë 05.03.2019, është paguar K. E në vlerën **1,176,000 lekë**, për dëmin e shkaktuar nga rënie zjarri në pemëtarinë e mbjellë prej tij (biznes privat), në sipërfaqe të mara me qira nga Bashkia Finiq. Procedurat për shpërblimin e dëmit, janë në shkelje të kërkesave ligjore, *pasi*:

- Në Vendimin e Këshillit të Bashkisë (VKB) nr. 120, datë 29.10.2018 për miratimin e shpërblimit të dëmit, nuk është përcaktuar vlera e ndihmës financiare ndaj z. K. E , por vetëm si fenomen, veprime në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kap. III, pika 1, germa “ë”.

- Vendimi i KB nr. 120, datë 29.10.2018, nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarku Vlorë, në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, Kap. III, pika 1, germa “f”.

- Në VKM nr. 329, datë 16.05.2012, nuk është parashikuar shpërblim dëmi nga fatkeqësitë për bizneset, në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C) , faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,176,000 lekë** nga përfituesi **K. E** .

**Brenda datës 31.07.2020**

**2. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër nr. 34, datë 27.02.2018, të ish- Kryetarit të Bashkisë L. H, është miratuar financimi i shpenzimeve për telefon celulari për **27 punonjës** në shumat nga 600 deri 11,200 lekë në muaj, për vlerën totale 551,531 lekë, vlerësuar me dëm ekonomik, nga e cila: *për vitin 2018 në vlerën 256,015 lekë dhe vitin 2019 në vlerën 295,516 lekë*, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pasjen me numër telefon celular të personave juridikë dhe publikë”, pika 9 dhe 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C) , faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **551,531 lekë** ndaj **27 personat** përfitues, sipas listave në Drejtorinë e Financës.

**Brenda datës 31.07.2020**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 2363 prot, datë 18.08.2017 me objekt “*Rehabilitimi i rrugës Fitore-Aliko*” Bashkia Finiq, me vlerë 69,202,342 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “2....T” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të paguara por të pakryera në objekt, si dhe penalitet për kryerje punimesh jashtë afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës në vlerën **436,837 lekë pa TVSH**, për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Germim toke seksion i detyruar peseta + tombino + ura; F.V tuba b/a 1000 mm dhe Hidroizolim si dhe penalitet për punime jashtë kontrate, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara dhe kryerjes së punimeve të ndërtimit të pamiratuara nga Kryetari i Bashkisë, jashtë afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, në kundërshtim me kontratën nr. 2363 prot, datë 18.08.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D.1.4), faqet 139-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **436,837 lekë pa TVSH** nga shoqëria “2....T” shpk, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe penalitetit për vonesat.

**Brenda datës 31.07.2020**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstrukcion i rrugës Karroq*” Bashkia Finiq, me vlerë 14,632,388 lekë me TVSH



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

bashkëfinancim 3(tre) vjeçar i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Bashkisë Finiq (neni 3 i kontratës), fituar nga Operatori Ekonomik “Y.....Y” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të pakryera, respektivisht për zërat: Cilindrim kasonete; Mure betoni M-200 si dhe Shtresë zhavorri për nivelim 20 cm kanali, në vlerën **446,465 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e situacionimit të volumeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2363 prot, datë 18.08.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Finiq dhe Operatorit Ekonomik “Y.....Y” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D.1.4), faqet 140-141 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **436,837 lekë pa TVSH** nga shoqëria “Y.....Y” SHPK, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.07.2020**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 869 prot, datë 27.03.2019 me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve të Bashkisë Finiq*”, me vlerë 14,662,272.60 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “A...I” shpk, rezultuan diferenca në volume pune për zërin e punimeve “*Emulsion bitumi + transport*” në vlerën 419,448 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 869 prot, datë 27.03.2019 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Finiq dhe shoqëria “A...I” shpk (*Më hollësisht trajtuar në pikan (IV/D.1.4), faqet 142-143 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **419,448 lekë pa TVSH** nga shoqëria “A...I” shpk, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.07.2020**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 2126 prot datë 21.07.2017 me objekt “*Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë*”, Bashkia Finiq, me vlerë 128,609,384 lekë me TVSh, fituar nga shoqëria “2....T” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 635,259 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2126 prot datë 21.07.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D.1.4), faqet 135-136 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **635,259 lekë pa TVSH** nga shoqëria “2....T” shpk, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.07.2020**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 2039 prot, datë 11.07.2017 me objekt “*Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja*”, Bashkia Finiq, me vlerë 59,319,179 lekë me TVSh, fituar nga shoqëria “G.....Y” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 706,106 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2039 prot, datë 11.07.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D.1.4), faqet 138-139 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **706,106 lekë pa TVSH** nga shoqëria “G.....Y” shpk, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.07.2020**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**8. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi procedurat me vlera të vogla, u konstatua se:

- Me urdhër shpenzimin nr. 359 datë 20.11.2017, likuiduar subjekti “V.....I” për vlerën **336,845 lekë**, me objekt “Koktej dhe aktivitete social kulturore”.

Tek ftesa e ofertës së subjektit për aktivitetin e datës 27.10.2017, vlera është për **83,100 lekë**, ndërsa fatura e subjektit në këtë datë është në vlerën **156,000 lekë**. Pra ka një vlerë mbi ofertën e paraqitur prej **72,900 lekë**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1173 datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, kapitulli i II “Procedurat e organizimit” pikat 2,4,5 dhe 6; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 40 “Procedura e prokurimit me vlera të vogla” pika 7; Udhëzimit të APP nr. 1 datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” (Gjerësisht trajtuar në pikën (IV/C.1), faqe 68-77 të Raport Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq me grup pune të analizojë shkeljet e konstatuara në urdhër shpenzimin nr. 359, datë 20.11.2017, për pranimin dhe likuidim e faturës 153, datë 27.10.2017 më shumë se oferta e paraqitur për vlerën **72,900 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj personave përgjegjës, *respektivisht:*

- **Vlera 36,450 lekë**, në ngarkim të **L. H** me detyrë ish- Kryetar i Bashkia Fini, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues;

- **Vlera 36,450 lekë**, në ngarkim të **L. M.** me detyrë Drejtoresh Ekonomike, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.

**Brenda datës 31.07.2020**

**9. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimi nr. 319 datë 23.10.2017, është likuiduar subjekti “T.....D” SHPK për vlerën **817,333 lekë**, me objekt “Riparime në shkollat e Bashkisë Finiq”, i renditur i dyti në radhë me vlerën **611,000 lekë pa TVSh**, pas kërkesës për tërheqje nga subjekti i parë “A.....A”.

Fatura e subjektit fitues “ T.....D” shpk me nr. 10 (seria 38301027), datë 14.09.2017, është në vlerën **681,111 lekë pa TVSh (pa firmosur nga blerësi)**, është më e lartë se oferta që subjekti ka paraqitur në zhvillimin e procedurës për vlerën **70,111 lekë** (oferta e subjektit është 611,000 lekë), veprime financiare me dëm në buxhetin e bashkisë (Gjerësisht trajtuar në pikën (IV/C.1), faqe 68-77 të Raport Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **70,111 lekë pa TVSH** nga shoqëria “ T.....D” shpk.

**Brenda datës 31.07.2020**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe përpunimi i të dhënave mbi evidentimin e konsumit të karburantit, u konstatua se:

- Nuk disponohej një plan shpërndarje, për çdo mjet transporti;

- Në fletudhëtimet e plotësuar për lëvizjet e kryera, nuk disponohet autorizimi, i shoqëruar me një program pune të miratuar nga titullari i këtij institucioni, për lëvizjet e punonjësve;

- Në lidhje me konsumin e karburantit (hyrje/ dalje dhe gjendje), konstatohet se *për vitin 2017*, nuk justifikohet me dokumente dalje sasia prej **4188 litra**, *për vitin 2018* nuk justifikohet me dokumente dalje sasia prej **2032 litra** dhe *për vitin 2019* nuk justifikohet me dokumente dalje sasia prej **1282 litra**. Këto dalje nuk janë evidentuar nëpërmjet magazinës si hyrje dhe dalje prej saj, si dhe nuk paraqiten as gjendje në gjendje në magazinën e Bashkisë Finiq dhe as bërë dalje mjeteve/ agregateve (**Tabela 3.1, bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimit nr. 11, datë 27.2.2020**), veprimet dhe mosveprimet financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e bashkisë për vlerën **1,291,786 lekë**.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10160 datë 15.10.2009 “Per rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nënpunësit civile” neni 2 pika 5; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pikat 35/b, 36, 38 dhe 59 (*Më hollësisht trajtuar në pinë (IV/C.1), faqe 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa që shpërndarja e karburantit të bëhet në bazë drejtorie/ sektori, sipas kërkesave që ato paraqesin, duke argumentuar me sasinë dhe destinacionin e lëvizjes. Në çdo rast fletudhëtimet të shoqërohen me urdhrin e titullarit dhe të plotësohen sipas formatit ligjorë, ku të identifikohet targa e mjetit, personi që do lëvizte, destinacionit dhe km e përshkruar.

**10.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për arkëtimin e vlerës së dëmit prej **1,291,786 lekë** për sasinë e karburantit **7502 litra**, të bërë hyrje dhe të padokumentuar si dalje nga magazina, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët ndaje personave përgjegjës;

- **Vlera 473,774 lekë**, ndaj ish- Kryetarit të Bashkisë Finiq **L. H.**

- **Vlera 112,175 lekë**, ndaj Kryetarit aktual të Bashkisë Finiq **K. K.**

- **Vlera 473,774 lekë**, ndaj ish- Magazinieres **I. K.** deri në muajin qershor 2018, aktualisht me detyrë punonjëse sociale në Qendrën e Solidaritetit dhe Vullnetarizmit

- **Vlera 232,063 lekë**, ndaj magazinierit **V. SH.** nga 8 qershor e vazhdim.

**Brenda datës 31.07.2020**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e kontratave të punëve/ shërbimeve dhe blerjes së mallrave, u konstatua se në **15 raste** nga ana e subjekteve sipërmarrës (fitues të procedurave), nuk janë respektuar afate e përcaktuara në kontratë për përfundimi e punimeve, blerjes së mallrave/ dhe shërbimeve sipas afateve të caktuara. Në këtë rast, nuk është llogaritur dhe kërkuar penalteti sipas kushteve të kontratës, veprime të cilat kanë ndikim negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Finiq për vlerën **18,010,631 lekë**, nga e cila për vitin 2017 në 5 raste me vlerë 7,265,684 lekë, për vitin 2018 në 7 raste me vlerë 6,763,525 lekë dhe për vitin 2019 në 3 raste me vlerë 3,981,422.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pjesa “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 42, 43 dhe 52; Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Kushteve të përcaktuara në kontratat e lidhura midis investitorit (Bashkia Finiq) dhe sipërmarrësit të punimeve lidhur me afatin e zbatimit të saj (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të analizojë situatë dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos respektim të afatit të kontratës së punimeve/ blerjes së mallrave dhe shërbimeve, si dhe të dalin me urdhrat për arkëtimin e dëmit të shkaktuar në buxhetin e Bashkisë në vlerën **18,010,631 lekë**, në ngarkim të subjekteve sipërmarrës, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos ndjekje të kontratës dhe llogaritje të kamatëvonesave, *respektivisht:*

- **Vlera 247,676 lekë**, në ngarkim të subjekti “**K.....I**” SHPK në objektin e prokurimit “Vazhdim i objektit Skema ujitëse SRU – 4, kanali K-K-2 Aliko”, zhvilluar datë 08.03.2019.

- **Vlera 1,503,707 lekë**, në ngarkim të subjekti “**K.....I**” SHPK në objektin e prokurimit “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues”, zhvilluar datë 14.5.2018

- **Vlera 2,819,588 lekë**, në ngarkim të subjekti “**K.....I**” SHPK në objektin e prokurimit “Ndërtim rruge Aliko – Shen Varvara”, zhvilluar datë 20.11.2017.

- **Vlera 873,598 lekë**, në ngarkim të subjekti “**K.....I**” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulik”, zhvilluar datë 29.5.2018.

- **Vlera 3,384,066 lekë**, në ngarkim të subjekti “**D.....A**” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje materiale ndërtimore”, zhvilluar datë 05.02.2019.





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- **Vlera 3,649,012 lekë**, në ngarkim të subjekti “D.....A” SHPK në objektin e prokurimit “Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)”, zhvilluar datë 20.6.2017.
- **Vlera 181,355 lekë**, në ngarkim të subjekti “V.....A” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje mjete teknologjike për mbeturinat urbane”, zhvilluar datë 30.5.2017.
- **Vlera 349,680 lekë**, në ngarkim të subjekti “V.....A” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje mjet gjermimi”, zhvilluar datë 08.03.2019.
- **Vlera 1,250,971 lekë**, në ngarkim të subjekti “SH.....I” SHPK në objektin e prokurimit “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaushe dhe Tremul”, zhvilluar datë 07.06.2018.
- **Vlera 437,089 lekë**, në ngarkim të JV “SH.....I + J.....Y” në objektin e prokurimit “Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/I”, zhvilluar datë 27.3.2017.
- **Vlera 315,187 lekë**, në ngarkim të subjekti “A.....Y” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje kamion vetëshkarkues”, zhvilluar datë 11.5.2018.
- **Vlera 809,676 lekë**, në ngarkim të subjekti “A.....Y” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje automjet VAN për nevojat e bashkisë”, zhvilluar datë 11.5.2018.
- **Vlera 178,640 lekë**, në ngarkim të subjekti “E.....N” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje mjet gjermimi”, zhvilluar datë 18.5.2017.
- **Vlera 1,392,866 lekë**, në ngarkim të subjekti “K.....A” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh”, zhvilluar datë 13.4.2018.
- **Vlera 617,520 lekë**, në ngarkim të subjekti “E.....Y” SHPK në objektin e prokurimit “Blerje automjete zjarrfikëse për nevojat e SHMZSH (copë 2)”, zhvilluar datë 16.7.2018.

**Brenda datës 31.07.2020**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e subjekteve që tregojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre në Bashkinë Finiq, u konstatua se në lidhje me pagesën e tarifës për pajisje me lejet përkatëse të tregtimit të karburantit (autorizime), tarifa për pajisjen me leje tregtimi nuk është llogaritur sipas ligjit, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën **10,800,000 lekë**, kjo pasi nuk është aplikuar tarifa prej 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, pasqyra si vijon:

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	Diferenca për pagesë
1	T.....N	VRION	2,200,000
2	G.....G	SMT	2,100,000
3	K.....A	LIVADHJA	2,100,000
4	B.....L	VRION	2,200,000
5	B.....L	DERMISH	2,200,000
	<b>SHUMA.....</b>		<b>10,800,000</b>

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **10,800,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, sipas pasqyrës mësipërm.

**Brenda datës 31.07.2020**



**13. Gjetje nga auditimi:** Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga **42** procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate 403,322,100 lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore/nënligjore të LPP në **10** procedura me vlerë kontrate 230,995,630 lekë ose 58% e vlerës së kontratave të audituar, duke kualifikuar operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve dhe skualifikuar operatorë ekonomik me mangësi të njëjta/ ose pa mangësi në plotësimin e kriterëve dhe me ofertë ekonomike më të leverdishme se operatorët ekonomik të shpallur fitues nga KVO, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq me vlerë **41,773,524 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2 e nenit 2 “Parimet e përzgjedhjes” dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (*Gjerësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 117 - 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, të konstatuara kjo në **10** procedurat e mëposhtëm, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq me vlerën **41,773,524 lekë pa TVSH**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit në ngarkim të personave përgjegjës të procedurave (në mënyrë të barabartë), *respektivisht procedurat:*

1. “Rruga Fitore – Aliko”, zhvilluar datë 31.3.2017 me fond limit 59,065,322 lekë pa TVSH.
2. “Shpenzime mirembajtje per infrastrukturën rrugore te Bashkisë Finiq (Blerje materiale ndertimi)”, zhvilluar datë 20.6.2017, me fond limit 6,833,334 lekë pa TVSH.
3. “Rehabilitim i rrugës Pllak – Kulluricë”, zhvilluar datë 15.6.2017 me fond limit 111,385,721 lekë pa TVSH.
4. “Blerje automjet per administratën”, zhvilluar datë 7.8.2017 me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH.
5. “Rehabilitim pjesor i sistemit ujitës Vurg – Aliko, kanali K-K-2 dhe K-K-2/1”, zhvilluar datë 27.3.2017 me fond limit 12,157,222 lekë pa TVSH.
6. “Blerje materiale per ndriçim rrugor”, zhvilluar datë 5.6.2017 me fond limit 6,916,667 lekë pa TVSH.
7. “Zgjerim i varrezave publike të fshatrave Aliko, Çaush dhe Tremul”, zhvilluar datë 7.6.2018 me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH.
8. “Blerje automjet PIC AP, copë 4”, zhvilluar datë 12.3.2018 me fond limit 5,000,000 lekë pa TVSH.
9. “Riparim mirëmbajtje në vepra ujitëse dhe kullues”, zhvilluar datë 14.5.2018 me fond limit 4,762,000 lekë pa TVSH.
10. “Blerje Autobuzi per transport udhëtarësh”, zhvilluar datë 13.4.2018 me fond limit 4,166,666 lekë pa TVSH.
11. “Riparim te mjeteve te rënda dhe të rënda”, zhvilluar datë 24.5.2019 me fond limit 3,750,000 lekë pa TVSH.

**Brenda datës 31.07.2020**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacioni mbi zbatimin e punimeve të kontratës nr. 1888, datë 22.6.2017 në objektin “Blerje materiale për ndriçim rrugor”, u konstatua se Bashkia Finiq (Drejtoria Ekonomike), ka likuiduar shoqërinë “V.....A” në vlerën 9,213,312 lekë me TVSH/ ose 7,677,760 lekë pa TVSH.

Referuar kushteve të kontratës nr. 1888, datë 22.6.2017 të lidhur midis investitorit (Bashkia Finiq) dhe sipërmarrësit të punimeve (shoqëria “V.....A”), vlera e kontratës është për shumën



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

8,020,200 lekë me TVSH/ ose 6,683,500 lekë pa TVSH, pra Bashkia Finiq ka likuiduar më shumë subjektin për vlerën 1,193,112 lekë me TVSH/ ose vlera 994,260 lekë me TVSH.

Sipas informacionit të marrë nga L. M. kjo shumë ka lidhje me shtesën e kontratës në masën 20% të kontratës fillestare nr. 2753, datë 27.12.2016 në shumën 4,971,300 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua procedura e ndjekur në lidhje me këtë shtesë kontrate dhe nuk u paraqit nga subjekti audituar për argumentimin e kësaj shtese kontrate.

Nga ana e ish titullarit të AK, nuk ka dalë urdhër prokurimi, i cili duhet të përmbante objektin e prokurimit, fondin limit, llojin e procedurës dhe arsyet e përdorimit të saj, si dhe emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

*Në dosjen e procedurës së prokurimit, mungon publikimi i kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.*

Autoriteti Kontraktor (AK) është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, siç përcaktohet në nenin 1 të LPP, ku parashikon se qëllimi është që të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ulë shpenzimet proceduriale, të nxisë pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet OE, si dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kushtet kur nuk argumentohet dhe dokumentohet shtesa e kontratës, përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është i pambështetur në ligjin e prokurimit publik dhe **vlera 1,193,112 lekë me TVSH/ ose vlera 994,260 lekë me TVSH**, është e paargumentuar dhe me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Finiq, pasi është një shpenzim i paligjshëm, i pa dokumentuar dhe i paargumentuar, referuar procedurës së ndjekur nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 1 e nenit 12 dhe pika 5/a e nenit 33 të ligjit ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Gjerësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 95-135 të Raport Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për likuidimin e vlerës së mallrave mbi vlerën e kontratës fillestare për shumën **994,260 lekë pa TVSH**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin në ngarkim të personave përgjegjës, *respektivisht:*

- **Vlera 331,420 lekë**, në ngarkim të **L. H** me detyrë ish- Kryetar i Bashkisë Finiq, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues;
- **Vlera 331,420 lekë**, në ngarkim të **F. P.** me detyrë ish- Përgjegjës i Sektorit Juridike të Procedurave të Prokurimit;
- **Vlera 331,420 lekë**, në ngarkim të **L. M.** me detyrë Drejtoreshë Ekonomike, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.

**Brenda datës 31.07.2020**

## **B/1. MASA PËR ELEMENIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË TRAJTIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË FINIQ.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;* nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Kryetari i Bashkisë Finiq**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e të ardhurave të munguara në **vlerën 41,976,838 lekë**, si më poshtë vijon:

**1. Gjetje nga auditimi:** Referuar Vendimeve të KB të viteve 2017 dhe 2018, nga Bashkia Finiq është planifikuar **tarifë gjelbërimi**, për subjektet fizike në vlerën 2,000 lekë, subjektet juridike 3,000 lekë dhe abonentë familjarë në vlerën 1,000 lekë,

Referuar njoftim detyrimi që Drejtoria e të Ardhurave Vendore (DAV), nga ana e Sektorit të Vlerësim Planifikimit nuk është bërë i mundur aplikimin e tarifës së gjelbërimit, pavarësisht faktit që në Vendimet e KB është planifikuar, veprime në kundërshtim me Vendimet e KB të viteve 2017 dhe 2018, të cilat kanë çuar në mos planifikim dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Finiq për vlerën **14,396,000 lekë**, në kundërshtim me paketat fiskale të VKB-në nr. 41, datë 20.01.2017 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2017” dhe për vitin 2018, miratuar me VKB-në nr. 78, datë 29.12.2017, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2018” (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqja 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësinë e personave përgjegjës, si dhe të ngarkojë Drejtorinë e të Ardhurave Vendore për planifikimin e tarifës së gjelbërimit për ndaj subjekteve fizik/ juridik dhe abonentëve familjare për vitet 2017 dhe 2018, si një tarifë e miratuar në vendimet respektive të KB, por të paaplikuar nga kjo Drejtori, për të mundësuar arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **14,396,000 lekë**.

**Brenda datës 31.07.2020**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi aplikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (ALUIZNI-t), për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2019), u konstatua se janë legalizuar gjithsej 339 objekte për sipërfaqe ndërtimi 100442 m<sup>2</sup>, me detyrim në vlerën 14,991,799 lekë, nga e cila janë paguar deri me datë 31.12.2019 për 139 subjekte me vlerë 3,636,433 lekë dhe mbetet për arkëtim **200 subjekte me vlerë 11,355,366 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetit e Bashkisë Finiq.**

Gjithashtu nga Bashkia Finiq, ndaj personave përgjegjës nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ZVRPP (sot ASHK), për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie, si dhe të bllokohet procesi i dhënies deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprime në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9632, datë “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e të ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (ALUIZNI-t), nga **200 individ familjarë në vlerën 11,355,366 lekë**, si një e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq.

Të njoftohet ASHK Sarandë, për bllokimin e pasurive të gjithë personave të cilat paraqiten për tu pajisur me certifikatën e pronësisë, pa mundësuar pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

**Brenda datës 31.07.2020**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në 1 (një) rast nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Delvinë, është lidhur kontrata datë 28.09.2001, me subjektin P. Z, përfaqësuar nga S. Z, për një periudhë kohore prej 49 vjet, për sipërfaqen prej 0.15 ha dhe vlerë 100,000/ha ose total 15,000 lekë, kontratë e ndryshuar më vonë me kontratën datë 29.09.2005, për vlerën prej 162,700 lekë/vit, kontratën nr. 5/7, datë 07.02.2012 dhe më tej me kontratën nr. 5/13, datë 30.09.2013, lidhur me subjektin “F.....E”, S. Z, për ndërtimi e një bar restorant prej 300 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe pushimi 1200 m<sup>2</sup> e vlerë qiraje vjetore prej 225,750 lekë.

Për këtë kontratë ka rezultuar se subjekti për periudhën nga viti 2019 e vijim është **debitorë për vlerën prej 201,960 lekë** por nga shqyrtimi i hollësishëm i dosjes të subjektit rezulton e administruar shkresa e protokolluar nga Bashkia Finiq me nr. 3134, datë 16.11.2018 e S. Z, shkresë me të cilën bën me dije bashkinë se është pajisur me leje legalizimi nr. 1011910, datë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

18.05.2018, lëshuar në emër të S. Z, për pasurinë nr. 183/1, me sipërfaqe parcele prej 2025 m<sup>2</sup> nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 675 m<sup>2</sup>, sipërfaqe banimi 226 m<sup>2</sup> dhe për aktivitet 675 m<sup>2</sup>. Bazuar në sa sipër qytetari ka kërkuar që të zbritet nga kontrata e qirasë sipërfaqja prej 675 m<sup>2</sup> dhe të përlllogaritet mbi bazën e sipërfaqes prej 825m<sup>2</sup>. Leja e legalizimit rezultoi se regjistruar në ZVRPP Sarandë për pasurinë 183/ND, në volum 4 faqe 15, me sipërfaqe prej 675 m<sup>2</sup> me shënimin “Kjo pasuri vendoset në hipotekë ligjore në favor të ALUIZNI deri në miratimin e parcelës ndërtimore”.

ALUIZNI nuk ka qenë në kushtet e lëshimit të lejes së legalizimit për shkak se parcela në fjalë është në pronësi të Bashkisë Finiq dhe se subjekti ndërtues ka pasur kontratë qiraje me bashkinë për një periudhë kohore për 49 vjet, po ashtu Bashkia Finiq nuk ka qenë në kushtet e plotësimit të formularit për pagesën e taksës në infrastrukturë për sipërfaqen prej 901 m<sup>2</sup> dhe vlerë 147,507 lekë, kur ky subjekt është kontraktor i bashkisë, dhe veçanërisht nëse do i referohemi nenit 8 të kontratës “Detyrime të përbashkëta të palëve”, sipas të cilës “në fund të periudhës të kësaj kontrate ose në përfundim të saj Qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë, dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.6), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Zyra Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Bashkia Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar **në vlerën prej 201,960 lekë**, si dhe të kërkojnë nga ASHK Drejtoria Sarandë, anulimin e lejes së legalizimit nr. 1011910, datë 18.05.2018, lëshuar në emër të S. Z, për pasurinë nr. 183/1, me sipërfaqe parcele prej 2025m<sup>2</sup> nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 675m<sup>2</sup>, sipërfaqe banimi 226m<sup>2</sup> dhe për aktivitet 675m<sup>2</sup> dhe vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kalimin e pronës në favor të Bashkisë Finiq.

**Brenda datës 31.07.2020**

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Finiq ka trashëguar nga ish-Komunat Finiq dhe Mesopotam, gjithsej 224 kontrata për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë për një periudhë 10, 35 dhe 99 vjeçare, nga të cilat 16 kontrata nga Njësia Administrative Finiq dhe 208 kontrata nga Njësia Administrative Mesopotam, në referim të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, akt i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

- Për Njësinë Administrative Finiq ka rezultuar se deri më datë 31.12.2019, nuk kanë shlyer detyrimet **6 subjekte** për vlerën prej **176,568 lekë** dhe kanë shlyer plotësisht ato 10 subjekte për vlerën prej 45,134 lekë. Kamatë vonesat e përlllogaritura për periudhën e auditimit rezultojnë në vlerën prej **1,442,156 lekë për 14 subjekte**.

-Për Njësinë Administrative Mesopotam ka rezultuar se deri më datë 31.12.2019, nuk kanë shlyer detyrimet **27 subjekte** për vlerën prej **1,194,819 lekë** dhe kanë shlyer plotësisht ato 181 subjekte për vlerën prej 1,828,096 lekë dhe paguar kamatëvonesa 67,863 lekë. Kamatë vonesat e përlllogaritura për periudhën e auditimit rezultojnë në vlerën prej **11,627,986 lekë për 14 subjekte** (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.6), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Bashkia Finiq si dhe Njësitet Administrative Mesopotam dhe Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos kryerja e pagesës në afatin e caktuar në kontratë për tokat e marra me qira dhe mos llogaritja e kamatëvonesa sipas kontratës **në vlerën prej 1,371,387 lekë dhe kamatëvonesa në vlerë 12,822,805 lekë**, si dhe për ato kontrata të cilat ende nuk rezultojnë të zbatuara apo kanë rezultuar në pronësi private dhe jo të bashkisë, të veprohet me prishjen e njëanshme të tyre.

**Brenda datës 31.07.2020**





**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Finiq, ka në territorin e saj 16 kontrata afatgjata për përdorimin e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullësor (nga të cilat 1 kontratë është lidhur nga bashkia dhe 15 kontrata janë të trashëguara nga ministria, Drejtoria e Shërbimit Pyjor apo ish-komunat), sipas tabelës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, kontrata të lidhura në referim të nenit 38 dhe 40, të ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.208 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

Nga auditimi i ndjekjes dhe zbatimit të tyre rezultoi se për periudhën objekt auditimit janë debitorë **8 subjekte** me vlerë **1,727,260 lekë** dhe kamatëvonesa për vlerën prej **102,060 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguar për bashkinë dhe duhet të paguhen nga subjektet e sipërcituara (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.6), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bashkia Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos kryerja e pagesës në afatin e caktuar në kontratë për sipërfaqet e fondit pyjor e kullësor në përdorim, sipas kontratave respektive, nga të **në vlerën prej 1,727,260 lekë** nga mos pagimi i detyrimit që rrjedh nga kontrata dhe **në vlerën prej 102,060 lekë** si të ardhura të munguar të krijuara nga mos llogaritja e kamatëvonesa sipas kontratës.

Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas kushteve të konstantës, të kërkohet prishja e njëanshme e kontratës për mos pagesë detyrimesh.

**Brenda datës 31.07.2020**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 1 (një) rast është lidhur kontrata e qirasë me subjektin “G.....O”, për dhënien me qira për 30 vjet të sipërfaqes prej 50 ha të fondit pyjor e kullësor, për vlerën e kontratës prej 12,100 lekë ha/vit, me destinacion përdorimi “Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

Lidhja e kontratës është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, pasi referenca e përdorur është ajo sipas shtojcës nr. 2.2 “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, pikat 4” me afat 6-10 vjet kohëzgjatje kontrate dhe vlerë 12,000 lekë/ha/vit, kur së pari toka e dhënë me qira nuk është kategorizuar në zërin “tokë me bimësi pyjore djerr” dhe kur qëllimi i përdorimit sipas dokumentacionit të sipërcituar është për mbarështimin e faunës dhe florës dhe ku referenca që duhej të ishte përdorur është sipas shtojcës nr. 3. “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut, pikat 2-4” me afat 6-10 vjet kohëzgjatje kontrate dhe vlerë 20,000 lekë/ha/vit, veprime me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën **11,850,000 lekë** (minimalisht).

Gjithashtu në këtë kontratë konstatohet dhe këto mangësi:

a- Dhënia me qira është bërë pa miratuar më parë në Këshillin Bashkiak të parcelës të ofruar për tu dhënë me qira, qëllimit të përdorimit dhe vlerës minimale të ofertës, pasi me vendimin nr. 72, datë 05.10.2017, KB ka bërë vetëm miratimin në parim të listës së inventarit pyjeve dhe kullotave, për dhënien me qira, dhe nuk ka autorizuar kryetarin për fillimin e ndonjë procedure konkrete

b- Dhënia me qira është bërë në kushtet kur eksperti i fushës (anëtar i komisionit vlerësues) z. S. H nuk ka nënshkruar procedurën e vlerësimit të ofertës.

c- Dhënia e kontratës është bërë për një person jo vetëm i cili rezulton si person fizik (**80 vjeç**), por edhe pa disponuar garanci bankare.

Dhënia e kontratës është bërë në kushtet kur subjekti nuk ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara nga bashkia dhe të bërë publike në buletin e APP.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

d- Lidhja e kontratës rezulton e “paracaktuar”, pasi subjekti fitues rezulton se ka regjistruar objektin e aktivitetit dhe vendin e ushtrimit të tij në QKL, disa ditë para se bashkia të kishte bërë shpalljen në buletin të njoftimit dhe për më tepër me vend ushtrimi aktiviteti në parcelë në pronësi të bashkisë, kur për këtë procedurë rezulton të kenë pasur dijeni para shpalljes së saj vetëm titullari i bashkisë dhe juristi, dhe është përjashtuar nga procedura Drejtoria e Shërbimit Pyjor Bashkia Finiq.

e- Lidhja e kontratës është bërë në kushtet kur bashkia nuk ka pasur të regjistruar në ASHK (ish ZVRPP Sarandë) pronën objekt kontrate, si dhe përpilimi dhe nënshkrimi i saj është bërë jashtë zyrës së protokoll arkivit të bashkisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.6), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bashkia Finiq, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos llogaritja e saktë e vlerës së kontratës me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën **11,850,000 lekë**.

**6.2 Rekomandimi:** Të merren masa të menjëhershme për rilloqaritje e periudhës së vlefshmërisë së kontratës sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, duke e shtrirë afatin e vlefshmërisë së saj deri në 10 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**Brenda datës 30.07.2020**

**7. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Finiq ka të trashëguara nga ish-Komuna Livadhja 3 (tre) kontrata qiraje të lidhura me operatorë të ndryshëm të telefonisë mobile dhe *konkretisht:*

**1. Kontrata nr. 5108 rep. dhe 2588 kol. datë 08.11.2007,** “Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile”, me palë qiradhënëse Komuna Livadhja, përfaqësuar nga kryetari dhe me palë qiramarrëse shoqëria “T.....A” sh.a., për sipërfaqen prej 300 m<sup>2</sup> me çmim prej 330,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 17.09.2016, zgjatur afati me kontratën nr. ska, datë 25.11.2016. Kontrata është llogaritur për vlerën prej 330,000 lekë x 9 vjet = 2,970,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 300 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 108 muaj = 3,240,000 lekë, shumë të cilët i duhet zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 2,970,000 = **270,000 lekë**, të ardhura të munguara me dëm ekonomik për ish-Komunën Livadhja.

Kontrata e lidhur rishtazi është lidhur me po të njëjtat kushte si dhe kontrata e mëparshme, pra me tarifë fikse prej 330,000 lekë në vit, ose 27,500 lekë/muaj kur në fakt duhej lidhur 300 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 12 muaj = 360,000 lekë, pra më shumë për vlerën prej 30,000 lekë, ose duhej më shumë në vlerën prej 2500 lekë/muaj.

Moszbatimi i rekomandimeve të KLSH për rregullimin e vlerës mujore të qirasë në rilidhjen e kontratës, me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën prej **337,500 lekë**, nga të cilat 270,000 nga kontrata e mëparshme dhe 67,500 lekë nga kontrata aktuale + (27 muaj sipas kontratës (deri 1.12.2019) x 2500 lekë/m<sup>2</sup> = 67,000 lekë).

**2. Kontrata datë 01.08.2010,** “Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile”, me palë qiradhënëse Komuna Livadhja, përfaqësuar nga kryetari dhe me palë qiramarrëse shoqëria “P.....N” sh.a., për sipërfaqen prej 400 m<sup>2</sup> me çmim prej 350,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 31.07.2019.

Kontrata është llogaritur për vlerën prej 350,000 lekë x 9 vjet = 3,150,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 400 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 108 muaj = 4,320,000 lekë, shumë të cilët i duhet zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 3,150,000 = **1,170,000 lekë**, të ardhura të munguara me dëm ekonomik për ish-Komunën Livadhja.

Këto kontrata kane qenë objekt auditimi dhe në kontrollin e mëparshëm dhe nga Bashkia Finiq (personat përgjegjës), nuk është vepruar për zbatimin e tyre, veprime në kundërshtim me nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Trajtuar gjëresisht në pikën (IV/B.6), faqe 24-46 të Raport Auditimit*).

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat fillimisht për kontabilizimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë si dhe më tej duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos llogaritja e saktë e vlerës së kontratës për vlerën prej **1,507,500 lekë**, konkretisht:

- **Vlera 337,500 lekë** nga subjekti “T.....A” sh.a.

- **Vlera 1,170,000 lekë** nga subjekti “P.....K” sh.p.k.

**Brenda datës 31.07.2020**

## B/2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të ndjekura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor), u konstatua se në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e debitorëve për subjektet fizik/ juridik dhe abonentët familjare paraqitet në vlerën **105,898,316 lekë**, nga e cila:

d- 204 subjekte fizik/ juridik me vlerë 14,742,473 lekë për taksat pasurisë, tokës, ndërtesës, hapësirave publike dhe tarifave vendore.

e- 4539 abonentët familjarë me vlerë 91,155,843 lekë, për taksën e pasurisë dhe tarifave vendore.

Nga të dhënat e mësipërme, detyrimet të abonentëve familjar janë në vlera të larta për vlerën vlerë 91,155 mijë lekë ose 77.5 % e totalit të detyrimeve, veprime në kundërshtim me pika 2 e nenit 23 dhe Kreut XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime dhe nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/B.4), faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **105,898,316 lekë**, si më poshtë vijon:

**a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare**, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

**b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

**c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat**, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare** dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

**e- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me 4 Njësitë Administrative, respektivisht: Livadhja, Dhiver, Aliko dhe Mesopotam**, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

**Brenda datës 13.12.2020**

### **B/3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET (3E), TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatuan se në vitet 2018 dhe 2019, janë kryer shpenzime transporti urban për komunitetin në itinerarin Livadhja- Finiq- Sarandë e kthim pa pagesë duke shpenzuar karburant gjithsej 7044 litra me vlerë **1,232,700 lekë**. Ky shërbim nuk është miratuar me Vendim të KB, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9, pikat 1.2/ c dhe neni 54/dh (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C), faqe 68-69 të Raport Auditimit*).

**1.2 Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Finiq, të analizohet rasti përsa janë kryer shpenzime pa u miratuar nga Këshilli i Bashkisë, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të sipërcituara, në kundërshtim me kërkesat ligjore në menaxhimin e fondeve publike.

#### **Menjëherë e në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga **42** procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate 403,322,100 lekë pa TVSH, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në **14** procedura me vlerë kontrate 136,713,771 lekë ose 38.9% e vlerës së kontratave të audituar, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK).

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duhej anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet (3E) për vlerën **136,713,771 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2 e nenit 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (*Gjerësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 95-135 të Raport Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet (3E) për vlerën **136,713,771 lekë pa TVSH**.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Finance në Bashkinë Finiq me *urdhër shpenzimin nr. 369/1, datë 14.8.2018* është kryer pagesa ndaj subjekti “E.....O” në vlerën 912,000 lekë me objekt prokurimit “Program për përmisimin e sistemit kompjuterik të tatimeve”, sipas faturës nr. 44 (seri 89767181), datë 5.7.2018 (hyrje në bashki me FH nr. 31, datë 13.7.2018). Fatura është nënshkruar nga ish- Kryetari i Bashkisë L. H, kjo referuar kontratës nr. 1679, datë 26.6.2018 për vlerën 760,000 lekë pa TVSH/ ose 912,000 lekë me TVSH.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Nga dokumentacioni, konstatohet se nuk është ndjekur asnjë procedurë qoftë dhe me blerje me vlera të vogla, ku tregon se subjekti “E.....A” të jetë shpallur fitues, por është bazuar vetëm në kontratën nr. 1679, datë 26.6.2018.

Sipas deklarimit verbal të Drejtorit të Taksave Bashkia Finiq dhe nga verifikimi në vend mbi funksionimin e këtij programi, u konstatua se ky sistem nuk funksionon, veprime të cilat bëjnë që shpenzimi i kryer të jetë pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet për vlerën **760,000 lekë pa TVSH**, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 24.04.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C.1), faqe 68-77 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera në *urdhër shpenzimin nr. 369/1, datë 14.8.2018 me vlerë 912,000 lekë*, si dhe të dalin me vlerësim nëse kemi një perdorim me mos efektivitet dhe efikasitet të këtyre shpenzimeve apo nëse i është shkaktuar dem buxhetit të Bashkisë në vlerën **760,000 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar për zhdëmtim personat përgjegjës.

**Brenda datës 31.07.2020**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit për procedurën e blerjes me vlera të vogla me objekt “*Blerje uniforme për policinë*”, u konstatua se për blerjet e kryera është aplikuar me prokurim nën 100,000 lekë, pasi vlera e përdorur ka tejkaluar këtë limit, duke çuar dhe në copëzim fondesh. Mungonin specifikimet teknike se çfarë të dhënash duhet të plotësojnë uniformat e blera. Në disa raste mungonte proces verbal i marrjes në dorëzim i mallrave, nga komisioni i marrjes në dorëzim, mangësi këto të konstatuara në *urdhër shpenzimin nr. 418 datë 23.12.2017*, për vlerën 41,000 lekë, likuiduar subjekti “B.....I”. Me *urdhër shpenzimin nr. 217 datë 14.05.2018*, është likuiduar subjekti “B.....I”, për vlerën 30,700 lekë. Me *urdhër shpenzimin nr. 347 datë 10.11.2017*, është likuiduar subjekti “A.....I”, për vlerën 238,128 lekë.

Me *urdhër shpenzimin nr. 238 datë 10.08.2017*, për vlerën 352,303 lekë, zhvilluar me procedure “*Blerje me vlera të vogla*” në mënyrë elektronike, ku një nga elementet e preventivit është dhe Panel elektrik (pinaka) trefazor 5.5 K $\hat{w}$ . Në dokumentacionin bashkangjitur mungojnë specifikimet teknike se çfarë kushtesh duhet të plotësojnë mallrat që do të blihen, blerje e realizuar me faturën nr 60 datë ----/06/2017, bere hyrje me flete hyrjen nr 29 datë 01.07.2017, fature e cila nuk ishte plotësuar me të gjitha të dhënat për mallin e blere (*panëshkruar nga Bashkia Finiq*).

Nuk ka një proces verbal nga komisioni mbi marrjen në dorëzim të materialeve të blera veçanërisht “Paneli elektrik” 5.5 K $\hat{w}$ , duke trajtuar specifikimet teknike që duhet të plotësonte paneli, si dhe procesverbal mbi arsyen e skualifikimit të subjekti “E.....I” me ofertë më të leverdishme se fituesi 346,800 lekë.

Me *urdhër shpenzimin nr. 238 datë 10.08.2017*, për vlerën 833,304 lekë, zhvilluar me urdhrin e prokurimit nr. 29 datë 03.07.2017, për procedure “*Blerje me vlera të vogla*”, me fond limit pa TVSh 800,000 lekë. Procedura e përcaktuar me vlera të vogla nuk duhej të ishte realizuar pasi ka kaluar limiti që duhej, ku duhej të realizohej, me procedurën “*kërkese për propozim*”.

- Është likuiduar subjekti “A.....I”, me objekt “*Blerje materiale për “U.....T”*”.

Me *urdhër shpenzimin nr. 347 datë 10.11.2017*, për vlerën 357,876 lekë për “*Shpenzime për uniforma*” në vlerën 238,128 lekë dhe “*Materiale për “U.....T”*” në vlerën 119,748 lekë.

Nuk disponohej bashkangjitur dokumentacioni mbi procedurën e ndjekur, fondin të planifikuar, preventivi mbi mallrat që do blihen, specifikimet teknike për kushtet që duhet të plotësojnë mallrat që do të bliheshin, etj. Nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me blerjen uniformave. Nuk ka ftesë për ofertë të shoqërive pjesëmarrës.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, pika 1; Udhëzimit të MF me nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, tek kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pika 36 dhe 37; pikën 5, të Udhëzimit të APP nr. 1 datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” (Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/C.1), faqja 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera në urdhër shpenzimet nr. 418, datë 23.12.2017, likuiduar subjekti “B.....I”, për vlerën 41,000 lekë, nr. 217 datë 14.05.2018, likuiduar subjekti “B.....I”, për vlerën 30,700 lekë dhe nr. 347 datë 10.11.2017, likuiduar subjekti “A.....I”, për vlerën 238,128 lekë, urdhër shpenzimin nr. 347, datë 10.11.2017 me vlerë 357,876 lekë, duke përlllogaritur vlerën e demit dhe ngarkuar për zhdëmtim personat përgjegjës.

**Brenda datës 31.07.2020**

## C. MASA DISIPLINORE:

### C/1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, si më poshtë:

**a- “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, për 1 (një) punonjës;**

**1. V. L.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

**Për shkeljet e konstatuara**, në moszbatimin e kontratës me objekt “Zgjerim i varrezave publike të fshatit Aliko, Çaushe dhe Tremul”, zhvilluar me datë 7.6.2018, për vlerën e kamatës 1,250,971 lekë, për mos përfundimin e tyre në afatet e caktuara në kontrata dhe mos marrjen e masave për aplikimin e penalteteve sipas kushteve të kontratave.

**Në kontratën e zbatimit me nr. 869, datë 27.03.2019** me objekt: “Rehabilitim i rrugëve të Bashkisë Finiq”, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik (OE) “A....I” SHPK, me pasojë:

- Dëm ekonomik në vlerën 419,448.75 lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume punë të likuiduara por të pakryera në fakt, për zërin e punimeve “Spërkatje me prajmeri”.

Për mos argumentimin e blerjeve të materialeve gur kave dhe çakull mbeturinë me fatura tatimore.

- Mos plotësimin e dosjes së plotë tekniko-ligjore të zbatimit të punimeve, në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e ndërtimit.

**Në kontratën e zbatimit me nr. 869, datë 27.03.2019**, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Karroq, Bashkisë Finiq”, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik (OE) “Y.....Y” SHPK, me pasojë:



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

- Dëm ekonomik në vlerën 446,465.60 lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume punë të likuiduara por të pakryera në fakt, për zërat e punimeve “Cilindrim kasonete; Mure betoni M-200 për kanale anësore, Shtresë zhavorri për nivelim 20 cm kanali”.
- Për mosplotësim të dokumentacionit tekniko-ligjor (libreza e masave; deklarata teknike, procesverbale të ndryshme, njoftim për fillimin e punimeve, akti i piketimit, akt dorëzimi i sheshit, etj., në zbatim të kuadrit ligjor të zbatimit të punimeve të ndërtimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.1.4, faqe 137-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **b- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 3 (tre) punonjës.**

**1.TH. Z.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave Vendore.

- **Për shkeljet e konstatuara**, në administrimin e të ardhurave vendore, në planifikim/aplikim të vlerës së detyrimeve dhe në ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizike/ juridik dhe abonentë familjarë, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF Nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.4, faqen 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. V. B.**, me detyrë Specialiste e Vlerësimit dhe Planifikimit

**3. Z. D.**, me detyrë Specialist i Vlerësimit dhe planifikimit.

- **Për shkeljet e konstatuara**, në administrimin e të ardhurave vendore, në planifikim/aplikim të vlerës së detyrimeve dhe në ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizike/ juridik dhe abonentë familjarë, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF Nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.4, faqen 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Finiq**, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, si më poshtë:

### **a- “Me gjobë” në zbatim të shkronjës (c) të nenit 9 të kontratës individuale, për 2 (dy) punonjës.**

**1. K. TH**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e personit përgjegjës për marrjen në dorëzim të materialeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

**Për shkeljet e konstatuara**, në moszbatimin e kontratave të punimeve/ shërbime dhe blerjeve të mallrave, për mos përfundimin e tyre në afatet e caktuara në kontrata dhe mos marrjen e masave për aplikimin e penalteteve sipas kushteve të kontratave (*Trajtuar gjerësisht në pikën IV/D, faqe 135-144 të Raportit Auditimit*), konstatuar kjo në procedurën, si vijon:

a- Procedura me objekt “*Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike*”, zhvilluar me datë 29.5.2018, për vlerën e kamatës 873,598 lekë;

b- Procedura me objekt “*Blerje kamion vetëshkarkues*”, zhvilluar me datë 11.5.2018, për vlerën e kamatës 315,187 lekë dhe,

- **Në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve**, të konstatuara në zbatimin e punimeve për kontratën e zbatimit me nr. Prot. 869 datë 27.03.2019 me objekt: “*Rehabilitim i rrugëve të Bashkisë Finiq*”, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik “A...I” SHPK, për:

a- Dëm ekonomik në vlerën 419,448.75 lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume punë të likuiduara por të pakryera në fakt, për zërin e punimeve “*Spërkatje me prajmeri*”.

b- Për mos argumentimin e blerjeve të materialeve, gur kave dhe çakull mbeturinë me fatura tatimore.

c- Mos plotësimin e dosjes së plotë tekniko-ligjore të zbatimit të punimeve, në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e ndërtimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.1.4, faqe 135-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. L. M.** me detyrë Drejtore e Financës, në cilësinë Nënpunësit Zbatues.

- **Për shkeljet e konstatuara**, në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019, pa kryer më para inventarizimin fizik të Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara, Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve Qarkulluese, në shkelje të kërkesave të Kreu II, neni 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyra financiare*” i ndryshuar, Kap. II, pika 3 të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor*” i ndryshuar, Kreu III, pika 30, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” dhe pikave; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar.

- Mos programimin në buxhetet vjetore si zë më vete, shlyerja e detyrimeve të mbartura nga vitet paraardhëse, në kundërshtim me pikën 101, të UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 “*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar.

- Mos pasqyrimi në pasqyrat financiare 2017, 2018 dhe llogaritë e vitit 2019, të gjitha detyrimet që Bashkia Finiq ka ndaj të tretëve;

- Mos zbatimin e procedurave të nevojshme ligjore për kontabilizimin e Aktive Afatgjata të material që Bashkia Finiq ka marë nga donator të ndryshëm si dhe grante në natyrë të Qeverisë Shqiptare, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 30, 35, 42, 55, 56 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kreu III, pika 28, 30.

- Nuk janë bërë procedurat ligjore dhe veprimet e nevojshme kontabël përsa Bashkia Finiq, ka transferuar për “U.....T” Sha asete në vlerën 350,273,775 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar neni 54/e, dh, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pikat 35/a, b, 42, 44 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kap. II, neni 17 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 46-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### ***b- “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, e parashikuar në shkronjës (b) të nenit 9 të kontratës individuale, për 6 (gjashtë) punonjës.***

1. **P. B**, me detyrë Specialist i mbrojtjes së konsumatorit në Drejtorinë e DAMT.

2. **V. J**, me detyrë Drejtor Drejtoria Ujitje Kullimit dhe Mbrojtjes së Brigjeve,

3. **K. D**, me detyrë Specialist I menaxhimit të tokës në Drejtorinë e DAMT

4. **K. S**, me detyrë Drejtor i DAMT.

**Për mangësitë e konstatuara**, në administrimin e kontratave të qirave të pyjeve/ kullotave etj, si dhe ndjekjen e procedurave në arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiletozë të pasurive shtetërore”; Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.4, faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5- **I. K.**, me detyrë specialiste në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në cilësinë e ish-Magaziniere deri në muajin qershor 2018.

6- **V. SH.**, me detyrë magazinier nga muaj qershor 2018 e vazhdim.

**Për shkeljet e konstatuara**, në mos dokumentimin e sasinë së karburantit të bërë dhe të pa bërë dalje sipas sektorëve/ punonjësve, për vlerën 1,291,786 lekë, në kundërshtim me Ligjit 10296, datë 08. 07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, pika 35/b,36 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C.1, faqe 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **C/3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE PA ADRESIM INSTITUCIONAL**

**Për 2 ish-punonjësit**, konkretisht: **F. P.** me detyrë ish- Përgjegjës në Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të KVO dhe **L. K.** me detyrë me detyrë ish- Përgjegjës në Sektorin Juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të NJHDT, të cilët aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Finiq, referuar shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, masa e rekomanduar do ishte **“Largim nga Shërbimi Civil/ dhe Zgjidhje e kontratës së punës”**, pasi:

- Kriteret e vendosura në procedurat e audituara, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe të paargumentuara, ku në disa raste kanë ulur numrin e pjesëmarrësve në procedurë, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike”.

- Në shpalljen e operatorëve ekonomik fitues në procedurat e audituara, nuk është mbajtur qëndrim i njëjtë në lidhje me operatorët pjesëmarrës në procedurë, duke kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST dhe skualifikuar operatorë me pa mangësi/ ose mangësi të njëjta, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë **“çmimi anomalisht më i ulët”**, veprime në kundërshtim me neni 1- **“Objekti dhe qëllimi”**, pika 2 e nenit 2- **“Parimet e përzgjedhjes”**, neni 24- **“Anulimi i një procedure prokurimi”**, neni 53- **“Shqyrtimi i ofertave”**, neni 55- **“Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”** të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/D), faqe 77-137 të Raport Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 5, 6 dhe 7, datë 27.02.2020*).





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

#### E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

#### F. MASA ADMINISTRATIVE:

##### F/1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), Bashkia Finiq.

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a), të ligjit nr. 9780, datë 16/7/2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë FINIQ**, që t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës, si më poshtë:**

**Për R. T.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në:

**a-** Kontratën nr. 2126 prot datë 21.07.2017, në objektin "*Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë*", Bashkia Finiq, me sipërmarrës punimesh shoqërinë "2....T" SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **635,259 lekë pa TVSH** dhe me kontratën nr. 2039 prot, datë 11.07.2017, në objektin "*Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja*", Bashkia Finiq, me sipërmarrës punimesh shoqërinë "G.....Y" SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 706,106 lekë pa TVSh, si diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**b-** Për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën e zbatimit të punimeve, me Nr. Prot. 2363 prot, datë 18.08.2017 me objekt: "*Rehabilitimi i rrugës Fitore - Aliko*", Bashkia Finiq me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik "2.....T" SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **436,837 lekë pa TVSH**, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt (*Trajtuara gjerësisht në kapitullin IV/D.1.4, faqe 135-144 të Raport Auditimit*).

**Menjëherë**

#### VII. ANEKSE

**Anekset janë pjesë përbërëse e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.**





## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë  
Finiq.**

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



**PASQYRAT ANEKS QË SHOQËROJË**  
**PROJEKTRAPORT AUDITIMIN**  
**NË**  
**SUBJEKTIN BASHKIA FINIQ**



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

### ANEKSET

#### **Vlerësimi i riskut të kontrollit;**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet, niveli i precizonit pranohet në vlerën 5,945 mijë lekë për vitin 2017, vlerën 7,429 mijë lekë për vitin 2018 dhe vlera 4,997 mijë lekë për vitin 2019, për tu konsideruar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë: - Risku i lidhur me shpenzimin specifik; - Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi për periudhën 2017-2018-2019, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikulli buxhetor : Precizoni x Faktor risku)

Niveli i materialitetit për vitin 2017-2018-2019, është përlllogaritur sipas tabelave të mëposhtme:

Bashkia FINIQ Viti 2017 NE 000/LEKE				Bashkia FINIQ Viti 2018 NE 000/LEKE				Bashkia FINIQ deri 30.9.2019 NE 000/LEKE			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar	Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar	Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	106,907	0.70	13	Paga (600)	121,053	0.70	11	Paga (600)	127,869	0.70	18
Sigurime Shoqërore (601)	17,349	0.70	2	Sigurime Shoqërore (601)	20,098	0.70	2	Sigurime Shoqërore (601)	22,040	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	62,010	0.70	7	Mallra e Shërbime (602)	84,748	0.70	8	Mallra e Shërbime (602)	71,019	0.70	10
Subvencione (603)		0.60	0	Subvencione (603)		0.60	0	Subvencione (603)		0.60	0
Princila + Interesa		0.60	0	Princila + Interesa		0.60	0	Princila + Interesa		0.60	0
Investime të brend. (230-231)	179,679	2.00	60	Investime të brend. (230-231)	231,513	2.00	62	Investime të brend. (230-231)	87,525	2.00	35
Te tjera transfer. korren (604)	1,001	0.70	0	Te tjera transfer. korren (604)	1,004	0.70	0	Te tjera transfer. korren (604)		0.70	0
<b>Total</b>	<b>366,946</b>			<b>Total</b>	<b>458,416</b>			<b>Total</b>	<b>308,453</b>		
Materialiteti në %	2%			Materialiteti në %	2%			Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>7,339</b>			<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>9,168</b>			<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>6,169</b>		



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Finiq.

Bashkia FINIQ Viti 2017 NE 000/LEKE			
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>7,339</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	734		
<b>Nëntotali</b>	<b>6,605</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>5,945</b>		

Bashkia FINIQ Viti 2017 NE 000/LEKE			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	155,778	0.70	16
Të ardhura te trashëguara	212,511	0.70	21
Të ardhurat e veta	60,369	0.70	6
<b>Total</b>	<b>428,658</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>8,573</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>8,573</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	857		
<b>Nëntotali</b>	<b>7,716</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>6,944</b>		

*Shënim: Te dhënat janë marra nga pasqyrat e subjektit*

Bashkia FINIQ Viti 2018 NE 000/LEKE			
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>9,168</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	917		
<b>Nëntotali</b>	<b>8,251</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>7,426</b>		

Bashkia FINIQ Viti 2018 NE 000/LEKE			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	279,831	0.70	22
Të ardhura te trashëguara	202,858	0.70	16
Të ardhurat e veta	63,223	0.70	5
<b>Total</b>	<b>545,912</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>10,918</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>10,918</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,092		
<b>Nëntotali</b>	<b>9,826</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>8,844</b>		

*Shënim: Te dhënat janë marra nga pasqyrat e subjektit*

Bashkia FINIQ deri 30.9.2019 NE 000/LEKE			
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>6,169</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	617		
<b>Nëntotali</b>	<b>5,552</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>4,997</b>		

Bashkia FINIQ deri 30.9.2019 NE 000/LEKE			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	158,183	0.70	22
Të ardhura te trashëguara	91,072	0.70	13
Të ardhurat e veta	58,337	0.70	8
<b>Total</b>	<b>307,592</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>6,152</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>6,152</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	615		
<b>Nëntotali</b>	<b>5,537</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>4,983</b>		

*Shënim: Te dhënat janë marra nga pasqyrat e subjektit*



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Aneksi A/4

**PASQYRAT SHOQËRUSE TË NJAB, MBI AKTIVITETIN 2017 – 2019**

**Pasqyra e angazhimeve në misione auditimi, viti 2017**

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit në vitin 2017									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhim e të përfunduar	Angazhim e në proces
			A. të përputhsh mërisë	A. të performan cës	A. financiare	A. tek. Informaci onit	A. të kombinua ra				
1	Bashkia Finiq ( Dhënie shërbim këshillimi)	1						1		1	
2	Bashkia Finiq ( Drejtoria e Financës/ struktura e prokurimeve/ administrimi i te ardhurave, etj)	1			1					1	
3	Krijimi dhe funksionimi i 4 njësive administrative	1	1							1	
	<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>

**Pasqyra e angazhimeve në misione auditimi, viti 2018**

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit në vitin 2018									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhim e të përfunduar	Angazhim e në proces
			A. të përputhsh mërisë	A. të performan cës	A. financiare	A. tek. Informaci onit	A. të kombinua ra				
1	Bashkia Finiq ( Drejtoria e Financës/ struktura e prokurimeve/ administrimi i te ardhurave, etj)	1									1
2	Krijimi dhe funksionimi i 4 njësive administrative	4	4							4	
	<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>1</b>





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

**Pasqyra e angazhimeve në misionet e auditimit, viti 2019**

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit në vitin 2019									
		Gjithsej	Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit	
			Shërbime të Sigurisë nga të cilat:							Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara	Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit					
1	Drejt. Financës/ Auditimi i detyrimeve të prapambetura	1	1						1		
2	Shoqëria “Ujësjetës kanalizime” sht. Finiq, mbi krijimin dhe funksionimin e shoqërisë.	1	1						1		
3	Bashkia Finiq ( Dhënie shërbim këshillimi)	1					1		1		
<b>Totali</b>		<b>3</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>

**Pasqyra e gjetjeve me shpërblim dëmi, viti 2018**

000/lekë

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT										Shuma e dëmit ekonomik
		Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq. sig. Shendetesore, përkujdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie	Privatizime, shitje, qiradhënie	Koncesione, ankande	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, subvencione	Të tjera	
a.	1	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.10	3
1	Njësitë administrative				32							32
<b>Totali</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>32</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>32</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Pasqyra e gjetje me shpërblim demi, viti 2019

000/lekë

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT										Shuma e dëmit ekonomik
		Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shendetesore, përkujdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie	Privatizime, shitje, qiradhënie	Koncesione, ankande	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, subvencione	Të tjera	
<b>a.</b>	<b>1</b>	<b>2.1</b>	<b>2.2</b>	<b>2.3</b>	<b>2.4</b>	<b>2.5</b>	<b>2.6</b>	<b>2.7</b>	<b>2.8</b>	<b>2.9</b>	<b>2.10</b>	<b>3</b>
1	Bashkia Finiq	116,702	300				21,117				19	138,138
2	Shoq. "Ujësjiellës - kanalizime" sha Finiq	246	649								1	896
	<b>Totali</b>	<b>116,948</b>	<b>949</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>21,117</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>20</b>	<b>139,035</b>

Gjatjet sipas fushave të aktivitet, viti 2018

Ne/ numër

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE										Gjithsej
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	
<b>1</b>	<b>Njësia Administrative Aliko</b>		<b>2</b>		<b>1</b>						<b>7</b>	<b>10</b>
	Masa Organizative		2								6	8
	Masa Shpërblim demi				1						1	2



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE										Gjithsej
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	
2	<i>Njësia Administrative Livadhja</i>				1						9	10
	Masa Organizative										8	8
	Masa Shpërblim demi				1						1	2
3	<i>Njësia Administrative Dhiver</i>				1						8	9
	Masa Organizative										8	8
	Masa Shpërblim demi				1							1
4	<i>Njësia Administrative Mesopotam</i>				1						8	9
	Masa Organizative										8	8
	Masa Shpërblim demi				1							1
5	<b>Bashkia Finiq ( Detyrimet e prapambetura)</b>										1	1
	Masa Organizative										1	1
	Masa Shpërblim demi											
	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>33</b>	<b>39</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Gjatjet sipas fushave të aktivitetit, viti 2019

Ne/numër

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE									Gjithsej	
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve		Të tjera
<b>1</b>	<b>Bashkia Finiq ( Detyrimet e prapambetura)</b>										<b>1</b>	<b>1</b>
	Masa Organizative										1	1
	Masa Shpërblim demi											
<b>2</b>	<b>Bashkia Finiq</b>	<b>31</b>	<b>2</b>		<b>3</b>	<b>2</b>	<b>10</b>				<b>6</b>	<b>54</b>
	Masa Organizative	8	1		3	2	5				4	23
	Masa Shpërblim demi	23	1				5				2	31
<b>3</b>	<b>Shoqëria “Ujësjiellës kanalizime” sha</b>	<b>1</b>	<b>17</b>		<b>1</b>	<b>1</b>					<b>19</b>	<b>39</b>
	Masa Organizative		15		1	1					18	35
	Masa Shpërblim demi	1	2								1	4
	<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>26</b>	<b>94</b>

Formati nr. 1

Pasqyra nr.3. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR VITI 2018, BASHKIA FINIQ

Resh	Referenca e llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
1	A	A K T I V E T	1,730,122,192	1,574,785,233
2		I.Aktivitet Afat shkurtra	318,874,721	372,621,372
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	109,560,256	213,132,893



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Resh	Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	109,560,256	213,132,893
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizjonet zhvlerësimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	19,265,699	15,054,579
12	31	Materiale	2,269,673	1,741,317
13	32	Inventar I imët	16,996,026	13,313,262
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmëri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te tretëve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provizjonet perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arkëtushme	190,048,766	144,433,900
22	411	Klientë e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shendetesore		
29	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
30	44	Institucione te tjera publike		





**KONTROLLI I LARTË I SHITËT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Resh	Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
31	465	Efekte per tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshem	117,876,251	84,956,816
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	72,172,515	59,477,084
34	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te marrëdhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shpërndarë ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II. Aktivët Afat gjata	1,411,247,471	1,202,163,861
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	10,211,123	941,623
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kërkime	10,211,123	941,623
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,401,036,348	1,201,222,238
48	210	Toka, Troje, Terene	300,000	300,000
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	256,513,453	216,884,494
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,051,283,136	924,310,886
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	47,253,831	29,093,576
53	215	Mjete Transporti	25,586,258	11,139,308
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	20,099,670	19,493,974
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Resh	Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	0	0
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		0
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	208,536,598	154,708,535
66		I.Pasivet Afat shkurtra	208,536,598	154,708,535
67		1. Llogari te Pagushme	208,536,598	154,708,535
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	60,238,456	48,734,423
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,592,501	8,746,672
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	623,620	454,731
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	1,545,585	1,383,972
76	436	Sigurime Shendetesore	172,353	157,286
77	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	18,487,832	10,274,635
82	467	Kreditore te ndryshem		
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime	117,876,251	84,956,816
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Resh	Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,521,585,594	1,420,076,698
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,521,585,594	1,420,076,698
98	101	Teprica (Fondi akumul.)/ Defic. I akumuluar	1,430,513,170	1,217,218,440
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	91,072,424	202,858,258
101	111	Rezerva	0	0
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
	15	Shuma te parashiko. per rreziqe e Zhvleresime	0	0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	0	0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	1,730,122,192	1,574,785,233
KONTROLL		Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen	Kuadratura	Kuadratura



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Resh	Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur në lekë	Ushtrimi paraardhës në lekë
Kontroll 1.		Aktivet Neto a janë te barab. me F. Konsolid.	0	0
Kontroll 2.		Totali Aktiv. a është barab. Me Totalin Pasiv.	0	0

**Pasqyra nr. 10. Llog. 466 Ngurtësime. V. 2018**  
**Garanci punimesh viti 2018, llog (466)**

Nr.	Date	U. Shpenz	Objekti i shpenzimit	Debi	Kredi
			GJENDJE 31.12.2017		10,274,685
	12.02.2018		SH.....I		168,224
	16.03.2018		Rikonstruksion I rrugës Fitore Aliko 2.....T		1,747,814
	07.03.2018		Rikonstru. I kanalit VURG-ALIKO K.....I		506,498
	14.05.2018		rikonstruksioni I rrugës Shen Varvara Aliko		157,435
	28.05.2018		rikonstruksioni I rrugës Pllake-Kullurice 2.....T		3,617,350
	17.07.2018	318	Rikonstru. Rrug. Shen Varvara Aliko K.....I		110,315
	23.10.2018	460	cbllokim gar.rikonstr.rrug. fshat Krane F. K.	99,387	0
	23.10.2018	460	cbllokim gar.rikonstr.rrug. fshat Dhrovjan F. K.	148,800	0
	23.10.2018	460	Sistem. kanali kullues Vurg Krane F. K.	74,387	
	05.11.2018	487	rikonstruksion varreza Aliko SH.....I		108,084
	12.11.2018	512	rikualifikim sheshi Livadhja G.....Y shpk		1,123,241
	12.11.2018	513	rruga Dermish Dhiver Cerkovice 4.....M		229,421
	16.11.2018		rikualifikim sheshi Livadhja G.....Y		767,625
	06.12.2018	555	rikualifikim sheshi Livadhja G.....Y		210,096
Shuma				322,574	19,020,788
<b>Gjendja 31/12/18</b>					<b>18,698,214</b>

**Pasqyra nr. 11. Llog. 2015. Inventari kontabël i mjeteve të transportit**

Nr	Emërtimi	Viti i prodhimit	Targa	Vlera kontabël Lekë
1	Autoveture 4+1 Mercedes. Benz	2000	AA ..... CF	2460200



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr	Emërtimi	Viti i prodhimit	Targa	Vlera kontabël Lekë
2	Autoveture 6+1 Land Rover	2000	AA ... CF	1896000
3	Autoveture 4+1 Mitsubishi	1999	AAS ... NR	1498600
4	Autoveture 4+1	1999	DL ... A	1494000
5	Autoveture 5+1	1999	SR ... B	1416000
6	Autoveture		DL...A	600000
7	Motoçikleta Dayang	2008		150000
8	Motoçikleta Dayang	2008		100000
9	Zetor 3 copë			4170200
10	Kamion vetëshkarkues		AA.PA	4999999
11	Vinç me kosh		AA...PA	4836000
12	Eskavator me goma		A..... 38	4985865
13	Autoveturë 8+1		AA.....CM	0
14	Kamion Benz Mercedesedes		SR.....B	0
15	Eskavator me zinxhir			0
16	Eskavator me zinxhir			9055196
17	Eskavator me goma		AA...CF	4872000
18	Kamion Man		AA...RJ	3022584
19	Kamion Mercedesedes Benz		AA...RJ	936000
20	Autoveture 4+1		AA...RJ	2928000
21	Autoveture 4+1		AA...SR	
	<b>Shuma (Vlera historike)</b>			<b>49,420,644</b>
	Amortizimi I llogaritur			4,917,719
	<b>Shuma neto</b>			<b>44,502,925</b>

**Pasqyra Nr. 13. Debitorët 2018. Llog. 468.**

Nr.	Subjekti debitor Juridik/Fizik	Urdher. zhdëmtimi		Vend. Gjyk. Formës Prerë		Fatura		Vlera Lekë	Përmbytja e debisë
		Nr.	Datë	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
1	V. L							2326	





**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr.	Subjekti debitor Juridik/Fizik	Urdher. zhdëmtimi		Vend. Gjyk. Formës Prerë		Fatura		Vlera Lekë	Përmbytja e debisë
		Nr.	Datë	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
2	TH. Z							64,464	
3	V. M.							57,874	
4	S. P.							10,278	
5	A. N.							35,656	
6	S. C.							36,603	
11	LL. P.							70,223	
12	A. K.							74,545	
13	V. SH							45,763	
15	S. J.							76,326	
16	L. I.							77,128	
17	A. R.							31,300	
18	L. SH.							38,003	
20	K. J.							63,442	
21	J. B.							36,382	
22	TH. K.							3,546	
23	K. LL.							100,476	
24	K. LL.							22,970	
25	H. K.							47,768	
26	T. K.							69,264	
27	K. M.							19,860	
29	S. P							52,000	
	<b>TOTALI</b>							<b>1,036,197</b>	



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

**Pasqyra Nr. 14 Gjendja Kreditore llog. 401-408 në fund të vitit 2018.**

Nr	Subjekti	Objekti	Vlera e detyrë. më 1/1/2018	Data e Krijimit	Gjendja dt. 31/12/2018 Lekë
1	M.....S	Ujësjetësi Navarice -Memoraq Dermish	15.913.410	Nr fat. 17 dt. 23/10/2017	15.913.410
3	M.....S	Ujësjetësi Navarice Memoraq Dermish	12.938.400	Fat. Nr. 4 dt. 13/02/2017	12.938.400
3	Z.....T	Mbkyq. obj. riparim, pastrim kanalet ujites	114.000	Nr fat.02 08/1/2018	114.000
4	Z.....T	Mbkyq. punim obj. Rehabil. Pjesor. Ujites "Vurg -Aliko" kanali -K-K2+K	114.000	Nr fat. 67 12/12/2017	114.000
5	T.....T	Kolaudim. Punim. obj. Rehabilitim. Rrg. Dermish Dhiver Cerkovice"	114.000	Nr fat. Nr. 44 dt. 14/07/2017	114.000
6	M.....S	Ujësjetësi Navarice Memoraq Dermish	24.000.000	Nr fat.17 30/11/2018	24.000.000
7	M.....S	Ujësjetësi Navarice Memoraq Dermish	2.370.190	Nr fat.19 18/12/2018	2.370.190
8	K. TH	Mobileri	55.000	Nr fat. 42 27/12/2018	55.000
9	E. D.		99.000	Nr fat. 01 dt. 20/03/2018	99.000
10	DH. P.	Gomisteri	169.300	Nr fat. 43 dt. 28/12/2018	169.300
11	Fatura ujësjetësis		737.610		737.610
12	D. B.	Vlerësim i aseteve te ujësjetësisit	3.613.546	Tetor 2018	3.613.546
		<b>Shuma</b>	<b>60.238.456</b>		<b>60.238.456</b>

**Pasqyra nr. 15. B. Finiq. Vendime Gjyqësore të pa kontabilizuara. V. 2018. Llog. 467**

Nr	Paditësi	Objekti	Nr i Vendimit të Gjykatës Apelit	Mbetur më 31/12/2018. Lekë
1	V. P.	Largim nga puna	Nr 85 dt 21.2.2012	237.000.
2	Il. G.	Largim nga puna	nr 173 dt 10.4.2012	60.400.
3	V. M.	Largim nga puna	nr 1236 dt 24.3.2017	1.011.920
4	E. K./ M. K.	Largim nga puna	Nr. 269 datë 20.03.2018	499,500



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr	Paditësi	Objekti	Nr i Vendimit të Gjykatës Apelit	Mbetur më 31/12/2018. Lekë
5	A. K.	Largim nga puna	Nr. 643 datë 10.11.2015	466,594
6	A. A..	Largim nga puna	Nr. 845 datë 2017	962,779
<b>Totali</b>				<b>3,238,193</b>

**Pasqyra Nr. 16. Analiza e llog 466 ngurtësime v. 2019.**  
**GARANCI PUNIMESH (466), VITI 2019**

Nr.	Date	Urdhër Shpenzim	Objekti i shpenzimit	Debi	Kredi
			GJENDJE 31.12.2018		18,698,214
1	07.02.2019	57	shpenzime per konstruksion e varrezave K.....I		264,997
2	12.02.2019	64	shpenzime per Konstruks. e varrezave SH.....I		79,229
3	12.02.2019	66	Rikonstruksion rruga Fitore Aliko 2.....T		1,612,200
4	18.02.2019	69	situacion nr 1 rruga Karroq -J.....Y		149,980
5	13.05.2019	211	Rehabilitim I rrugëve Bashkia Finiq –A.....I		471,335
6	30.10.2019	417	mirembajtje e rrjeteve ujore-K.....I	174,000	127,448
7	07.11.2019	443	Rehabilitim I rrugëve Bashkia Finiq –A.....I		150,000
8	20.11.2019	454	cbllokim Rikon. Rrg. Shen Varvara -Aliko (K.....I)	395,198	
9	20.11.2019	455	cbllokim Rikonstr. kanalit Vurg-Aliko ( K.....I)	506,499	
<b>Shuma</b>				<b>1075697</b>	<b>2,855,189</b>
<b>Gjendja 31/12/19</b>					<b>20.477.706</b>

**Pasqyra Nr. 17. Gjendja e debitorëve, llog. 468. Viti 2019.**  
**Sipas rekomandimeve nga auditimet e KLSH-së**

Nr.	Subjekti debitor Juridik/Fizik	Urdher. zhdëmtimi		Vend. Gjyk. Formës Prerë		Fatura		Vlera Lekë
		Nr.	Datë	Nr.	Datë	Nr.	Datë	



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr.	Subjekti debitor Juridik/Fizik	Urdher. zhdëmtimi		Vend. Gjyk. Formës Prerë		Fatura		Vlera Lekë
		Nr.	Datë	Nr.	Datë	Nr.	Datë	
1	TH. Z							44,464
2	V. M.							57,874
3	S. P.							10,278
4	A. N.							20,656
5	S. C.							21,603
6	LL. P.							70,223
7	A. K.							74,545
8	V. SH							9,763
9	S. J.							76,326
10	L. I.							77,128
11	A. R.							10,300
12	L. SH.							38,003
13	K. J.							63,442
14	J. B.							36,382
15	TH. K.							3,546
16	K. LL.							64,476
17	K. LL.							22,970
18	H. K.							47,768
19	T. K.							69,264
20	K. M.							19,860
21	S. P							19,000
	<b>TOTALI</b>							<b>863,871</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

**Pasqyra Nr. 18 Llogarite kreditore 401-408 dhe 467. V. 2019**  
**FATURAT E PALIKUJDUARA DERI MË 31.12.2019, LLOG 401 - 408**

Nr	Data	EMËRTIMI	Subjektet	Detyrim. Lekë
40	11.06.2019	Blerje Goma	G.....Y	671,600
41,42	11.06.2019	Blerje Vaj dhe Bateri	G.....Y	779,844
5688	01.11.2019	Depozitim mbetjesh	B. L.	98,056
157	01.12.2019	Karburant	T. V.	4,047,951
83	10.12.2019	Lëvizje e ekskavatorëve	J....Y	246,000
35	22.05.2019	Materiale ndertimi	K.....I	1,542,889
66	21.04.2019	portali tatim paguesve	E. XH.	520,000
65	21.04.2019	Dixhitalizimi I asetëve në pyje dhe kullota	E. XH.	1,788,000
63	14.04.2019	Blerje sistemi faturimit të ujit për ujësjellësin	E. XH.	768,000
21	09.05.2019	situacioni për rrugët	A.....I	2,235,582
7	25.06.2019	Furnizim Bariera Mbrojtëse	S.....C	4,566,840
69	25.09.2019	shpenzime Mirembajtje e shkollave	J.....Y	779,760
67	12.12.2017	Mbyq. punimesh kanal Vurg Aliko K-K2+K-k2/1	Z.....T	114,000
43	14.07.2017	Kolaudim Punimesh Dermish Dhiver Cerkovice	T.....I	114,000
2	08.01.2018	mbyqyrjesisteme kanalet ujites	Z.....T	114,000
41	11.12.2018	Mbikëqyrja e punimeve Pllake-Kullurice	Z.....T	827,820
42	11.12.2018	Mbikëqyrja e punimeve Fitore - Aliko	Z.....T	653,428
40	11.12.2018	Mbikëqyrja e punimeve Rikualifikimi sh Livadhja	Z.....T	568,499
7	03.04.2019	Shpim pusi për ujë në shkollën Livadhja	M. P.	884,340
50	17.05.2019	materiale për ujin në shkollën Livadhja	A. G.	1,346,124
278	15.05.2019	Pajisje elektrike	V.....A	8,577,600
18	15.10.2019	mirembajtje mjeteve transporti	DH. F.	347,000
80	01.11.2019	Sipas kuponit tatimor	K.....S	2,000
1553	28.12.2019	Blerje materiale ndertimi	D.....A	2,676,530
862	18.11.2019	Sherbime ekskavatori I ri	T.....C	151,458





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Nr	Data	EMËRTIMI	Subjektet	Detyrim. Lekë
24	22.12.2019	Lodra per femije parashkollore	F. L.	36,200
32	08.11.2019	Goma	V. M.	34,000
3E+08	2.110.2019	Sherbim Foni dhe Ndricim	P.....D	17,500
125	18.03.2019	Radio Saranda	R. S.	117,000
30	25.11.2019	Ariana Mehilli	F. K.	16,200
55	12.02.2019	Certifik. Mbykq. ob Rr Dermish dhiver cerkov	H.....L	840,000
633	03.12.2019	Kancelari	m.....o	150,960
672	31.10.2019	Tavolina Pune	P. B.	120,000
18	13.12.2019		A. G.	351,228
		Vleresim I ujësjesit (asetet)	D. B.	3,613,546
		<b>Shuma</b>		<b>39,717,954</b>

Nr	Llog	401-408 Kreditore te mbartur	Subjekti	Detyrimet
4	13.02.2017	Ujësjesi Navarice Memorag Dermish	M.....S	12,938,400
17	23.10.2017	Ujësjesi Navarice Memorag Dermish	M.....S	15,913,410
17	30.11.2018	Ujësjesi Navarice Memorag Dermish	M.....S	24,000,000
19	18.12.2018	Ujësjesi Navarice Memorag Dermish	M.....S	2,370,190
		<b>Shuma</b>		<b>55,222,000</b>
507	20.05.2018	Punime situacioni pllake kullurice	2.....T	24,113,410
508	20.05.2019	Punime situacioni pllake kullurice	2.....T	2,000,897
	Difer. fatur	Rruga Dermish Dhiver Cerkovice		509,439
		<b>Shuma</b>		<b>26,623,746</b>

	Llog.	467	Subjekti	Lekë
592	31.12.2019	Letra zyrtare	P.....A	121,035
		Dety. Per Auditim e brendsh	Bashkia Dropull	1,572,735
377	24.12.2019	oponence teknike	I.....m Tir	282,295



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

	Llog.	467	Subjekti	Lekë
Nr. 13960 dt. 12.12.2019		Drejt. pergjithsh e arkivave	Drejt. Pergj. e arkivav	1,600
1036	16.12.2019	Linja e internetit	B. K.	120,000
		energji muaji nentor	Energjia	7,459,547
		vendime gjykate	Vendime Gjykate	1,300,371
		Programeve te BE	TVSH	1,774,446
110	13.12.2019	Aktivite te Kulturore	V. Z.	77,750
111	22.12.2019	Aktivite te Kulturore	V. Z.	188,750
		<b>Shuma</b>		<b>12,898,529</b>

**Evidenca përmbledhëse e realizimit të detyrave të rekomanduara (Formulari nr. 12)**

Nr.	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :						Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike (duke vendosur dhe vlerën e gjobave)													
		Rekomandime gjithsej në numër	Paparuar	Pranuar	Nga te pranuarat janë			Rekomanduar Gjithsej		Nuk Pranohen		Jane Pranuar		Nga rekomandimet e pranuarat janë:							
					Zbatuar pjesërisht	Zbatuar në numër	Në proces	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Zbatuar pjesërisht	Zbatuar	Në proces zbatimi (jane kontabilizuar)		Në proces gjyqësor, civiapo pena			
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	18	19	20	22
I.	Në fushën e legjislacionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
1	Shfuqizim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Përmirësim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
II.	Masa Organizative (Gjithsej, Ne numër dhe vlere)	18		18	6	4	7	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “BASHKINË FINIQ”

Nr.	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :						Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike (duke vendosur dhe vlerën e gjobave)													
		Rekomandime gjithsej në numër	Papruar	Pranuar	Nga te pranuarat janë			Rekomanduar Gjithsej		Nuk Pranohen		Jane Pranuar		Nga rekomandimet e pranuarat janë:							
					Zbatuar pjesërisht	Zbatuar në numër	Në proces	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Zbatuar pjesërisht		Zbatuar		Në proces zbatimi (jane kontabilizuar)		Në proces gjyqësor, civiapo pena	
														Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë	Nr. pers	Në mijë/1 ekë
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	18	19	20	22
III.	Masa Shpërbllim Demi (Nga te cilat nuk jane kontabilizuar, ne Finance)	18	3	15	6	0	9	37	53,582	9	24,854	28	28,728	3	476	-	-	12	24,378	9	24,854
IV.	MASA DISIPLINORE (Nga te cilat nuk jane nxjerrë urdhrat, vendimi përkatës)	14	14	0	14	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
V.	Masa Administrative Nga të cilat:	19	-	19	-	-	19	19	1,970	-	-	19	1,970	-	-	-	-	-	-	19	1,970
	a. Gjobat e Inspektorateve (Nga te cilat nuk jane kontabilizuar ne Financë)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	b. Gjobat e APP (Nga të cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)	19	-	19	-	-	17	17	1,970	-	-	19	1,970	-	-	-	-	-	-	19	1,970
	-Pa përgjigje nga APP	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VI	c. Dhe të tjera masa nëse ka. -Heqje Licence, profesionale -Përrjashtim nga pjesëmarrja ne tendera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI:</b>		<b>69</b>	<b>17</b>	<b>52</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>35</b>	<b>56</b>	<b>55,552</b>	<b>9</b>	<b>24,854</b>	<b>47</b>	<b>30,698</b>	<b>3</b>	<b>476</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>24,378</b>	<b>28</b>	<b>26,824</b>

Aneksi E/1.2



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË FINIQ”**

Aneksi E/1.4

**PASQYRA E PENALITETEVE NGA APP (MASA ADMINISTRATIVE)**

Nr. Rekom	Emri Punonjësit	Gjoha	Pranuar
1	TH. Z	300,000	300,000
	L. K	200,000	200,000
2	I. E.	160,000	160,000
3	L. M	50,000	50,000
4	G. K	55,000	55,000
5	E. Gj.	80,000	80,000
6	TH. Z	300,000	300,000
7	M. L	60,000	60,000
8	S. J	70,000	70,000
9	F. TH	120,000	120,000
10	F. S.	55,000	55,000
11	V. L	100,000	100,000
12	E. P.	140,000	140,000
13	A. D.	140,000	140,000
14	S. C.	150,000	150,000
15	V. C.	180,000	180,000
16	L. D.	130,000	130,000
17	V. A.	90,000	90,000
18	A. A.	80,000	80,000
19	A. B.	30,000	30,000
<b>SHUMA</b>		<b>2,190,000</b>	<b>2,190,000</b>